



RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI
“AUDITIMIN FINANCIAR DHE I PËRPUTHSHMËRISË

“BASHKIA LEZHË”

Tiranë, Prill 2024

 PËRMBAJTJA

| | |
|---|------------|
| I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE | 4 |
| 1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit | 4 |
| 2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve | 4 |
| 3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit | 6 |
| II. HYRJA | 8 |
| 1. Objektivat e auditimit..... | 9 |
| 2. Qëllimi i auditimit..... | 9 |
| 3. Identifikimi i çështjes | 9 |
| 4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese | 10 |
| 5. Përgjegjësitë e audituesve | 10 |
| 6. Kriteret e vlerësimit | 10 |
| 7. Standardet e auditimit | 11 |
| 8. Metodologjia e auditimit | 11 |
| 9. Dokumentimi i auditimit | 12 |
| III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT | 13 |
| 1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin | 13 |
| 2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit | 13 |
| 2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik | 13 |
| 2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit. | 29 |
| 2.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, për vitin 2022 | 69 |
| 2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik | 80 |
| 2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike. | 120 |
| 2.5 Mbi organizimin, funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit | 134 |
| 2.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit | 146 |
| IV. GJETJE DHE REKOMANDIME | 146 |
| V. ANEKSET | 165 |

Lista e shkurtimeve

| | |
|---------|---|
| KLSH | Kontrolli i Lartë i Shtetit |
| MFE | Ministria e Financave dhe Ekonomisë |
| MFK | Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli |
| NA | Nëpunës Autorizues |
| NZ | Nëpunës Zbatues |
| GMS | Grupi i Menaxhimit Strategjik |
| NJAB | Njësia e Auditimit të Brendshëm |
| AB | Auditi i Brendshëm |
| MAB | Manuali i Auditimit të Brendshëm |
| FZHR | Fondi i Zhvillimit të Rajoneve |
| AQT | Aktive të Qëndrueshme të Trupëzuara |
| UMF | Udhëzim i Ministrisë së Financave |
| VKM | Vendim i Këshillit të Ministrave |
| VKB | Vendim i Këshillit Bashkiak |
| ASHK | Agjencia Shtetërore e Kadastrës |
| NJA | Njësi Administrative |
| SHA | Shoqëri Anonime |
| NJP | Njësia e Prokurimit |
| BOE | Bashkim i Operatorëve Ekonomikë |
| OE | Operator Ekonomik |
| KVO | Komisioni i Vlerësimit të Ofertave |
| ISSAI | Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit |
| INTOSAI | Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit |
| IFAC | Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve |
| IPSAS | Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik |
| AKB | Agjencia Kombëtare e Bregdetit |

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Përshkrim i shkurtër i projektit të auditimit

Departamenti i Auditimit të Vetëqeverisjes Vendore në Kontrollin e Lartë të Shtetit, në zbatim të planit vjetor të auditimeve kreu auditimin financiar dhe të përputhshmërisë me objektiv vlerësimin e veprimtarisë së Bashkisë Lezhë, për aktivitetin ekonomik dhe financiar, prokurimet publike, investimet publike, planifikimi dhe zhvillimi i territorit, etj. Auditimi mbuloi periudhën nga data 01.01.2022 deri në datën 31.12.2022. Auditimi është kryer duke mbajtur në konsideratë Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (ISSAI), Manualin e auditimit financiar të KLSH-së, Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë, Rregulloren e Procedurave të Auditimit të KLSH-së, Kodin e Etikës, si dhe praktikat më të mira audituese të fushës.

Auditimi u fokusua në përmbushjen e detyrave dhe përgjegjësi kryesore nga Bashkia Lezhë si planifikimi, hartimi dhe realizimi i zërave të shpenzimeve buxhetore, realizimi dhe përdorimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifave vendore, auditim me zgjedhje i transaksioneve financiare nëse janë në përputhje me kërkesat ligjore, mbajtjen e evidencës kontabël, zbatimin e dispozitave ligjore në fushën e procedurave të prokurimit publik, planifikimi dhe zhvillimi i territorit etj.

Në mënyrë të përmbledhur nga auditimi rezultoi se:

- Në Bashkinë Lezhë funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

- Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 740,000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 438,851 mijë lekë ose 59%. Nga auditimi rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar, nga Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore nuk është hartuar regjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.

- Debia progresive sipas njësive administrative deri më datë 31.12.2021 rezulton për 3,595 subjekte në vlerën 242,692,897 lekë. Debia krijuar brenda vitit 2022 rezulton për 23 subjekte në vlerën 3,648,941 lekë. Debia progresive më 31.12.2022 rezulton për 3,572 subjekte në vlerën 246,341,820 lekë.

- Në zbatimin e punimeve civile të kontratave rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 3,776,085 lekë.

- Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 6 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit, apo të paargumentuara teknikisht dhe në 4 raste, në vlerën totale të fondit limit prej 139,427,639 lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST.

2. Përshkrim i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

| Nr. | Përmbledhje e gjetjeve | Rëndësi a | Rekomandimi |
|-----|---|--------------|---|
| 1 | - Në Bashkinë Lezhë funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 10296, datë | E lartë | Nga Titullari i Bashkisë Lezhë, me atributet e Nëpunësit Autorizues, të marrë masa për njohjen nga stafi i ligjit për MFK dhe komponentëve të tij, për hartimin dhe miratimin e një strategjie të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve |

| | | | |
|---|---|---------|--|
| | 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. | | që mund të kenë impakt në arritjen e objektivave të institucionit. |
| 2 | Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lartë. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”. | E lartë | Nga NJAB të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB. Në raportet e auditimit të kryhen teste substanciale dhe analitike, në mënyrë që në fushat me risk të lartë auditimet të jenë të thelluara, duke evidentuar mangësitë e sistemeve të kontrollit nëpërmjet formulimit të qartë të gjetjeve. |
| 3 | Niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet jo të mira në vitin 2022, konkretisht në masën 72.2 %. Kjo gjendje vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Lezhë në fillim të vitit buxhetor planifikon procedurë të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. | E lartë | Kryetari i Bashkisë Lezhë dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre. |
| 4 | Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2021 detyrimi i prapambetur është në vlerën 1,022,164 lekë. Për vitin 2022 nuk është parashikuar likudimi i detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore. | E lartë | Titullari i Bashkisë Lezhë, në rolin e Nëpunësit Autorizues në bashkëpunim me Nëpunësin Zbatues, të marrë masat e nevojshme që gjatë hartimit të kërkesave buxhetore (PBA dhe buxhet vjetor) të planifikojë mënyrën dhe kronologjinë e likuidimit të detyrimeve të prapambetura, si dhe respektimin gjatë zbatimit të buxhetit. |
| 5 | Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 740,000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 438,851 mijë lekë ose 59%. Nga auditimi rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar, nga Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore nuk është hartuar regjistri i taksapaguesve privat dhe familjar. | E lartë | Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Bashkia Lezhë të hartojë një plan të mirë studiuar, mbështetur mbi numrin e taksapaguesve, llojit të taksave dhe tarifave, si dhe vlerës së secilës prej tyre. Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Taksave dhe e Tarifave Bashkia Lezhë të hartohet regjistri i taksave. |
| 6 | -Debia progresive sipas njësive administrative deri më datë 31.12.2021 rezulton për 3,595 subjekte në vlerën 242,692,897 lekë. - Debia krijuar brenda vitit 2022 rezulton për 23 subjekte në vlerën 3,648,941 lekë. -Debia progresive më 31.12.2022 rezulton për 3,572 subjekte në vlerën 246,341,820 lekë. Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore për vitin 2022, ka marrë masa vetëm lidhur me “Njoftim dhe kërkesë për pagesë debie” dhe “Bllokimi i llogarive bankare” si rezultat i masave të marra është mbledhur borxhi për vlerën 16,564,420 lekë. Nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal. | E lartë | Drejtoria e të Ardhurave të marrë masa për identifikimin e subjekteve që ushtrojnë aktivitet në territorin administrativ të Bashkisë Lezhë, me qëllim përditësimin e regjistrit të taksave dhe tarifave për bizneset, si dhe në vijim nxjerrjen e njoftim vlerësimit tatimor për debitorët, duke ndjekur të gjitha rrugët (bllokimi i llogarive bankare, njoftim të Drejtorisë Rajonale të Transportit për vendosje të barrës sigurose për mjetet dhe në ASHK për pasuritë e paluajtshme, etj) për arkëtimin e taksave dhe tarifave vendore, në vlerën 246,341,820 lekë. |
| 7 | Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2022 është në vlerën 923,488,685 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 512,259,280.90 lekë, pra me një rënie të vlerës së debitorëve të Bashkisë Lezhë në vlerën 411,229,404 lekë. | E lartë | Drejtoria e Financës Bashkia Lezhë, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.470 “Të ardhura për t’u marrë”. |
| 8 | Për vitin 2022 nuk rezulton të jetë kryer inventarizimi i të gjithë pasurive (kryesisht trojet, pyjet, kullotat) të cilat janë në pronësi të Bashkisë Lezhë. Nga 4473 pasuri në pronësi të Bashkisë Lezhë, rreth 441 / 10% prej tyre janë regjistruar në kadastër dhe janë pajisur me certifikatë pronësie | E mesme | Kryetari i Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me Drejtorin e Financës të planifikojë në buxhet një fond të detajuar për kryerjen e verifikimit fizik dhe vlerësimin me vlerë financiare të sipërfaqeve të pyjeve, kullotave dhe plantacioneve nga ekspertë vlerësues të licencuar. |
| 9 | Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit publik për | E | Kryetari i Bashkisë Lezhë, në cilësinë e Titullarit |

| | | | |
|----|---|---------|---|
| | periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 6 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit, apo të paargumentuara teknikisht, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. | mesme | të Autoritetit Kontraktor, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet. |
| 10 | Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, u konstatua se në 4 raste, në vlerën totale të fondit limit prej 139,427,639 lekë, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes së kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. | E mesme | Kryetari i Bashkisë Lezhë, në cilësinë e Titullarit të AK, të analizojë arsyet e kualifikimit të padrejtë të operatorëve ekonomikë dhe të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, të vlerësohen objektivisht kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës. |
| 11 | Nga auditimi i 6 (gjashtë) kontratave për punë publike për periudhën e auditimit në vlerën totale 866,263,599 lekë pa TVSH, u konstatua se: Në 6 (raste) raste, rezultuan zëra pune të pakryera në volumet e situacionuara si dhe, punime të realizuara jo në përputhje me specifikimet teknike në vlerën 3,776,085 lekë pa TVSH, në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, si dhe Kontratat përkatëse të zbatimit. | E lartë | Titullari i Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën 3,776,085 lekë pa TVSh nga gjashtë shoqëritë zbatuese, si pasojë e realizimit të punimeve të kryera jo në përputhje me Specifikimet Teknik dhe kosto më të vogël se çmimi ofertues. |

3. Konkluzioni i Përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit

OPINIONI I AUDITIMIT

Opinion i modifikuar me rezervë mbi pasqyrat financiare.

Për drejtimin e Bashkisë Lezhë:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Lezhë për vitin ushtrimor 2022, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705, dhe ISSAI 1200¹, pasi kemi marrë evidencat dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një opinion të modifikuar me rezervë për llogaritë vjetore të subjektit Bashkia Lezhë, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, të cilat janë të shprehura në bazën për opinionin.

¹ Objektivi i audituesit është të formulojë një opinion mbi besueshmërinë e llogarive vjetore dhe llogarive bazuar në një vlerësim të përfundimeve të hartuara nga evidencat e marra të auditimit dhe të shprehë qartë opinionin nëpërmjet një raporti të shkruar që shpjegon bazat e opinionit. Objektivi i audituesit është të ofrojë siguri të arsyeshme nëse pasqyrat si një e tërë nuk përmbajnë anomali materiale, raste mashtrimi ose gabime, si edhe të raportojë mbi këto pasqyra përsa i takon gjetjeve nga auditimi.

Opinionit:

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjeve të përshkruara në paragrafin e “Bazës për Opinionin me rezervë”², pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozitën financiare Bashkisë Lezhë më 31 dhjetor 2022, referuar Udhëzimit të MFE nr.5, datë 21.02.2022 për disa ndryshime në Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes e raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njëjësive të Qeverisjes së Përgjithshme” mbi të cilat subjekti i audituar është mbështetur për përgatitjen e pasqyrave financiare.

Baza për Opinionin:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen përgjegjësitë e audituesit për pasqyrat financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Lezhë, në përputhje me kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme³ për të dhënë një bazë për opinionin tonë⁴.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin gabime materiale, por jo të përhapura, të cilat sipas gjykimit tonë, kanë efekt në rezultatin financiar të Bashkisë Lezhë. Për këto arsye kemi dhënë opinionin me rezervë, sipas shpjegimeve në paragrafin e mëposhtëm:

Përshkrimi i çështjeve kryesore⁵:

- Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, është pasqyruar më pak për vlerën 60,565,959 lekë;
- Llogaria nr.466 “Kreditorë për mjete në ruajtje”, është pasqyruar më shumë për vlerën 21,331,952 lekë;
- Llogaria nr.520 “Disponibilitete në thesar”, është pasqyruar më pak për vlerën 2,301,850 lekë;
- Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, është pasqyruar më pak për vlerën 3,071,000 lekë;
- Llogaria nr.467 “Kreditor të tjerë” është pasqyruar më pak për vlerën 5,082,537 lekë;
- Llogaria nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është pasqyruar më shumë për vlerën 512,259,280 lekë.

II. Opinionin mbi përputhshmërinë.

Ne audituam përputhshmërinë e veprimtarisë së Bashkisë Lezhë, sa i takon shkallës së zbatueshmërisë së rregullave, ligjeve dhe rregulloreve, politikave dhe marrëveshjeve që lidhen dhe ndikojnë në përdorimin e fondeve/burimeve, gjatë ushtrimit të aktivitetit përkatës për periudhën 01.01.2022-31.12.2022.

Në opinionin tonë, bazuar në evidencat e auditimit dhe në dokumentacionin e vënë në dispozicion, kemi konstatuar se në veprimtarinë e Bashkisë Lezhë, janë evidentuar devijime nga kuadri ligjor dhe rregullator në fuqi, të përshkruara në paragrafin “Baza për Opinionin”, të cilat nën gjykimin profesional të audituesit të pavarur janë materiale por jo të përhapura dhe justifikojnë dhënien e një opinionit të modifikuar për përputhshmërinë.

Baza për dhënien e opinionit të modifikuar:

Opinionin e dhënë e mbështesim në anomalitë e konstatuara, si më poshtë:

- Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 6 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e

² SNA 705

³ SNA 500

⁴ SNA 700

⁵ SNA 701

kritereve për kualifikim dhe në 4 raste, kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërbushjes së kritereve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST;

- Nga auditimi i zbatimit të kontratave në 6 objekte, rezultoi dëm ekonomik në vlerën 3,776,085 lekë, si rezultat i diferencave në volume pune;

- Detyrimi nga mos pagesa e autorizimit për subjektet që tregëtojnë hidrokarbure është në vlerën 2,400,000 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë.

- Detyrimeve për taksat dhe tarifatat vendore në vlerën 246,341,820 lekë;

- Mos taksim i plotë i kategorisë taksapaguese “Familje”, për tarifatat e ndriçimit, gjelbërimit dhe arsimit për vitin 2022, në vlerën 7,675,258 lekë;

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Bashkisë Lezhë

Strukturat drejtuese të subjektit Bashkia Lezhë, Nëpunësi Autorizues dhe Zbatues, janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator të fushës.

Drejtimi është gjithashtu përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikën, ligjet dhe rregulloret e miratuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar dhe realizimit të të ardhurave nga taksat e tarifatat vendore, planifikimin dhe realizimin e buxhetit, për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH

Objekti i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse pasqyrat financiare në tërësi, nuk paraqesin anomali materiale, kështu si pasaktësi apo gabime që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin një opinion. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin profesional në punën audituese. Këto standarde kërkojnë që ne t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme, për faktin nëse Pasqyrat Financiare, nuk kanë gabime materiale, qoftë nga mashtrimi ose gabimi. Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin e pasqyrave financiare të periudhës aktuale të cilat i përshkruajmë në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit⁶.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, në zbatim të programit të auditimit nr. 765/1 Prot., datë 13.09.2023, i ndryshuar, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 14.09.2023, deri më 10.11.2023, në institucionin Bashkia Lezhë u krye auditimi “Financiar dhe i Përputhshmërisë”. Auditimi mbuloi periudhën prej datës 01.01.2022 deri me datën 31.12.2022.

⁶ Objekti i audituesit është të hartojë dhe kryej ato procedura auditimi që ju japin mundësi të sigurojë evidencën e auditimit e cila duhet të jetë e mjaftueshme, përkatëse dhe e besueshme (ISSAI 1500, ISA 300).

Auditimi u krye nga grupi i auditimit me përbërje:

1. A.Z (Përgjegjës grupi)
2. S.M, anëtar
3. A.Ç, anëtare
4. S.D, anëtar
5. A.D, anëtar
6. B.Z, Anëtar me autorizim,
7. G.J.P, Anëtar me autorizim

1. Objektivat e auditimit

Auditimi financiar dhe i përputhshmërisë në Bashkinë Lezhë kishte si objektiva kryesore:

-Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjor e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

-Vlerësimin e zbatimit të kuadrin ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)⁷;

-Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimit të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 1700;

-Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mbështetur mbi evidenca të besueshme, të mjaftueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objektivi i auditimit financiar në Bashkinë Lezhë është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar, kjo referuar kuadrin ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të pavarur, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Lezhë dhe përgjegjësisë, që burojnë nga kuadri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbim të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

- Auditim mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe auditin e brendshëm.
- Auditim mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, burimi i krijimi të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
- Auditim mbi vlerësimin e raportimit financiar, për të arritur në opinionin në se pasqyrat financiare për vitin 2022, japin një paraqitje të vërtetë e të drejtë të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë, bazuar në kuadrin rregullator në fuqi.
- Auditim mbi planifikimin, realizimin, zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike për periudhën nga data 01.01.2021, deri më 31.12.2022.
- Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

⁷Në zbatim të përcaktimeve të Manualit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

- Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Mbrojtjes së Territorit të Njësisë Vendore (IMTV).
- Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Lezhë, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiarë në përputhje me ligjin për kontabilitetin. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin e prokurimeve së bashku me aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, etj.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare dhe përputhshmërinë e zbatimit të procedurave të prokurimit dhe zbatimit të kontratave në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që audituesi të respektojë kërkesat etike, të planifikojë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mbështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Lezhë është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërbyer si bazë për burimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Lezhë. Burimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014, “Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
- Ligji nr. 139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar;
- Ligji nr. 88/2019, datë 18.12.2019, “Për buxhetin e vitit 2020” i ndryshuar;
- Ligji nr. 137/2020, datë 16.11.2020, “Për buxhetin e vitit 2021” i ndryshuar;
- Ligji nr. 9780, datë 06.07.2007, “Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” i ndryshuar;
- Ligji nr. 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”;
- Ligji nr. 10279, datë 20.5.2010, “Për kundërvajtjet administrative”;
- Ligji nr. 9643, datë 20.11.2016, “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar;
- Ligji nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”;
- VKM nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”;
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006, “Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël”;
- VKM nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017;
- VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”;
- VKM nr.165, datë 02.03.2016, “Për grupimin e njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civilë e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar;
- Udhëzimi i MFE nr. 5, datë 27.12.2014, “Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura”;
- Udhëzimi MFE nr. 21, datë 25.10.2016, “Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve”;

- Udhëzim i MFE nr. 23, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.
- Udhëzimi i MFE nr. 10, datë 28.02.2020, "Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm vendor 2021-2023".
- Udhëzimin i MFE nr. 22, datë 30.07.2018, “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore”;
- Udhëzimi i MF nr. 8, datë 09.03.2018, “Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit e të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2011, “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar;
- Etj.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e auditimit financiar dhe të përputhshmërisë në Bashkinë Lezhë grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë:

- ISSAI 100 “Parimet themelore të auditimit të sektorit publik;
- ISSAI 400 “Parimet themelore të auditimit të përputhshmërisë”, që përcakton parimet themelore të ISSAI-t 100 dhe i zhvillon më tej ato duke i përshtatur me kontekstin specifik të auditimit të përputhshmërisë;
- ISSAI 4000 “Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë”; si dhe ISSAI 4200;
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontabilistëve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik:

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por midis regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë sintetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbartjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohemi nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogaritë përkatëse, që përfundojnë me nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim (*Ditari i kontabilizimit të urdhër shpenzimeve*).

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese:

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ai mund të jetë i gabuar, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me realitetin. Kontrolli me zgjedhje të pjesëve justifikuese (*Urdhër shpenzimeve*), konstatoi nëse shifrat e kaluara kanë pasur justifikim të mjaftueshëm dokumentar në bazë të Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011, “Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i ndryshuar.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese:

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaminoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse, por probleme u konstatuan mbi ekzistencën reale të aktiveve në subjekt. Gjithashtu, u krye mbikëqyrje fizike e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit:

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmim nga të tretët:

Transaksionet e përzgjedhura për t’ju nënshtruar testeve të detajeve, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga Thesari dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi:

Përdorimi i treguesve statistikorë me qëllim që të kërkohen fakte ose të dhëna “*jashtë normales*”, që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mungesa e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shumta të shifrave, etj.,.

7. Intervistimi:

U kryen intervista me specialistët e Bashkisë Lezhë me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raporte dhe Informacione:

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale⁸.

Sa më sipër grupi i auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar te përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimi profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogarisë, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogarisë të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përlllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm. Gjatë kryerjes së testeve të kontrollit është arritur në përfundimin që sistemet e kontrollit të brendshëm paraqesin risk të moderuar deri të lartë.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Kemi ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjekti për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtruar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Gjatë vlerësimeve u mbështetëm në Modelin e Riskut që KLSH-ja aplikon⁹.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionin financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistra/ditarë/partitarë, ose ne trajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e limituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur, dhe së fundi *kërkimi* që konsiston në kërkimin e informacionit te personat kompetent dhe të mirinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i mjaftueshëm për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullator, rezultatet

⁸ ISSAI 1315

⁹ Risku i Auditimit = Risku i qenësishëm * Risku i kontrollit * Risku i Zbulimit

e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. PËRSHKRIMI I AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Të dhëna të përgjithshme dhe pozicioni gjeografik:

Lezha kufizohet në veri me Bashkitë e Vaut të Dejës dhe Pukës, në perëndim me Detin Adriatik, në lindje me Bashkinë e Mirditës dhe në jug me Bashkinë Kurbin. Qendra e kësaj bashkie është qyteti i Lezhës.

Popullsia: Sipas Censurit të vitit 2011, Lezha ka 65,633 banorë. Ndërkohë që sipas Regjistrimit Civil, kjo bashki numëron 106,245 banorë. Me një sipërfaqe prej 509.1 km², bashkia e re e Lezhës ka një densitet prej 208.69 banorë/km² sipas të dhënave të Regjistrimit Civil dhe 128.91 banorë/km² sipas Censurit 2011.

Të dhëna të tjera: Bashkia e Lezhës shtrihet në pjesën dërrmuese të vet në një zonë të ulët dhe bregdetare, me lartësi 5 metra mbi nivelin e detit. Trashëgimia e pasur historike dhe kulturore e bën këtë bashki një destinacion tërheqës për turizmin kulturor. E shtrirë në të dy anët e lumit Drin, e rrethuar nga lagunat Kunë e Vain si dhe nga plazhi i bukur i Shëngjinit, Lezha ofron bukuri natyrore të larmishme dhe mundësi të shumta për zhvillimin e turizmit jo vetëm brenda territorit të saj, por edhe në një distancë të afërt. Aktualisht, ekonomia në qytet është e diversifikuar, por mbështetet në tregti dhe shërbime, sektorë që punësojnë numrin më të madh të banorëve të Lezhës. Ndërtimi i Parkut të Biznesit në pjesën veriore të qytetit pritet të nxisë përqendrimin e bizneseve vendore dhe rajonale në këtë qytet.

Pozicioni i favorshëm gjeografik mundëson akses në të mirat bujqësore, të agrikulturës, blegtorisë dhe peshkimit, të cilat ndikojnë gjithashtu në potencialin ekonomik dhe rritjen e punësimit në Bashki. Bashkia e re do të ketë në territorin e saj qytetin e Shëngjinit dhe një vijë të gjatë bregdetare, e cila fillon nga rezervatet natyrore të mbrojtura të Bregut të Matit dhe të Kune-Vain-Tales deri te plazhet shkëmbore në veri të qytetit të Shëngjinit.

2. Përshkrimi rezultateve sipas drejtimeve të auditimit

2.1 Mbi kontrollin e brendshëm financiar publik

Ky auditim u krye në zbatim të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, ndryshuar, si aktet ligjore e nënligjore dalë në zbatim të tij, për të vlerësuar nëse sistemi i drejtimit, politikat, procedurat, veprimtaritë dhe kontrollet, kanë ndikuar që planifikimi dhe përdorimi i burimeve financiare, kanë bërë të mundur ofrimin me efikasitet dhe efektshmëri të shërbimeve publike, si dhe si ka ndikuar në adresimin e risqeve, për të dhënë garanci të mjaftueshme se objektivat e njesisë publike do të arrihen nëpërmjet:

- pajtueshmërisë me legjislacionin dhe me aktet e brendshme e kontratat;
- informacioneve operative e financiare të besueshme e të plota;
- mbrojtjes së informacionit e të aktiveve.

Mbështetur në vetëvlerësimin e bërë nga ana e Bashkisë Lezhë, si dhe referuar përgjigjeve të pyetësorit, më poshtë rendisim punën e bërë nga ky institucion, si dhe mangësitë e konstatuara në plotësimin e kërkesave që kërkojnë komponentët në drejtim të funksionimit me përgjegjshmëri menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit dhe përdorimit me efektivitet të fondeve të tij.

Në lidhje me vlerësimin e komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit rezultoi se:

I. Komponenti “Mjedisi i kontrollit”:

Në lidhje me parimin 1 “Angazhimin për integritet dhe vlerat etike”

- Bashkia Lezhë ka miratuar Rregulloren e Brendshme të Bashkisë me Vendimin nr. 393 prot., datë 11.09.2018 ,të Kryetarit të Bashkisë . Njohjen e stafit me rregulloret dhe bazën ligjore në fuqi kryhet në mënyrë manuale dhe elektronike sipas fushës dhe strukturave përkatëse nga Drejtoria Juridike, por nuk ka trajnime për këto raste.

-Bashkia Lezhë nuk ka Kod të Etikës, por në nenin 27 e në vijim të Rregullores së Brendshme të kësaj Bashkie , është përfshirë edhe “ Etika për punonjësit e Bashkisë Lezhë dhe kodi i veshjes “.

Në lidhje me parimin 2 “Titullari demonstroi pavarësi dhe përgjegjshmëri në ushtrimin e përgjegjësisë për mbikëqyrje”.

-Procedurat e institucionit për ushtrimin e përgjegjësisë mbikëqyrëse që përcaktojnë rolin dhe fushëveprimin e NA dhe të stafit menaxherial janë përcaktuar që në rregulloren e brendshme dhe veprohet në bazë tij.

- Nga drejtoritë ka raporte periodike , mujore , për realizimin e të ardhurave të veta të Bashkisë Lezhë me format të miratuar me Drejtorinë e Tatim Taksave apo Drejtorinë Ekonomike me marrëdhëniet me Degën e Thesarit .

-Ka raporte monitorimi periodik dhe vjetor për buxhetin vjetor pranë Këshillit Bashkiak dhe NA si dhe në MFE.

-Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuuese, kur shfaqen mangësi në sistemin e kontrollit të brendshëm. Nga njësitë e varësisë nuk ka raporte për performancën e përmbushjes së detyrave gjatë ushtrimit të veprimtarisë, por ka akt rakordime për realizimin e shpenzimeve gjatë muajve.

- Në bazë të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” nenin 19 dhe 29, dhe shkresave përkatëse të Ministrisë së Financave nga Bashkia është plotësuar dhe dërguar pranë Njësisë Qendrore të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit pranë Ministrisë së Financave“ Pyetësori i vetëvlerësimit për funksionimin e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe raporti vjetor mbi funksionimin e sistemit të kontrollit të brendshëm ” për vitin 2022 me shkresën nr. 2375 prot, datë 24.02.2023, për vitin 2022 është dërguar në ministrinë e financave raporti vjetor mbi sistemin e kontrollit të brendshëm dhe pyetësori i vetëvlerësimit, gjithashtu është nënshkruar dhe deklarata e cilësisë. Titullari i Institucionit merr opinione për performancën e institucionit nga institucione të pavarura si KLSH nëpërmjet raporteve të auditimit, nga Auditimi i Brendshëm nëpërmjet veprimtarisë së audituesve si dhe nga Projekti i Bashkive të Forta.

-Këshilli bashkiak me kompetencat e tij nëpërmjet vendim-marrjes ushtron përgjegjësitë e mbikëqyrjes dhe kontrollit të veprimtarisë së bashkisë.

Në lidhje me parimin 3 “Titullari/NA krijon strukturat organizative, linjat e raportimit, autoritetet dhe përgjegjësitë”

- Në dokumentet e PBA-ve ka miratuar strategjinë me objektivat dhe prioritetet strategjike në përputhje me ligjin organik të buxhetit, të cilat janë dërguar pranë MFE me shkresat përkatëse.

- Sipas kontakteve të bëra me menaxhimin dhe pyetësorëve, në hartimin e planit strategjik, nuk rezultojnë se janë organizuar takime me palët e treta si me grupet e interesit nëpërmjet dëgjësive me publikun.

- Bashkia Lezhë për periudhën objekt auditimi ka hartuar dhe ka funksionuar me një rregullore të brendshme në përshtatje me strukturën organike, me vendimin nr. 101 , datë 11.09.2018 të Kryetarit të Bashkisë Lezhë e cila aktualisht është në fuqi. - Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet deri me njëfarë mase me ndryshimet e strukturave organike, pasi mungojnë detyrat dhe përgjegjësitë e Strukturës së Drejtorisë së Zhvillimit Ekonomik dhe Turizmit, të strukturave për funksione të deleguara të atashuar si Sektori i Shërbimit të

Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin, (MZSH-së), sektorë këta të cilat nuk janë përfshirë në Rregullore.

Informimi i stafit me rregulloren e re është bërë me adresën zyrtare të emali- it për stafin dhe drejtoritë dhe nuk ka urdhër të veçantë të Kryetarit së Bashkisë. Rregullorja e brendshme i përgjigjet dhe përputhet me ndryshimet e strukturave organike.

-Mungon plani strategjik për monitorimin dhe arritjen e objektivave, në të cilën duhet të përfshiheshin aktivitetet, plan veprimet për arritjen e qëllimeve strategjike, duke përcaktuar dhe afatet përkatëse dhe sektorët me personat përgjegjës.

- Për periudhën objekt auditimi është miratuar struktura organizative në përputhje me madhësinë dhe aktivitetet e Bashkisë. Kështu: *Për vitin 2022 struktura është miratuar me Vendim të Titullarit nr. 68 prot ., datë 21.01.2022 , me 768 punonjës bashke me institucionet e varësisë dhe funksioneve të deleguara.*

- Në Rregulloren e Brendshme janë për çdo Drejtori misioni, objektivat, baza ligjore, përbërja e strukturës, detyrat dhe përgjegjësitë për çdo drejtori, sektor dhe specialist. Ndërsa në dosjet e personelit janë vendosur përshkrimet e punës për çdo pozicion, por jo objektivat për secilin punonjës,

- Bashkia Lezhë ka linkun dhe faqen e saj zyrtare në internet në të cilën janë paraqitur dokumentet e rëndësishme dhe informacione për njësi vendore

- Vlerësimin e punës së strukturës organike, Bashkia e kryen nëpërmjet plotësimit të vetëvlerësimit, nëpërmjet raporteve të auditimit, të cilat në fakt janë të përputhshmërisë dhe nuk ka raporte performance.

Në lidhje me parimin 4 “Njësia publike demonstroi angazhimin në realizimin e kompetencave”

- Procedurat e rekrutimit bëhen sipas nevojave që dalin gjatë vitit, por nuk ka një plan vjetor rekrutimi. *Për planin vjetor të pranimit në Bashkinë Lezhë pjesë e shërbimit civil për vitin 2022 “ e kryetarit së Bashkisë Lezhë.* Për çdo punonjës të rekrutuar krijohet dosja personale sipas, e cila përmban të dhëna të karakterit teknik, profesional, të dhënat për marrëdhëniet e punës, arsimin, rekrutimin, kualifikimin, trajnimin, masat disiplinore, të dhëna për vlerësimin periodik të rezultateve individuale në punë. Dokumentet përkatës që vërteton pohimin e bërë si: certifikata e gjendjes familjare; diploma e shkollës së lartë, lista e notave; certifikatat ose diplomat e kualifikimeve ose të specializimeve; dëshmi të gjuhëve të huaja, të tjera.

-Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime, pra nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme. Nga Bashkia Lezhë është hartuar një tabelë me kërkesat për trajnime nga menaxheret e programeve dhe kjo tabelë i është dërguar Shkollës Shqiptare të Administratës Publike. Nga vetë Bashkia nuk ka organizime dhe realizime trajnimesh për fusha të ndryshme.

Përsa i përket politikave që lidhen me burimet njerëzore jo në cdo rast janë zbatuar kërkesat sipas manualit MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Kapitulli III pika 3.1. Komponentët E Menaxhimit Financiar Dhe Kontrollit si më poshtë :

Politikat e burimeve njerëzore duhet të garantojnë:

- Një procedurë transparente për rekrutimin dhe emërimin e punonjësve;
- Krite dhe kërkesa të përshtatshme në drejtim të kualifikimit dhe përvojës profesionale në procesin e rekrutimit dhe të emërimit të stafit, që synojnë të fuqizojnë kapacitetin administrativ të njësisë dhe të krijojnë një ekip pune të besueshëm dhe kompetent;
- Një sistem trajnimi dhe kualifikimi që synon t'i përgatisë punonjësit për kryerjen e detyrave në nivelin e pritur;
- Një sistem për vlerësimin e performancës që të inkurajojë zhvillimin profesional të punonjësve dhe të ofrojë mundësi për ngritje të merituar në detyrë dhe të ndëshkojë në rast të kundërt;

- Një sistem stimujsh për punonjësit për t'i nxitur të rrisin cilësinë e kryerjes së detyrave të caktuara;
- Një sistem për qarkullimin e punonjësve për të lejuar punonjësit të përftojnë një eksperiencë të gjerë në njësinë ku punojnë;
- Një sistem transparent sanksionesh, që të përcjellë një ide të qartë të qëndrimit të titullarit të njësisë ndaj shkeljes së rregullave të vendosura dhe një tolerancë zero ndaj sjelljeve të tilla;
- Zhvillimin dhe miratimin e politikave, rregullave dhe procedurave të zbatueshme, që janë në harmoni me dispozitat ligjore të vlefshme për rekrutimin, emërimin, vlerësimin, trajnimin, shpërblimin dhe motivimin e stafit.

Në kuptimin e filozofisë së menaxhimit dhe stilit të vepruarit nga menaxheri i njësisë në njësi veprohet në bazë të detyrave të caktuara në rregullore dhe kërkesa e llogarisë organizohet sipas hierarkisë së organigramës të përcaktuar, duke realizuar mbikëqyrjen e punonjësve për kryerjen e detyrave. Përsa i përket politikave dhe praktikave të ndjekura për menaxhimin e burimeve njerëzore në rregullore janë përcaktuar detyrat sipas Drejtorive dhe Sektorëve dhe linjat e raportimit.

- Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm” i cili përcakton se “Komiteti i Auditimit të Brendshëm është organ i pavarur, monitorues e këshillëdhënës për titullarin e njësisë publike, si dhe mbështetës për njësinë e auditimit të brendshëm:

- Nënpunësi zbatues për zbatimin e programit buxhetor është përcaktuar në përputhje me ligjin, ka arsimimin dhe profesionalizmin të përshtatur me pozicionin si Përgjegjës i Zyrës së Financës.

Në lidhje me parimin 5 “Njësia Publike vepron në përputhje me përgjegjshmërinë menaxheriale”.

Janë kryer delegime detyrash të cilat janë bërë në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore” neni 59, pika 3 me autorizimet dhe Urdhërat përkatës, kryesisht delegimi i funksioneve në rast të mungesës së nënpunësit autorizues dhe nuk ka raste të delegimit nga nënpunësi zbatues ose drejtorët e drejtorive.

- Në zbatim të ligjit organik të buxhetit ligjit nr. 9936 datë 26.06.2008, dhe të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2019 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe udhëzimit të MFE nr. 7 , datë 26.02.2021 “ Për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2021 – 2024 Titullari i Bashkisë ka nxjerrë urdhra për ngritjen e GMS:

Për vitin 2022 me shkresën nr. prot., 22490 datë 15.12.2020 ka dalë urdhri i titullarit nr. 882 datë 15.12.2020 “Për ngritjen EMP-ve ekipeve të menaxhimit të programeve” për vitet 2020-2023.

Me urdhër nr. 35, datë 07.01.2022 protokolluar me shkresën nr. 134, datë 07.01.2022. është krijuar Grupi i menaxhimit strategjik (GMS)

- Në Rregulloren e Brendshme nuk janë përfshirë funksionimi, detyrat dhe përgjegjësitë e Komisionet e përhershme, të përkohshme dhe strukturat konsultative të Bashkisë në të cilin të përfshihej Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) me detyrat dhe përgjegjësitë e tij.

- Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Nuk ka vendosur rregullat të monitorimit të sistemit të brendshëm të kontrollit financiar.

- Nuk është dokumentuar procesi i paraqitjes së kërkesave buxhetore sipas programeve te Koordinatorit i GMS-së. Përsa i përket dokumenteve të hartuara është bërë deklarimi se si ka funksionuar në parim kontrolli i brendshëm në lidhje me realizimin e sistemeve të aktivitetit të Bashkisë: Sistemi i menaxhimit të burimeve njerëzore; sistemi i programimit te zbatimit ë buxhetit; sistemi i pagesave, sistemi i prokurimeve me vlera të vogla dhe të larta; inventarët e

aktiveve të qëndrueshme e qarkulluese; sistemi i tatim-taksave. Në kapitullin “Vlerësimi i sistemit të MFK” janë përshkruar se sa janë arritur objektivat në fushat prioritare për bashkinë si në sektorin e shërbimeve publike, sektorin e urbanistikës dhe sektorin e tatim-taksave. Si ka ndikuar komponenti i informimit dhe komunikimit me procedurat me rregulloret e hartuara dhe të realizuara nga kjo njësi në arritjen e objektivave në sektorët më të rëndësishëm të veprimtarisë së bashkisë. Si ka funksionuar komponenti i monitorimit të kontrollit të brendshëm në cilësinë e performancës. Si ka ndikuar veprimtaria e AB në monitorimin e Kontrollit të brendshëm.

Pjesë e Deklaratës duhet të jetë edhe fakti se si është realizuar ngritja dhe zbatimi i sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit në të gjitha njësitë, strukturat, programet, veprimtaritë dhe proceset që menaxhohen prej nëpunësit autorizues, në përputhje me parimet e ligjshmërisë, të menaxhimit të shëndoshë financiar dhe të transparencës.

Kjo duhej realizuar nëpërmjet:

Monitorimit të veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe të rregullshmërinë duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit.

Realizimit të “gjurmës së auditimit” që përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendim-marrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve.

Mbikëqyrjes së ndarjes së detyrave, caktimin e përgjegjësisë, rishikimin sistematik dhe shprehjen e miratimit për punën e secilit punonjës në pika kritike, në mënyrë që të sigurohet se ajo është kryer sipas parashikimit. Udhëzimeve të dhëna dhe kryerjes së trajnimeve të nevojshme për punonjësit, për të garantuar minimizimin e akteve të parregullta, gabimeve dhe shpërdorimeve, si dhe se direktivat e dhëna, të cilat duhet të kuptohen dhe të arrihen nga punonjësit.

II. Komponenti “Menaxhimi i Riskut”

Në lidhje me parimin 6: Njësia Publike specifikon objektivat si bazë për identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në lidhje me këto objektiva.

Bashkia Lezhë në hartimin e PBA-ve ka vendosur objektiva si në planet operacionale strategjike, në planet vjetore të veprimtarisë, në planifikime në investimeve, në planet buxhetore vjetore, të cilat janë në përputhje me strategjitë dhe politikat kombëtare e sektoriale si dhe me vizionin dhe misionin e njësisë. Këto objektiva bëhen të njohura, duke u paraqitur bashkë me dokumentin e PBA në MFE, në këshillin Bashkiak. Në disa raste ka mospërputhje midis objektivave afatmesme (PBA) dhe objektivave të parashikuara në buxhetin vjetor të njësisë, por këto mospërputhje janë të vogla. PBA është miratuar me V.K.B nr. 177 prot., datë 23.12.2021.

Përsa i përket regjistrit të riskut rezulton se nga ana e bashkisë Lezhë nuk është hartuar regjistri i riskut. *Në kundërshtim me ligjin nr.10296, datë 8.7.2010 për “menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 11 dhe neni 12.*

Sa më sipër konstatohet se, për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut. Strategjia e riskut e një njësie duhet të miratohet nga titullari i njësisë, e cila përgatitet nga NA dhe duhet t’u vihet në dispozicion punonjësve dhe të njihet prej tyre. Këto mosveprime janë *në kundërshtim me nenin 21, pika 2 të ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, i ndryshuar ku citohet se: “Titullari i njësisë publike miraton një strategji risku, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut”.*

Në lidhje me parimin 7: “Njësia Publike identifikon dhe analizon risqet për arritjen e objektivave”.

Në lidhje me parimin 8: “Njësia Publike vlerëson mundësinë e riskut për mashtime”

Duke mos patur një vlerësim të riskut, ky institucion nuk ka bërë vlerësimin e riskut të mashtrimit, pasi nuk ekzistojnë politika dhe procedura lidhur me mashtrimin. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit. Në rregulloren e brendshme nuk janë përfshira detyrat dhe përgjegjësit e koordinatorit të riskut, dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe gjithëpërfshirës.

Në lidhje me parimin 9: “Njësia Publike identifikon dhe analizon ndryshimet që mund të ndikojnë në sistemin e kontrollit të brendshëm”.

Bashkia Lezhë në politikat dhe procedurat e veprimtarisë së saj ka marrë vazhdimisht në konsideratë ndikimet e mundshme në sistemin e kontrollit të brendshëm nga ristrukturimi apo riorganizimi i këtij institucioni, apo nga ndryshimet në menaxhim, duke marrë masa për ti paraqitur rregullat e nevojshme në përputhje me ndryshimet në rregulloret e brendshme dhe duke përcaktuar apo deleguar e autorizuar detyrat në personat zëvendësues përgjegjës për realizimin e funksioneve të ndryshuara. Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirës.

III. Komponenti: “Aktivitetet e Kontrollit”

Në lidhje me parimin 10: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete kontrolli”

- Në Rregulloren e Brendshme në mënyrë të përgjithshme dhe për çdo strukturë janë përcaktuar krahas detyrave janë identifikuar pak a shumë dhe proceset e punës. Ekzistojnë procedura të brendshme për proceset e punës të cilat i referohen edhe hartës së proceseve të punës të përcaktuara në dispozitat ligjore (si procedurat standarte të zbatimit të buxhetit, të menaxhimit të aktiveve në sektorin publik, për arkivat, kodit të procedurave administrative, etj.) jo të gjitha aktivitete e kontrollit janë të dokumentuara në formën e hartave të proceseve të punës .

- Angazhimet financiare miratohen në të njëjtën kohë nga NA dhe NZ, pra urdhër-shpenzimet konfirmohen nga NA dhe NZ.

- Kontrolli i dokumentacionit dhe pranimi i tij para njohjes së shpenzimit në kontabilitet kryhet nga Drejtori i Financës (NZ). Kontabilizimi i transaksioneve financiare kryhet nga Përgjegjësi i financës/Autorizimi i pagesës nga Kryetari i Bashkisë (NA).

- Për prokurimet nga NA kanë dalë urdhrat e krijimit dhe funksionimit të komisionit të llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike, njësia e prokurimit, komisioni i vlerësimit të ofertave, komisioni i blerjeve të vogla, komisioni i pranimit të mallit.

- Për çdo vit buxhetor hartohet regjistri i planit dhe realizimit të prokurimeve, i cili azhurnohet sa herë ka ndryshime fondesh.

Për dokumentacionin e financës nuk parashikohet dhe specifikohet ndonjë rregull i veçantë, por veprohet në bazë të legjislacionit për arkivat.

- Për menaxhimin e aktiveve veprohet në bazë të Udhëzimit nr. 30 datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në Njësitë e sektorit publik” i ndryshuar, në bazë të cilit është mbajtur regjistri i aktiveve, i cili përditësohet çdo vit për ndryshimet e pësuar si për shtesat dhe pakësimet. Aktivitet afatgjatë dalin në përdorim në bazë urdhër-dorëzimeve nga personi i autorizuar dhe për to janë hapur kartelat e Zyrave dhe kartelat personale të konfirmuar nga përgjegjësit materiale. Është ndjekur kjo praktikë ligjore për të ruajtur nga përdorimi i paautorizuar, keqpërdorimi dhe humbjet i këtyre aktiveve. Aktivitet Afatgjatë nuk janë regjistruara në SIFQ, pasi kjo Bashki akoma nuk është pilot për aplikimin direkt në programin e Qeverisë SIFQ.

Në lidhje me parimin 11: “Njësia publike përzgjedh dhe zhvillon aktivitete të kontrollit të përgjithshme të kontrollit të teknologjisë”

- Bashkia Lezhë nuk ka procedurë të përshtatshme për të siguruar IT në sektorë të ndryshëm si dhe nuk ka plan investimesh për programet e IT. Jo çdo sistem ka procedurën e vet të ruajtjes së të dhënave nga ndërhyrjet e paautorizuara. Gjithashtu nuk ka procedurë për ruajtjen e të dhënave të aktiveve.

Sektori i IT, i cili varet nga Drejtori i Sektorit të Burimeve Njerëzore ka vetëm detyra për mirëmbajtjen e sistemit kompjuterik dhe menaxhimin e programeve, dhe merret me instalimin e programeve. Gjithashtu ka përgjegjësi dhe menaxhon Serverin kryesor, duke garantuar sigurinë e sistemit të IT në lidhje me ndryshimet e fjalëkalimeve, firewall-et.

Në lidhje me parimin 12: “Njësia publike vendos aktivitetet e kontrollit përmes politikave dhe procedurave”.

- Për aktivitetet e kontrollit janë përcaktuar përgjegjësitë si për drejtuesit dhe personelit tjetër të caktuar, përgjegjësi këto të identifikuar në rregulloren e brendshme dhe në veprimtarinë e përditshme të Bashkisë, por mungojnë plan-veprime të ndryshme operative dhe të menaxhimit të riskut.

- Bashkia Lezhë ka krijuar Njësinë e sinjalizimit e cila ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsisë. Nga evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstata se për periudhën në auditim nuk janë ndërmarrë hapa konkrete sa i përket implementimit dhe funksionimit të kësaj njësie, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 17, pika 1.

-Bashkia Lezhë ka një procedurë të qartë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, e cila bën të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Në Bashkinë Lezhë ka përfunduar hartimi dhe miratimi i kësaj procedure por nuk janë marrë masa konkrete për implementimin e saj e më tej kontrollin e performancës, veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

-Bashkia Lezhë nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

- Bashkia Lezhë ka krijuar Njësinë e sinjalizimit e cila ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsisë. Nga evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstata se për periudhën në auditim nuk janë ndërmarrë hapa konkrete sa i përket implementimit dhe funksionimit të kësaj njësie.

-Bashkia Lezhë ka një procedurë të qartë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, e cila bën të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Në Bashkinë Lezhë ka përfunduar hartimi dhe miratimi i kësaj procedure por nuk janë marrë masa konkrete për implementimin e saj e më tej kontrollin e performancës.

IV. Komponenti: “Informimi dhe komunikimi”

Në lidhje me parimin 13: “Njësia Publike merr, gjeneron dhe përdor informacion cilësor”.

Drejtesit në Bashkinë Lezhë kanë identifikuar dhe përcaktuar informacionin e kërkuar nëpërmjet raportimit financiar dhe operacional, në nivelet përkatës dhe specifikat e duhura tek personeli i duhur.

Sistemi i raportimit ofron pjesërisht informacion për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësive të varësisë të saj.

- Raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit hartohen çdo 4-mujor dhe vjetor dhe paraqiten pranë Këshillit Bashkiak si dhe në Degën e Thesarit.

- Raportet për detyrimet e konstatuara por të papaguara hartohen çdo muaj dhe paraqiten në degën e thesarit.

- Drejtoria e Financës Buxhetit dhe Kontabilitetit në Bashkinë Lezhë për mbajtjen e kontabilitetit operon me program të vetin të kontabilitetit, pa e dubluar programin SIFQ. Në bazë të këtij programi kontabilitetit me të cilin operohet, është mundësuar monitorimi i shpenzimeve nga Drejtoria Ekonomike. Ndërsa monitorimi i të ardhurave kryhet me program të veçantë të cilin e menaxhon Sektori i Tatim-Taksave.

Në lidhje me parimin 14: Njësia publike përdor komunikimin e brendshëm.

Në lidhje me parimin 15: Njësia publike përdor komunikimin e jashtëm.

Në rregulloren e brendshme janë parashikuar mënyrat e informimit dhe komunikimit, në nenin 11 “Bashkëpunimi ndërmjet strukturave të Administratës së Bashkisë”, neni 13 “Marrëdhëniet me Këshillin Bashkiak”, neni 21 “Informacioni dhe komunikimi me median”, neni 9 “Marrëdhëniet me publikun”.

Informacioni që sigurohet nga drejtuesit dhe përgjegjësit e sektorëve i transmetohet Titullarit për çdo muaj, i cili informohet mbi shpenzimet aktuale, të ardhurat e veta të realizuara dhe buxhetin e planifikuar. Informacioni prej drejtuesve dhe përgjegjësve të sektorëve dërgohet çdo javë çdo muaj dhe nëpërmjet analizave të herëpashershëm sigurohet informacion për arritjen e objektivave dhe dëmeve të mundshme.

Të gjithë punonjësit e Bashkisë Lezhë, me statusin e nëpunësit civil, janë të pajisur me e-mail zyrtar.

- Nga Bashkia Lezhë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

Komunikimi i brendshëm Një prej kanaleve më të rëndësishme të komunikimit nuk është në nivelet e duhura, në një njësi është ai ndërmjet titullarit, menaxherëve dhe punonjësve të tij “komunikimi vertikal”. Punonjësit nuk njihen sa duhet me sistemin e komunikimit të brendshëm dhe të kuptojnë rolin e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë që çdonjëri ka në këtë sistem. Falë komunikimit ata bëhen më të ndërgjegjshëm për rolin dhe përgjegjësitë që kanë në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë.

Komunikimi si shkëmbim i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet e punës, nuk dokumentohet ashtu sikurse përcaktohet në Manualin e MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, Kapitulli III. Komponentët E Menaxhimit Financiar Dhe Kontrollit pika 3.4.

V. Komponenti: “Monitorimi”

Në lidhje me parimin 16: “Njësia publike përzgjedh, zhvillon dhe kryen vlerësime të vazhdueshme”

- Procedurat periodike të raportimit që rregullojnë zbatimin dhe monitorimin e objektivave në këtë institucion konsistojnë në planet mujore dhe vjetore të punës, analizat për aktivitetin e bashkisë, por mungojnë pjesërisht raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti.

- Monitorimi i progresit lidhur me arritjen objektivave dhe analiza e shkaqeve për dështimet e mundshme nga ana e drejtuesve të programeve buxhetore e lidhin me monitorimin e zbatimit të buxhetit, dokument i cili hartohet çdo 4 muaj. Në fakt monitorimi i progresit të ngritjes e të zbatimit të sistemit të kontrollit të brendshëm lidhur me arritjen objektivave ka të bëjë me monitorimin e veprimtarive të kontrollit para faktit dhe pas faktit në lidhje me ligjshmërinë dhe rregullshmërinë, duke marrë parasysh parimet e ekonomizimit, të efikasitetit dhe të efektivitetit. Për këtë fakt mungojnë raportet.

- Bashkia monitorimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit e kryen nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm, dokument i cili është dërguar çdo vit pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Harmonizimit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, pranë Ministrisë së Financave për vitin 2022 me shkresën nr. Për vitin 2022 nga

Bashkia Lezhë janë përgatitur 3 raporte për monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit. Raporti i monitorimit 4 mujorin e parë me nr. 1107/1 Prot, datë 10.06.2022, raporti i monitorimit për 4 mujorin e dytë 2022 me nr. 16106 Prot, datë 26.09.2022 dhe për 12 mujorin 2022 me nr. 1651/1 prot., datë 14.02.2023

- Në Bashkinë Lezhë mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. *Plani i veprimit për menaxhimin financiar dhe kontrollin shoqëron shkresën e sipërcituar dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit.*

- Në Bashkinë Lezhë aktivitetet e vlerësimit të njësisë janë pjesërisht në përputhje me burimet dhe pjesërisht të përshtatshme për të përmbushur qëllimet për të cilat janë ngritur, pasi mungojnë Planet e Menaxhimit dhe Raportet e Zbatimit, mungojnë Indikatorët e Performancës si dhe Komiteti i Auditimit.

- Një nga drejtimet e monitorimit kanë të bëjë me aktivitetin e Auditimit të Brendshëm.

Auditi i Brendshëm, është angazhuar për ndërmarrjen e masave korrigjuese, nëpërmjet plan-veprimit për zbatimin e rekomandimeve si dhe ka organizuar dhe realizuar programe angazhimi të veçantë për ndjekjen e zbatimit të rekomandimeve të lëna nga KLSH.

Në lidhje me parimin 17: “Njësia publike vlerëson dhe komunikon mangësitë”

- Sipas kontakteve me menaxhimin dhe pyetësorëve nuk ka raportime apo ankesa për çështje të kontrollit të brendshëm. Rastet e veprimeve të gabuara apo në shkelje të rregullave dhe mangësitë e vërejtura në sistemin e kontrollit të brendshëm nga Drejtuesit e Programeve janë bërë prezentë në mbledhjet periodike me Kryetaren e Bashkisë, ku janë shqyrtuar dhe janë përcaktuar masat për eliminimin e tyre.

Sa më sipër arrihet në konkluzion se:

Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përkatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korrigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. - Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme.

Përsa i përket politikave që lidhen me burimet njerëzore jo në cdo rast janë zbatuar kërkesat sipas manualit MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Kapitulli III pika 3.1.

“Menaxhimi i Riskut”

Nga auditimi rezulton se nga ana e bashkisë Lezhë nuk është hartuar regjistri i riskut. Në kundërshtim me ligjin nr.10 296, datë 8.7.2010 për “menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 11 dhe neni 12.

-Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të Bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, rryshfetit dhe korrupsionit.

Për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se si sillet institucioni ndaj risqeve dhe vendos kuadrin e përgjithshëm të procesit të menaxhimit të riskut.

“Aktivitetet e Kontrollit”

- Bashkia Lezhë ka krijuar Njësinë e sinjalizimit e cila ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullive. Nga evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se për periudhën në auditim nuk janë ndërmarrë hapa konkrete sa i përket implementimit dhe funksionimit të kësaj njësie, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 17, pika 1.

-Bashkia Lezhë ka një procedurë të qartë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, e cila bën të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Në Bashkinë Lezhë ka përfunduar hartimi dhe miratimi i kësaj procedure por nuk janë marrë masa konkrete për implementimin e saj e më tej kontrollin e performancës, veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

-Bashkia Lezhë nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.- Mungojnë raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Lezhë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

Komunikimi i brendshëm Një prej kanaleve më të rëndësishme të komunikimit nuk është në nivelet e duhura, në një njësi është ai ndërmjet titullarit, menaxherëve dhe punonjësve të tij “komunikimi vertikal”. Punonjësit nuk njihen sa duhet me sistemin e komunikimit të brendshëm dhe të kuptojnë rolin e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë që çdonjëri ka në këtë sistem. Falë komunikimit ata bëhen më të ndërgjegjshëm për rolin dhe përgjegjësitë që kanë në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Kapitulli III. Komponentët E Menaxhimit Financiar Dhe Kontrollit pika 3.4.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohen me përgjegjësi, *zj. B.V Drejtor i Financës Bashkia Lezhë, në cilësinë e nënpunësit zbatues.*

Zj. J.LDrejtor i Burimeve Njerëzore.

Titulli i gjetjes: KLSH ka konstatuar se, në Bashkinë Lezhë funksionimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit ka shfaqur mangësi, duke sjellë fenomenin që sistemet e kontrollit nuk kanë funksionuar plotësisht. Për ta përmirësuar atë në të ardhmen kërkohet një

vëmendje e shtuar për implementimin dhe respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga zbatimi i Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar.

Situata: Nga auditimi i zbatimit të dispozitave ligjore për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin e Brendshëm u konstatua se, gjendja aktuale e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, nisur nga vetëvlerësimi dhe rezultatet e testeve të kryera, tregon se aspektet e kontrollit të brendshëm kuptohen dhe funksionojnë mjaftueshëm, përgjatë gjithë strukturave të njësisë. Akoma mbeten pa u kuptuar dhe zbatuar disa koncepte në lidhje me komponentët e MFK si:

“Mjedisi i kontrollit”

- Mungojnë raportet mbi mangësitë në sistemin e kontrollit të brendshëm të njësisë publike, për pasojë nuk ka as një plan menaxhimi për veprime korigjuese. Mungon një program strategjik dhe vjetor i trajnimit dhe zhvillimit të stafit e për rrjedhojë nuk ka një buxhet të planifikuar për trajnime. - Në Rregulloren e brendshme nuk janë përfshirë detyrat dhe përgjegjësitë e koordinatorit të riskut dhe grupit të menaxhimit të riskut, gjë që do të kishte ndihmuar në funksionimin e këtij komponenti të MFK në mënyrë më të plotë dhe më gjithëpërfshirëse.

-Mungojnë procedurat e sinjalizimit të rasteve të parregullsive, mashtrimeve, të veprimeve korruptive, të cilat nuk janë përfshirë as në Rregulloren e Brendshme.

Përsa i përket politikave që lidhen me burimet njerëzore jo në cdo rast janë zbatuar kërkesat sipas manualit MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Kapitulli III pika 3.1.

“Menaxhimi i Riskut”

Nga auditimi rezulton se nga ana e Bashkisë Lezhë nuk është hartuar regjistri i riskut. Në kundërshtim me ligjin nr .10 296, datë 8.7.2010 për “menaxhimin financiar dhe kontrollin” neni 11 dhe neni 12.

-Mungon Urdhri për përcaktimin e grupit të punës së riskut. Nuk janë hartuar evidenca të monitorimit të riskut nga niveli i lartë, duke mos vlerësuar në mënyrë periodike të ekspozimit të bashkisë ndaj veprimtarisë mashtruese, të cilat përbëjnë riskut për veprimtarinë e bashkisë, në arritjen e objektivave dhe pengon marrjen e masave kundër mashtrimit, ryshfetit dhe korrupsionit.

Për periudhën objekt auditimi nuk ka një strategji të miratuar të riskut ku të përcaktohet mënyra se **“Aktivitetet e Kontrollit”**

- Bashkia Lezhë ka krijuar Njësinë e sinjalizimit e cila ka të përcaktuara në rregulloren e brendshme të institucionit procedurat anti-korrupsion dhe të sinjalizimit të parregullsive. Nga evidencat e vëna në dispozicion të grupit të auditimit u konstatua se për periudhën në auditim nuk janë ndërmarrë hapa konkrete sa i përket implementimit dhe funksionimit të kësaj njësie, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 17, pika 1.

-Bashkia Lezhë ka një procedurë të qartë lidhur me mbledhjen dhe dokumentimin e gabimeve, ankesave dhe analizën e tyre, e cila bën të mundur identifikimin e shkaqeve dhe eliminimin e problemeve të dala gjatë kryerjes së detyrave. Në Bashkinë Lezhë ka përfunduar hartimi dhe miratimi i kësaj procedure por nuk janë marrë masa konkrete për implementimin e saj e më tej kontrollin e performancës, veprime këto në kundërshtim me, Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar, neni 4, pika 20.

-Bashkia Lezhë nuk ka hartuar, miratuar dhe arkivuar gjurmën e auditimit e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre dhe synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to.

“Informimi dhe komunikimi”

- Sistemi i raportimit nuk ofron aq sa duhet informacion të plotë për monitorimin e progresit në arritjen e objektivave në tërësi të institucionit dhe të njësisë të varësisë të saj.- Mungojnë

raporte periodike apo publikime vjetore për performancën e bashkisë në lidhje me shërbimet e ofruara publikut. Nga Bashkia Lezhë kryhen konsultime me publikun dhe palët e interesit, por mungon dokumenti i konsultimit publik.

Komunikimi i brendshëm një prej kanaleve më të rëndësishme të komunikimit nuk është në nivelet e duhura, në një njësi është ai ndërmjet titullarit, menaxherëve dhe punonjësve të tij “komunikimi vertikal”. Punonjësit nuk njihen sa duhet me sistemin e komunikimit të brendshëm dhe të kuptojnë rolin e tyre, detyrimet dhe përgjegjësitë që çdonjëri ka në këtë sistem. Falë komunikimit ata bëhen më të ndërgjegjshëm për rolin dhe përgjegjësitë që kanë në lidhje me arritjen e qëllimeve dhe objektivave të njësisë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. Kapitulli III. Komponentët E Menaxhimit Financiar Dhe Kontrollit pika 3.4.

“Monitorimi”

- Mungojnë raportimet e menaxherëve për përmbushjen e objektivave mbi bazë impakti dhe produkti. Mungojnë rregulla të brendshme të miratuara për monitorimin e Sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit. Mungon plani i veprimit për ecurinë e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Kriteri: Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar. Manuali i MFK, miratuar me Urdhërin e Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.

Shkaku: Mungesa e trajnimeve të dedikuara për gjithë stafin në drejtim të njohjes së dispozitave të MFK dhe të menaxhimit të sistemit buxhetor.

Rëndësia: E mesme.

Mbi vlerësimin e veprimitarisë së njësisë së auditit të brendshëm.

- Njësia e Auditit të Brendshëm për vitin 2022 ka funksionuar me 3 (tre) Auditues të certifikuar deri me datë 29 Prill 2022, një përgjegjës Sektori dhe dy specialiste auditit, sipas VKM nr. 83, datë 03.02.2016 “Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”, ku sipas pikës 3, të këtij vendimi thuhet se “Njësia e Auditit të Brendshëm përbehet nga jo më pak se 3(tre) punonjës, përfshirë dhe drejtuesin e Njesisë”. Në strukturën e Njesisë së Auditit të Brendshëm mund të punësohen deri 1/3 e punonjësve të pa certifikuar si Auditues të Brendshëm në sektorin publik.

Me datë 29.04.2022 Përgjegjësi i Auditit të Brendshëm, Z. B.GJka dalë në pension dhe në vend të tij është komanduar Përgjegjëse Auditit Znj. P.F , me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 264, date 29.04.2022. Nga data 29.04.2022 deri me date 19.09.2022, Njësia e Auditit të Brendshëm Bashkia Lezhë, ka funksionuar me 2 (dy) Punonjës, Një Përgjegjëse e Auditit të brendshëm dhe një specialiste Auditit. Me datën 19.09.2022 struktura e Auditit plotësohet me tre punonjës, një Përgjegjës Auditit dhe dy specialistë.

Tabela nr.1 -Struktura e Auditit të Brendshëm me të dhënat sipas tabelës

| Nr. | PeriU | Funksioni | Emëruar | Arsimimi | Vjetërsia ne pune | Vjetërsia ne Auditim / vite | Certifikimi | Trajnime te vijeshme |
|-----|-------|----------------------------|------------|-------------|-------------------|-----------------------------|-------------|----------------------|
| 1 | B.GJ | P/Spektori(05.01-29.04.22) | Viti 2022 | Ek.Industri | 40 | 15 | 2007 | 40 ore / vit |
| 2 | A.B | P/Spektori (19.09.2022) | 19.09.2022 | Ek.Finance | 24 | 4 muaj | | |
| 3 | P.F | Specialiste Auditit | 13.01.2017 | Ek.Finance | 27 | 7 | 2010 | 64 ore / vit |
| 4 | F.D | Specialiste Auditit | 01.03.2017 | Ek.Finance | 7 | 7 | 2021 | 64 ore / vit |

Burimi:Bashkia Lezhë Njësia e Auditit të Brendshëm.

Planet Strategjike dhe Vjetore të NJAB të Bashkisë Lezhë janë përcjellë në Ministrinë e Financave brenda afateve të përcaktuara në Ligjin 114/2015 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, në “Manualin e Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik”

Për vitin 2022 është miratuar nga Titullari i Bashkisë me shkresën nr. 2596 dt. 14.10.2020 plani vjetor dhe ai strategjik për vitet 2022-2024 të veprimtarisë së Auditit të Brendshëm dhe me i është dërguar Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave.

Raportimi: Për veprimtarinë e NJAB në Bashkisë Lezhë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike. Janë hartuar dhe dërguar në NJQHAB te MFE raportet periodike vjetore të shoqëruara këto me evidencat e raportimit në mënyrë progresive dhe vlerësimin përmbyllës për veprimtarinë e NJAB, përkatësisht për vitin 2022 me shkresën nr. 1653 prot., datë 08.02.2023. Për veprimtarinë e NJAB në Bashkisë Lezhë për periudhën objekt auditimi, është raportuar në mënyrë sistematike.

Karta e AB : Karta e Auditimit të Njesisë AB dhe Urdhëri i Titullarit për miratimin e saj, është ngritur me Urdhërin e Titullarit nr. 256, date 26.04.2022 “Për miratimin e kartës së Auditit të Brendshëm” dhe Karta e Auditit të Brendshëm është protokolluar me shkresën nr. 19434 prot., datë 07.12.2022.

Plani vjetor i punës së Auditit të Brendshëm të miratuar nga Titullari i Bashkisë Lezhë, për vitin 2022.

Në Planin Vjetor të punës së Auditit të Brendshëm, të miratuar nga Titullari i Bashkisë, me nr. 2596 për vitin 2022, janë planifikuar këto angazhime auditimi për vitin 2022, si më poshtë vijon:

1. Njësia Administrative Zejmen
 2. Drejtoria Ujësjiellës Kanalizime (Sh.A.Ujësjiellës-Kanalizime)
 3. Drejtoria Shërbimeve Publike
 4. Klubi i Sportit Besëlidhja
 5. Policia Bashkiake
 6. Njësia Administrative Balldre
 7. Njësia Administrative Ungrej
 8. Njësia Administrative Dajç
 9. Drejtoria e Turizmit dhe Kulturës.
 10. Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes se Territorit
- Si dhe është bërë shtesë në planin vjetor për :
11. Drejtoria e Projekteve Strategjike, Europës Migracionit, Diasporës, Komunikimit e Transparencës me objekt (Blerje Automjeti Zjarrfikës), e financuar nga donator të huaj e konkretisht Ambasada Japoneze, në bashkëpunim me Bashkinë Lezhe, auditim i zhvilluar sipas kërkesës së donatorit për një raport auditimi për procedurën e kryer nga Bashkia Lezhë për blerjen e një automjeti zjarrfikës të ri.

Njësia e Auditit të Brendshëm sipas planeve strategjike dhe vjetore, dhe programeve të auditimit të miratuara nga Kryetari i Bashkisë për auditimet e Drejtorive dhe Njësive Administrative, ka kryer këto angazhime auditimi për vitin 2022, si më poshtë vijon:

1. Njësia Administrative Zejmen.
2. Drejtoria Ujësjiellës Kanalizime (Sh.A. Ujësjiellës-Kanalizime)
3. Drejtoria Shërbimeve Publike.
4. Klubi i Sportit Besëlidhja
5. Policia Bashkiake.
6. Njësia Administrative Balldre.

7. Njësia Administrative Ungrej.
8. Njësia Administrative Dajç.
9. Drejtoria e Turizmit dhe Kulturës.
10. Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit.

Si dhe është bërë shtesë në planin vjetor për :

-Drejtoria e Projekteve Strategjike, Europës Migracionit, Diasporës, Komunikimit e Transparencës me objekt (Blerje Automjeti Zjarrfikës), e financuar nga donator të huaj e konkretisht Ambasada Japoneze, në bashkpunim me Bashkinë Lezhë.

Nga 10 (dhjetë) Auditime, që është plani vjetor i miratuar për vitin 2022, Njësia e Auditimit të Brendshëm ka realizuar 10 (dhjetë) angazhime auditimi sipas planit dhe 1 (një) subjekt është shtuar, me kërkesë të titullarit dhe konkretisht Drejtoria e Projekteve Strategjike, Europës, Migracionit, Diasporës, Komunikimit e Transparencës, me objekt për procedurën e kryer nga Bashkia Lezhë për “Blerje Automjeti Zjarrfikës”, e financuar nga donatorë të huaj e konkretisht Ambasada Japoneze, në bashkpunim me Bashkinë Lezhë.

Tabela nr.2 Subjekte të Audituar sipas viteve për vitin 2022

| Nr | Planifikuar | Realizuar | Niveli i Riskut |
|----|---|-----------|-----------------|
| 1 | Klubi i Sportit | Po | I larte |
| 2 | Drejtoria e Shërbimeve PublikeTransportit Infrastruktures dhe mjedisit | Po | I larte |
| 3 | Ujësjiellës Kanalizime Sh.A. | Po | I larte |
| 4 | Policia Bashkiake | Po | I larte |
| 5 | Inspektorati Vendorë i Mbrojtjes se Territorit | Po | I larte |
| 6 | Drejtoria e Turizmit dhe Kulturës | Po | I Mesem |
| 7 | Njësia Administrative Zejmen | Po | I Mesëm |
| 8 | Njësia Administrative Balldre | Po | I Mesëm |
| 9 | Njësia Administrative Ungrej | Po | I Mesem |
| 10 | Njesia Administrative Dajç | Po | I Mesem |
| 11 | Drejtoria e Projekteve Strategjike, Europës Migracionit, Diasporës, Komunikimit e Transparencës me objekt (Blerje Automjeti Zjarrfikës) | Po | I Mesëm |

Burimi: Bashkia Lezhë Njësia e Auditit të Brendshëm

Tabela nr.3 Auditimet e planifikuara dhe të realizuara.

| Nr. | PeriU | TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT | | | | | | | | |
|-----|-----------|---------------------------|------------------------|----------------------------------|-----------|-----------|-------------|---------|-------------------------------|--------------------|
| | | Auditime te planifikuara | Auditime te realizuara | Nga te realizuarat, sipas llojit | | | | | | Zbatim Rekomandime |
| | | | | Përputhshmëri | Financiar | Kombinuar | Performance | Tematik | Teknologjisë se Informacionit | |
| 1 | Viti 2022 | 10 | 11 | 11 | | | | | | |

Burimi: Bashkia Lezhë Njësia e Auditit të Brendshëm

Duke iu referuar tabelës më sipër rezulton se janë planifikuar 10 auditimi dhe janë realizuar 11 auditime dhe 1 (një) subjekt është shtuar, me kërkesë të titullarit dhe konkretisht Drejtoria e Projekteve Strategjike.

Tabela nr.4 Rekomandimet e dhëna

| Nr | PeriU | TË DHËNA SIPAS RAPORTIMIT | | | | SIPAS Raportimit | | | |
|----|---------------|-----------------------------------|-----------|-----------|------------|--|----------|-----------|------------|
| | | Rekomandime te shprehura ne numër | | | | Rekomandime te shprehura ne vlerë (shpërblim demi) | | | |
| | | Gjithsej ne numër | Zbatuar | Ne proces | Pa zbatuar | Gjithsej ne numër | Zbatuar | Ne proces | Pa Zbatuar |
| 1 | Viti 2022 | 71 | 50 | 21 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| | Totali | 71 | 50 | 21 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |

Burimi: Bashkia Lezhë Njësia e Auditit të Brendshëm

Për periudhën e vitit 2022 janë dhënë në total 71 rekomandime nga të cilat janë zbatuar 50 rekomandime , në proces zbatimi 21 rekomandime, dhe nuk ka rekomandime të pa zbatuara.

Sa më sipër, nga shqyrtimi i dokumentacionit të vendosur në dispozicion u konstatua se: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se përgjithësisht janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, “Manuali i Auditimit të Brendshëm” (MAB). Rezulton se në fillim të vitit janë hartuar deklaratat e pavarësisë, për çdo rast të angazhimit të auditimit janë bërë njoftimet për fillimin e angazhimit të auditimit si dhe autorizimet përkatëse me protokoll të veçantë, si dhe për çdo auditim janë hartuar deklaratat e pavarësisë. Është zhvilluar takimi i hapur prezantues dhe ai përmbyllës, janë hartuar pyetësorët e vlerësimit të përgjithshëm të riskut dhe të fushës që është audituar, si dhe është bërë inventari i dosjeve me dokumentet përkatëse. Hartimi i projekt-raporteve dhe raporteve përfundimtare është bërë sipas strukturës së miratuar në manualin e auditimit.

Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”, të MAB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të MF “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” kapitulli IV, pika 4.1.1 “planifikimi i një angazhimi auditimi”; kapitulli VI “Evidentimi dhe dokumentimi i punës audituese”, pika 6.1 “Niveli i dokumentimit”; Kapitulli VII, “Sigurimi i cilësisë së punës të AB”, pika 7.1.1 “Vlerësimi i brendshëm i cilësisë që kryhet nga vetë NJAB”,

Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë NJAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. “Për Auditin e Brendshëm Publik”.

-Në Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nuk ka të përcaktuar Indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë. Rezulton se nuk është kryer procedura sigurimi i cilësisë.

- Në disa dosje nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim.

Gjithashtu në disa dosje të auditimit mungon Memo e planifikimit, pra Projekt Drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit.

-Mungon dokumenti i miratimit të kodit të etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik.

-Në auditimin e pasqyrave financiare nuk jepet vlerësim mbi vërtetësinë / saktësinë e gjendjes aktuale të paraqitjes së pasqyrave financiare dhe përcaktimin e riskut, materialiteti dhënien e opinionit të sigurisë së arsyeshme mbi pasqyrat financiare.

-Në fund të procesit të auditimit në disa dosje mungojnë letrat e punës për secilin auditues të cilat duhet të përfshijnë regjistrimin e punës së audituesit dhe rezultatet e vlerësimit të sistemit. Në programet e auditimit nuk është përfshirë si drejtim “vlerësimi i komponentëve të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, si pasojë audituesit e brendshëm nuk kanë marrë në shqyrtim identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 10296, datë 08.07,2010 Për menaxhimin financiar dhe kontrollin, i ndryshuar.

-Në formulimin e gjetjeve ka mangësi, pasi në disa rasteve situata e përshkruar është i karakterit të përgjithshëm pa u adresuar qartë, hallka që nuk ka funksionuar dhe mosveprimet konkrete, nuk ka të përcaktuar periudhën e audituar, kujt viti i referohet, si dhe nuk është pjesë e gjetjes kriteri ligjor i detajuar i mospërputhshmërisë apo raportimit financiar për problematikën e konstatuar nga auditimi në kundërshtim me pikën 2.4.1 “Auditimi i përputhshmërisë” dhe 2.4.2 “Auditimi financiar”.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

-Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

Për veprimet e mësipërme, mban përgjegjësi, ish përgjegjësi i Njësisë së Auditit të Brendshëm, z. B.GJ.

z. A.B Përgjegjës sektori i auditit të brendshëm.

Zj. Përgjegjëse Auditit Znj. P.F , me Urdhërin e Kryetarit të Bashkisë nr. 264, date 29.04.2022, nga data 29.04.2022 deri me date 19.09.2022.

Titulli i gjetjes: KLSH ka konstatuar se, në lidhje me organizimin dhe funksionin e Sektorit të AB ekzistonin mangësi dosjet e Auditimit të kryera.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit të dosjeve të përzgjedhura u konstatua se:

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

- Në disa dosje nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim.

Gjithashtu në disa dosje të auditimit mungon Memo e planifikimit, pra Projekt Drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit.

Në Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nuk ka të përcaktuar indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë. Rezulton se nuk është kryer procedura sigurimi i cilësisë.

Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. “Për Auditin e Brendshëm Publik”.

Kriteri: Ligji nr. 114/2015, datë 22.10.2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 12 dhe neni 14 pika iv, Manuali i AB të miratuar me Urdhrin nr. 100, datë 25.10.2016 të Ministrisë të Financave “Për miratimin e Manualit të AB në sektorin publik” Kapitullin VII pika 2.4.1, 2.4.2, pikën 7.1.1, kapitulli IV pikat 4.1.7 - 4.1.12 kapitulli IV pika 4.1.1, pika 4.1.12; kapitulli VI, pika 6.1; Kapitulli VII, pika 7.1.1.

Ndikimi/Efekti: Nuk jep siguri të arsyeshme për objektivat e përcaktuara nga Institucioni. Nuk pasqyron aktivitetin e drejtorive me risk të lartë.

Shkaku: Nga neglizhenca, dhe mos përmbushja e angazhimeve për auditim sipas planifikimit

të bërë.

Rëndësia: E Mesme

2.2 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

1. Programimi PBA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitet 2022-2024.

PBA janë hartuar pjesërisht bazuar në Udhëzimin e MFE nr. 23 datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor Afatmesëm të njëjësive të Qeverisjes Vendore”. Është marrë në konsideratë instrumenti i planifikimit financiar, i cili përbëhet nga: struktura financiare, struktura funksionale, shpenzimet e viteve të kaluara, burimet e financimit të viteve të kaluara, detyrimet e prapambetura, trashëgimi me destinacion (*kontratat në vazhdim*), angazhimet (*detyrimet e prapambetura sipas llojit*), tavanet, llogaria ekonomike, vlerësimi i burimeve të ardhurat, përmbledhje të kërkesës buxhetore për secilin program shpenzimet e pritshme (*kostot direkt dhe të ardhurat e pritshme*).

Nga auditimi i procedurave të PBA-së për vitin 2022-2024 u konstatua se përgjithësisht janë realizuar fazat e përgatitjes buxhetore.

PBA për periudhën 2022-2024 është miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendim nr. 177 datë 23.12.2021 “Për miratimin e Buxhetit Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë më shkresën nr. 1049/6, datë 07.01.2022.

Si fusha me prioritet për investime në bashkinë Lezhë janë konsideruar:

- a. *Infrastruktura rrugore;*
- b. *Urbanistika;*
- c. *Furnizimi me ujë të pijshëm;*
- d. *Arsimi bazë;*
- e. *Shërbimi zjarrfikës;*
- f. *Sport dhe argëtim.*

Burimet e financimit të buxhetit të Bashkisë për vitin 2022, realizohen nga dy burime:

Nga burimet e veta vendore, ku përfshihen të ardhurat nga taksat vendore dhe taksat e ndara, të ardhurat nga tarifat vendore, të ardhura të tjera, donacione dhe të ardhura që trashëgohen;

Nga burimet qendrore, ku përfshihen transfertat e pakushtëzuar, transfertat specifike për funksionet e reja, që i janë transferuar Bashkisë dhe transfertat e kushtëzuar.

Planifikimi dhe realizimi i buxhetit për vitet 2022-2024, paraqitet sipas situacionit të rakorduar me thesarin. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet planifikimi sipas PBA-ve dhe buxheti vjetor.

Tabela nr. 1 PBA 2022-2024 me planin buxhetor 2022, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Në lekë

| Nr. | Emërtimi | Plani përfundimtar 2022 | Sipas PBA 2022-2024 | Ndryshimi |
|-----|---|-------------------------|----------------------|-------------------|
| 1 | Shpenzime për pagat (600+601) | 543,008,000 | 543,008,000 | 0 |
| 2 | Shpenzime (602.604.606.609) | 424,480,000 | 424,480,000 | 0 |
| 3 | Investime Bashkia | 347,158,000 | 347,158,000 | 0 |
| 4 | Investime nga FZSHH | 0 | 0 | 0 |
| | Total i planit fillestar | 1,314,646,000 | 1,314,646,000 | 0 |
| | Shtesat nga Pushteti Qendror | 85,411,711 | | 85,411,711 |
| 5 | Investime | 44,466,448 | 0 | 44,466,448 |
| 6 | Shpenzime për pagat -sigurime | 9,827,263 | 0 | 9,827,263 |
| 7 | Shpenzime operative | 28,358,000 | 0 | 28,358,000 |
| 8 | Transferta familjeve dhe individëve (606) | 2,760,000 | 0 | 2,760,000 |
| | Gjithsej | 1,400,057,711 | 1,314,646,000 | 85,411,711 |

Burimi : Bashkia Lezhë përpunuar nga grupi i auditimit

Referuar tabelës së mësipërme, vërehet se plani përfundimtar për vitin 2022 është në vlerën 1,400,057,711 lekë, ndërsa sipas planit të PBA 2022-2024 është 1,314,646,000 lekë, ndryshimet janë në vlerën 85,411,711 lekë.

Në veçanti nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA për periudhën 2022, por në dosje administrohet vetëm VKB nr. 52., datë 31.03.2021 për miratimin e tavanëve përgatitore për PBA 2022-2024, i cili nuk ka dalë në përputhje me përcaktimin e bërë pikën 6 të nenit 34 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

-Për hartimin e PBA 2022-2024 janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Lezhë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

- Për PBA 2012-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 37 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si vijon:

“Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik”.

- Për PBA 2022-2024 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit.

-Nuk dokumentohet në dosje dokumenti për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm ku thuhet se :

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 korrik 2021, merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024.

-Pjesë e dokumentacionit të Projekt-dokumentit të PBA 2022-2024 që duhet dërguar në MFE si edhe në Këshillin Bashkiak janë vetëm formatet output, të cilat gjenerohen nga Instrumenti i Planifikimit Financiar.

-Në buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”.

Titulli i gjetjes: Zbatimi i Procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024.

Situata: *Në veçanti nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:*

Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA për periudhën 2022, por në dosje administrohet vetëm VKB nr. 52., datë 31.03.2021 për miratimin e tavanëve përgatitore për PBA 2022-2024, i cili nuk ka dalë në përputhje me përcaktimin e bërë pikën 6 të nenit 34 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

-Për hartimin e PBA 2022-2024 janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Lezhë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

- Për PBA 2012-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 37 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”, si vijon:

“Bazuar në vlerësimet dhe parashikimet afatmesme të përditësuara të të ardhurave dhe transfertave nga Buxheti i Shtetit, të përcaktuara në udhëzimin plotësues të përgatitjes së

buxhetit vendor të Ministrisë së Financave, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit dhe paraqet për miratim në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm në nivel programi. Këshilli i njësisë së vetëqeverisjes vendore miraton tavanet përfundimtare të shpenzimeve të programit buxhetor afatmesëm brenda datës 20 korrik”.

- Për PBA 2022-2024 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit.

-Nuk dokumentohet në dosje dokumenti për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm ku thuhet se :

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 korrik 2021, merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024.

-Pjese e dokumentacionit të Projekt-dokumentit të PBA 2022-2024 që duhet dërguar në MFE si edhe në Këshillin Bashkiak janë vetëm formatet output, të cilat gjenerohen nga Instrumenti i Planifikimit Financiar.

-Në buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”, hyrë në fuqi më datë 13.06.2020.

Kriteri: Shkronja “ç” e nenit 5, pika 1 e nenit 33, pika 6 e nenit 34, pika 1 e nenit 35, pika 1 e nenit 37, pika 2 e nenit 39 dhe pika 3 e nenit 41, në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

Pika 5 e nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 4.5.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, në fuqi për periudhën deri më datë 12.06.2020, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet.

Pika 29, shkronjat “a-h” të pikës 38 në Udhëzimin nr. 23, datë 30.07.2018 “Për procedurat standarde të përgatitjes së programit buxhetor afatmesëm të njësive të vetëqeverisjes vendore”.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Efkti: Planifikim jo i saktë dhe real i kërkesave buxhetore, si dhe mos kryerjen e investimeve në fusha të caktuara të aktivitetit të Bashkisë Lezhë.

Rëndësia: I Mesëm.

2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fonde të çelura.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vëna në dispozicion nga Pushteti Qendror nëpërmjet transfertës së pakushtëzuar, transfertës së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të grandeve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit, si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, grandeve qeveritare, si ndihma ekonomike, gjendja civile, shpërblime lindje, etj., të cilat kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestare të vitit duke u bazuar në faktin e vitit paraardhës.

Gjatë vitit janë kryer ndryshime në buxhet (shitesa/pakësime). Këto lëvizje, në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit, e përcaktuar kjo me VKB, ndërsa lëvizjet ndërmjet programeve buxhetore janë kryer me Vendim të KB.

Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”.

Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduara me Degën e Thesarit Lezhë dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periudhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudhën e ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve, sipas periudhave të planifikuara.

Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dega e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit, duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periudhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të çeljes së buxhetit.

Ndarja e plan buxheteve sipas strukturës dhe çelja e fondeve është realizuar sipas detajimeve të bëra në fillim të vitit ushtrimor, duke reflektuar ndryshimet e diktuar sipas nevojave të mbështetura në kriteret ligjore gjatë ushtrimit të veprimtarisë.

Nga auditimi i dokumentacionit që shoqëron plan-buxhetet për periudhën 2022-2024, rezultoi se është realizuar në nivel titulli, kapitulli, artikulli e nën artikulli, duke respektuar disiplinën buxhetore sipas strukturës buxhetore dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit buxhetor, buxheti i Bashkisë Lezhë ka pësuar ndryshime nëpërmjet vendimeve të Këshillit Bashkiak, ndryshime të cilat për çdo rast janë shoqëruar me praktikën përkatëse për ndryshimin e buxhetit në Degën e Thesarit, e reflektuar normalisht në situacionet e shpenzimeve. Për të gjitha rastet e ndryshimit të buxhetit, VKB-të janë të konfirmuara nga Prefekti i Qarkut Lezhë .

U verifikuan situacionet mujore të rakorduara me Degën e Thesarit Lezhë dhe u gjetën të rakorduara me shpenzimet e kontabilizuara për pjesën e të ardhurave nga taksat dhe tarifat e Bashkisë dhe nga grantet. Të gjitha veprimet për arkëtimet dhe pagesat, për llogari të Bashkisë Lezhë janë kryer në bankat e nivelit të dytë, të cilat janë të dokumentuara dhe të rregullta, edhe në mbështetje të rakordimeve periodike me Degën e Thesarit Lezhë, për çdo muaj dhe në mënyrë progresive. Nga Këshilli i Bashkisë është bërë miratimi i të ardhurave dhe shpenzimeve, sipas burimeve të financimit, strukturës buxhetore dhe institucioneve.

Tabela nr.2 Planifikimi i buxhetit për vitin 2022, Bashkia Lezhë

| Planifikimi i të ardhurave për vitin 2022 | | | | Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022 | | | | |
|---|--|---|-------------------|---|---|----------------|---------------------|--|
| Burimi i të ardhurave | Buxheti fillestar, miratuar me VKB nr. 177, datë 23.12.2021, në bazë të vlerësi-mit të të ardhurave dhe të transfertave të pakushtëzuara, të përcaktuara në ligjin e buxhetit vijtor | Buxheti Shtesë | Vlera në 000/lekë | Emërtimi i zërave | Buxheti fillestar | Buxheti shtesë | Pakësimi i Buxhetit | Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (në 000/lekë) |
| | Miratuar me VKB nr. 5, dt. 01.02.2022 VKB Nr.20, dt. 28.02.2022 shkresa MFE | Miratuar me VKB nr. 177, dt. 23.12.2022 | | | Miratuar me VKB nr. dt. dhe Kryetarit të Bashkisë | | | |
| | 1 | 2 | 1+2+3 | | 4 | 5 | 6 | 4+5+6 |
| Të ardhura të planifikuara për vitin 2022 | 740,000,000 | 0 | 740,000,000 | Art. 600 Paga | 465,308,000 | 24,188,518 | 5,602,418 | 483,894,100 |
| Të ardhurat e veta të trashëguara nga viti i mëparshëm (2021) dhe të planifikuara për shpenzim për vitin 2022 | 0 | 93,567,754 | 93,567,754 | Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 77,700,000 | 4,541,824 | 466,624 | 81,775,200 |

| | | | | | | | | |
|--|----------------------|--------------------|----------------------|---|----------------------|--------------------|-------------------|----------------------|
| Të ardhurat e veta të planifikuara për shpenzim për vitin 2022 | 740,000,000 | 93,567,754 | 833,567,754 | Art.602 Shpenzime operative | 372,723,000 | 97,595,539 | 12,974,839 | 457,343,700 |
| Total të ardhurat e veta | 740,000,000 | 93,567,754 | 833,567,754 | Art. 603 Sponsorizime | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Të ardhura të trashëguara nga transfertat e pakushtëzuar | 0 | 89,435,327 | 89,435,327 | Art.604 Transferime korrente të brendshme | 0 | 13,284,400 | | 13,284,400 |
| Të ardhura të trashëguara nga transfertat specifikë | 0 | 22,773,083 | 22,773,083 | Art. 606 Transferime buxhetit familjar dhe individë | 30,415,000 | 12,040,649 | 0 | 42,455,649 |
| Transferta e pa kushtëzuar e çelur për llogari të vitit 2022 | 340,463,000 | 80,424,448 | 420,887,448 | Art.651-166 kredi dhe interesi | 11,129,000 | 0 | 0 | 11,129,000 |
| Transferta specifikë e çelur për llogari të vitit 2022 | 234,183,000 | 4,987,263 | 239,170,263 | Art. 230-231 Investime | 347,158,000 | 206,706,008 | 40,749,133 | 513,114,875 |
| Total të ardhurat nga transfertat e buxhetit të shtetit | 574,646,000 | 197,620,121 | 772,266,121 | Fondi Rezervë + Kontigjencës | 10,213,000 | 0 | 7,376,049 | 2,836,951 |
| TOTALI TE ARDHURAVE | 1,314,646,000 | 291,187,875 | 1,605,833,875 | TOTALI SHPENZI MEVE | 1,314,646,000 | 358,356,938 | 67,169,063 | 1,605,833,875 |

Burimi: Bashkia Lezhë përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Rezulton se buxheti i konsoliduar (Bashki+Njësia e Varësisë Agjencia e Shërbimeve Komunale) vitit 2022 është miratuar i balancuar dhe pa defiqite. Të ardhurat dhe shpenzimet fillestare të miratuara janë në shumën **1,605,833,875 lekë**.

Tabela nr. 3 Ndryshimet buxhetore për vitin 2022

| Emërtimi i zërave | Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2022 dhe rishpërndarja e fondeve | | | | | | | | | | | |
|--|--|------------------------------------|---------------------------------|--------------------------------------|-------------------------------------|--------------------------------------|--------------------|---------------------------------------|----------------------------------|-------------------------|----------------------|---|
| | Buxheti fillestar | Buxheti shtesë | | | | | Pakësimi Buxhetit | Shtesat dhe Pakësimet buxhet në total | Rishpërndarjet: Shtesa/Pakësimet | | | Vlerat e buxhetit fillestar + buxheti shtesë (000/lekë) |
| | | Miratuar me VKB Nr.177, 23.12.2021 | Miratuar me VKB Nr. dt.01.02.22 | Miratuar me VKB Nr. 20, dt.28.2.2022 | Miratuar me VKB Nr.10 dt.23.09.2022 | Miratuar me VKB Nr.13 dt. 20.12.2022 | | | Shkresa MFI | Miratuar me VKB Nr. dt. | Miratuar me VKB | |
| 1 (Vlera) | 2 (Vlera) | 3 (Vlera) | 4 (Vlera) | 5 (Vlera) | 6 (Vlera) | 7 (Vlera) | 8=2+3+4+5+6-7 | 9 (Vlera) | 10 (Vlera) | 11=9+10 | 13=1+6+11 | |
| Art. 600 Paga | 465,308,000 | 6,245,000 | 14,630,097 | 1,908,537 | 0 | 0 | 22,783,634 | 1,404,884 | -5,602,418 | -4,197,534 | 483,894,100 | |
| Art.601 Sigurime shoqërore dhe shëndetësore | 77,700,000 | 1,043,000 | 2,945,482 | 318,726 | 0 | 0 | 4,307,208 | 234,616 | -466,624 | -232,008 | 81,775,200 | |
| Art.602 Shpenzime operative | 372,723,000 | 0 | 23,372,176 | 0 | 28,358,000 | 0 | 51,730,176 | 45,865,363 | -12,974,839 | 32,890,524 | 457,343,700 | |
| Art. 603 Sponsorizime | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| Art.604 Transferime korrente të brendshme | 0 | 0 | 4,400 | 0 | 0 | 0 | 4,400 | 0 | 13,280,000 | 13,280,000 | 13,284,400 | |
| Art. 606 Transferime të buxhetit familjar dhe individë | 30,415,000 | 312,000 | 2,584,449 | 0 | 0 | 2,760,000 | 5,656,449 | 90,000 | 6,294,200 | 6,384,200 | 42,455,649 | |
| Art.651-166 Kredia-Interesi | 11,129,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 11,129,000 | |
| Art. 230-231 Investime | 347,158,000 | 0 | 162,239,560 | 0 | 35,800,000 | 8,666,448 | 206,706,008 | -40,218,814 | -530,319 | -40,749,133 | 513,114,875 | |
| Fondi Rezervë+Kontigjencës (609) | 10,213,000 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | -7,376,049 | 0 | -7,376,049 | 2,836,951 | |
| TOTALI SHPENZIMEVE | 1,314,646,000 | 7,600,000 | 205,776,164 | 2,227,263 | 64,158,000 | 11,426,448 | 291,187,875 | 0 | 0 | 0 | 1,605,833,875 | |

Burimi: Bashkia Lezhë përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Mbështetur në përcaktimin e bërë në pikën 149 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, në gjykimin e grupit të auditimit ndryshimet buxhetore përgjatë vitit buxhetor, tregojnë për një performancë jo të mirë në planifikimin dhe zbatimin e buxhetit.

3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

Për zbatimin e buxhetit është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit Lezhë, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kufijtë

e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikulli sipas klasifikimit ekonomik. Në të gjithë periudhën e audituar në përgjithësi janë respektuar procedurat ligjore për çeljen e fondeve me Degën e Thesarit Lezhë, duke pasqyruar rregullisht dhe periodikisht ndryshimet në buxhetin fillestar për vitin respektiv, të realizuar me Vendim të Kryetarit të Bashkisë ose të diktuar nga Transferta e deleguar nga pushteti qendror.

Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit për periudhën 2022-2024, referuar akt-rekomandimeve me thesarin paraqitet në tabelën e mëposhtme;

Tabela nr. 4 Realizimi i buxhetit në nivel artikulli ekonomik – viti 2022

| Art. | Emertimi | Plani progresiv | Fakti | % |
|----------|---------------------------------|----------------------|----------------------|-------------|
| 600 | Paga | 483,894,100 | 421,480,007 | 87.1 |
| 601 | Sigurime Shoqërore | 81,775,200 | 70,256,606 | 85.9 |
| 602 | Mallra dhe Shërbime të Tjera | 457,343,700 | 344,119,237 | 75.2 |
| 604 | Transferta Korente të Brendshme | 13,284,400 | 12,077,099 | 90.9 |
| 606-609 | Trans per Buxh. Fam. & Individ | 45,292,600 | 25,870,517 | 57.1 |
| 651- 166 | Kredi + Intresi | 11,129,000 | 11,089,722 | 99.6 |
| 230 | Kapitale të Patrupëzuara | 17,624,000 | 17,623,969 | 100.0 |
| 231 | Kapitale të Trupëzuara | 495,490,875 | 256,789,380 | 51.8 |
| | TOTAL | 1,605,833,875 | 1,159,306,537 | 72.2 |

Burimi: Bashkia Lezhë , përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Referuar të dhënave të pasqyrës së mësipërme rezulton se për vitin 2022 realizimi i shpenzimeve sipas artikujve ekonomik është 72.2 %, ku realizimin më të lartë e ka artikulli 230 “Kapitale të pa trupëzuara ”, duke vijuar me 604 Transferta Korente të Brendshme, si dhe realizimin më të ulët e kanë kapitalet e trupëzuara 51.8 %. Vihet re se për vitin 2022 art. (606) transferta për buxhet te familjarët dhe individët paraqitet në masën 57.1 %, pra në krahasim me artikujt e tjerë ekonomik, ka realizimin më të ulët.

Tabela nr. 5 Realizimi i buxhetit sipas burimeve të financimit

| | | Buxheti përfundimtar Plan-Fakt. | | | | | | | | | | Në |
|-----|---|--|---------------|-------------|----------------------|--------------------------------|-------------------------------|---------------------------------------|-------------------|--|-------------|--|
| | | lekë | | | | | | | | | | |
| | | Burimi i financimit të shpenzimit të realizuar | | | | | | | | | | |
| Nr. | Përshkrimi Shpenzimeve | Plani | Fakti | Realizimi % | Nga ardhurat të veta | % e realizimit nga të ardhurat | Nga Granti Qeveritar | | | | | Nga transferta e kushtëzuar për investimet |
| | | | | | | | Nga transferta e pakushtëzuar | Nga transferta e kushtëzuar specifike | Nga Sponsorizimet | Nga transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara | | |
| 1 | Paga 600 | 492,444,100 | 429,947,844 | 87.3 | 6,986,157 | 1.6 | 263,075,129 | 151,418,721 | 0 | 8,467,837 | 0 | |
| 2 | Sigurime shoqërore 601 | 83,355,200 | 71,663,615 | 86.0 | 1,177,300 | 1.6 | 43,870,080 | 25,209,226 | 0 | 1,407,009 | 0 | |
| 3 | Shpenz. Operative 602 | 519,304,800 | 389,991,920 | 75.1 | 271,794,089 | 69.7 | 51,794,271 | 20,530,877 | 0 | 941,663 | 44,931,020 | |
| 4 | Subvencione 603 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0.0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 5 | Transferta Korrente të brendshme 604 | 13,284,400 | 12,077,099 | 90.9 | 12,077,099 | 100.0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 6 | Transferta familje dhe individe 606-609 | 964,862,500 | 763,691,694 | 79.2 | 13,601,262 | 1.8 | 6,327,000 | 6,037,605 | 0 | 706,699,904 | 31,025,923 | |
| 7 | Kredia + principali 651-166 | 11,129,000 | 11,089,722 | 99.6 | 0 | 0.0 | 11,089,722 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| 8 | Investime 230-231 | 1,720,829,100 | 1,374,566,975 | 79.9 | 181,140,207 | 13.2 | 93,177,792 | 0 | 0 | 191,473,780 | 908,775,196 | |

| | | | | | | | | | | |
|--------|---------------|---------------|------|-------------|------|-------------|-------------|---|-------------|-------------|
| Totali | 3,805,209,100 | 3,053,028,869 | 80.2 | 486,776,114 | 15.9 | 469,333,994 | 203,196,429 | 0 | 908,990,193 | 984,732,139 |
|--------|---------------|---------------|------|-------------|------|-------------|-------------|---|-------------|-------------|

Burimi: Bashkia Lezhë , përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Referuar tabelës së mësipërme, rezulton se fondet e shpenzuara nga transferta e kushtëzuar për investime, në vlerën 984,732,139 lekë, kanë peshën më të lartë në krahasim me burimet e tjera të të ardhurave të Bashkisë Lezhë , ndjekur nga transferta e pakushtëzuar për funksionet e deleguara në vlerën 908,990,193 lekë dhe transferta e pa kushtëzuar kushtëzuar në vlerën 469,333,994 lekë.

Transferta e kushtëzuar për funksionet e deleguara.

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2022 është realizuar në vlerën 908,990,193 lekë, ose 29.7 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për funksionet e deleguara, e zënë transferta për familje dhe individ, dhe për investime.

Transferta e kushtëzuar për Investime.

-Buxheti nga transferta e kushtëzuar për investime për vitin 2022 është realizuar në vlerën 984,732,139 lekë, ose 32.2% e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës kushtëzuar për investime, e zënë shpenzimet për investime.

Transferta e pakushtëzuar.

-Buxheti nga transferta e pakushtëzuar për vitin 2022 është realizuar në vlerën 469,333,994 lekë, ose 15.3 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës së pakushtëzuar, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe shpenzime operative dhe për investime.

Të ardhurat e veta.

-Buxheti nga të ardhurat e veta për vitin 2022 është realizuar në vlerën 486,776,114 lekë, ose 15.9 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda të ardhurave të veta, e zënë fondet e shpenzuara për paga, investime dhe shpenzime operative.

Transferta kushtëzuar specifike.

-Buxheti nga transferta specifike për vitin 2022 është realizuar në vlerën 203,196,429 lekë, ose 6.6 % e buxhetit total të shpenzuar për vitin 2022, ku peshën kryesore brenda transfertës specifike, e zënë fondet e shpenzuara për paga dhe sigurime shoqërore.

Miratimi dhe përdorimi i fondit rezervë dhe të kontigjencës.

Në buxhetin e vitit 2022 është planifikuar fondi rezervë dhe i kontigjencës në shumën 7,376,049 lekë i cili është përdorur me Vendime të Këshillit Bashkiak si më poshtë:

Tabela nr. 6

| Nr | VKB Nr. Datë | Shuma në lekë | Përdorimi |
|---------------|-------------------------|------------------|---|
| 1 | Nr.40, datë 19.04.2022 | 944,000 | 231 Investime - Blerje automjetesh |
| 2 | Nr.43, datë 27.04.2022 | 1,274,500 | 600 Paga 1,092,116 lekë 601 Sigurime 182,384 leke |
| 3 | Nr.46, datë 04.05.2022 | 854,108 | 231 Investime Rikonstruksion i Qëndres Rinore Lezhë |
| 4 | Nr.88, datë 28.07.2022 | 2,788,707 | 602 Mallra e shërbime Likujdim detyrime të prapambetura |
| 5 | Nr.95, datë 29.08.2022 | 60,000 | 606 Shpenzime varrimi për 2 persona të vetmuar |
| 6 | Nr.101, datë 23.09.2022 | 30,000 | 606 Shpenzime varrimi për 1 personë të vetmuar |
| 7 | Nr.115, datë 31.10.2022 | 1,200,000 | 602 Shpenzime për Ekipin e Basketbollit |
| 8 | Nr.123, datë 02.12.2022 | 224,734 | 231 Investime Këndi i Lojrave Rrilë |
| TOTALI | | 7,376,049 | |

Burimi: Bashkia Lezhë , përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Miratimi dhe përdorimi i fondit të emergjencave civile.

Në buxhetin e vitit 2022 është planifikuar fondi i emergjencave civile në shumën 25,533,431Lekë i cili është përdorur me Vendime të Këshillit Bashkiak si më poshtë:

Tabela nr. 7

| Nr | VKB Nr. Datë | Shuma në lekë | Përdorimi |
|---------------|-------------------------|-------------------|---|
| 1 | Nr.18, datë 28.02.2022 | 198,653 | 606 Ndihmë financiare për djegie banese |
| 2 | Nr.20, datë 28.02.2022 | 88,650 | 606 Ndihmë financiare për djegie banese |
| 3 | Nr.21, datë 28.02.2022 | 102,000 | 606 Ndihmë financiare për qira banese |
| 4 | Nr.50, datë 25.05.2022 | 1,196,268 | 231 Investime Ndërtim i murit mbajtës të rrugës Spiten-Prull |
| 5 | Nr.51, datë 25.05.2022 | 230,231 | 606 Ndihmë financiare për djegie banese |
| 6 | Nr.80, datë 06.07.2022 | 23,200,283 | 231 Rehabilitim i murit mbajtës të rrugës së Spitalit Lezhë |
| 7 | Nr.84, datë 28.07.2022 | 185,146 | 606 Ndihmë financiare për dëmtim banese |
| 8 | Nr.87, datë 28.07.2022 | 232,200 | 606 Qira banese për 4 familje të dala pastreha nga dëmtimi i banesave |
| 9 | Nr.136, datë 20.12.2022 | 100,000 | 602 Blerje pako ushqimore për familjet e përmytura |
| TOTALI | | 25,533,431 | |

Burimi: Bashkia Lezhë , përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Subvencionet nga/dhe për Bashkinë Lezhë.

Nga dokumentacioni i paraqitur, rezulton se Bashkia Lezhë përgjatë periudhës 2022 nuk ka marrë nuk ka dhënë asnjë subvencion.

Realizimi i Investimeve.

Nga auditimi grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet jo të mira në vitin 2022, konkretisht në masën 72.2 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Lezhë në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Neni 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Raportet e Monitorimit

Në zbatim të nenit 48 “Monitorimi dhe raportimi i zbatimit të buxhetit vendor” të ligjit 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligjin organik të buxhetit nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar neni 65, UMF nr. 2, datë 06.02.2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit” i ndryshuar, udhëzimin nr. 22 dt.30.07.2018 “Për Procedurat standarde të Monitorimit të Buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Vendore”, si dhe nenin 44¹⁰, të ligjit nr. 139/2015 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”.

Për vitin 2022 nga Bashkia Lezhë janë përgatitur 3 raporte për monitorimin e procesit të zbatimit të buxhetit. Raporti i monitorimit 4 mujorin e parë me nr. 1107/1 Prot, datë 10.06.2022, raporti i

Titulli i gjetjes: Planifikimi i procedurave për investime, shërbime dhe blerje malli.

Situata: Nga auditimi grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet jo të mira në vitin 2022, konkretisht në masën 72.2 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Lezhë në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u

mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifatat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Neni 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Kriteri: Shkronja “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”; Neni 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Shkaku: Planifikim i procedurave të prokurimeve për mallra/shërbime dhe investime, pa një studim të mirëfilltë, duke i planifikuar ato në raport me planin dhe jo me faktin e të ardhurave të vitit të mëparshëm.

Efkti: Mos realizim i investimeve të planifikuara.

Rëndësia: I Lartë.

Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lezhë dhe Drejtoria e Financës dhe të Ardhurave, të marrë masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i faturave të palikujduara, vendimet gjyqësore, vendimet e shpronësimeve.

Me miratimin e fondeve sipas funksioneve dhe zërave të shpenzimeve prioritet kanë detyrimet e paguara të vitit paraardhës. Lidhur me detyrimet e konstatuara nga Bashkia Lezhë, rezultojnë se është bërë planifikimi i likuidimit të tyre për çdo vit buxhetor, si dhe në fund të vitit 2022 janë raportuar në Këshillin Bashkiak dhe MFE, pra jo raportim periodik të tyre.

Me fondet buxhetore të vitit 2022, përgjithësisht janë likuiduar edhe detyrimet për fatura të palikuiduara nga vitet e mëparshme, duke bërë pjesë-pjesë pagesat e detyrimeve kontraktuale. Sipas raportimit të kryer në strukturat/institucionet e mësipërme, shuma e detyrimit përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 ka ardhur duke u rritur. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohet zhvillimi i shumës së detyrimit përgjatë vitit 2022.

Tabela nr. 8

Detyrimet e prapambetura për periudhën 2022

| Emerimi i detyrimit të prapambetura | Detyrimi prapambetur progresiv më 31.12.2021 | Vlera e planifikuar për likuidim në planin e buxhetit 2022 për detyrimet e prapambetura | Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur (vlera e paguar për kolonën 3) | Vlera e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 (pa detyrimet e krijuara gjatë vitit 2022) | Detyrim i prapambetur i krijuar vetëm gjatë vitit 2022, i cili nuk është likuiduar gjatë vitit 2022 (situata më 31.12.2022) | Vlera totale e detyrimeve të prapambetura më 31.12.2022 | Fondet e papërdorura në fund të vitit 2022 të cilat trashëgohen në vitin 2023 |
|---|--|---|--|--|---|---|---|
| 2 | 3 | 4 | 5 | 6=3-5 | 7 | 8=6+7 | |
| Detyrime që kanë si burim financimi të ardhurat e veta | | | | | | | |
| Detyrime për vendime gjyqësore | 1,022,164 | 0 | 1,022,164 | 0 | 0 | 14,172,364 | 159,327,237 |
| Detyrime për shërbime | 49,166,775 | 15,000,000 | 49,166,775 | 0 | 29,014,494 | 29,014,494 | |
| Detyrime për mirëmbajtje | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| Detyrime për investime | 85,330,485 | 100,000,000 | 34,719,314 | 50,611,171 | 0 | 50,611,171 | |
| Detyrime për mallra | 12,081,307 | 3,000,000 | 12,081,307 | 0 | 10,205,374 | 10,205,374 | |
| Detyrime të tjera | 126,027,087 | 0 | 126,027,087 | 0 | 0 | 0 | |
| Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi të ardhurat e veta | 273,627,818 | 118,000,000 | 223,016,647 | 50,611,171 | 39,219,868 | 104,003,403 | |
| II. Detyrime të prapambetura nga granti (FSHZH etj (Ministritë e linjës) | | | | | | | |
| Detyrime për Investime nga Ministritë e Linjës (Min. e Infrastruktues) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| Detyrime për vendime gjyqësore (Min. e Brendshme për punonjës të Gj.Civile) | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |
| Totali i detyrimeve që kanë si burim financimi | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 | |

| | | | | | | | |
|---|-------------|-------------|-------------|------------|------------|-------------|--|
| Detyrime ne total nga të ardhurat e veta + granti | 273,627,818 | 118,000,000 | 223,016,647 | 50,611,171 | 39,219,868 | 104,003,403 | |
|---|-------------|-------------|-------------|------------|------------|-------------|--|

Burimi: Bashkia Lezhë , përpunuar nga grupi i auditimit.

Vlera e detyrimeve të mësipërme është kryqëzuar me vlerën e detyrimeve që Bashkia Lezhë ka ndaj palëve të treta, të pasqyruar në Pasqyrat Financiare të vitit 2022, si dhe dokumentacionin justifikues dhe detyruës (faturë tatimore/vendim gjykate) që krijon detyrimin përkatës.

-Nga shqyrtimi i raportit të vetëvlerësimit financiar për vitin 2022, përcjellë në MFE me shkresën nr. 5443 prot., datë 23.05.2023, rezulton se vlera e detyrimeve të prapambetura të Bashkisë Lezhë ndaj palëve të treta raportuar në MFE është në vlerën 89,831,039 lekë, e cila përbëhet nga detyrime për shpenzime korrente, shpenzime kapitale, pasqyruar në tabelën më poshtë:

Tabela nr. 9 Situata Financiare për vitin 2022.

| Nr. | Emërtimi | Stoku në vlerë | Totali i shpenzimeve të miratuara për NJVQV-në | Stoku/Shpenzimeve totale të miratuara të NJQV-së |
|------------|--------------------------|--------------------|--|--|
| I | Borxhe (a+b) | 8,347,481 | | 0.64 % |
| a | Hua afatgjatë | 8,347,481 | | |
| a,1 | Principali | 8,178,221 | | |
| a,2 | Interesi | 169,260 | | |
| b | Hua afatshkurtër | - | | |
| b,1 | Hua | 0 | | |
| b,2 | Overdrafte | 0 | | |
| b,3 | Kredi të furnitorëve | 0 | | |
| II | Detyrime (a+b+c) | 104,003,403 | | 7.91 % |
| a | Shpenzime korrente | 39,219,868 | | |
| a,1 | Mallra dhe shërbime | 39,219,868 | | |
| a,2 | Paga dhe sigurime | 0 | | |
| a,3 | Të tjera | 0 | | |
| b | Shenzime kapitale | 50,611,171 | | |
| b,1 | Insituacione buxhetore | 0 | | |
| b,2 | Subjekte private | 50,611,171 | | |
| c | Vendime gjyqësore | 0 | | |
| c,1 | Marrëdhënie pune | 2,810,080 | | |
| c,2 | Mallra dhe shërbime | 0 | | |
| c,3 | Investime | 0 | | |
| c,4 | Të tjera | 11,362,284 | | |
| III | Totali (I+II) | 118,175,767 | 1,314,646,000 | 8.9% |

Burimi: Bashkia Lezhë , përpunuar nga grupi i auditimit.

-Në vijim parashtrojmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, çfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:

-Nga verifikimi i ditarit të bankës për periudhën Janar-Mars 2023, me qëllim kryerjen e verifikimit nëse përgjatë kësaj periudhe janë kryer likujdime të detyrimeve të prapambetura për llogari të vitit 2022, rezultoi se nga Bashkia Lezhë janë kryer 3 pagesa në vlerën 5,082,537 lekë për likujdimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë, të cilat kanë dalë në muajin Shtator të vitit 2022 dhe deri në datën 31.12.2022 nuk janë likujduar. Në këto kushte detyrimi i mësipërm duhet të ishin pasqyruar tek raporti i stokut të detyrimeve të prapambetura. Pra stoku i detyrimeve të prapambetura është në vlerën 118,175,767 lekë.

“Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta”, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontratë, faturë ose sipas ligjit”.

“Detyrimet e prapambetura regjistrohen në llogarinë ekonomike nr. 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”¹¹.

Në vijim parashtrijmë përcaktimet e bëra për detyrimet e prapambetura, çfarë përfaqësojnë dhe cilat detyrime përfshihen:

“Detyrime të prapambetura ndaj palëve të treta”, nënkupton të gjitha llojet e detyrimeve financiare të NJVQV-ve, të pa paguara brenda 60 ditëve kalendarike (30 ditë për procedurat 3 e aprovimit në njësinë shpenzuese dhe 30 ditë për procedurat e miratimit e procesimit të pagesës në degën e thesarit) nga data e pagesës së specifikuar në kontratë, faturë ose sipas ligjit”.

“Detyrimet e prapambetura regjistrohen në llogarinë ekonomike nr. 4864 “Shpenzime të periudhave të ardhshme për detyrime të prapambetura”¹².

“Njësitë e qeverisjes së përgjithshme përpara mbylljes së llogarive vjetore 2022, kryejnë veprimin e mbylljes së llogarisë nr. 486 në debi të llogarisë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm për totalin e detyrimeve të prapambetura që figurojnë në llogari në datën 31.12.2022”¹³.

-Pra sa më sipër vlera e stokut të detyrimeve të prapambetura është në masën 8.9 % ndaj totalit të shpenzimeve të miratuara për vitin 2022.

Stoku i detyrimeve të prapambetura ndaj palëve të treta paraqitet më pak se 13 % të shpenzimeve vjetore të miratuara, **ç’ ka do të thotë se Bashkia Lezhë në fund të vitit 2022 rezulton në një situatë normale.**

-Detyrimet nga vendimet gjyqësore

Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2021 detyrimi i prapambetur është në vlerën 1,022,164 lekë. Për vitin 2022 nuk është parashikuar likudimi i detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore. Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur për vendimet gjyqësore rezulton te jetë në vlerën 1,022,164 lekë. Si rrjedhojë e Vendimit nr.345 prot ., datë 15.09.2022 në vlerën 1,966,120 nuk rezulton të jetë pasqyruar si vlerë e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 edhe pse vendimi i formes së prerë është me datë 15.09.2022 .

Gjithashtu dhe për vendimin me nr. 346. Prot datë 15.09.2022 për vlerën 843,960 lekë konsatohet se nuk është pasqyruar si vlerë e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 edhe pse vendimi i formes së prerë është me datë 15.09.2022. Ekzekutim vendimi gjyqësor-Kesti 6 -V.GJ 2,272,457 lekë Vendim nr.720/53 dt.27.11.2018. Vendimet gjyqësore janë paguar në vitin 2023 në vlerën 5,082,537 lekë, për llogari të vitit 2022.

Pra në total kemi të bëjmë më një detyrimi në fund të vitit 31.12.2022 në vlerën 2,810,080 lekë

Vendime gjyqësore për Marrëdhënie pune dhe në vlerën 11,362,284 lekë për çështje të tjera të ndryshme. vlerë e cila nuk është e raportuar si detyrim i prapambetur nga vendimet gjyqësore.

-Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 8 dhe Pikën 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njërive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. Udhëzimin e MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”.

-Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar”.

Faturat e palikuiduara brenda afatit 30 ditor.

Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqërues në Degën e Thesarit Lezhë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2022, ky afat nuk është respektuar në 20 raste për vlerën 106,457,953 lekë , pasqyruar në tabelën përmbledhëse më poshtë dhe tabelën analitike nr. në Kapitullin “Aneksë”.

Tabela nr. 10 Përmbledhëse e faturave për vitin 2022

| Nr. | PeriU | Llog.602 | | Llog.230+231 | | Shuma | |
|-----|-----------|----------|------------|--------------|------------|-------|-------------|
| | | Nr. | Vlera | Nr. | Vlera | Nr. | Vlera |
| 1 | Viti 2022 | 10 | 67,213,065 | 10 | 39,244,868 | 20 | 106,457,933 |

Burimi : Bashkia Lezhë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Për periudhën deri në fund të vitit 2022 janë 20 fatura të palikuiduara për shpenzime për investime, shpenzime ,shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 106,457,933 lekë.

Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet radha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë, ilustruar me disa raste.

Konkretisht për rastin e detyrimit ndaj subjektit:

-Konkretisht për detyrimin sistemim . asfaltim i rrugës qendër Kakarriq gocaj –R detyrim i lindur në vitin 2019 për vlerën 5,245,680 lekë dhe likujduar ne me urdhër shpenzimit nr. 551 prot., datë 05.04.2022 ndërkohë që janë kryer likujdime përpara kësaj date për detyrime të krijuara në vitin 2022 pra shumë kohë më pas.

-Paguat Sistemim asfaltim i rrugëve te brendshme L. Pukjanëve - R paguar me urdhër shërbimit nr. 552 prot., në datën 15.04.2022, detyrim i lindur në vitin 2019 për vlerën 5,912,173 lekë.

- paguar për detyrimin blerje materiale kancelarie për nevojat e bashkisë në detyrim të OE- A. sh.p.k pagesë e kryer me urdhër shërbimit nr. 1448 prot., datë 20.10.2022 për detyrimin e krijuar në vitin 2021 për vlerën 2,676,328 lekë.

-Paguat për detyrimin e krijuar ndaj OE- NdreGJ me objekt punime, asfaltim i rrugëve të brendshme fshati Gramsh për vlerën 5,972,719 lekë faturë e paguar me urdhër shërbim nr. 681 prot., datë 12.05.2022, për detyrimin e krijuar në vitin 2019.

Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Titulli i gjetjes: Likuidimi i detyrimeve si rrjedhojë e vendimeve gjyqësore.

Situata: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2021 detyrimi i prapambetur është në vlerën 1,022,164 lekë. Për vitin 2022 nuk është parashikuar likuidimi i detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore. Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur për vendimet gjyqësore rezulton te jetë në vlerën 1,022,164 lekë. Si rrjedhojë e Vendimit nr.345 prot ., datë 15.09.2022 në vlerën 1,966,120 nuk rezulton të jetë pasqyruar si vlerë e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 edhe pse vendimi i formes së prerë është me datë 15.09.2022 .

Gjithashtu dhe për vendimin me nr. 346. Prot datë 15.09.2022 për vlerën 843,960 lekë konsatohet se nuk është pasqyruar si vlerë e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022 edhe pse vendimi i formes së prerë është me datë 15.09.2022. Ekzekutim vendimi gjyqësor-Kesti 6 -V.GJ 2,272,457 lekë Vendim nr.720/53 dt.27.11.2018. Vendimet gjyqësore janë paguar në vitin 2023 në vlerën 5,082,537 lekë, për llogari të vitit 2022.

Pra në total kemi të bëjmë më një detyrim në fund të vitit 31.12.2022 në vlerën 2,810,080 lekë

Vendime gjyqësore për marrëdhënie pune dhe vlera 11,362,284 lekë për çështje të tjera të ndryshme. vlerë e cila nuk është e raportuar si detyrim i prapambetur nga vendimet gjyqësore.

Kriteri: Pikat 8 dhe 60 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar;

Udhëzimi nr.1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësisve të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar”.

Shkaku: Moszbatimi i kuadrit rregullator të fushës, mungesa e planifikimit në buxhet të likuidimit të detyrimeve të prapambetura.

Efekti: Krijimi i detyrimeve të prapambetura, të cilat ndikojnë negativisht në buxhetin e Bashkisë Lezhë.

Titulli gjetjes: Fatura të pa likuiduara brenda afatit 30 ditor, duke krijuar në fund të vitit buxhetor detyrime të prapambetura, si dhe mosrespektimi i rradhës në likuidimin e tyre.

Situata: Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Lezhë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2022, ky afat nuk është respektuar në 20 raste për vlerën 106,457,953 lekë.

Për periudhën deri në fund të vitit 2022 janë 20 fatura të palikuiduara për shpenzime për investime, shpenzime shërbime dhe mirëmbajtje në vlerën 106,457,933 lekë.

Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet radha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë likuidohet më parë, ilustruar me disa raste.

Konkretisht për rastin e detyrimit ndaj subjektit:

-Konkretisht për detyrimin sistemim . asfaltim i rrugës qendër Kakarriq gocaj –R detyrim i lindur në vitin 2019 për vlerën 5,245,680 lekë dhe likuiduar ne me urdhër shpenzimit nr. 551 prot., datë 05.04.2022 ndërkohë që janë kryer likuidime përpara kësaj date për detyrime të krijuara në vitin 2022 pra shumë kohë më pas.

-Paguat Sistemim asfaltim i rrugëve te brendshme L. Pukjaneve - R paguar me urdhër shërbimit nr. 552 prot., në datën 15.04.2022, detyrim i lindur në vitin 2019 për vlerën 5,912,173 lekë.

- paguar për detyrimin blerje materiale kancelarie për nevojat e bashkisë në detyrim të OE-Atom sh.p.k pagesë e kryer me urdhër shërbimit nr. 1448 prot., datë 20.10.2022 për detyrimin e krijuar në vitin 2021 për vlerën 2,676,328 lekë.

-Paguat për detyrimin e krijuar ndaj OE- NdreGJ me objekt punime, asfaltim i rrugëve të brendshme fshati Gramsh për vlerën 5,972,719 lekë faturë e paguar me urdhër shërbim nr. 681 prot., datë 12.05.2022, për detyrimin e krijuar në vitin 2019.

Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Kriteri: Pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar.

Shkaku: Likuidim me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh dhe mos likuidimi i vlerës së plotë të faturës, në pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh, mosrealizim të ardhurash, si dhe mosrespektim i rradhës në likuidimin e detyrimeve të prapambetura.

Efekti: Mos likuidim në kohë i shpenzimeve sjell akumulim të borxhit të institucionit për fatura të palikuiduara.

Rëndësia: I Lartë

5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfituara përmes FZHR/Ministritë e linjës, saktësia e raportimit buxhetor të tyre.

Nga auditimi i evidencave të marra nga Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për vitin 2022, në lidhje me investimet publike, rezultoi se Bashkia Lezhë ka marrë 24 financime projektesh nga Ministrinë e linjës.

Tabela nr. 11

| Nr | Objekti i investimit | Burimi Financimit | Op.Fitues | Dt. Lidhjes kontrates | Vl. Kont. Me tvsh | Afati Ikontrates | Likujduar 31.12.2022 |
|----|--|---|------------------|---------------------------|-------------------|----------------------------------|----------------------|
| 1 | Ndertim ujesjellesi ne fshatrat Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh | Ministria e infrastruktures dhe energjise | SHB,G COMPANY | Nr 4020/7 date 18.06.2020 | 295,856,875 | Amenduar deri me dt 30.08.2022 | 246,323,281 |
| 2 | Supervizim Ndertim ujesjellesi ne fshatrat Pllane, Zejmen, Markatomaj, Spiten, Tresh | Ministria e infrastruktures dhe energjise | XH M shpk | Nr 9139/8 date 21.07.2020 | 3,149,752 | | 2,229,949 |
| 3 | Ndretim Ujesjellesi ne fshatrat Pllane,Markatomaj, Zejmen,Spiten,Tresh---LOTI i 2 | Ministria e infrastruktures dhe energjise | SH Shpk& N | Nr 23130/12 dt 07.04.2021 | 160,621,066 | 18 muaj | 152,160,127 |
| 4 | Mbikqyrje punimesh:Ndretim Ujesjellesi ne fshatrat Pllane,Markatomaj, Zejmen,Spiten,Tresh---LOTI I 2 | Ministria e infrastruktures dhe energjise | A.SH Engineering | Nr 2109/1 dt 26.03.2021 | 2,234,596 | | 1,407,795 |
| 5 | Ndertim Ujesjellesi per zonat Bregdetare te Njesise Administrative Shenkoll | Ministria e infrastruktures dhe energjise | A SHPK | 22408/13 dt 11.02.2021 | 786,272,802 | 48 muaj | 208,378,404 |
| 6 | Mbikqyrje Punimesh :Ndretim Ujesjellesi per zonat Bregdetare te Njesise Administrative Shenkoll | Ministria e infrastruktures dhe energjise | A&E ENGINEERING | 5017/8 dt 05.05.2021 | 4,783,712 | | 1,875,657 |
| 7 | Muri Mbajtes rruge e spitali | Ministria e mbrojtjes | Z | Nr.14300/10 dt 19.09.2022 | 22,363,882 | | 18,551,675 |
| 8 | Rikonstruksion I Mjediseve be Bashkepronesi ose te Perbashketa ne Ndertesat Pallat te prkura nga termeti I dt 26.12.2019 | Ministria e infrastruktures dhe energjise | U SHPK | Nr 23034/22 dt 18.02.2021 | 211,461,570 | 11 muaj,Amenduar deri 18.05.2022 | 211,461,570 |
| 9 | Mbikqyrje punimesh :Rikonstruksion I Mjediseve be Bashkepronesi ose te Perbashketa ne Ndertesat Pallat te prkura nga termeti I dt 26.12.2019 | Ministria e infrastruktures dhe energjise | H S SHPK | Nr 1901/22 dt 16.03.2021 | 2,900,000 | Sipas punes | 2,900,000 |
| 10 | Rikonstruksion I Mjediseve be Bashkepronesi ose te Perbashketa ne Ndertesat Pallat te prkura nga termeti I dt 26.12.2019 LOTI II | Ministria e infrastruktures dhe energjise | R COMPANY | 7534/21 DT 14.06.2021 | 92,410,112 | 6muaj,Amenduar deri 14.04.2022 | 91,543,918 |
| 11 | Mbikqyrje punimesh :Rikonstruksion I Mjediseve be Bashkepronesi ose te Perbashketa ne Ndertesat Pallat te prkura nga termeti I dt 26.12.2019 LOTI II | Ministria e infrastruktures dhe energjise | MSHPK | 9559/22 date 03.08.2021 | 1,400,000 | Sipas punes | 1,302,000 |
| 12 | Rindertim I Konviktit te Shkolles se mesme Profesionale Kolin Gjoka | Ministria e infrastruktures dhe energjise | G SHPK | 23131/24 DT 24.12.2020 | 151,500,000 | Amenduar deri 18.04.2022 | 151,499,856 |

| | | | | | | | |
|---------------|--|---|----------------|---------------------------|----------------------|------------------------------|----------------------|
| 13 | Mbikqyrje Punimesh "Rindertimi shkolles se mesme Profesionale Kolin Gjoka | Ministria e infrastruktures dhe energjise | M SHPK | 1725/35 DT 12.04.2021 | 1,510,000 | Sipas punes | 1,510,000 |
| 14 | Rindertimi I shkolles 9-vjecare At Zef Pllumbi - Njesia Adm.Zejmen | Ministria e infrastruktures dhe energjise | N | 23479/23 DT 16.02.2021 | 220,376,980 | 6 muaj | 218,049,815 |
| 15 | Mbikqyrje Punimesh "Rindertimi shkolles 9-vjecare AT Zef Pllumbi | Ministria e infrastruktures dhe energjise | G , K | 1725/23 dt 08.03.2021 | 2,400,000 | Sipas punes | 2,015,414 |
| 16 | Rifocimi I Njesive te Banimit ne ndertesat pallat dhe banesat individuale ne kuader te rindertimit ne territorin e Bashkise | Ministria e infrastruktures dhe energjise | L.S.H.P.K-60 % | 236767/23 dt 19.04.2021 | 301,012,860 | Amenduar deri 19.08.2022 | 300,194,096 |
| 17 | Rifocimi I Njesive te Banimit ne ndertesat individuale ne kuader te rindertimit ne territorin e Bashkise | Ministria e infrastruktures dhe energjise | E. SHPK-40% | 236767/23 dt 19.04.2021 | 200,675,240 | Amenduar deri 19.08.2022 | 188,858,973 |
| 18 | Sherbim mbikqyrje:Rifocimi I Njesive te banimit ne ndertesat (pallat)dhe banesat individuale ne kuader te rindertimit ne territorin e bashkise | Ministria e infrastruktures dhe energjise | M.SHPK | 2107/23 DT 12.02.2021 | 6,200,000 | Sipas punes | 5,828,000 |
| 19 | Rindertim I 40 njesive individuale te banimit ne njesine Lezhe | Ministria e infrastruktures dhe energjise | K shpk | Nr 17791/21 dt 14.12.2021 | 88,855,210 | Zgjidhur kontrata | 0 |
| 20 | Mbikqyrje:Rindertim I 40 njesive individuale te banimit ne njesine Lezhe | Ministria e infrastruktures dhe energjise | P | Nr 21617/9 dt 21.12.2021 | 775,326 | | 0 |
| 21 | Rindertim I Ures se Zeze mbi Lumin Drin&Rehabilitim I rr Inxhinier Gjadri | Ministria e infrastruktures dhe energjise | G | 18553/24 DT 24.01.2022 | 285,604,492 | 330 dite | 57,893,700 |
| 22 | Mbikqyrje :Rindertim I Ures se Zeze mbi Lumin Drin&Rehabilitim I rr Inxhinier Gjadri | Ministria e infrastruktures dhe energjise | M | 670/15 dt 04.03.2022 | 3,750,000 | Sipas punes | 750,000 |
| 23 | Perforcim dhe Rik.i Bibliotekes Gjergj Fishta &Riko.i pallatit te Kultures Ded Ndue Lazri | Ministria e infrastruktures dhe energjise | J SHPK | 18530/21 dt 21.01.2022 | 236,725,554 | 344 dite Amenduar 20.04.2023 | 217,154,814 |
| 24 | Mbikqyrje :Perforcim dhe Rik.i Bibliotekes Gjergj Fishta &Riko.i pallatit te Kultures Ded Ndue Lazri | Ministria e infrastruktures dhe energjise | P | 669/15 dt 01.03.2022 | 2,800,000 | Sipas punes | 2,520,000 |
| Totali | | | | | 3,085,640,029 | | 1,615,588,041 |

Burimi : Bashkia Lezhë, përpunuar nga grupi i auditimit.

Sa i përket fondeve të alokuara nga Ministrinë e Linjës Fonde të deleguara për vitin 2022 për investime të cilat kanë filluar në vitin 2020, kanë vazhduar në vitin 2021 dhe sipas kontratës përfundojnë në vitin 2022, ose janë në proces gjatë vitit 2022, rezulton se janë financuar 24

projekte investimi me vlerë kontrate 3,085,640,029 lekë, nga të cilat është likuajduar vlera prej 1,615,588,041.

Objektet e investimit kanë patur si prioritet ndërtimet e ujësjellësit , rindërtim urash, rindërtim njësjive të banimit, Rikonstruksion i Mjediseve në bashkëpronësi ose te përbashkëta ne ndërtesat pallat te prekura nga tërmeti LOTI II, Rindërtim i 40 njësjive individuale te banimit ne njësinë Lezhë, objektet e investimit të detajuara në tabelën e mësipërme. Përsa i përket kontratave të lidhura rezultojn se :

-Kontratave nuk janë likuajduar sipas afateve të përcaktuara por në periU të mëvonshme, kjo si rezultat i mos alokimit të fondeve nga ministrinë e linjës dhe për pjesën e Bashkisë Lezhë nga mos realizimi i të ardhurave nga taksat/tarifave vendore.

-Kontratave janë regjistruar në afat dhe me vlerë të plotë në SIFQ nga Dega e Thesarit Lezhë dhe të shtrira në kohë sipas financimit e ndarë në tre vitet sipas shkresës përcjellëse nga Ministria e linjës. Për çdo rast të depozitimit të kontratave në thesar është hartuar shkresë përcjellëse, ku është cilësuar vlera e plotë e saj, struktura buxhetore përkatëse sipas plan-buxhetit, kur është e shtrirë në disa vite, vlera për secilin vit.

Lidhur me Shpronësimin publik

Nga auditimi lidhur me shpronësimet publike rezultoi se, ka dalë VKB nr. 96 prot., datë 29.08.2022

“për heqjen nga kontabiliteti i detyrimeve të prapambetura që nuk justifikohen me dokumentacion financiar justifikues”. Detyrime të cilat i përkasin periudhës që nga viti 2015 të cilat janë në llogarinë ekonomike (486). Përsa i përket detyrimeve për shpronësim bëhet fjalë për vlerën 126,103,140 lekë, vlerë e pasqyruar në tabelën e mëposhtme.

Tabela nr. 12

| Nr. | Pronari | Vlera e shpronësimit | % e pjesëmarrjes në financim Bashkia | Likuidimet nga Bashkia | Vlera e mbetur e palikuajduar deri në 31.12.2021 |
|---------------|--------------------------------------|----------------------|--------------------------------------|------------------------|--|
| 1 | Blloku 11.2 ha L.Beslidhja/Mark Doda | 10,739,262 | | 10,377,792 | 361,470 |
| 2 | Shpron.Bregu I drinit/17 per | 64,564,293 | | | 64,564,293 |
| 3 | Shpron.Tek 11.2 ha | 30,102,826 | | | 30,102,826 |
| 4 | Shpron.Rruga Kune Shengj | 2,688,556 | | | 2,688,556 |
| 5 | Blloku 11.2 ha L.Beslidhja | 5,061,500 | | | 5,061,500 |
| 6 | Rikons.L.Beslidhja | 546,642 | | | 546,642 |
| 7 | Rruga Kune Shengjin | 961,800 | | | 961,800 |
| 8 | Blloku 11.2 ha L.Beslidhja | 21,740,000 | | | 21,740,000 |
| Totali | | | | | 126,027,087 |

Burimi: Bashkia Lezhë

Konkluzion i përgjithshëm:

- Nga auditimi i procedurave të PBA-së për vitin 2022-2024 u konstatua se përgjithësisht janë realizuar fazat e përgatitjes buxhetore.

PBA për periudhën 2022-2024 është miratuar në Këshillin Bashkiak me Vendim nr. 177 datë 23.12.2021“Për miratimin e Buxhetit Afatmesëm Përfundimtar 2022-2024”, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Lezhë më shkresën nr. 1049/6, datë 07.01.2022.

- Në veçanti nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA për periudhën 2022, por në dosje administrohet vetëm VKB nr. 52., datë 31.03.2021 për miratimin e tavaneve përgatitore për PBA 2022-2024, i cili nuk ka dalë në përputhje me përcaktimin e bërë pikën 6 të nenit 34 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

--Nuk dokumentohet në dosje dokumenti për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm ku thuhet se :

Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore brenda datës 5 korrik 2021, merr masat e nevojshme për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm Vendor 2022-2024.

- Grupi i KLSH konstaton se, niveli i realizimit të investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet jo të mira në vitin 2022, konkretisht në masën 72.2 %. Ky mos realizim vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Lezhë në fillim të vitit buxhetor planifikon procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifave vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara.

- Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”;

Neni 47 në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

- Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2022 janë në vlerën 14,172,364 lekë. Konstatohet se detyrimet gjyqësore në fund të periudhës ushtrimore 2022 nuk janë pasqyruar në Raportin e Monitorimit dërguar në MFE. Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Lezhë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2022, ky afat nuk është respektuar në 20 raste për vlerën 106,457,953 lekë.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi, Drejtor i financës B. V., në cilësinë e nëpunësit Autorizues.

6. Burimi i krijimit të të ardhurave, planifikimi dhe realizimi i tyre.

Për periudhën 2022, pranë Bashkisë Lezhë është krijuar dhe ka funksionuar Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore, si një nga strukturat kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Lezhë nga taksat dhe tarifave. Ky sektor në aktivitetin e tij për arkëtimin e disa prej llojeve të të ardhurave bashkëpunon edhe me sektor të tjerë pranë Bashkisë, si ai i pronave, pyjeve, urbanistikës, infrastrukturës, ku roli i këtyre sektorëve është hartimi i autorizimit për arkëtim, si dhe roli i sektorit të taksave dhe tarifave vendore është hartimi i faturës për arkëtim, dokument i cili i shërben subjektit për kryerjen e pagesës, duke vijuar me ndjekjen e arkëtim/marrjen e masave të nevojshme për ekzekutimin e pagesave/detyrimeve të krijuara.

Ky sektor përgjatë periudhës 2022 ka pësuar 5 ndryshime në numër punonjësish dhe strukturë, konkretisht, specifikuar në tabelën e mëposhtme.

Në tabelën më poshtë të pasqyrohet informacioni për punonjësit e sektorit të mësipërm, si dhe lëvizjet e tyre në detyrë:

Tabela nr.1 Struktura e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore

| Nr. | Emër Mbiemër | Pozicioni | Date fillimi | Ndryshimet |
|-----|--------------|---|--------------|---------------------------------|
| 1. | A.B | Drejtor Drejtorie | 29.10.2019 | Larguar nga puna dt. 16.05.2022 |
| 2. | D.B | Drejtor Drejtorie | 21.06.2022 | |
| 3 | A.GJ | Përgjegjës i Sektorit të Regjistrimit dhe Vlerësimit | 16.05.2022 | |
| 4. | T.Z | Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren | 24.08.2020 | |
| 5. | P.M | Specialist i Mbledhjeve dhe Menaxhimit të Borxhit | 05.05.2021 | |
| 6. | L.N | Specialist në Sektorin e Regjistrimit, Vlerësimit, Verifikimit, dhe Kontrollit në Terren të atimpagusve | 03.01.2020 | |
| 7. | O.T | Specialist për Taksat dhe Tarifave të Biznesit | 07.07.2016 | |

| | | | | |
|-----|------|---|------------|---|
| 8. | A.K | Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren | 03.07.2017 | |
| 9. | A.Z | Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren | 24.08.2020 | |
| 10. | S.R | Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren | 07.11.2011 | Specialist, ndryshim 06.01.2022 |
| 11. | D.P | Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren | 02.03.2020 | |
| 12. | K.N | Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren | 24.08.2020 | |
| 13 | R.GJ | Specialist për Taksat dhe Tarifat Familjare | 03.01.2020 | Specialist në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit te Biznesit 06.01.2022 ndryshimi |
| 14. | F.M | Specialist në Sektorin e Regjistrimit, Vlerësimit Verifikimit, dhe Kontrollit në Terren të Tatimpagusve | 03.01.2020 | Specialist në Sektorin e Regjistrimit dhe Vlerësimit te Biznesit 10.01.2022 ndryshimi |
| 15. | T.M | Specialist për Taksat dhe Tarifat e Biznesit | 02.03.2020 | Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren 10.01.2022 ndryshimi |
| 16. | M.Z | Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren | 30.01.2015 | |
| 17. | E.P | Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren | 02.03.2020 | |
| 18. | K.S | Specialist i Mbledhjeve dhe Menaxhimit te Borxhit | 02.03.2020 | |
| 19. | F.U | Specialist i Kontrollit dhe Verifikimit në Terren | 03.01.2020 | Larguar nga puna dt. 26.09.2022 |

Burimi: Bashkia Lezhë Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore

Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore Bashkia Lezhë, për vitin 2022 është struktura kryesore për vlerësimin dhe arkëtimin e të ardhurave të Bashkisë Lezhë nga taksat dhe tarifat. Veç Sektorit të taksave dhe tarifave vendore, në Bashkinë Lezhë janë të angazhuara edhe struktura të tjera për faturimin dhe/ose mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore, si më poshtë vijon:

Tabela nr.2

| Struktura | Lloji i të ardhurës | Plani | Fakti |
|--|---|---------|---------|
| Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore | Taksat dhe tarifate vendore për biznesin dhe familjarët | 291 743 | 283 728 |
| Drejtoria e Urbanistikës | Taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale | 298 780 | 28 638 |
| | Taksën e ndikimit në infrastrukturë për leje ndërtimi | | |
| | Certifikatë përdorimi | 0 | 0 |
| Drejtoria/Ndërmarrja e Shërbimit Pyjor | Qira për fond pyjor dhe kullosor | 0 | 0 |
| | Shitja e lëndës drusore | 509 | 0 |
| | Shitja e prodhimeve pyjore | 0 | 0 |

Burimi: Bashkia Lezhë Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore

Tabela nr.3 Punonjësit të ndarë sipas detyrës që kryejnë

| Nr | Emër | Taksat dhe tarifate për Biznesin | Evidentim Subjekteve | Administrimi i regjistrimit të taksave dhe tarifave vendore | Maturim | Menaxhim Borxhit |
|----|------|----------------------------------|----------------------|---|---------|------------------|
| 1 | T.Z | x | | x | x | |
| 2 | P.M | | | | | x |
| 3 | L.N | x | | x | x | |
| 4 | O.T | x | | x | x | |
| 5 | A.K | x | | x | x | |
| 6 | A.Z | x | | x | x | |
| 7 | S.R | x | | x | x | |
| 8 | D.P | x | | | | |
| 9 | K.N | x | | x | x | |
| 10 | R.GJ | x | | x | x | |
| 11 | F.M | x | | x | x | |
| 12 | T.M | x | | x | x | |
| 13 | M.Z | x | | x | x | |
| 14 | E.P | x | | x | x | |
| 15 | K.S | | | | | x |

Burimi: Bashkia Lezhë Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore

Planifikimi dhe realizimin i taksave dhe tarifave vendore

Titulli i gjetjes: Mangësi në planifikimin e të ardhurave.

Për vitin 2022 paketa e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Lezhë është miratuar me VKB-në nr. 157, datë 17.11.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Lezhë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”.

Tabela nr.4

000

lekë

| Nr. | Emërtimi | Viti 2022 | | | |
|--------------------------------------|---|-----------------|-----------------|----------------|-------------|
| | | Plani Fillestar | Plani Rishikuar | Fakti | Ne % |
| I | Të ardhurat nga taksat (I/a +I/b) | 462.891 | | 216.848 | 47% |
| I/a | Vendore (1-6) | 419.391 | | 139.384 | 33% |
| 1 | Taksa mbi pasurinë | 105.116 | | 96.534 | 92% |
| 1,1 | Taksa mbi ndërtesat | 79.122 | | 76.484 | 97% |
| 1,2 | Taksa mbi tokën bujqësore | 10.410 | | 6.011 | 58% |
| 1,3 | Taksa mbi truallin | 15.584 | | 14.039 | 90% |
| 2 | Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin | 300 | | 956 | 319% |
| 3 | Taksa e ndikimit të infrastrukturës nga nd.reja | 298.780 | | 28.335 | 9% |
| 4 | Taksa e tabelës dhe reklamës | 4.750 | | 2.347 | 49% |
| 5 | Taksa e fjetjes në hotele | 10.445 | | 10.810 | 103% |
| 6 | Taksa të tjera të përkohshme | - | | 402 | 100% |
| - | Për infrastrukturën nëntokësore | - | | | |
| - | Për infrastrukturën në arsim | - | | | |
| I/b | Të Ndara (1-5) | 43.500 | | 77.464 | 178% |
| 1 | Taksa e kalimit të drejtës pronësisë P.Paluaajtshme | 8.500 | | 8.334 | 98% |
| 2 | Taksa e regjistrimit të automjeteve | 34.500 | | 46.093 | 134% |
| 3 | Taksa e rentës minerale | 500 | | 317 | 63% |
| 4 | Tatimi mbi të ardhurat personale | - | | 21.743 | 100% |
| 5 | Taksa të tjera | - | | 977 | 100% |
| II | Të Ardhurat Jotatimore (II/a + II/b + II/c) | 277.109 | | 222.003 | 80% |
| II/a | Të ardhurat nga tarifave vendore | 211.834 | | 204.616 | 97% |
| 1 | Tarifa shërbimi | 101.132 | | 114.199 | 113% |
| - | Tarifa e pastrimit & largimit mbetjeve dhe Dekor | 65.993 | | 92.506 | 140% |
| - | Tarifë ndriçimi publik | 19.171 | | 11.814 | 62% |
| - | Tarifë gjelbërimi | 15.968 | | 9.879 | 62% |
| 2 | Tarifë shërbimi veterinar | - | | 138 | 100% |
| 3 | Tarifa të tjera (licence, leje, autorizime etj.) | 4.000 | | 4.400 | 110% |
| 4 | Tarifë parkimi | 7.245 | | 7.825 | 108% |
| 5 | Tarifë për kulturën | 1.975 | | 1.548 | 78% |
| 6 | Tarifë për hapësirat publike | 70.000 | | 53.734 | 77% |
| 7 | Të ardhura nga tarifave e Urbanistikës | 11.000 | | 10.523 | 96% |
| 8 | Tarifë për shërbimet e MZSH | 1.325 | | 998 | 75% |
| 9 | Tarifë leje transporti | 1.480 | | 862 | 58% |
| 10 | Të ardhura nga tarifa e lëndëve drusore | 509 | | 42 | 8% |
| 11 | Tarifa për shërbimet administrative | - | | | |
| 12 | Tarifa e shërbimit të ujitjes dhe kullimit | - | | | |
| 13 | Pagesat nga Çerdhet | 3.168 | | 2.221 | 70% |
| 14 | Pagesat nga Kopshtet | 10.000 | | 8.126 | 81% |
| 15 | Pagesat nga nxënësit e Konviktit | - | | | |
| 16 | Tarifa për sportet | - | | | |
| II/b | Të ardhura nga shitja e pronës, dhënia me qira | 8.385 | | 219 | 3% |
| 1 | Shitje ndërtese banimi | - | | | |
| 2 | Shitje troje | - | | | |
| 3 | Shitje prona të tjera (automjete dhe inv.ek.) | - | | | |
| 4 | Qira mbi trojet | 6.943 | | 193 | 3% |
| 5 | Qira tokë bujqësore | - | | 16 | 100% |
| 6 | Qira mbi ndërtesat ,pajisje etj. | 1.442 | | 10 | 0,7% |
| II/c | Të ardhura të tjera | 56.890 | | 17.168 | 30% |
| 1 | Nga dhuratat dhe sponsorizimet etj. | 51.000 | | 1.474 | 3% |
| 2 | Nga gjobat | 5.770 | | 7.829 | 136% |
| 3 | Të ardhura të tjera (debitorë.ankande etj) | 120 | | 7.865 | 6554% |
| GJITHSEJ TË ARDHURAT (I + II) | | 740.000 | | 438.851 | 59% |

Burimi: Drejtoria të ardhurave dhe tarifave vendore

Për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 740.000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 438.851 lekë ose 59%.

Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksa/tarifa të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk planifikohet vlerë për t'u arkëtuar, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime.

Nga auditimi rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar, nga Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore nuk është hartuar regjistri i taksapaguesve privat dhe familjar.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Duke iu referuar tabelës më lart vërehet një realizim i dobët i taksave dhe i tarifave vendore.

Kriteri: VKB-në nr. 157, datë 17.11.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Lezhë , administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”. Rregullore e brëndshme nr. 493 prot., datë 18.07.2022 neni 43.

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator të fushës

Ndikimi/Efekti: Mos planifikim i saktë i treguesve në planin e të ardhurave.

Rëndësia: i Lartë.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. A.B ish drejtori i taksave dhe i tarifave Vendore për periudhën 29.10.2019-16.05.2022.

Lidhur me evidencën e bizneseve

Biznesi i Vogël:

Lidhur me biznesin e vogël për vitin 2022 gjendja në fillim të vitit rezulton te jetë me 4,561 biznese, regjistrime të reja 490 biznese, kanë mbyllur aktivitetin 493 biznese dhe gjendja në fund të periudhës është 4,558 biznese.

Biznesi i Madh:

Gjendja në fillim të vitit për biznesin e madh është në një numër prej 961 biznesesh, regjistrime të reja janë një numër prej 22 biznese, kanë mbyllur aktivitetin 11 biznese dhe gjendja në fund të vitit është në një numër prej 972 biznesesh.

Tabela nr.5 Evidenca e gjendjes së numrit të bizneseve për 2022.

| Nr. | Lloji Biznesit | Viti | Gjendja Në fillim | Regjistrime Reja | Mbyllur Aktiviteti | Gjendja në fund të periudhës |
|-----|----------------|------|-------------------|------------------|--------------------|------------------------------|
| 1 | Biznes i vogel | 2022 | 4561 | 490 | 493 | 4558 |
| 2 | Biznes i madh | 2022 | 961 | 22 | 11 | 972 |
| | TOTAL | | 5522 | 512 | 504 | 5530 |

Burimi: Bashkia Lezhë Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore .

Titulli gjetjes: Debitorët “Biznes”, “Institucione” dhe “Qiramarrës” të cilët nuk kanë likujduar detyrimet për taksat dhe tarifave vendore, si dhe mosmarrja e masave ligjore në mënyrë shteruese për arkëtimin e detyrimeve përkatëse.

Situata: Debitorët sipas kategorive të tyre.

1. Biznesi dhe Institucionet

Bazuar në të dhënat e vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore, ecuria e debitorëve përgjatë periudhës së vitit 2022, për tarifën e pastrimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, reklamës, tabelës, zënies së hapësirës publike, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë.

Tabela nr.6

| Subjekti | Debi Progressive 31.12.2021 (principal + kamatvonesë, e cila ka rezultuar e pa likujduar) | Debi e krijuar gjatë vitit 2022 | | | | | | Total krijuar në 2022 | Kamatvonesë e aplikuar | Debia progresive 31.12.2022 në vlerën = 246,341,820 | |
|--------------------|---|---------------------------------|-------------------|------------------|-------------------------|------------------------|-------------------|-----------------------|------------------------|---|-------------------|
| | | Principal, që ndahet në | | | | | | | | Principal | Kamatvonesë |
| | | Takse ndertese | Takse Trualli | Takse Tabele | Taks e fjetjes në hotel | Tarife Sherbimi Publik | Hapesire Publike | | | | |
| BM | 120,941,375 | 27,130,627 | 10,733,295 | 861,898 | 11,250,028 | 45,260,657 | 21,216,560 | 116,453,065 | 64,859 | 109,547,748 | 31,556,749 |
| BV | 110,169,493 | 22,171,415 | 4,584,613 | 168,928 | 4,350,620 | 35,612,692 | 32,532,387 | 99,420,655 | 339,535 | 87,818,938 | 5,813,085 |
| Institucion | 4,331,150 | | | | | 1,326,816 | | 1,326,816 | - | 4,465,076 | - |
| Pronare | 7,250,861 | 4,127,750 | 654,864 | | | | | 4,782,614 | 4,577 | 6,821,489 | 318,735 |
| Totali | 242,692,879 | 53,429,792 | 15,972,772 | 1,030,826 | 15,600,648 | 82,200,165 | 53,748,947 | 221,983,150 | 408,971 | 208,653,251 | 37,688,569 |

Burimi: Bashkia Lezhë Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore.

Debia progresive më 31.12.2021 për Bisnezin e madh , Bisnezin e vogël, institucione dhe pronarë është 242,692,879 lekë.

Debia e krijuar gjatë vitit 2022 për Bisnezin e madh , Bisnezin e vogël, institucione dhe pronarë është 3,648,941 lekë.

Debia më 31.12.2022 për Bisnezin e madh , Bisnezin e vogël, institucione dhe pronarë është 246,341,820 lekë.

Borxhi progresiv është dërguar pranë drejtorisë së financës me shkresën nr. 2964 prot., datë 13.03.2023 për vlerën 246,341,820 lekë.

Në tabelën e mëposhtme janë të pasqyruara subjektet debitorë

Tabela nr. 7

Debitor (Biznesi) sipas Njësive Administrative

| Njësia administrative | Progressive deri ne 31.12.2021 | | Krijuar brenda vitit 2022 | | Progressive deri ne 31.12.2022 | |
|--------------------------------|--------------------------------|--------------------|---------------------------|------------------|--------------------------------|--------------------|
| | Nr | Vlera | Nr | Vlera | Nr | Vlera |
| | Njësia Administrative Balldre | 90 | 4,394,990 | (7) | 781,870 | 83 |
| Njësia Administrative Blinisht | 33 | 1,246,653 | 3 | 278,248 | 36 | 1,524,901 |
| Njësia Administrative Dajç | 66 | 3,350,908 | (1) | 1,777,041 | 65 | 5,127,949 |
| Njësia Administrative Kallmet | 31 | 1,197,295 | (6) | 218,041 | 25 | 1,415,336 |
| Njësia Administrative Kolsh | 44 | 2,167,535 | (4) | 420,004 | 40 | 2,587,539 |
| Njësia Administrative Lezhë | 1,968 | 114,340,162 | (23) | (8,265,569) | 1,945 | 106,074,593 |
| Njësia Administrative Shëngjin | 986 | 84,367,876 | 62 | 7,213,612 | 1,048 | 91,581,488 |
| Njësia Administrative Shënkoll | 232 | 10,981,702 | (36) | 864,679 | 196 | 11,846,381 |
| Njësia Administrative Ungrej | 7 | 531,874 | - | 37,124 | 7 | 568,998 |
| Njësia Administrative Zejmen | 138 | 20,113,884 | (11) | 323,891 | 127 | 20,437,775 |
| Totali | 3,595 | 242,692,879 | (23) | 3,648,941 | 3,572 | 246,341,820 |

Burimi: Bashkia Lezhë Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore

-Debia progresive sipas njësive administrative deri më datë 31.12.2021 rezulton për 3,595 subjekte në vlerën 242,692,897 lekë.

- Debia krijuar brenda vitit 2022 rezulton për 23 subjekte në vlerën 3,648,941 lekë.

-Debia progresive më 31.12.2022 rezulton për 3,572 subjekte në vlerën 246,341,820 lekë.

Tabela nr. 8

Përmbledhja e Borxhit

| Ndikimi i aplikimit te mjeteve ligjore | Viti 2022 | | Nr debitorësh (biznes dhe institucione) | Mbuluar me masa shtrenguese |
|--|-------------|--------------------------|---|-----------------------------|
| | Nr.i masave | Borxhi i mbledhur ne lek | | |
| Përmes njoftimit për pagesën | | | | |
| Njoftim dhe Kerkese per Pagese Debie | 496 | 8,378,209 | | |
| Njoftim per vendosje te masave siguruese | 10 | - | | |
| Përmes masave shtënguese | | | | |

| | | | | |
|--|-----|------------|------|-----|
| Blokime të llogarive bankare | 115 | 8,186,211 | 1552 | 641 |
| Vendosje të barrës hipotekore në Kadastër | 8 | - | | |
| Vendosje të barrës siguruese në DPSHTTR | - | - | | |
| Vendosje të barrës ndaj titujve në QKB | 12 | - | | |
| Përmasave ekzekutuese | | | | |
| Urdh-ekezekutimi kalim shume nga llog e tatimpaguesve ne llogari Bashkise. | - | - | | |
| Totali i mbledhur | | 16,564,420 | | |
| Planifikimi vjetor për mbledhjen e borxhit | - | - | | |

Burimi : Bashkia Lezhë Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore

Sikurse vërehet nga tabela e mësipërme, rezulton se Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore për vitin 2022, ka marrë masa vetëm lidhur me “Njoftim dhe kërkesë për pagesë debie” dhe “Blokim i llogarive bankare” si rezultat i masave të marra është mbledhur borxhi për vlerën 16,564,420 lekë. Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, për më tej nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal.

Kriteri: Neni 76, neni 114, i Ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në RSH”, i ndryshuar;

-Pikat 1, 2 në nenin 4, neni 9, pikat 1 dhe 2 në nenin 20, pika 1 në nenin 22, neni 22/5, nenin 24, shkronjën “c” të pikës 3 në nenin 27, neni 34 dhe neni 35 në Ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore”, i ndryshuar;

-Pikën 1.3 në pikën 1 në nenin 9, pikën 2 në nenin 27, neni 35, neni 64 në Ligjin nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar;

Shkronjën “a” të nenit 5, pikën 2 të nenit 7, pikën 1 të nenit 12, nenin 14, neni 40, pikën 2 të nenit 42 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”; Udhëzimin e përbashkët Nr. 17, Datë 20.6.2022 Për Përcaktimin e Uniformitetit Minimal Të Standardeve Procedurale Për Mbledhjen E Detyrimeve Të Taksave e Tarifave Vendore.

Shkaku: Mungesa e marrjes së masave shtrënguese në mënyrë shtrëruese për arkëtimin e debitorëve të biznesit.

Rëndësia: I Lartë

Ndikimi/Efekti: Të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Mat në vlerën **246,341,820** lekë.

Rëndësia: I Lartë

-Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. A.B ish drejtori i taksave dhe i tarifave Vendore për periudhën 29.10.2019-16.05.2022 , z. D.B Drejtor i taksave dhe i tarifave Vendore për periudhën 21.06.2022 e në vazhdim. Specialist i Mbledhjeve dhe Menaxhimit të Borxhit, z. K.S , z.P.M Specialist i Mbledhjeve dhe Menaxhimit të Borxhit.

Për taksën e ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit për familjarët

Titulli gjetjes: Mbi procedurat e ndjekura të arkëtimin të taksës së ndërtesës dhe tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit nga abonentët familjar

Situata: Bashkia Lezhë, për mbledhjen e detyrimeve për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi –gjelbërim-ndriçimi për abonentët familjarë e realizon nëpërmjet agjentit tatimor që në rastin konkret është UK Sha Lezhë në bazë të VKB nr. 157 prot., datë 17.11.2021 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”, i ndryshuar, Pika III në të cilën përcaktohet: “Të caktojë si Agjent Tatimor, për vjeljen e Taksës mbi “Ndërtesat për Qëllime Banimi” dhe “Tarifën për “Shërbimet Publike”, ndaj kategorisë së taksapaguesve si “Familjarë”,

Drejtorinë e Sh. A. Ujësjellës Kanalizime Lezhë, për ato familje që kanë kontratë furnizimi me ujë.” Nga Bashkia Lezhë është lidhur akt-marrëveshje me nr. 6494 prot., datë 16.07.2018 Agjentin tatimor UK sha.

Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Lezhë nuk ka regjistër të familjeve me të dhënat sa është numri i familjeve gjithsej për sipërfaqet e banimit, që ka secila familje dhe se kujt viteve i përket, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk plotësohet njoftim detyrimi për familjet që nuk kanë kontratë me UK sha Lezhë për taksën e ndërtesës, tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Faturimi dhe realizimi i taksës së ndërtesës dhe tarifës pastrim-gjelbërim-ndriçimit për familjarët për periudhën e vitit 2022, sipas akt-rakordimeve mes Bashkisë Lezhë dhe Agjentit Tatimor UK sha Lezhë paraqitet në tabelën mëposhtme:

Tabela nr. 9

| NR | PERIU | Faturimi I taksave | | Arketimi I taksave | | Akt rakordim mes Bashkise dhe UK sh.a. per arketimin e e taksave dhe tarifav | Takse Banese | Tarife sherbimit (Pastim gjelberim ndriçim) |
|----|-----------|--------------------|------------|--------------------|------------|--|--------------|---|
| | | Numer | Vlere | Numer | Vlere | | | |
| 1 | Viti 2022 | 15,495 | 72,108,269 | 13,845 | 64,433,011 | 64,433,011 | 27,699,216 | 36,733,795 |

Burimi: Bashkia Lezhë Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore

Debitorë për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit (pastrim-gjelbërim-ndriçim) për vitin 2022 janë 1,650 familje në vlerën 7,675,528 lekë Nga të dhënat e Drejtorisë së Taksave dhe tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për vitin 2022 nuk ka planifikuar dhe realizuar të ardhura nga Taksa e ndërtesës dhe Tarifa e shërbimit (pastrim-gjelbërim-ndriçimit) për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sh. A Lezhë.

Tabela nr. 10 Kategoria Familje

| Nr | Njësi Administrative | Familje të taksuara 2022 |
|--------------|--------------------------------|--------------------------|
| 1 | Qender - BASHKIA LEZHE | 6,530 |
| 2 | NJESIA ADMINISTRATIVE SHENGJIN | 6,038 |
| 3 | NJESIA ADMINISTRATIVE BALLDRE | 987 |
| 4 | NJESIA ADMINISTRATIVE BLINISHT | 827 |
| 5 | NJESIA ADMINISTRATIVE ZEJMEN | 450 |
| 6 | NJESIA ADMINISTRATIVE DAJÇ | 494 |
| 7 | NJESIA ADMINISTRATIVE KALLMET | 871 |
| 8 | NJESIA ADMINISTRATIVE Shenkoll | 391 |
| 9 | NJESIA ADMINISTRATIVE Ungrej | 173 |
| 10 | NJESIA ADMINISTRATIVE Kolsh | 125 |
| TOTAL | | 16.886 |

Burimi: Bashkia Lezhë Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore

Tabela nr. 11

Tabela lidhur me Debitorët Familje

| Nr. | Njësi Administrative | Progresive deri në vitin 2021 | | Familje Debitorë krijuar brenda vitit 2022 | | Progresive deri në vitin 2022 | |
|--------------|--------------------------------|-------------------------------|-------------------|--|------------------|-------------------------------|-------------------|
| | | Nr | Vlerë | Nr | Vlerë | Nr | Vlerë |
| 1 | Qender - BASHKIA LEZHE | 930 | 16,291,292 | | 3,212,897 | 930 | 19,504,189 |
| 2 | NJESIA ADMINISTRATIVE SHENGJIN | 860 | 14,550,238 | | 1,704,791 | 860 | 16,255,029 |
| 3 | NJESIA ADMINISTRATIVE BALLDRE | 135 | 1,352,188 | | 750,000 | 135 | 2,102,188 |
| 4 | NJESIA ADMINISTRATIVE BLINISHT | 114 | 1,523,650 | | 780,520 | 114 | 2,304,170 |
| 5 | NJESIA ADMINISTRATIVE ZEJMEN | 47 | 615,230 | | 373,350 | 47 | 988,580 |
| 6 | NJESIA ADMINISTRATIVE DAJÇ | 57 | 795,600 | | 385,200 | 57 | 1,180,800 |
| 7 | NJESIA ADMINISTRATIVE KALLMET | 98 | 1,325,600 | | 468,500 | 98 | 1,794,100 |
| TOTAL | | 2,241 | 36,453,798 | - | 7,675,258 | 2,241 | 44,129,056 |

Burimi: Bashkia Lezhë Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore

Për vitin 2022 pranë Njësi administrative kemi një numër prej 16,886 familje të cilat taksohen. Konstatohet se nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është krijuar regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve.

Debia progresive me 31.12.2021 është 36,453,798 lekë për 2241 familjarë.

Familje debitorë të cilët janë krijuar gjatë vitit 2022 janë në vlerën 7,675,258 lekë.

Debi progresive deri me 31.12.2022 është në vlerën 44,129,056 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë.

Vlera e debive i referohet 7 Njësive Administrative të paqyruara në tabelën më lart, përta i përket NJA Shënkoll, Ungrej, dhe Kolsh faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur familjarët janë paraqitur pranë NJA-ve dhe si pasojë e këtij veprimi nuk identifikohen debitorë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me pika 7 e nenit 4, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshime dhe nenin 70, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me VKB nr. 157, datë 17.11.2021 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.a.5 “Taksa e ndërtesës”, Rubrika “Strukturat përgjegjëse për vjeljen e taksës sipas kategorive të taksapaguesve janë : “ b. Për vjeljen e taksës mbi ndërtesat, për kategorinë “familjarë”, që kanë kontratë me Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A.Lezhë, strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Ujësjetllës Kanalizime Sh.A. Lezhë, ndërsa për ato familjarë, që nuk kanë kontratë me Drejtorinë e Ujësjetllës-Kanalizime Sh.A. Lezhë, atëherë strukturë përgjegjëse është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore dhe Njësitet Administrative.”

Pika B. 1 “Tarifa e Shërbimeve Publike (pastrimit gjelbërimit, ndriçimit dhe dekorit” në të cilën përcaktohet: “Kategoria A. “Familjarët”: Detyrimi paguhet me këste mujore të barabarta, të përfshira në faturën e ujit të pijshëm, për klientët e Ujësjetllës-Kanalizime Sh. A. Lezhë, ndërsa për ato familje, që nuk kanë kontratë me Ujësjetllës-Kanalizime Sh. A. Lezhë, detyrimet paguhet me një këst të vetëm, pranë Njësitet Administrative ku ato banojnë.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e Tarifës së Shërbimeve Publike është Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore, pranë Bashkisë Lezhë.”

Kriteri: pika 7 e nenit 4, të ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” me ndryshime dhe nenin 70, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, me VKB nr. 157, datë 17.11.2021 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.a.5 Pika B.1.

Ndikimi/Efekti: Ka ndikuar në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore vlera prej 44,129,056 lekë, si ardhur e munguar në buxhetin e Bashkisë Lezhë.

Shkaku: Nga UK sha nuk janë marrë masa për arkëtimin e vlerës debitorë, si dhe nga DTTV e Administratorët e NJA nuk kanë marrë masa identifikimin e familjarëve taksapagues që nuk kanë kontratë me UK, sha për faturimin e tyre dhe ndjekjen e arkëtimit të taksës së ndërtesës dhe tarifës së shërbimeve.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjës sipas VKB nr. 157 datë 17.11.2021, Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. A.B ish drejtori i taksave dhe i tarifave Vendore për periudhën 29.10.2019-16.05.2022 , z. D.B Drejtor i taksave dhe i tarifave Vendore për periudhën 21.06.2022 e në vazhdim. z. A.Z Administrator njësia administrative Ungrej. z .F.Z Administrator Njësia administartive Kolsh. z. E.R Njësia administartive Shënkoll.

Taksa e Tokës Bujqësore

Titulli gjetjes: Mbi procedurat e ndjekura të planifikimit dhe të arkëtimit të taksës së tokës.

Situata: Taksa e tokës bujqësore për vitin 2022 është realizuar në shumën 6.011 mijë lekë nga 10.410 mijë lekë të planifikuara ose në masën 58 % . Planifikimi i taksës së tokës është bërë nga NJA në bazë të realizimit në vitin paraardhës dhe jo mbi bazë të dhënash për bazën e taksueshme, pasi regjistrat e tokës për familjet fermere (taksapagues), nuk janë azhornuar në

mënyrë të plotë dhe të saktë me të gjitha të dhënat e domosdoshme, (sipërfaqen, marrëdhëniet juridike me tokën, llojin e tokës bujqësore, kategorinë, zonën e shtrirjes, kryefamiljarin, numrin e ID, nivelin e taksës së tokës të përlllogaritur, këstet e parashikuara të pagesës të shtrirë gjatë vitit ushtrimor, njoftimet e kryera, pagesat e kryera, detyrimet e mbetura, nëse janë të kultivuar dhe me çfarë etj)

Për vitet 2022 menaxhimin e taksës së tokës, ndjekjen e procedurave për faturimin dhe arkëtimin e taksës së tokës të familjeve fermere në 9 Njësitë Administrative i kanë kryer specialistët e NJA dhe jo DTTV. Faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë NJA-ve. Nuk është bërë kryqëzimi i regjistrit të familjarëve të mbajtur nga specialistët e NJA-ve me pagesat. Pra nuk ka evidentim të debitorëve dhe si rrjedhojë nuk janë bërë njoftim detyrime për fermerët e pasqyruar në regjistrat e NJA-ve, gjithmonë nëse ka evidentim të tyre, pasi ka pasaktësi dhe mos përditësim të të dhënave mbi bazën e të cilave janë përlllogaritur detyrimet.

Kriteri: Ligji nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24 dhe në papajtueshmëri me VKB nr. 157, datë 17.11.2021 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penaliteteve ndaj kundërvajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.b.4 “Taksa mbi tokën bujqësore”, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 24, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10.

Ndikimi/Efekt: Kanë ndikuar në nivelin e të ardhurave për taksa e tarifa vendore vlera prej nga mos faturimi dhe mos arkëtimi i fermerëve për tokën e ndarë në pronësi dhe në përdorim, duke sjellë mos evidentimin e debitorëve .

Shkaku: Mos organizimi i mirë i punës nga menaxhimit i lartë dhe mos marrja e masave të plota për menaxhimin e taksës së tokës nga strukturat përgjegjëse

Rëndësia: I lartë

Rekomandimi: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Kadastrës dhe Njësitë Administrative të ngrejë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrit të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse (ish-ZVRPP apo ASHK dhe Qarku Lezhë). Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjet njoftim-vlerësimeve për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermere dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi sipas VKB nr.157 prot., datë 17.11.2021, Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. A.B ish drejtori i taksave dhe i tarifave Vendore për periudhën 29.10.2019-16.05.2022 , z. D.B Drejtor i taksave dhe i tarifave Vendore për periudhën 21.06.2022 e në vazhdim. z. E.S drejtor i i bujqësisë, z. G.J.M Drejtor i Aseteve. Administrator i njësisë Shënkoll E.R , administrator i Njësia Administrative klolsh F.Z . Nja Ugrenj A.Z . Administrator i Njësia Administrative Shëngjin B.M , E.R nga data 16.08.2022, Administrator Njësia Administrative Zejmen G.J.M , ,Nja Balldren R.GJ , Njësia Administrative Blinisht L.M, Njësia Administrative Dajç M.M , Njësia Administrative Kallmet E.M , Njësia Administrative Ungrej A.Z.

Titulli i gjetjes: Mbi të ardhurat e krijuara nga kontratat e dhënies me qira parcelave nga fondi pyjor.

Situata : Grupi i auditimit gjatë auditimit pranë Bashkisë Lezhë auditori kontrat e dhëna me qira në bazë të VKM nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë

21.6.2006 të këshillit të ministrave "për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

Nga Njësia e administrimit të pyjeve Bashkia Lezhë janë dhënë 3 kontrata 2 kontratat për vitin 2021 dhe 1 kontratë për vitin 2022. Kontratat e aduduara janë të përshkruara si më poshtë; Kontratat për dhënie me qira të fondit pyjor , kullor, që janë aktive deri në vitin 2022, janë si më poshtë vijon:

1- Qiramarrësi K. O. në zonën e malit të zadriës me objekt kontratës vendosje anemometri për matjen e erës me afat për një periudhë 2 vite me nr. Kontrate 16348/3 datë 01.10.2021.

Vlera e kontratës :

1 ha cungishte x 96,000 lek/ha/vit x 2 vjet = 192,000 lekë.

1 ha shkurre x 96,000 lekë/ha/vit x 2 vjet = 192 000 lekë.

Vlera totale e kontratës për dy vjet është 384,000 lekë.

2-Qiramarrësi Gener 2 në zonën e malit të rrencit rehabilitim rruga shëngjin – baks – Rrjoll me nr. kontrate 13392/1 datë 02.12.2021.

a)Vlera e përdorimit të rrugës lek/km/vit.

-1.91 km x 70,000 lek/km/vit x 2 vjet = 267,400 lekë.

-1.34 km x 50,000 lek/km/vit x 2 vjet = 134,000 lekë.

-0.83 km x 35,000 lekë/km/ vit x 2 vjet = 58,100 lekë.

-0.43 km x 35,000 lekë/km/vit x 2 vjet = 30,100 lekë.

-1.40 km x 25,000 lekë/m/vit x 2 vjet = 70,000 lekë.

b) Vlera e lëndës drusore që do të pritët:

- Lëndë punimi 26.97 m³ x 2300 lekë = 62,031 lekë.

- Dru zjarri 26.89 m³ x 200 lekë= 5,378 lekë.

- Dru zjarri 99.05 m³ x 500 lekë = 49,525 lekë.

Vlera Totale e (a+b) kontratës për dy vjet është 676,534 lekë.

3-Qiramarrësi Kiraç Otomayson me vendodhje në Malin e Zadrimës, me objekt kontrate vendosje anemometri për matjen e erës, me afat për një periudhë 2 vite me nr kontrate 2733/2 datë 19.04.2022 .

Vlera e kontratës:

a)Vlerën e sipërfaqes së dhënë në përdorim lek/ha/vit.

1Ha x 76,800 lek/ha/vit x 2 vjet 153,600 lekë.

b) Vlerën e përdorimit të rrugës lek/km/vit.

-1.1 km x 35,000 lek/km/vit x 2 vjet = 77,000 lekë.

-0.9 km x 25,000 lek /km/vit x 2 vjet = 45,000 lekë.

c) Vlera e lëndës drusore që do të pritët:

- nuk do hiqet material drusor në këto sipërfaqe.

Totali (a+b+c) = 275,600 lekë.

Për kontratën me numër 2733/2 prot., datë 19.04.2022 është aplikuar tarifa referuar VKM. nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", tabela nr 9.

Objekti kontratës është vendosje anemometri për matjen e erës, njësia e administrimit të pyjeve i është referuar veprimtarise për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektsh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe. Nga ana e strukturave të bashkisë Lezhë konkretisht Drejtoria e bujqësisë njësia e administrimit të pyjeve nuk argumentohet fakti, pse janë referuar tabelës nr. 9 bashkëlidhur VKM. nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006.

Sipas objektit të kontratës nga ana e strukturave të Bashkisë Lezhë duhej aplikuar tarifa sipas tabelës 8 të VKM nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të

kullotave" ku përcaktohet veprimtaria "Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj.)"

Në tabelën numër 8 niveli i tarifës është i përcaktuar Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit 2-5 vjet është 150,000 lekë.

Subjekti Kiraç Otomayson albania ka paguar vetëm për kontratën nr.273/2 prot., datë 19.04.2022 për vlerën 275,600 lekë, ndërkohë që duhej të paguante 422,000 lekë duke sjellë një vlerë debitore prej **146,400 lekë** e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë.

- Lidhur me subjektet që operojnë në territorin e Bashkisë Lezhë.

Duke iu referuar subjekteve nxjerrë nga regjistri i lejeve minerare, konstatohet se në territorin e Bashkisë lezhë ushrojnë aktivitetin e tyre me veprimtari gurë gëlqeror argjilë etj.

Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion nga njësisia së Administrimit të pyjeve, konstatohet se për subjektet e pasqyruar në tabelën e mëposhtme nuk është lidhur kontratë qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor kombëtar.

Tabela nr. 12 Subjektet nxjerrë nga rregjistri i lejeve Minerare

| Nr. | Emri i subjektit | Nipt | Bashkia | Emertimi i vendburimit | Lloji i Mineralit |
|-----|------------------|-------|---------|------------------------------|-------------------|
| 1 | A shpk | K...P | Lezhë | Baldre, Lezhë | Gur gëlqeror |
| 2 | K shpk | L...G | Lezhë | Tresh | Gur gëlqeror |
| 3 | Q shpk | K...N | Lezhë | Gjocaj, Balldre, | Gur gëlqeror |
| 4 | B shpk | J...P | Lezhë | Torrovice, | Gur gëlqeror |
| 5 | GJ Sh.p.k | J...M | Lezhë | Gjonbardhaj, Ungrej, Lezhe | Gabro |
| 6 | K | L...G | Lezhë | Objekti Tresh | Gur gëlqeror |
| 7 | M shpk | J...S | Lezhë | Obj. Gryke Zeze, Qarku Lezhe | Argjilë |

Burimi: nxjerrë nga rregjistri i lejeve Minerare.

-Veprime në kundërshtime VKM nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

Kriteri: VKM nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 të këshillit të ministrave "për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave".

Shkaku: Mos zbatim i kuadrit rregullator të fushës.

Ndikimi /Efekti: Të ardhura të munguara në vlerën 146,400 lekë.

Rëndësia: e Lartë

Për veprimet dhe mos veprimet ngarkohen me përgjegjësi, z. A. P. Përgjegjësi i njësisë së Administrimit të pyjeve.

Auditimi i procedurave të kryera për menaxhimin e të ardhurave nga taksa e lëshimit të Autorizimeve / Licencave për subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Lezhë.

Titulli i Gjetjes: Menaxhimi i të ardhurave nga tarifa e licencimit të subjekteve që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë.

Situata: Grupi i auditimit auditoi dokumentacionin lidhur me pajisjen e subjekteve me autorizim për ushtrimin e aktivitetit në zbatim të legjislacionit në fuqi përkatësisht:

- Ligjit nr. 8450, datë 24.2.1999 "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, të gazit dhe nënprodukteve të tyre", i ndryshuar me ligjin nr. 71/2014 "Për disa shtesa dhe ndryshime

në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, të ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2;

- VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr. 970, datë 02.12.2015, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj”, pika 2/9 “Pagesa për dhënien dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3,000,000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1,000,000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera”.

Nga auditimi i dokumentacionit për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, që operojnë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë (periudhën e viti 2022 rezultojnë se ushtrojnë veprimtarin e tyre 13 subjekte. Duke iu referuar tabelës së më poshtme vërehet se kemi të bëjmë me 4 (katër) raste të subjekteve të cilët nuk janë të pajisur me licensat përkatëse, 4 nga subjektet nuk kanë kryer pagesën e plotë.

Tabela nr.14 Subjektet që tregtojnë karburante për konsumatorët fundorë të Bashkisë Lezhë.

| Nr | Subjekti | Adresa | NIPTI | Paisur me licence | | Licenca | | Fatura vlera | Pagesa | Detyrimi |
|---------------|-----------|--------------------|-------|-------------------|----|------------|------------|-------------------|-------------------|------------------|
| | | | | Po | jo | Fillon | Mbaron | | | |
| 1 | G | ISHULL LEZHË | K...T | PO | | 14.01.2022 | 13.01.2027 | 1.000.000 | 1.000.000 | |
| 2 | G | DAJÇ, LEZHË | K...T | PO | | 26.01.2021 | 25.01.2026 | 1.000.000 | 1.000.000 | |
| 3 | G | LEZHË-SHKODËR, km1 | K...T | PO | | 29.12.2020 | 28.12.2025 | 1.000.000 | 1.000.000 | |
| 4 | G | LEZHË-TIRANË, km 1 | K...T | PO | | 29.12.2020 | 28.12.2025 | 1.000.000 | 1.000.000 | |
| 5 | V | LAGJE GURRA, LEZHË | K...U | PO | | 16.09.2019 | 15.09.2024 | 1.000.000 | 1.000.000 | |
| 6 | L | SHËNKOLL, LEZHË | K...U | PO | | 18.10.2022 | 17.10.2027 | 1.000.000 | 1.000.000 | 0 |
| 7 | A | SHËNKOLL, LEZHË | L...F | PO | | 26.10.2021 | 25.10.2026 | 1.000.000 | 1.000.000 | 0 |
në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe çështje të rëndësishme, që dolën gjatë auditimit, përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet e rëndësishme profesionale të bëra në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshtatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinionet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

Mbajtja e Kontabilitetit dhe Hartimi i Pasqyrave Financiare.

▪ **Pjesë përbërëse të Pasqyrave Financiare të vitit 2022 janë:**

- Pasqyra e pozicionit financiar (F1);
- Pasyra e performancës financiare (F2);
- Pasqyra e flukseve monetare (F3);
- Pasqyra e ndryshimeve në aktivet neto/fondet neto (F4);
- Pyetësor dhe shënimet shpjeguese mbi pasyrat financiare (F5);

Pasqyrat statistikore:

- Investimet dhe burimi i financimit (F6);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, kosto historike (F7.a);
- Gjendja dhe ndryshimet në aktivet afatgjata, vlera neto (F7.b);
- Numri i punonjësve dhe fondi i pagave (F8);
- Gjithashtu, Pasqyrat Financiare për nga forma janë përgatitur dhe janë plotësuar sipas kërkesave të udhëzimit nr. 8, datë 09.03.2018, i ndryshuar, ku është dhënë informacion mbi:
 - Emrin e njësisë ekonomike raportuese, Bashkia Lezhë me NIPT K....Ë;
 - Periudhën kontabël të mbuluar nga pasqyrat financiare, nga 01.01.2022-31.12.2022;
 - Monedhën e paraqitjes së pasqyrave financiare, në lekë;
 - Data e hartimit të Pasqyrave Financiare, 31.03.2023;
 - Përgatitur nga znj.M.LL ;
 - Pasqyrat Financiare janë dërguar në Degën e Thesarit Lezhë me shkresën nr.3619, datë 31.03.2022, nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, në mungesë dhe me porosi Sekretari i Përgjithshëm z. R.C .

-Mbajtja e kontabilitetit dhe funksionimi i llogarive sintetike me llogaritë analitike. Në këtë Bashki, kontabiliteti mbahet në mënyrë manuale, që e bën me risk të lart për sa i përket sigurisë në saktësinë informacionit që marrim nga ky sistem kontabiliteti.

Mbi aktivet e qëndrueshme të trupëzuara dhe të pa trupëzuara.

a. Objektivat e auditimit të aktiveve të qëndrueshme, janë që të sigurohemi se:

Aktivitet ekzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

b. Kontrolle të llogarive dhe dokumenteve.

Gjendja e llogarive të Pasqyrave Financiare të Bashkisë Lezhë paraqitet si më poshtë:

| Nr. Llogarisë | Përshkrimi | Viti 2022 | Viti 2021 |
|---------------|--|-----------------------|-----------------------|
| | A K T I V E T | 10,283,077,386 | 10,523,408,890 |
| | I.Aktivët Afat shkurtra | 807,274,243 | 2,163,894,354 |
| | 1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre | 2,495,767 | 799,097,875 |
| 520 | Disponibilitete ne Thesar | 594,883,955 | 798,481,575 |
| 532 | Vlera te tjera | 2,495,767.20 | 616,300 |
| | 2.Gjendje Inventari qarkullues | 80,184,830 | 77,938,943 |
| 31 | Materiale | 13,478,877.93 | 10,002,698.00 |
| 32 | Inventar i imet | 66,705,952.00 | 67,936,245.00 |
| | 3.Llogari te Arketueshme | 634,762,607 | 1,013,229,718 |
| 468 | Debitore te ndryshem | 512,259,280.90 | 923,488,685 |
| 4342 | Operacione me shtetin (Te drejta) | 122,503,325.72 | 89,741,032.80 |
| | 4.Te tjera aktive afatshkurtra | 89,831,039 | 273,627,818 |

| | | | |
|-----------|---|--------------------------|-----------------------|
| 486 | Shpenzime te periU ve te ardhshme | 89,831,039 | 273,627,818 |
| | II.Aktivet Afat gjata | 9,475,803,143 | 8,359,514,536 |
| 20 | 1.Aktive Afatgjata jo materiale | 14,022,117 | 16,496,609 |
| 202 | Studime dhe kerkime | 14,022,117 | 16,496,609 |
| 21 | 2.Aktive Afatgjata materiale | 6,231,711,666 | 6,211,259,116 |
| 210 | Toka, Troje, Terene | 1,085,472,103.00 | 1,085,472,103.00 |
| 211 | Pyje, Plantacione | 32,209,779.36 | 33,419,030.95 |
| 212 | Ndertesa e Konstruksione | 3,079,665,003.00 | 3,138,308,660.00 |
| 213 | Rruge, rrjete, vepra ujore | 1,875,468,770.23 | 1,843,984,301.90 |
| 214 | Instalime teknike, makineri e paisje | 11,933,750.82 | 14,186,538.80 |
| 215 | Mjete Transporti | 43,842,905.44 | 22,397,031.80 |
| 218 | Inventar ekonomik | 103,119,354 | 73,491,450.00 |
| 25-26 | 3.Aktive Afatgjata Financiare | 0 | 0 |
| | 4.Investime | 3,230,069,360 | 2,131,758,811 |
| 230 | Per Aktive Afatgjata jo materiale | 102,665,632.00 | 85,041,663.00 |
| 231 | Per Aktive Afatgjata materiale | 3,127,403,728.00 | 2,046,717,148.00 |
| B | PASIVET(DETYRIMET) | 874,514,505 | 1,390,151,180 |
| | I.Pasivet Afat shkurtra | 865,693,670 | 1,370,772,907 |
| | 1. Llogari te Pagushme | 863,197,902.62 | 1,370,156,607 |
| 401-408 | Furnitore e llogari te lidhura me to | 78,809,807.72 | 50,565,776.80 |
| 42 | Detyrime ndaj personelit | 31,504,215.00 | 28,060,688.00 |
| 431 | Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa | 1,597,944 | 1,654,833 |
| 435 | Sigurime Shoqerore | 9,205,073 | 8,224,529 |
| 436 | Sigurime Shendetsores | 1,277,439 | 1,141,769 |
| 437,438, | Organizma te tjere shteterore | 108,847 | 93,437 |
| 466 | Kreditore per mjete ne ruajtje | 138,604,257.00 | 83,299,071.00 |
| 467 | Kreditore te ndryshem | 89,831,039.00 | 273,627,818.00 |
| 4341 | Operacione me shtetin(detyrime | 512,259,280.90 | 923,488,684.90 |
| | 2.Te tjera pasive afatshkurtra | 2,495,767 | 616,300 |
| 480 | Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar | 2,495,767.20 | 616,300.00 |
| | II.Pasivet Afat Gjata | 8,820,835 | 19,378,273 |
| 16.17,18 | Huate Afat gjata | 8,820,834.92 | 19,378,272.92 |
| C | AKTIVET NETO/ FONDET (A-B) | 9,408,562,881.26 | 9,133,257,711 |
| D | FONDI I KONSOLIDUAR : | 10,003,446,836.13 | 9,133,257,711 |
| | Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar | 6,328,164,500.18 | 6,314,910,100.70 |
| 101 | Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar | 6,328,164,500.18 | 6,314,910,100.70 |
| 85 | Rezultati I Veprimtarise Ushtrimore | 454,033,810.87 | 705,967,071.77 |
| 105 | Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme | 3,221,248,525.08 | 2,112,380,538.08 |
| E | TOTALI I PASIVEVE(B+C) | 10,877,961,341 | 10,523,408,890 |

1. Pasqyra e pozicionit financiar (F1)

Aktivet neto janë të barabarta me Aktivet-Pasivet = 10,003,446,836 lekë.

- Aktivet 10,877,961,341 lekë
- Pasivet 874,514,505 lekë
- Aktivet neto 10,003,446,836 lekë

Aktivi i Bilancit

Aktivet afatshkurtra

Aktivet afatshkurtra më datë 31.12.2022 paraqiten në vlerën **1,402,158,198 lekë** dhe përbëhen nga:

- Llogaritë e Klasës 5 “Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre” në shumën 597,379,722 lekë;
 - Llogaritë e Klasës 3 “Gjendje inventari qarkullues” në shumën 80,184,830 lekë;
 - Llogaritë e Klasës 4 “Llogari të arkëtueshme” në shumën 634,762,607 lekë dhe
 - “Të tjera aktive afatshkurtra” në shumën 89,831,039 lekë.
- Vlera e llogarisë 520 “Disponibilitete në thesar” në shumën 594,883,955 lekë, e cila përbëhet nga gjendja e fondeve ne thesar me 31.12.2022 në shumën 456,279,698 lekë dhe gjendja e llogarisë 466 "Mjete në ruajtje" në shumën 138,604,257 lekë.
 - Mjetet në ruajtje përbëhen nga ndalesat e 5 % të garancisë së punimeve.
 - Llogaritë e Klasës 3, sipas Pasqyrës së Pozicionit Financiar të Bashkisë Lezhë në 31.12.2022 paraqiten në vlerën 80,184,830 lekë dhe përbehet nga llogaria kontabël 31 “Materiale” në

vlerën 13,478,877 lekë dhe nga llogaria kontabël 32 “Objekte inventari” në vlerën 66,705,952 lekë.

Diferenca me vitin e mëparshëm përfaqëson lëvizjen e inventarit në shumën (2,245,887) lekë, përbën efektin në shpenzime e cila kuadron me llogarinë 63 “Ndryshimi gjendjes së inventarit” (pasqyra F2 – performanca financiare).

Gjendja e llogarive të mësipërme është e kuadruar me gjendjen e inventarëve. Për kryerjen e tyre është zbatuar udhëzimi i MF nr. 30, datë 27.12.2012 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, Titullari i Bashkisë Lezhë ka nxjerrë Urdhrin nr.538, datë 05.10.2022 dhe 539, datë 05.10.2022.

Llogaritë e klasës 3 kanë funksionuar duke u debituar për shtesat në kredi të llog. 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit” dhe duke u kredituar për daljet e inventarit në debi të llogarisë 63 “Ndryshimi i gjendjeve të inventarit”.

Llogaria 4342 “Të tjera Operacione me shtetin (të drejta)” paraqitet me gjendje në shumën 122,503,325 lekë në fund të vitit 2022. Vlerat e mëposhtme përfaqësojnë detyrimet e muajit dhjetor të cilat likujdohen kryesisht në vitin 2023.

| Përshkrimi | Mbetja në fund të vitit 2022 (Debitimi) |
|-------------------|---|
| Furnitore | 39,132,168.79 |
| Furnitore per AQT | 39,677,638.94 |
| Paga punonj. | 31,504,215.00 |
| Tatime | 1,597,944.00 |
| Sig.Shoq. | 9,205,073.00 |
| Sig Shendetesore | 1,277,439.00 |
| Sig Supplement | 108,847.00 |

-Gjendja e llogarisë 202 “Studime e projekte” në çelje të vitit 2022 gjendjet në vlerën 16,496,609 lekë, ndërsa në fund të vitit 2022 rezulton në vlerën 14,022,117 lekë, pakësuar me vlerën 2,474,491, amortizimi i përlllogaritur për vitin 2022.

-Gjendja e llogarisë 210 “Toka, troje dhe terrene”, në çelje të vitit 2022 ka qenë në shumën 1,085,472,103 lekë, e pa ndryshuar dhe në fund të vitit 2022.

-Gjendja e llogarisë 211 “Pyje, Plantacione”, në çelje të vitit 2022 ka qenë në shumën 33,419,030 lekë, ndërsa në mbyllje të ushtrimit për vitin 2022 rezulton në vlerën 32,209,779 lekë, si rrjedhojë e shtesave në vlerën 486,000 lekë dhe amortizimi për vitin 2022 në vlerën 1,695,252 lekë.

-Gjendja e llogarisë nr.212 “Ndërtime e konstruksione” në çelje të vitit 2022 ka qenë në shumën 3,138,308,660 lekë (kosto historike, duke zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 3,079,665,003 (kosto historike – amortizimin e akumuluar + shtesa gjatë vitit 2022 - amortizimin e vitit 2022). Shtesat gjatë vitit janë si më poshtë:

| Objekti | Shtesa |
|--|------------|
| Rikonstrukcion Gjimnazi i vjeter Hydajet Lezha | 14,985,961 |
| Rikonstrukcion i SHMB Ishull Lezhe | 80,221,200 |
| Riko Shkolla 9-vjecare Manati | 2,517,740 |
| Rikonstrukcion SHMB Kallmet | 5,504,727 |
| Shtim Riko. i godines se ish banks | 299,040 |

-Gjendja e llogarisë 213 “Rrugë, rrjete dhe vepra ujore” në çelje të vitit 2022, ka qenë në shumën 1,843,984,302 lekë (kosto historike, zbritur amortizimin e akumuluar) dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 1,875,468,770 lekë (kosto historike – amortizimin e akumuluar + shtesa gjatë vitit 2022 - amortizimin e vitit 2022). Shtesat gjatë vitit janë si më poshtë:

| Objekti | Vlera |
|---|---------------|
| Rruga Koder Marlekaj | 4,759,200.00 |
| Sistemim asfaltimi rruges Azem Hajdari | 36,693,840.00 |
| Rehabilitim i kanalit ujites Koterr Rraboshte | 27,659,436.00 |
| Rehabilitim i kanalit ujites Koterr Rraboshte | 18,439,816.00 |
| Sistemim asfaltimi i rruges se brendshme fshati Mabe | 13,995,300.00 |
| Sistemim asfaltimi i rruges se brendshme fshati Grash | 13,970,719.00 |
| Sistemim asfaltim i rruges superstrad Piraj | 14,675,040.00 |

Pasivi i Bilancit

Shuma e llogarisë sintetike të klasës 4 “Detyrimet afatshkurtra” është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shtetin (debitor) në aktivin e bilancit.

-Llogaria 401- 408 “Furnitorë e llogari të lidhura me to” në çelje të vitit 2022 paraqitet në vlerën 50,565,776 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2022 paraqitet në shumën 78,809,807 lekë.

Llogaria 401

| Përshkrimi | 31.12.2021 | Shtesa (K) | Pakesime (D) | 31.12.2022 |
|---|----------------------|-----------------------|-----------------------|----------------------|
| Blerje dokumentacioni blloqe -Enti Botues | 23,040.00 | 118,500.00 | 118500 | 23,040.00 |
| Blerje materiale kancelarie per nevoja te Bashkise Lezhe -Infosoft | 536,681.70 | 2,888,540.40 | 1,425,222.00 | 2,000,000.10 |
| Blerje Gazi | 2,079,371.04 | 48,648,988.31 | 47,522,080.00 | 3,206,279.35 |
| Blerje materiale kancelarie per nevoja te Bashkise Lezhe -Infosoft | 2,676,328.80 | 0 | 2,676,328.00 | 0.8 |
| Blerje materiale ndertimi | 8,516,652.00 | 672,000.00 | 9,188,652.00 | |
| | 209,364.00 | | | 209,364.00 |
| Blerje kancelarie leter A4 | 0.8 | 119,525.00 | 119,525.00 | 0.8 |
| Blerje Blloqesh | 784,500.00 | 127,200.00 | 911,700.00 | |
| Blerje materiale ndertimi | 24,684,616.80 | 61,298,730.00 | 65,505,331.00 | 20,478,015.80 |
| Blerje dru zjarri | 3,969,787.20 | 2,520,600.00 | 6,490,387.20 | |
| Blerje materiale per sinjalistiken vertikale –T. K.. | 55,199.32 | | 55,199.00 | 0.32 |
| Blerje Ushqimesh | 3,130,835.14 | 10,309,375.12 | 12,404,282.00 | 1,035,928.26 |
| Blerje Detergjent | 0.00 | 3,944,695.36 | | 3,944,695.36 |
| Blerje materiale per sinjalistiken vertikale dhe horizontale SI-SI AL | 2,231,400.00 | | 2,231,400.00 | |
| Aktivitet Vizitat kulturore mes shkollave ,blerje bluza –A.Sh. | | 18,000.00 | 18,000.00 | |
| P | 1,668,000.00 | | | 1,668,000.00 |
| Blerje kancelarie | | 338,900.00 | 338,900.00 | |
| Sherbim interneti | | 355,320.00 | 355,320.00 | |
| Blerje boje prinetri | | 30,000.00 | 30,000.00 | |
| Blerje broshura dhe harta | | 418,800.00 | 418,800.00 | |
| Dru Zjarri dhe Pelet | | 3,473,100.00 | | 3,473,100.00 |
| A. G. -Lule natyrale | | 3,093,744.00 | | 3,093,744.00 |
| | 50,565,776.80 | 138,376,018.19 | 149,809,626.20 | 39,132,168.79 |

Llogaria 404

| Nr. | | 12/31/2021 | Shtesa (K) | Pakesime (D) | 12/31/2022 |
|-----|--|------------|----------------------|----------------------|-------------------|
| 1 | Blerje sobash per shkolla dhe kopshtet –T. K. | | | 869,398.00 | |
| 2 | Blerje paisje kompjuterike per nevojat e Administrates dhe MZSH -FASTECH | | | 2,058,720.00 | |
| 3 | Blerje paisje elektronike per Drejtorine E Integritit - EU.-FASTECH | | | 1,387,319.00 | |
| 4 | Blerje automjeti zjarrfikes -S | | | 11,850,600.00 | |
| 5 | Raft metaik – E.C. | | | 120,000.00 | |
| | Hyrje ne magazine 6m-I | | 16,286,037.00 | .00 | |
| 6 | Blerje korres bari -Luca | | | 120,000.00 | |
| 7 | Blerje paisje kondicionimi FV per nevojat e administrates -Hidroklima N. Ll. | | | 310,800.00 | |
| 8 | Blerje automjetesh -S | | | 11,808,000.00 | |
| 9 | Blerje lavastovilje per kopshte –M. Xh. FH nr 43 dt 07.10.2022 | | | 120,000.00 | |
| 10 | Blerje kompjuteri per financen – C.R. C. | | | 117,600.00 | |
| 11 | Kamioncina 3.5 ton me 7 vende per Dr. e Sherbimeve S SHPK | | | 2,400,000.00 | |
| | Hyrje ne magazine 6m-II | | 54,554,038.94 | .00 | |
| | Levizja | | 70,840,075.94 | 31,162,437.00 | |
| | Gjendja | | | | 39,677,639 |

Fondi i Konsoliduar

Në mbyllje të vitit ushtrimor 2022 paraqitet në vlerën **10,003,446,836 lekë**. Fondi i Konsoliduar është i barabartë me fondet neto. Gjendja e fondit të konsoliduar rezulton nga diferenca e shumës së aktiveve me pasivet.

| | | |
|--|--------------------------|----------------------|
| Fondi i konsoliduar | 10,003,446,836.13 | 9,133,257,711 |
| Teprica (Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar | 6,328,164,500.18 | 6,314,910,100.70 |
| Rezultati i Veprimtarise Ushtrimore | 454,033,810.87 | 705,967,071.77 |
| Teprica e Granteve kapitale Te Brendshme | 3,221,248,525.08 | 2,112,380,538.08 |

-Pasqyra e performancës financiare dhe rezultati i ushtrimit i pasqyruar në llogarinë nr.85 për vlerën 454,033,810 lekë është e rakorduar me akt-rakordimin e mbajtur në degën e thesarit Lezhë.

Nga auditimi i pasqyrave financiare individuale rezultoi:

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në thesar”.

Situata: Llogaria nr. 520 “Disponibilitete në thesar”, në fillim të vitit 2022 është në vlerën 798,481,575 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 594,883,955 lekë.

Nga testimi i llogarisë 520, rezulton se në fund të vitit është në vlerën 592,582,104 lekë, ose 2,301,850 lekë më pak nga vlera e pasqyruar në PF në mbyllje të vitit 2022, e cila pasqyrohet në vlerën 594,883,955 lekë.

Testimi i llogarisë nr.520

| I.Të trashëguara nga viti 2021 | Lekë |
|--|-------------------------|
| Sipas aktit të rakordimit për shumën. Nga të cilat: | |
| Granti i trashëguar | 598,841,664.30 |
| Të ardhura të trashëguara | 93,567,748.63 |
| Mjete në ruajtje të trashëguara (llog. 466) | 83,299,071 |
| Fonde specifike | 22,773,083.20 |
| FZHR | |
| Totali | 798,481,567.13 |
| | |
| II.Të hyrat (Shtesat debitore) gjatë vitit 2022 | |
| Granti i vitit | 420,887,675.66 |
| Të ardhurat e vitit | 438,851,259 |
| Të hyra nga mjetet në ruajtje | 67,046,971 |
| Granti specifik | 239,170,397 |
| Rindertimi | 772,182,911 |
| Tot. | 1,938,139,213.66 |
| Totali i të ardhurave (I+II) | 2,736,620,780.79 |
| | |
| III.Lëvizjet kreditore të llogarisë 520 gjate vitit 2022 | |
| Paga sigurime (600+601) | 490,337,580 |
| Shpenzime operative (602) | 389,050,257 |
| Transferime korente të brendshme (604) | 12,077,099 |
| Transferime për buxhetet familjare dhe individë (606) | 54,525,165 |
| Kredia (ISP) + Interesa për huamarje (651) | 11,089,722 |
| Investime (231) | 1,171,422,185 |
| Të dala nga mjetet në ruajtje (466) | 14,043,635 |
| Transferime korente te brendshme + transfertat buxhetin e vet (418,470,743 +5,975,765) | 1,493,033 |
| Totali i shpenzimeve | 2,144,038,676 |
| Diferenca = (I+II) - (III) | 592,582,104.79 |

Burimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Lezhë

-Pra llogaria nr.520 është mbivlerësuar me 2,301,850 lekë.

Kriteri: Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, pika 15.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.520 “Disponibilitete në thesar”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2022.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”.

Situata: Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2022 është në vlerën 923,488,685 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 512,259,280.90 lekë, pra me një rritje të vlerës së debitorëve të Bashkisë Lezhë në vlerën 411,229,404 lekë.

| Levizja e llogarisë 468 Sintetike | | | | Viti 2022 | | |
|-----------------------------------|-----------------------|----------------------|-----------------------|------------|-------------|-------------|
| Viti | Bashkia Lezhë dhe NJA | Përshkrimi | Gjendja 31.12.2021 | Debi | Kredi | Mbetja |
| 2022 | | Debitore te ndryshem | 923,488,685 | 31,100,438 | 442,329,842 | 512,259,281 |

Nga verifikimi i listës analitike të debitorëve në fund të vitit 2022, konstatohet se nuk janë kontabilizuar të drejtat për arkëtim në vlerën 60,565,959 lekë, si më poshtë vijon:

44,129,056 lekë për taksat dhe tarifat ndaj kategorisë “Familjar” – për këtë mban 6,141,053 lekë për taksën e ndikimit në infrastrukturë për legalizimin e objekteve informale;
103,000 lekë për gjoba të policisë bashkiake;
6,240,000 lekë kamat-vonesë e papërlllogaritur për gjobat e IVMT;

| Nr. | Subjekti | Principal | Kamat-vonesa | Ditë | Vlera e kamat-vonesës | Total |
|-----|----------|------------|--------------|------|-----------------------|------------|
| 1 | I | 500,000 | 0.02 | 30 | 300,000 | 800,000 |
| 2 | H.B | 500,000 | 0.02 | 30 | 300,000 | 800,000 |
| 3 | P | 500,000 | 0.02 | 30 | 300,000 | 800,000 |
| 4 | Z.N | 500,000 | 0.02 | 30 | 300,000 | 800,000 |
| 5 | N | 500,000 | 0.02 | 30 | 300,000 | 800,000 |
| 6 | F | 1,000,000 | 0.02 | 30 | 600,000 | 1,600,000 |
| 7 | L | 500,000 | 0.02 | 30 | 300,000 | 800,000 |
| 8 | L | 500,000 | 0.02 | 30 | 300,000 | 800,000 |
| 9 | N.K | 500,000 | 0.02 | 30 | 300,000 | 800,000 |
| 10 | I | 500,000 | 0.02 | 30 | 300,000 | 800,000 |
| 11 | A.P | 4,900,000 | 0.02 | 30 | 2,940,000 | 7,840,000 |
| | | 10,400,000 | | | 6,240,000 | 16,640,000 |

3,952,850 lekë për shfrytëzimin e hapësirës së plazhit;

| Nr. | Emër Mbiemër, Subjekt | Nipt | Vendodhja (Plazhi) | Lekë/m ² | Sip. m ² | Vlera në Lekë |
|-----|-----------------------|-------|--------------------|---------------------|---------------------|-------------------|
| 1 | A.D | M...T | Zona 1 | 600 | 1500 | 900.000 |
| 2 | V.M | L...G | Zona 2 | 500 | 618 | 309.000 |
| 3 | N.S | L...B | Zona 2 | 500 | 826 | 413.000 |
| 4 | M.D | L...C | Zona 2 | 500 | 1087 | 543.500 |
| 5 | K | J...U | Zona 2 | 500 | 2609 | 1.304.500 |
| 6 | Y | L...J | Zona 3 | 450 | 177 | 79.650 |
| 7 | K.N | M...P | Zona 3 | 450 | 179 | 79.200 |
| 9 | N.M | L...T | Zona 4 | 400 | 30 | 12.000 |
| 11 | B.P | M...H | Zona 4 | 400 | 780 | 312.000 |
| | Totali | | | | | 3,952, 850 |

-Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

Kriteri: Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12;

Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, paragrafi 21, shkronja “c”.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr.468 “Debitorë të ndryshëm”, nuk paraqet situatën e drejtë të përbërjes së debitorëve të Bashkisë Lezhë në fund të vitit 2022.

Shkaku: Mungesë e bashkëpunimit ndërmjet strukturave të Bashkisë Lezhë në shkëmbimin e informacionit, si dhe mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”.

Situata: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 138,604,257 lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Lezhë.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2022, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Në mënyrë analitike, garancitë të cilave u ka kaluar afati i shlyerjes, si dhe objekti për të cilën është mbajtur kjo garanci ka përfunduar, paraqiten si më poshtë:

| Nr | Objekti | Vlera |
|----|--|-----------|
| 1 | Rik.Rruge Qender Shengjin-Stom | 10,476 |
| 2 | Nd.Shkolla (9vjeçare) Beselidhja | 44,681 |
| 3 | Pune publike | 99,996 |
| 4 | Rik. Rruges tacioni trenit | 87,110 |
| 5 | Pajisje zyre Aparati | 88,680 |
| 6 | Sist. Rruge NeneTeraza | 452,585 |
| 7 | Sis. Blloku Sh.Ushtarakut | 90,147 |
| 8 | Rik Rruga A.Çela Gryke Lumi | 103,183 |
| 9 | Rik Rruga Gjader | 62,170 |
| 10 | Sist.Asf.Blloku L.Beselidhja prane DTT | 707,992 |
| 11 | Sist.Asf. Rruga Çameria | 275,000 |
| 12 | Rr.Hydajet Lezha perball Hotel Leti | 73,250 |
| 13 | Blloku prane pallteve te Gjok Nikes | 190,000 |
| 14 | Asfaltim Rruga Barbulloje | 78,000 |
| 15 | Sist.Asf.Rr.Varrezave Pllane | 369,000 |
| 16 | Rehab. Kanaleve urjrave larta | 63,247 |
| 17 | Rruga Lidhese Kune Shengjin | 489,302 |
| 18 | Rik.Rr.L.Gurakuqi (Prok-Ura e Cënit) | 115,850 |
| 19 | Sis asf. Ures torovice | 174,897 |
| 20 | Lulishte dhe parkim para Gjimmnazit | 1,096,213 |
| 21 | Ambjent.sportive Shkolla Balldre | 2,444,610 |
| 22 | Palestra Nene Tereza | 927,952 |
| 23 | Palestra Nene Tereza | 479,969 |
| 24 | Ambjent.sportive Shkolla Balldre | 1,264,439 |
| 25 | Rik Rruga Gjader | 264,052 |
| 26 | Ndertim Grope Septike | 35,340 |
| 27 | Spostim muri tek kthesa e rruges se plazhit | 37,620 |
| 28 | Rik.,Rruga Superstrate IEVP | 2,029,453 |
| 29 | F.V Trau elektronik per parkimin tek Sheshi Gjergj Kastrioti | 91,200 |
| 30 | Rruge te Brendshme Troshan | 350,000 |
| 31 | Rruga Rraboshte Shkolla 9 Vj | 313,590 |
| 32 | Sist.Asf.Rr.Qender Kakarriq-Gocaj,Ndriçimi Qender Kakarriq | 225,000 |
| 33 | Sist.Asf.Rr.Shkolles Lagjia Pukjaneve Gryke Lumi | 190,550 |
| 34 | Zyra informimit turistik | 66,888 |
| 35 | Sist.Rr.Frengen Kalivaç | 41,880 |
| 36 | Miremb.sis.asfaltim I Rr. Rurale | 2,710,329 |
| 37 | Sist. Asf.I rr. Tale1-Alk-Tale 2 | 700,000 |
| 38 | Rikon.Gjimmnazi Hydajet Lezha | 749,298 |

| | | |
|----|--|-------------------|
| 39 | Kanalit Ujites-Koterr Rrabosht, Nnenshat-Piraj-Nanshat | 300,000 |
| 40 | Kanalit Ujites-Koterr Rrabosht, Nnenshat-Piraj-Nanshat | 450,000 |
| 41 | Ndertim Ujesjellesi Nj Ad.Zejmen Loti I | 1,417,807 |
| 42 | Ndertim Ujesjellesi Nj Ad.Zejmen Loti I | 1,226,277 |
| 43 | Ndertim Ujesjellesi Nj Ad.Zejmen Loti I | 343,919 |
| | Total | 19,832,654 |

-Llogaria 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje” është mbivlerësuar për 19,832,654 lekë për vitin 2021.

Kriteri: Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 466 “Kreditore për mjete nën ruajtje”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2022.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimi e Llogarisë nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, vlera kontabël paraqitet në shumën 0 lekë.

Situata: Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Ujësjetllës Kanalizime Lezhë Sh.A” me NIPT M...C, u konstatua se Bashkia Lezhë zotëron 30.71% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 30710 aksione me vlerë nominale 100 lekë secili, në **total 3,071,000 lekë**.

-Pra sa më sipër llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar me **3,071,000 lekë**.

Kriteri: Urdhri i Ministrisë nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivët Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”.

VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikën kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”.

Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, Kreu 3.1, pika 31, shkronja “b”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2022.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”.

Situata: Gjendja e llogarisë nr.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën kontabël 512,259,280 lekë. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të parkëtuara nga vitet e mëparshme. Nga analiza e llogarisë analitike, rezulton se në llogarinë 4341, ndër të tjera janë kontabilizuar edhe debitorët (llogaria 468) ndaj Bashkisë Lezhë, për taksa dhe tarifa vendore, gjoba etj.

-Sa më sipër konstatohet se në llogarinë 4341 është bërë kontabilizim i gabuar i vlerës së debitorëve për taksa dhe tarifa vendore, gjoba etj. Nga analizimi i përbërjes së debitorëve, ilustruar për disa zëra, Bashkia Lezhë nuk ka detyrimin që t’i arkëtojë ato për llogari të buxhetit të shtetit, pasi nuk janë taksa të ndara apo Bashkia Lezhë të veprojë si agjent tatimor.

| Emërtimi i zërave në llogarinë 468 | Vlera |
|------------------------------------|-------------|
| Gjoha të IVMT | 95,048,780 |
| Biznesi i Madh | 141,104,498 |

| | |
|-----------------|------------|
| Biznesi i Vogël | 93,632,023 |
| Institucione | 4,465,076 |

Në këtë rast kemi të bëjmë me taksa dhe tarifa vendore, si dhe gjoba, të cilat kalojnë direkt në buxhetin e Bashkisë Lezhë.

-Sa më sipër llogaria nr.4341 është mbivlerësuar me vlerën 512,259,280 lekë.

Kriteri: Udhëzimi nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, klasa 4 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve”.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2022.

Shkaku: Mos zbatim i akteve ligjore të kontabilitetit dhe parimeve kontabël.

Titulli i gjetjes: Mbi kontabilizimin e llogarisë nr.467 “Kreditor të tjerë” me kundërparti llogarinë 486 “Shpenzime të periudhave të ardhshme”.

Situata: Llogaria 467 në fund të vitit 2022 paraqitet me vlerën 89,831,039 lekë. Nga auditimi i llogarisë analitike, konstatohet se nuk janë kontabilizuar detyrimet për:

- vendimet gjyqësore në vlerën 5,082,537 lekë, të cilat janë likujduar gjatë vitit 2023 për llogari të vitit 2022, pasqyruar si më poshtë vijon:

| Nr Urdher Shpenzimi | Data e pageses | Pershkrimi | Vlera |
|---------------------|----------------|--|-----------|
| 121 | 2/6/2023 | Ekzekutim vendimi gjyqësor-Kesti 6 -V.GJ | 2,272,457 |
| 157 | 2/14/2023 | Ekzekutim vendim gjyqësor I. M. | 843,960 |
| 158 | 2/15/2023 | Ekzekutim vendim gjyqësor P. Gj. | 1,966,120 |

Kriteri: Funksionimi kontabël i llogarive të klasës 4, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekti: Llogaria nr. 467 “Kreditor të tjerë”, nuk paraqet situatën e drejtë në fund të vitit 2022.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Titulli i gjetjes: Mbi inventarizimin, kontabilizimin si AQT dhe regjistrimin në kadastër të aseteve në pronësi të Bashkisë Lezhë.

Situata: Si çdo institucion publik, edhe Bashkia Lezhë, ka detyrimin ligjor që përpara konsolidimit të pasqyrës së pozicionit financiar, ndër të tjera, duhet të ketë të saktësuar zërat si: Pronat, tokat dhe pasuritë natyrore. Një pjesë e konsiderueshme e pronave dhe tokave, Bashkia Lezhë i ka fituar nëpërmjet akteve ligjore dhe nënligjore, shpronësimeve, si dhe një pjesë të tyre nga shkrija e ish komunave, aktualisht NJA të Bashkisë Lezhë. Me qëllim pasqyrimin real dhe të drejtë të vlerës së pronave dhe tokave në pasqyrat financiare, nga Bashkia Lezhë duhet bërë inventarizimi i tyre, duke bërë vlerësimin fizik, identifikimin e të metave dhe humbjeve, vlerësimin monetar, si dhe krijimin e regjistrit kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimi i aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëposhtme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes dhe datën e daljes nga pronësia etj. Pas përfundimit të procesit të inventarizimit, bëhet regjistrimi i tyre në regjistrat publik të pronës dhe në kontabilitet, duke vijuar me përditësimin periodik të tyre, sa herë që ka ndryshime në statusin juridik/fizik/monetar të saj. Për kryerjen e detyrave të mësipërme Bashkia Lezhë ka detyrimin që të krijoj ose të ngarkoj një strukturë të posaçme, e cila ka për objekt të veprimtarisë së saj vetëm inventarizimin, plotësimin, përditësimin dhe ndjekjen e

procesit deri në regjistrimin e pronave në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme dhe pajisjen me certifikatë pronësie, për çdo pasuri.

Të gjitha sa më sipër përcaktohen në kuadrin rregullator, si: Ligji nr. 20/2020 datë 5.3.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”, Ligji nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Ligji nr.111/2018 “Për Kadastrën”; Ligji nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala për zbatimin e tyre.

-Sa më sipër grupi i auditimit kërkoi regjistrin e pronave, tokave dhe pasurive natyrore të cilat janë në pronësi të Bashkisë Lezhë.

Gjithashtu referuar rregullores së brendshme të Bashkisë Lezhë, në nenin 42 përcaktohen detyrat konkrete për Drejtorinë e Administrimit të Aseteve për inventarizimin, përditësimin, regjistrimin e pronave të të gjitha llojeve.

Nga verifikimi i llogarisë 210, 211 dhe 212 për pasuritë e paluajtshme të aseteve, nuk rezulton të jetë kryer plotësisht detyra e mësipërme.

Konkretisht, për vitin 2022 nuk rezulton të jetë kryer inventarizimi i të gjithë pasurive (kryesisht trojet, pyjet, kullotat) të cilat janë në pronësi të Bashkisë Lezhë.

Nga 4473 pasuri në pronësi të Bashkisë Lezhë, rreth 441 / 10% prej tyre janë regjistruar në kadastrë dhe janë pajisur me certifikatë pronësie, pasqyruar në tabelën më poshtë:

| Nr. | Bashkia/Njesite | Nr. Pronave në Inventar | Prona të regjistruara në Kadastrë |
|-----|-----------------|-------------------------|-----------------------------------|
| 1 | Bashkia Lezhë | 291 | 169 |
| 2 | NJA. Balldren | 941 | 53 |
| 3 | NJA. Zejmen | 183 | 22 |
| 4 | NJA. Kolsh | 204 | 26 |
| 5 | NJA. Shengjin | 362 | 70 |
| 6 | NJA. Kallmet | 285 | 10 |
| 7 | NJA. Ungrej | 600 | 0 |
| 8 | NJA. Dajc | 154 | 13 |
| 9 | NJA. Shenkoll | 1258 | 73 |
| 10 | NJA. Blinisht | 195 | 5 |
| | Total | 4473 | 441 |

-Gjithashtu konstatohet se jo të gjithë VKM të cilat kanë kaluar në pronësi të Bashkisë Lezhë, gjejnë pasqyrim në inventarin e mbajtur nga Drejtoria e Administrimit të Aseteve, si më poshtë vijon:

VKM nr.177, datë 13.2.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Blinisht, të Qarkut të Lezhës”.

VKM nr.516, datë 23.4.2008 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave, pyje dhe kullota, që do të transferohen në pronësi të njësisë së qeverisjes vendore, Komuna Ungrej, të Qarkut të Lezhës”.

VKM nr. 1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga ministria e bujqësisë, zhvillimit rural dhe administrimit të ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujëtjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të bordeve rajonale të kullimit”.

VKM nr. 600, datë 13.10.2021 “Për pronësinë e rrugëve shtetërore dhe kalimet e pronësisë ndërmjet enteve pronare të rrugëve”.

VKM nr. 134, datë 03.03.2021 për disa ndryshime në vendimin nr. 433, datë 8.6.2016, të këshillit të ministrave, “për transferimin në pronësi të bashkive të pyjeve dhe kullotave publike, sipas listave të inventarit, dhe aktualisht në administrim të ministrisë së mjedisit e të ish-komunave/bashkive”, të ndryshuar.

Gjithashtu, nga auditimi i pasqyrave financiare, llogari nr.210, konstatohet se:

1. Nuk është kryer inventarizimi i tyre;

2. Objektet e kontabilizuara nuk pasqyrohen me emërtimet e tyre, por vetëm me mbishkrimin “Toka, troje dhe terrene”, pra nuk identifikohet përbërja e kësaj llogarie dhe saktësia e veprimeve kontabël;

3. Rregjistri që mbahet nga Drejtoria e Financës për këtë llogari, nuk është i plotë me informacion, pasi mungon informacioni për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës etj.

-Nga analiza e llogarisë nr.211, konstatohet se:

1. Nuk është kryer inventarizimi i tyre;

2. Objektet e kontabilizuara nuk pasqyrohen me emërtimet e tyre, por vetëm me mbishkrimin “Pyje, plantacione”, pra nuk identifikohet përbërja e kësaj llogarie dhe saktësia e veprimeve kontabël;

3. Rregjistri që mbahet nga Drejtoria e Financës për këtë llogari, nuk është i plotë me informacion, pasi mungon informacioni për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës etj.

Kriteri: Nenin 35, nenin 37, nenin 41 dhe nenin 44 në Ligjin nr. 20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 6 në Ligjin nr.8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, i ndryshuar; Nenin 62 në Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”; Nenin 9 dhe nenin 12 në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; VKM Nr.500, datë 14.8.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore dhe transferimin e pronave në njësitë e qeverisjes vendore”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Kapitulli III, pika 30 dhe paragrafi 104 në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar.

Ndikimi/Efekt: Llogaritë nr. 210 “Toka, troje, terrene”, nr. 211 “Pyje Plantacione” nr.212 “Ndërtesa dhe konstruksione” nuk paraqesin situatën e vërtetë dhe të drejtë në fund të vitit 2022.

Shkaku: Moszbatim i kuadrit rregullator përkatës.

Për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi M.LL përgjegjëse e Sektorit të financës hartuese e Pasqyrave Financiare.

z. G.J.M Drejtor i Aseteve Bashkia Lezhë.

2.4 Mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik

Në zbatim të Programit të Auditimit nga audituesit e KLSH-së u audituan procedurat e nëposhtme:

| Nr | Objekti | Fondi limit | Operatori fitues |
|----|--|---------------|-----------------------------|
| 1 | “Përmirësimi I infrastrukturës rrugore për këmbësorët dhe biçikletat në fshatin Ishull Lezhë”, Bashkia Lezhë | 20,400,020 | BOE “Z ” ShPK & “I ” ShPK |
| 2 | “Blerje automjete dhe mjete të rënda për nevoja të Bashkisë Lezhë”, Bashkia Lezhë | 17,130,000 | “S ” SHPK |
| 3 | “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në plazhin e Tales, Njësia Administrative Shënkoll”, Bashkia Lezhë | 76,897,654.66 | BOE “A ” ShPK dhe “A ” ShPK |
| 4 | “Blerjen Naftë për nevoja të Bashkisë Lezhë | 37,054,956.51 | “L ” SHPK |
| 5 | “Shërbimi për organizimin e eventeve, festave dhe dekorit në Bashkinë Lezhë | 31,137,828 | OE “R ” ShPK |

| | | | |
|---|--|-------------|---------------------------------------|
| 6 | “Rikonstruksion i çerdhes në Qytetin Lezhë” | 24,999,965 | BOE “R ” ShPK & “U ” ShPK & “A ” ShPK |
| 7 | “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë” | 250,814,497 | OE “U ” ShPK |
| 8 | “Rehabilitimi i shëtitores dhe lulishtes mbi lumin Drin”, Bashkia Lezhë | 94,750,000 | “M ” SHPK, “E ” SHPK & “V ” SHPK |

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

- 1- Regjistri i realizimit të prokurimeve të periudhës 01/01/2022 – 31/12/2022;
- 2- Dosjet e procedurave të përcaktuara për auditim, sipas analizës së riskut;
- 3- DST e hartuar nga NJP për procedurat e përcaktuara për auditim;
- 4- Sistemi elektronik i APP, sipas kodit të marrë nga APP si Auditues;
- 5- Dosjet fizike të OE/BOE shpallur fitues;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

-Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve.

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/ shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimor.

-Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, Bashkia Lezhë referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve ka kryer gjithsej **46** procedura prokurimi me vlerë kontrate **833,012,773.05** lekë pa tvsh, me një vlerë ulje nga fondi limit në shumën **18,064,948.00** lekë ose 2.12 %. Sipas llojit të procedurave dhe natyrës të dhënat janë në pasqyrën si vijon:

| Procedura 01.01.2022 – 31.12.2022 | Nr. | Vl.Fond Limit | Vl.Kontrate |
|--|------------|----------------------|--------------------|
| GJITHESEJ | 46 | 851,077,721.05 | 833,012,773.05 |
| -Të hapura | 14 | 633,193,801.58 | 620,435,068.52 |
| - Kërkesë me propozim | 0 | 0 | 0 |
| - Shërbim konsulence | 0 | 0 | 0 |
| - Negocim pa shpallje | 0 | 0 | 0 |
| - E hapur e thjeshtuar | 17 | 75,942,076.75 | 72,304,758.30 |
| - E kufizuar/rindertimi | 2 | 135,455,740.49 | 134,883,049.15 |
| - Me vlerë të vogël | 13 | 6,486,102.23 | 5,389,897.13 |
| Sipas objekteve | | | |
| -Objekte në fushën e punëve publike | 11 | 651,621,058.65 | 639,793,306.47 |
| -Objekte në fushën e shërbimeve/blerje | 35 | 199,456,662.40 | 193,219,466.63 |

Kanë marrë pjesë në procedura gjithsej **296** OE/BOE, nga të cilat janë s’kualifikuar **164** OE/BOE. Procedura me 1 (një) OE janë gjithsej **4** procedura ose 8.6 % e procedurave të zhvilluara.

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH’së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi i APP, përzgjedhi për auditim:

1. Procedura e prokurimit me objekt “Përmirësimi I infrastrukturës rrugore për këmbësorët dhe biçikletat në fshatin Ishull Lezhë”, Bashkia Lezhë

| | | |
|---|-------------------------------------|------------------------------------|
| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Përmirësimi I infrastrukturës rrugore për këmbësorët dhe biçikletat në fshatin Ishull Lezhë”, Bashkia Lezhë, Nr. REF-33849, datë 06-22-2022. | | |
| 1. Urdhër Prokurimi | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave |

| | | |
|---|--|---|
| Nr. 22, datë 10.06.2022 | Urdhër nr. 166, datë 16.03.2022 | Urdhër nr. 351, datë 10.06.2022 |
| 2. Lloji i Procedurës – “E hapur, punë” | 1. E.PKryetar, 2. A.L 3. Z.Z 1. Urdhër Prokurimi Nr. Nr. 22, datë 10.06.2022 Njësia e Prokurimit 1. E.P , Personi përgjegjës, jurist 2. A.L , Inxhinier 3. E.F , Marrëdhënie Ndërkombëtare | 1. E.P , Kryetar 2. A.LL 3. E.M |
| 5. Fondi Limit (pa TVSh) 20,400,020 lekë, | 6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “Z ” ShPK & “I ” ShPK me ofertë 19,816,834 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 3382/12 prot, dt. 19.08.2022 me afat 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës. | 7. Diferenca me fondin limit 583,186 lekë, ose 2.9 % |
| 8. Data e hapjes së tenderit Datë 11.07.2022 | 9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë dhe bashkëfinancim me Programin e Zhvillimit Rajonal | 10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 8 OE/BOE b) S’kualifikuar 7 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE |
| 11. Ankimime; nuk ka ankesë. | 12. Përgjigje Ankesës nuk ka | 13. Përgjigje Ankesës nuk ka |

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 20,400,020 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë dhe bashkëfinancim me Programin e Zhvillimit Rajonal.

Mbi përcaktimin e kryerjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet kërkesa me nr. 3382, datë 16.03.2022 e Drejtorisë së Shërbimeve, Infrastrukturës dhe Mjedisit për realizimin e kësaj procedure prokurimi.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Me Urdhër nr. 166, datë 16.03.2022 të TAK është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përlllogaritjen e fondit limit për këtë procedurë.

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga Grupi i punës nëpërmjet Procesverbalit, pa nr. prot, datë 23.06.2022.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhër nr. 1, datë 31.03.2022, është mbajtur procesverbalit me nr. 3382/6 prot, datë 23.06.2022, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit.*

Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se:

1- Në pikën 6 të KVK është vendosur kriteri për staf teknik me përbërje 4 inxhinierë të ndryshëm (inxhinier ndërtimi, inxhinier topograf, inxhinier elektrik, inxhinier mjedisi) të jenë në licencë, si dhe staf mbështetës 2 teknikë (ndërtimi dhe elektrik). Këto kritere janë të paargumentuara teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk janë në përpjestim me volumin dhe natyrën e punimeve në objektin që prokurohet (inxhinieri i mjedisit dhe dy teknikët).

2. Në kriterin për numrin e të punësuarve (dhjetë), nuk është bërë argumentimi teknik bazuar në analizat e çmimeve të zërave të preventivit dhe grafikut të punimeve.

3- Është kërkuar NP-12/A “Punime të inxhinierisë së mjedisit”. Ky kriter është i paargumentuar teknikisht, pasi, nisur nga preventivi i punimeve, nuk është në përpjestim me natyrën e punimeve në objektin që prokurohet.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit E.P , A.L dhe E.F .

Mbi përlogaritjen e fondit limit dhe hartimit të specifikimeve teknike

Argumentimi i fondit limit, hartimi i specifikimeve teknike dhe preventivit, janë hartuar nga grupi i punës të ngritur për këtë qëllim me Urdhrin nr. 166, datë 16.03.2022 të titullarit të AK z. P.N , me përbërje E.P , kryetar dhe A.L dhe E.F , anëtarë.

Nga verifikimi i preventivit të administruar në dosje u konstatua si më poshtë:

- Analiza e zërit të punës “FV bordura 15 x 25 cm” është shënuar me nr. 3.617 dhe çmim 989 lekë/ml, ndërkohë që duhet të ishte shënuar 3.616/a dhe të ishte marrë me çmimin e manualit të miratuar me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” në vlerën 871 lekë/ml, ose 118 lekë/ml më pak. Për shkak të këtij gabimi, vlera e preventivuar është rritur fiktivisht me **312,110 lekë** (2645 ml x 118 lekë/ml), e cila përbën përdorim pa ekonomikitet të fondeve dhe ngarkon me përgjegjësi hartuesit e fondit limit.

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, punë”. Në dosje administrohet procesverbali për vlerësimin e ofertave, datë 25.07.2022. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 8 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës |
|-----|--|-------------------|
| 1 | OE “N” ShPK | 16,926,636 |
| 2 | BOE “Z” SH.P.K, me Nuis J....K & “I” ShPK | 19,816,834 |
| 3 | OE “A” ShPK | 20,084,246 |
| 4 | OE “D” ShPK | 20,151,709 |
| 5 | OE “K.T” ShPK | 18,080,878 |
| 6 | OE “L” ShPK | 18,109,956 |
| 7 | OE “S” ShPK | 20,123,476 |
| 8 | OE “SH” ShPK | 12,700,000 |

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 3382/11 prot, datë 09.08.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. P.N

Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se

1. OE “N” ShPK, është skualifikuar nga KVO-ja, pasi:

- Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka te deklaruar ne formularin permblledhes te vetedeklarimit, disponimin e 1 (nje) hekurkthyesi, i cili eshte kerkuar ne piken 2.3.5, te kriterëve te vecanta te kualifikimit duke mos permbushur kete kriter.

2. OE “A ” ShPK, është skualifikuar nga KVO-ja, pasi:

- Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes sipas shtojces 3;

- Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomike nuk ka paraqitur dokumentacion provues ne lidhje me disponimin ne pronesi/ me qira/ kontrate bashkepunimi per impiant prodhimi inertesh, betoni dhe asfalti duke mos permbushur kete kriter.

3. OE “D ” ShPK, është skualifikuar nga KVO-ja, pasi:

- Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomike nuk ka paraqitur dokumentacion provues ne lidhje me furnizimin me materialet elektrike duke mos permbushur kete kriter;

- Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomike ka paraqitur Çertifikaten OHSAS 18001:2015, mbi “Sistemin e Menaxhimit te Shëndetit dhe sigurise në punë”, e cila ka skaduar me daten 17.04.2022, duke mos permbushur kete kriter.

4. OE “K.T ” ShPK, është skualifikuar nga KVO-ja, pasi:

- Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomik nuk ka plotesuar per administratorin A.T , i cili sipas QKB-se eshte emeruar administrator me daten 21.12.2021, te dhenat ne formularin përmbledhës të vetedeklarimit ne kreun A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT, ne seksionin ne lidhje me informacionin dhe deklarimin ne zbatim te pikes 2(c), te nenit 26, te VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te prokurimit publik”, i ndryshuar;

- Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur kontrate furnizimi me nje subjekt (furnizues i cili nuk rezulton te jete prodhues), por nuk ka paraqitur autorizimin/aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër qe provon lidhjen e ketij subjekti me ndonje prodhues.

5. OE “L ” ShPK, është skualifikuar nga KVO-ja, pasi:

- Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se per impiantin e prodhimit te inerteve eshte paraqitur kontrate furnizimi me nje subjekt i cili nuk eshte i pajisur me license III.1.B.

Nga verifikimi ne QKB, rezulton se subjekti me te cilin OE ka kontrate bashkepunimi per Impiant prodhimi Inerte dispon leje te tipit “C”, te cilat jane shfuqizuar me ndryshimet ligjore te parashikuara ne nenin 10, te ligjit nr. 52/2020 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, të ndryshuar, parashikohet se: “1. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat, në varësi të kapacitetit referuar shtojcës 1, të këtij ligji, klasifikohen si leje mjedisit të tipit B, aplikojnë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për t’u pajisur me leje mjedisi të tipit B brenda 12 muajve, nga hyrja në fuqi e ligjit.

3. Të gjitha instalimet ekzistuese të tipit C, të cilat nuk klasifikohen si leje mjedisi të tipit B, sipas pikës 1, të këtij neni, me hyrjen në fuqi të këtij ligji shfuqizohen.

Sa me siper duke qene se subjekti me te cilin operatori ekonomik ka kontrate furnizimi per impiant prodhimi inertesh nuk diponon license III.1.B, ku kriter konsiderohet i papermbushur;

- Nga verifikimi ne SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur kontrate furnizimi me nje subjekt, si dhe ka paraqitur autorizimin ne gjuhe te huaj nga prodhues, por verehet se perkthimi i ketij autorizimi nuk eshte bere sipas percaktimeve ligjore te nenit 135, te ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”, ku parashikohet se: “Përktimi i një dokumenti nga një gjuhë e huaj në gjuhën shqipe dhe anasjelltas bëhet nga vetë noteri, në gjuhën për të cilën është i përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë të administruar nga Ministria e Drejtësisë. Për gjuhë të tjera, që noteri nuk i zotëron, përkthimi bëhet nga përkthyes të përfshirë në listën e përkthyesve zyrtarë për dokumente zyrtare dhe nga persona të tjerë, për dokumente të një natyre tjetër. **Në rastet e përkthimeve të bëra nga përkthyes ose persona të tjerë të pranuar nga palët, noteri pasqyron në akt identitetin e përkthyesit, njësoj si për palët. Përkthimi shkruhet në fund ose përbri dokumentit dhe nënshkruhet përkatësisht nga noteri, sipas ligjit, ose nga përkthyesi”.**

KVO verën se, në dokumentacionin e paraqitur nga ky OE, në përmbushje të këtij kriteri mungon të dhënat e përktësimit (emri dhe mbiemri), data e përktësimit, si dhe vërtetimi i përktësimit sipas nenit 135, të ligjit nr. 110/2018 “Për noterinë”.

6. OE “S ” ShPK, është skualifikuar nga KVO-ja, pasi:

- Nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes sipas shtojcës 3;
- Nuk ka paraqitur Formularin Përmbledhës të vetdeklarimit
- Nuk ka paraqitur vërtetim për xhiron për vitet financiare 2019, 2020, 2021;
- Nuk provon disponimin e kategorive të nevojshme të licencës profesionale për zbatimin e kontratës;
- Nuk plotëson kriteret 2.3.8, 2.3.9 të DST-se pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon përmbushjen e këtyre kriterëve
- Nuk ka vetedeklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit disponimin e punonjësve, stafit kryesor, mbeshtetes, të certifikuar dhe mjeteve.

7. OE “SH ” ShPK, është skualifikuar nga KVO-ja, pasi:

- Nga verifikimi në SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, disponimin e **1 (një) teknik elektrik**, i cili është kërkuar në pikën 2.3.5, të kriterëve të vecanta të kualifikimit duke mos përmbushur këto kriter;
- Nga verifikimi në SPE rezulton se operatori ekonomik ka paraqitur kontratë furnizimi me një subjekt (furnizues, i cili nuk rezulton të jetë prodhues), por **nuk ka paraqitur autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen e këtij subjekti me ndonjë prodhues.**

KVO duke pasur në konsideratë se të gjithë prodhuesit e kanë detyrim ligjor pajisjen me leje mjedisore nga QKL, bëri një kërkim në faqen zyrtare qkb.gov.al, ku rezultoi se furnizuesi për materialet elektrike nuk disponon QKL si prodhues.

Sa më sipër duke qenë se furnizuesi i paraqitur nga OE, nuk disponon QKL si prodhues, si dhe duke qenë se nuk ka paraqitur autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen midis Furnizuesit (si distributori zyrtar) me ndonjë prodhues, ky kriter konsiderohet i papërmbushur;

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verën se oferta e paraqitur nga OE është oferte anomalisht e ulët, pasi ky OE ka paraqitur oferte më të ulët se 35% e fondit limit dhe më të ulët se 70% e mesatares së ofertave të paraqitura, si dhe për KVO-ne, kjo anomali vërehet e dyshimte (e papërgjegjshme) duke qenë se çmimet e materialeve të ndërtimit kanë pësuar një rritje të konsiderueshme në treg.

Megjithatë, duke qenë se Operatori Ekonomik rezulton i skualifikuar për arsye të mësipërme, KVO, vendosi të mos kërkojë sqarim nga ofertuesi meqenëse pozitat e OE-se nuk ndryshojnë.

8. **BOE “Z ” ShPK & “I ” ShPK**, është kualifikuar nga KVO-ja.

- Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE “2 N” ShPK, rezulton se është skualifikuar me të drejtë, pasi:

1. Nuk ka të deklaruar në formularin përmbledhës të vetdeklarimit, disponimin e 1 (një) hekurkthyesi.

- Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE “D ” ShPK, rezulton se është skualifikuar me të drejtë, pasi:

- operatori ekonomike nuk ka paraqitur dokumentacion provues në lidhje me furnizimin me materialet elektrike duke mos përmbushur këto kriter;

- operatori ekonomike ka paraqitur Çertifikatën OHSAS 18001:2015, mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe sigurisë në punë”, e cila ka skaduar më datën 17.04.2022, duke mos përmbushur këto kriter.

- Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE “K.T” ShPK, rezulton se është skualifikuar me të drejtë, për arsyet e paraqitura nga KVO në Raportin përmbledhës të prokurimit.

- Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE “L ” ShPK, rezulton se është skualifikuar me të drejtë, për arsyet e paraqitura nga KVO në Raportin përmbledhës të prokurimit.

- Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE “SH ” ShPK, rezulton se është skualifikuar me të drejtë, pasi:

1. mungon tekniku elektrik

2. ka paraqitur kontrate furnizimi me një subjekt (furnizues, i cili nuk rezulton të jetë prodhues), por nuk ka paraqitur autorizimin/ aktin e marrëveshjes ose cdo dokument tjetër që provon lidhjen e këtij subjekti me ndonjë prodhues.

-Gjithashtu, nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të **BOE fitues “Z ” ShPK & “I ” SHPK**, rezultoi se nuk i plotëson kriteret e vendosura në DT dhe është kualifikuar padrejtësisht, pasi:

- Për dy drejtuesit teknik G.T , inxhinier mekanik dhe P.I , inxhinier gjeolog, nuk janë paguar sigurimet shoqërore, pasi nuk janë në listëpagesa në periudhën e kërkuar në DT.

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, sipas të cilit “Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Është hartuar Formulari i Njoftimit të Fituesit në datën 28.07.2022, i cili është nënshkruar nga titullari i AK z. , me shkresën nr. 3382/10, datë 28.07.2022.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 98, pika 1/b, sipas të cilit “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...

b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”, KVO nuk duhet të kishte shpallur fitues këtë OE dhe duhet të kishte bërë anulimin e procedurës së prokurimit dhe propozimin për një procedurë të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 23,780,200 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së E.P , Kryetar, E.M dhe A.LL , anëtarë.

Ndikimi: Vendosja e kriterëve të kualifikimit dhe vlerësim i ofertave në kundërshtim me aktet ligjore e nënligjore të PP.

Shkaku: Moszbatim i akteve ligjore e nënligjore të PP.

Rëndësia: E lartë

Rekomandim: Nga ana e Bashkisë Lezhë, strukturave të përcaktuara për zhvillimin e procedurave të prokurimit, të merren masa për vendosjen e kriterëve të kualifikimit në përputhje me volumin dhe natyrën e objekti të prokurimit, si dhe për argumentimin e saktë të skualifikimit/kualifikimit të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 15737/20, datë 21.03.2024, është observuar nga KVO dhe NjP, të përfaqësuar respektivisht nga z. E.P dhe z. A.LL , si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Lidhur me konstatimin se për dy drejtuesit teknikë G.T inxhinier mekanik dhe P.I inxhinier Gjeolog nuk janë paguar sigurimet shoqërore, pasi nuk janë në listëpagesa në periudhën e kërkuar në DT, bëjme me dije se në kriteret e vecanta të kualifikimit nuk është kërkuar asnjë inxhinier mekanik apo gjeolog. (shiko faqen 5, të akt konstatimit nr.6).

Po ashtu argumentojmë se duke qenë se në DST nuk janë kërkuar inxhinier mekanik dhe inxhinier gjeolog, KVO nuk mund të dilte përtej objektit të vlerësimit duke verifikuar të dhëna që nuk lidhen me kriteret e veçant të kualifikimit, pasi bazuar në nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. I ndryshuar, parashikohet që “KVO verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, **duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme**”.

Opinioni i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar në Projektraport, bazuar në VKM nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, Kreu IV, “Drejtuesi teknik i shoqërisë dhe papajtueshmëria me këtë detyrë”, pika 2, ku parashikohet se “Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike.

Drejtuesi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit”.

Nisur nga kjo dispozitë, personat e paraqitur si Drejtues Teknikë, duhet të jenë në listëpagesat e shoqërisë.

Gjithashtu, lidhur me pretendimin e observuesve, se KVO nuk mund të dilte përtej objektit të vlerësimit, sqarojmë se pagesa e kontributeve të të punësuarve nga ana e OE pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, nuk është jashtë objektit të vlerësimit, por një nga kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit (pika dh).

Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

2. Procedura e prokurimit me objekt “Blerje automjetesh dhe mjete të rënda për nevoja të Bashkisë Lezhë”, Bashkia Lezhë

| | | |
|---|---|---|
| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Blerje automjetesh dhe mjete të rëndapër nevoja të Bashkisë Lezhë”, Bashkia Lezhë, Nr. REF-28144, datë 05-10-2022. | | |
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 13, datë 06.05.2022 | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Urdhër nr. 261, datë 28.04.2022 | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër nr. 282, datë 09.05.2022 |
| 2. Lloji i Procedurës – “E hapur, mallra” | 1. E.P Kryetar, 2. G.J.L 3. E.Z 1. Urdhër Prokurimi Nr. 13, datë 06.05.2022 Njësia e Prokurimit 1. A.LL , Personi përgjegjës Jurist 2. E.P , Jurist 3. E.Z , Ekonomist | 1. E.P , Kryetar 2. N.P 3. E.M |
| 5. Fondi Limit (pa TVSh) 17,243,000 lekë, | 6. Oferta fituese (pa TVSh) BOE “S ” ShPK me ofertë 17,130,000 lekë pa tvsh, sipas kontratës nr. 6791/14 prot, dt. 20.06.2022 me afat 6 muaj nga data e lidhjes së kontratës. | 7. Diferenca me fondin limit 113,000 lekë, ose 0.7 % |
| 8. Data e hapjes së tenderit Datë 11.07.2022 | 9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë | 10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 8 OE/BOE b) S’kualifikuar 7 BOE, c) Kualifikuar 1 OE/BOE |
| 11. Ankimime; nuk ka ankesë. | 12. Përgjigje Ankesës nuk ka | 13. Përgjigje Ankesës nuk ka |

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Kjo procedurë është “E Hapur”, me vlerë 17,243,000 lekë pa TVSH, i cili do të financohet nga Buxheti i Bashkisë dhe bashkëfinancim me Programin e Zhvillimit Rajonal.

Mbi përcaktimin e krverjes së këtij investimi

Në dosjen e prokurimit administrohet kërkesa me nr. 5488, datë 13.04.2022 e MZSh, kërkesa nr. 6791, datë 28.04.2022 e Drejtorisë së Shërbimeve, Infrastrukturës dhe Mjedisit, kërkesa me nr. 6791/2, datë 28.04.2022 e Drejtorisë së Ujitjes dhe Administrimi të Pyjeve dhe kërkesa nr. 6791/1, datë 28.04.2022 e Drejtorisë së Emergjencave Civile për realizimin e kësaj procedure prokurimi, të cilat kanë marrë miratimin e TAK z. P.N .

Mbi përlogarijen e fondit limit

Fondi limit është përcaktuar nga grupi i punës së ngritur për këtë qëllim, duke bërë testimin e tregut. Në dosje administrohet procesverbali në të cilin citohen ofertat e tregut, të marra nga “P” ShPK, “I” ShPK dhe “S” ShPK. Fondi limit është marrë si mesatare e tre oferta dhe është përcaktuar në vlerën 17,243,000 lekë.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Me Urdhër nr. 261, datë 28.04.2022 të TAK është ngritur grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike, si dhe për përlogaritjen e fondit limit për këtë procedurë.

Kriteret e kualifikimit janë përcaktuar nga Grupi i punës nëpërmjet Procesverbalit, me nr. 6791/8 prot, datë 10.05.2022.

-Nga auditimi i dosjes së prokurimit, u konstatua se për kriteret e veçanta të vendosura në DST nga Grupi i Punës i ngritur me Urdhrin nr. 261, datë 28.04.2022, është mbajtur procesverbalit me nr. 6791/8 prot, datë 10.05.2022, veprim në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, “Hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit”, pika 2, sipas të cilës “*Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit.*

Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”.

- Nga verifikimi i kriterëve të vendosura, u konstatua se kriteret janë vendosur sipas natyrës dhe volumit të objektit të prokurimit, në përputhje me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar.

Situata 1

Mbi vlerësimin e ofertave

AK, ka aplikuar procedurën e prokurimit të llojit “E hapur, mallra”. Në dosje administrohet procesverbali për vlerësimin e ofertave, datë 30.05.2022. Nisur nga ky procesverbal dhe verifikimi në SPE, ka paraqitur interes dhe kanë marrë pjesë në procedurë 2 OE, me ofertat e mëposhtme:

| Nr. | OE pjesëmarrës | Vlera e Ofertës |
|-----|----------------|-----------------|
| 1 | OE “A” ShPK | 17,216,000 |
| 2 | OE “S” ShPK | 17,130,000 |

Burimi i të dhënave: SPE

Punoi: KLSH

Nga auditimi rezulton se nga KVO është hartuar Raporti Përmbledhës me shkresën me nr. 6791/13 prot, datë 10.06.2022, i cili është miratuar nga Titullari i Autoritetit Kontraktor z. P.N. Nga auditimi i vlerësimit të ofertave, u konstatua se

1. OE “A. A. I. Group” ShPK, është skualifikuar nga KVO-ja, pasi:

- nuk ka paraqitur sigurimin e ofertes sipas shtojces 3;
- OE per te deshmuar furnizimet e meparshme te ngjashme ka paraqitur kontrata sherbimi mirembajtje mjetesh dhe jo kontrata furnizimi sipas kerkesave te DST;
- OE nuk ka paraqitur asnje dokumentacion qe deshmon se operatori ekonomik eshte i pajisur me licence te leshuar nga Qendra Kombetare e Licencimit (QKL) Kodi VII.3.B.2 “Shitblerja e mjeteve rrugore me motor dhe/ose e rimorkiove të reja ose të përdorura, të autorizuar nga prodhuesi”, sipas Udhezimit te Ministrise se Transnportit dhe Infrastruktures Nr. 1545, dt. 29/03/2016”.

2. OE “S ” ShPK, është kualifikuar nga KVO-ja.

- Nga verifikimi në SPE dhe në dokumentet e paraqitura në letër nga OE “A” ShPK, rezulton se është skualifikuar me të drejtë, për arsyet e paraqitura nga KVO në Raportin përmbledhës te prokurimit.
- Gjithashtu, nga verifikimi në SPE të dokumentacionit të OE fitues “S ” SHPK, rezultoi se i plotëson kriteret e vendosura ne DT dhe është kualifikuar me të drejtë.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 15737/20, datë 21.03.2024, është observuar nga KVO dhe NjP, të përfaqësuar respektivisht nga z. E.P dhe z. A.LL , si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Ne lidhje me konstatime për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje Automjetesh dhe mjete të rënda për nevoja të Bashkise Lezhë”, Komisioni i Vleresimit te ofertave vëren se në kriterin 2.2.3 te DST-se kerkohet qe operatoret ekonomike duhet te paraqesin një dokument që vërteton se i ka plotësuar te gjitha detyrimet te maturuara te taksave dhe tarifave vendore te vitit **2021**, lëshuar nga Administrata e Qeverisjes Vendore. Nga verifikimi i dokumentacionit si dhe nga konstatimi i audituesit rezulton se operatori ekonomik i shpallur fitues ka ushtruar aktivitetin ne Bashkine Durrës nga data 14.12.2021. Sa me sipër, verehet se operatori ekonomik i shpallur fitues ka ushtruar per **17 dite** te vitit 2021 aktivitet ne Bashkine Durrës dhe keto detyrime maturohen ne vitin 2022.

Komisioni i Vleresimit te Ofertave mban ne konsiderate percaktimet e pikes 2 , te nenit 76, te ligjit 162/2020 “Per Prokurimin Publik” ku parashikohet se: *“Një operator ekonomik skualifikohet nga pjesëmarrja në një procedurë prokurimi kur operatori ekonomik ka shkelur detyrimet e tij në lidhje me pagesën e taksave ose kontributeve të sigurimeve shoqërore, me përjashtim të rasteve kur:*

c) operatori ekonomik nuk ka paguar shuma të vogla tatimesh ose kontributesh të sigurimeve shoqërore deri në vlerën prej 10 000 lekësh”;

Per sa me lart verehet se operatori ekonomik i shpallur fitues rezulton se nuk ka paraqitur vertetim per shlyerje detyrimesh per 17 dite te ushtrimit te aktivitetit dhe rrjedhimisht vlera per keto detyrime eshte me e vogel se 10,000 leke.

Sa me sipër kerkojme rishikimin e projekt raportit ne zbatim te Akt konstatimit nr. 6, date 07.12.2023, per proceduren me objekt “Blerje Automjetesh dhe mjete te renda per nevoja te Bashkise Lezhe” duke pranuar argumentimet dhe sqarimet e sipercituara nga ana jone.

Opinion i Grupit të auditimit

Pas shqyrtimit të observacionit, grupi i auditimit merr në konsideratë argumentin dhe do të reflektohet në Projektraportin e Auditimit.

3.Tenderi me objekt: “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në plazhin e Tales, Njësia Administrative Shënkoll” me këto të dhëna:

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Ndërtimi i infrastrukturës rrugore në plazhin e Tales, Njësia Administrative Shënkoll”

| | | |
|--|--|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 42, Datë 31.10.2022 | 3. Hartuesit e Dokumenteve të Tenderit Hartim/Konfirmim Specifikime teknike dhe përlogaritje fond limit Urdher Nr. 583. dt. 31.10.2022 1. A.LL 2. E.Z 3. L.GJ Njësia e Prokurimit Urdhër Nr. 42 dt. 31.10.2022 1. A.L 2. E.Z 3. GJ.L | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 584 dt. 31.10.2022 1. E.P 2. E.P 3. E.M |
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur | | |
| 5. Fondi Limit (pa TVSH) 76,897,654.66 lekë | 6. Oferta fituese (pa TVSH) 76,499,198.82 lekë nga BOE A dhe A | 7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 398,456 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit 17.11.2022 | 9. Burimi Financimit: (Të ardhurat) Vënë në dispozicion me anë të vendimit nr. 105, datë 23/09/2022 të Këshillit Bashkiak Lezhë “Për disa ndryshime në VKB nr. 177, datë 23.12.2021 “Për Miratimin e Buxhetit per vitin 2022 dhe të PBA 2022-2024”. | 10. Operoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 8 OE b) S’kualifikuar 7 OE, c) Kualifikuar 1 OE |
| 11. Ankimime AK-s’ka; APP–s’ka KPP-s’ka. | 12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka | 13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP S’ka |
| b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave | | |
| 14. Lidhja e kontratës Nr. 17799/13, datë 14.12.2022 | 15. Vlera e kontratës (me TVSH) 91,799,038.58 lekë | 16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. |
| 17- Situacioni Përfundimtar | 18. Afati i kontratës në ditë 120 ditë | 19. Zgjatja e kontratës me - ditë |

Nga auditimi i dosjes së tenderit ka rezultuar:

Preventivi

Projekti i zbatimit, preventivi dhe i gjithë dokumentacioni teknik i projektit, është hartuar nga shoqëria “4 KPPF” dhe i është bërë dhuratë Bashkisë Lezhë, nëpërmjet kontratës së dhurimit nr.15145/1 prot., datë 13.09.2022, të lidhur ndërmjet palëve. Me procesverbalin nr.15145/2 prot., datë 22.09.2022 është marrë në dorëzim projekti. Në vijim nga titullari i Bashkisë Lezhë, me urdhrin nr.583, datë 31.10.2022 është ngritur komisioni për kontrollin dhe verifikimin e përputhshmërisë së çmimeve të zërave të punimeve për projektin e mësipërm. Komisioni i përbërë nga A.LL , E.Z dhe L.GJ ka mbajtur procesverbalin nr.01, datë 31.10.2022 për verifikimin e dokumentacionit të mësipërm.

Nga grupi i auditimit u testuan disa prej zërave të preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar. Nga verifikimi u konstatua se çmimet për njësi përputhen me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit.

Hartimi dhe argumentimi i kriterëve të veçanta të kualifikimit, dokumentuar me procesverbalin nr.17799/5, datë 01.11.2022.

Pika 2.3.3 AK ka kërkuar që OE duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 30 punonjës të siguruar, për tre muajt Korrik – Shtator 2022 – Për kërkesën e mësipërme, në procesverbalin

e argumentimit të kriterëve të vecanta të kualifikimit, mungon analiza teknike për argumentimin e numrit të punonjësve të kërkuar.

Pika 2.3.6 - Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës, si më poshtë: 1 (një) punonjës të disponojë çertifikatë: “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt Korrik – Shtator 2022. Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontraktojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes. Pra duhet të lënë mundësia e kontraktimit.

Pika 2.3.8 kërkohet që OE ofertues duhet të ketë licencë për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve inerte, Kodi III.2.B – Kërkesa e mësipërme nuk është e lidhur ngushtë me natyrën e kontratës, pasi në preventivin e punimeve nuk ka zë pune që të kërkojë disponimin e kësaj licence. Gjithashtu subjekti mund të lidhë kontratë shërbimi me një subjekt tjetër që ofron shërbimin e grumbullimit të mbetjeve, pa qenë e nevojshme që të kryejë vetë këtë shërbim. Për më tepër sipas paketës fiskale të vitit 2022 Bashkia Lezhë aplikon tarifën e grumbullimit dhe pastrimit nga mbetjet, për cdo kantier ndërtimi, pra në kushtet kur bashkia e siguron shërbimin e pastrimit si dhe e tarifon subjektin për kohëzgjatjen e kantierit, është e panevojshme vendosja e kërkesës për disponimin e licencës së mësipërme. Sa i përket transportit të dheut nuk është e nevojshme pajisja me licencën e mësipërme, pasi në këtë rast dheu është material ndërtimi dhe do t’i nënshtrohet transformimit fizik. Për transportin e dheut si mall, shërben certifikata e transportit të mallrave që lëshohet për mjetin përkatës.

Në pikën 2.3.11 kërkohet që operatori ekonomik duhet të ketë një kontratë bashkepunimi me një laborator të testimit të betonit, i cili duhet të jetë i akredituar nga organizma kombëtare ose ndërkombëtare, sipas standarteve SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12504-4:2008; SSH EN 12350-2: 2009 dhe SSH EN 12504-2:2012 ose ekuivalent – Dy referencat e standardizimit SSH EN 12390-3:2009, SSH EN 12350-2:2009 janë të shfuqizuara¹⁶.

Në vijim sqarohet se është kërkuar kontratë shërbimi me një laborator testimi të materialeve të ndërtimit, e cila ka si qëllim vlerësimin e konformitetit të produkteve të ndërtimit. Detyrimin për vlerësimin e konformitetit të materialeve të ndërtimit e ka prodhuesi i tyre, i cili në përfundim të prodhimit të produktit, fikson markimin CE në trupin e produktit kur e lejon natyra e tij/harton deklaratën e konformitetit për produktin. Pra në rastin kur një importues/shpërndarës i materialeve të ndërtimit që mund të marrë pjesë në prokurim e ka të panevojshme kontratën e shërbimit me një laborator testimi, por mjafton që për atë parti/lot produkte/prodhimi që do të përdor gjatë zbatimit të kontratës të ketë vlerësimin e konformitetit, e cila vërtetohet nga deklaratat e konformitetit, e hartuar nga prodhuesi i produktit. Për më tepër referuar përcaktimit të bërë në shkronjën “c” të pikës 1 dhe shkronjën “dh” në pikën 9 në Kreun III të Udhëzimit Nr.2, datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, këto janë dokumente që dorëzohen gjatë zbatimit të punimeve, ku plotësohet dosja e kantierit dhe kontrollohen nga përgjegjësi/drejtuuesi teknik i kantierit dhe jo gjatë pjesëmarrjes në tender. Gjithashtu referuar argumentimit në procesverbalin përkatës, pasqyrohet informacioni se kjo kërkesë është për të siguruar se malli që furnizohet është brenda standardeve teknike, rezulton se kërkesa e mësipërme është e panevojshme, në momentin që vetë AK ka hartuar specifikimet teknike për mallrat që do të përdoren gjatë zbatimit të kontratës dhe OE ka detyrimin që të vetëdeklarojë plotësimin e specifikimeve teknike.

¹⁶<https://standards.iteh.ai/catalog/standards/cen/7eb738ef-44af-436c-ab8e-e6561571302c/en-12390-3-2019>
<https://standards.iteh.ai/catalog/standards/cen/cf0e0511-2176-454c-948d-9e515f3a03f1/en-12350-2-2019>

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi antarët e grupit të punës për hartimin e DT, A.LL , E.Z dhe L.GJ .

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Lezhë me nr. 584, datë 31.10.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.P (Kryetar), E.Pdhe E.M (Anëtar).

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.17799/7, datë 23.11.2022 për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave nr.17799/11 prot., datë 12.12.2022, drejtuar titullarit të AK për miratim.

Nëpërmjet kërkesës në SPE, datë 24.11.2022, KVO i është drejtuar BOE A dhe A për dorëzimin e dokumentacionit. Me shkresën nr.17799/8 prot., datë 30.11.2022 nga BOE A dhe A është dorëzuar dokumentacioni pranë Bashkisë Lezhë. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.17799/9, datë 30.11.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 8 OE/BOE, përkatësisht:

1-OE “A ” SH.P.K, me Nuis J...Q dhe me ofertë ekonomike 53,918,743.85 lekë pa TVSH.

2-BOE “A ” SH.P.K, me Nuis L...I & “A ” SH.P.K, me Nuis K...I dhe me ofertë ekonomike 76,499,198.82 lekë pa TVSH.

3-BOE “B ” SH.P.K, me Nuis K...A & “R ”, person juridik i huaj me nr. biznesi 810802422 dhe me ofertë ekonomike 70,516,658 lekë pa TVSH.

4-BOE “B ” SH.P.K, me Nuis J...V & “B ”, SH.P.K me Nuis L...O dhe me ofertë ekonomike 58,124,858 lekë pa TVSH.

5-BOE “E ”, SH.P.K me Nuis K...H & “M ” SH.P.K, me Nuis J...V dhe me ofertë ekonomike 73,710,426.94 lekë pa TVSH.

6- BOE “L ” SH.P.K, me Nuis L...F & “E ”, SH.P.K me Nuis K...K dhe me ofertë ekonomike 52,592,360 lekë pa TVSH.

7-BOE “RR ” SH.P.K, me Nuis K...H & “K ” SH.P.K, me Nuis J...Ë & “SH ” SH.P.K, me Nuis K...N dhe me ofertë ekonomike 66,464,073.26 lekë pa TVSH.

8- OE “S ” SH.P.K, me Nuis J...M dhe me ofertë ekonomike 59,504,123.31 lekë pa TVSH.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s’kualifikuar 7 OE/BOE, si më poshtë:

Nr. OE/BOE

1 OE “A ”

2 BOE “B ” SH.P.K, & “R ”

3 BOE “B ” SH.P.K, & “B ”, SH.P.K

4 BOE “E ”, SH.P.K & “M ” SH.P.K

5 BOE “L ” SH.P.K, & “E ”

6 BOE “RR ” SH.P.K, & “K ” SH.P.K, & “SH ” SH.P.K

7 OE “S ” SH.P.K

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹⁷, nga OE shpallur fitues, konstatohet se:

-Nuk plotësohet **pika 2.2.3** në DST, pasi nga BOE “A ” ShPK dhe “A ” ShPK, nuk janë dorëzuar vërtetimet për likuidimin e taksave vendore në njësitë vendore në të cilat kanë ushtruar aktivitet “Punime ndërtimi”, si më poshtë vijon:

| Autoriteti_kontraktues | Objekti_i_prokurimit | Fituesi | Teritorri Administrativ | Ka dorëzuar vërtetim |
|------------------------|---|---------|-------------------------|----------------------|
| Bashkia Mallakastër | Ndërtim linje trasmetimi rrjeti i jashtëm ujsjellesi Rajonal (Nga burimi i Pocemit) | A | NJQV Mallakastër | Jo |

¹⁷ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

| | | | | |
|-----------------------------|---|---|--------------|----|
| Fondi Shqiptar i Zhvillimit | Qendra Multifunkionale e Zhvillimit Rajonal, Rajoni 4, Faza 1 | A | NJQV Vlorë | Jo |
| Bashkia Gramsh | Riparim "muri mbajtëse, vendosje tombinash Kodovjat-Kukur" | A | NJQV Gramsh | Jo |
| Bashkia Shkoder | Rikonstruksion rruga "Mehmet Shpendi", Faza e Dyte | A | NJQV Shkodër | Jo |

-Nuk plotësohet **pika 2.3.5** në DST, lidhur me punësimin e stafit mbështetës, me profesionin "Teknik elektrik". Konkretisht nga verifikimi i dokumentacionit "Shtojca 8", të plotësuar nga OE A , pasi OE A nuk ka deklaruar teknik elektrik, rezulton se ka deklaruar si teknik elektrik, punonjësin "S.GJ ". Nga verifikimi i dokumentacionit "listë-pagesa" mbi punonjësin "S.GJ ", konstatohet se ai figuron i punësuar me kodin e profesionit 9312.02, ndërkohë duhet të jetë me kod profesioni 3113.

Sqarojmë se bazuar në përcaktimet e bëra në VKM nr.514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve" (LKP), të rishikuar, punonjësit e regjistruar në listë-pageë me kodin 9312.02, janë punëtor krahu, **ndërkohë** për prokurimin në përkatës duhen punonjës me **kod profesioni 3113 "Teknikë të inxhinierisë elektrike"**, i cili kryen detyra teknike për të ndihmuar inxhinierët në kërkime të inxhinierisë elektrike në projekte, prodhime, montime, ndërtime, operime, mirëmbajtje dhe riparime të pajisjeve elektrike, të makinave, komponentëve të tyre, objekteve dhe sistemeve të shpërndarjes nën mbikëqyrjen e inxhinierëve elektrikë. Ai/a jo mund të punësohet në kompani të ndryshme që përdorin pajisje, makineri apo sisteme elektrike, në reparte të mirëmbajtjes apo instalimeve elektrike apo të vetëpunësohet. Sqarojmë se bazuar në Udhëzimin nr.23, datë 09.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore", i ndryshuar, për plotësimin e rubrikave të deklaratës "Listëpagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore, shëndetësore dhe tatimit mbi të ardhurat nga punësimi", tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë mbajnë parasysh sa më poshtë respektimin e pikave 1-12, ndër të cilat është edhe pika 11. *Në rubrikën 11 "Detyra, funksioni, profesioni apo puna që ka kryer punonjësi" – shënohet detyra apo profesioni që punonjësi kryen në tatimpaguesin përkatës. Detyra apo profesioni zgjidhen nga lista kombëtare e profesioneve.*

-Nuk plotësohet **pika 2.3.5** në DST, lidhur me punësimin e stafit mbështetës, me profesionin "Manovrator". Konkretisht nga verifikimi i dokumentacionit "Shtojca 8", konstatohet se vetëm OE A ka dorëzuar dokumentacion për disponimin e manovratorëve, ndërkohë OE A , nuk ka dorëzuar dokumentacion. Sipas preventivit të punimeve dhe ndarjes së tyre, referuar akt-marrëveshjes së bashkëpunimit, OE A , ka marrë përsipër kryerjen e punimeve të ndërtimit, të cilat kërkojnë mjete të rënda për punime ndërtimi dhe toke.

Pra sa më sipër jemi përball përcaktimit të bërë në pikën 3 të nenit 88 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar: Kërkesat për kualifikim: ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike, duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, **në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë**, shërbim apo furnizim, **të përcaktuara në aktmarrëveshje.**

-Nuk plotësohet **pika 2.3.7** në DST, lidhur me dokumentet për mjetet: Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 5-10 ton, fadromë dhe asfalto shtruese. Konkretisht kamioni vetëshkarkues ka kapacitet mbajtës më të lartë se ai i kërkuar, për fadromën nuk janë dorëzuar foto dhe dokumentacioni teknik, si dhe për asfalto shtruesen nuk janë dorëzuar foto.

-Formulari i vetëdeklarimit "Shtojca 8", shkronja "c", për të dy OE, nuk është e plotë në përmbajtje, pasi nuk deklarohet asnjë informacion mbi impiantet e prodhimit të betonit, asfaltit dhe inerteve. Ky element përbën shkak për s'kualifikimin nga procedura e prokurimit

Sa sipër, kualifikimi i këtij BOE është i padrejtë, në kundërshtim me nenin 82, pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, sipas të cilit "Komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke

kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme”.

Me skualifikimin e këtij OE, në zbatim të Ligjit Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, Neni 98, pika 1/b, sipas të cilit “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur: ...

b) në procedurat me një fazë nuk është dorëzuar asnjë ofertë e përshtatshme”, KVO nuk duhet të kishte shpallur fitues këtë OE dhe duhet të kishte bërë anulimin e procedurës së prokurimit dhe propozimin për një procedurë të re. Ky mosveprim ka sjellë lidhjen e kontratës me vlerë 91,799,038.6 lekë me TVSH, me një OE, i cili është shpallur fitues në papajtueshmëri me legjislacionin e PP dhe ngarkon me përgjegjësi anëtarët e KVO-së E.P , Kryetar, E.M dhe E.P , anëtarë.

Lidhur me objektin e mësipërm, me shkresën nr. 15737/20, datë 21.03.2024, është observuar nga KVO dhe NjP, të përfaqësuar respektivisht nga z. E.P dhe z. A.LL , si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Lidhur me gjetjet e grupit të auditimit për kriterin 2.3.8 ku kërkohej që “Operatori ekonomike ofertues duhet të jetë i pajisur me: Licence e leshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit (QKL) Kodi III.2.B “Për grumbullim dhe transport i mbetjeve inerte”, dhe sipas gjykimit të grupit të auditimit nuk është e lidhur ngushtë me natyrën e kontratës dhe preventivi nuk ka ze pune që të kerkoje disponimin e kesaj licence.

Njesia e prokurimit thekson se ky kriter është vendosur bazuar në nenin 39, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” ku parashikohet se: “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”, si dhe bazuar në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” dhe bazuar në Nenin 5 “Mbrojtja e shëndetit të njeriut dhe mjedisit”, në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit”.

Njesia e prokurimit sqaron se në faqen 65 të raportit teknik parashikohet se “**Materiali i dale nga germimet i cili nuk do të perdoret si material për mbushje do të depozitohet në vendet e miratuara nga Autoritetet perkatëse**”.

Ndërsa në faqen 9, të “Specifikimeve teknike” parashikohet se: “1.16 Pastrimi përfundimtar i zonës: Ne përfundim të punës, sa here që është e aplikueshme Sipermarresi, me shpenzimet e tij, duhet të pastrojë dhe të heqë nga sheshi të gjitha impiantet ndërtimore, materialet që kanë tepruar, mbeturinat, skelerite dhe ndërtimet e perkoheshme të çdo lloji dhe të lere sheshin e lire dhe veprat të pastra dhe në kondita të pranueshme. PAGESA përfundimtare e Kontrates do të mbahet deri sa kjo të realizohet dhe pasi të jepet miratimi nga Mbikëqyresia i Punimeve”.

Po ashtu, në faqen 22, të specifikimeve teknike, parashikohet se “2.17 Heqja e materialeve të tepërta nga germimi: **I gjithë materiali i tepërt i germuar nga Sipermarresi do të largohet në vendet e aprovuara ose të caktuara nga Bashkia. Kur është e nevojshme të transportohet material mbi rruget ose vende të shtruara. Sipermarresi duhet ta sigurojë këtë material nga derdhja në rrugë ose ato vende të shtruara**”.

Njesia e prokurimit në vendosjen e këtij kriteri ka mbajtur në konsideratë përcaktimet e nenit 57, të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” ku parashikohet se:

“Transportuesit e mbetjeve: **1. Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve. 2. Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën për transportin e mbetjeve, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që**

trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Sa me sipër bazuar në Raportin Teknik dhe Specifikimet Teknike të hartuara nga projektuesi konstatohet se gjatë zbatimit të punimeve duhet të transportohen materiale inerte, si dhe bazuar në nenin 57, të Ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve” ku parashikohet se: **“Transporti i mbetjeve kryhet nga persona që disponojnë licencë të vlefshme për transportin e mbetjeve”, ky kriter është në përputhje me kërkesat ligjore të prokurimit publik.**

Njesia e prokurimit thekson se mbrojtja e mjedisit është paresore pasi punimet zhvillohen në zonën bregdetare me impakt të lartë në turizmin dhe po ashtu thekson se asnjë preventiv nuk parashikon me ze konkret për mbrojtjen e ajrit, mbrojtjen e ujit, mbrojtjen nga zhurmat apo mbrojtjen e mjedisit gjatë zbatimit të punimeve apo transportit të mbetjeve inerte, pasi rregullat për mbrojtjen e mjedisit janë parashikuar në Ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011 “Për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve”, në Ligjin nr. 10431, datë 9.6.2011 “Për Mbrojtjen e Mjedisit” dhe aktet nënligjore të dale në zbatim të këtyre ligjeve.

Opinion i Grupit të auditimit

Pas shqyrtimit të observacionit, grupi I auditimit sqaron se rëndësia e një mjedisi të pastër nuk mund të jetë arsye për vendosjen e kriterëve të kualifikimit jo sipas natyrës së objektit që prokurohet. Siç është shprehur edhe në aktkonstatimin nr. 8 dhe në Projektraport, grupi I auditimit i qëndron argumentit që transporti mund të realizohet me të tretë që janë të licencuar në fushën e grumbullimit dhe transportit të mbetjeve dhe nuk është detyrim që të bëhet nga realizuesi i këtij objekti. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Pretendimi i subjektit:

2. Lidhur me konstatimin e audituesit për KVO (faqe 16 e akt konstatimit nr 8) se nuk plotësohet kriteri 2.2.3 në DST, në lidhje me dorëzimin e vertetimeve për taksat vendore, ju sqarojmë se KVO verifikon vetëm ekstraktet e QKB-se të operatoreve ekonomike ofertues. Në lidhje me konstatimet e audituesit për mosparaqitjen e vertetimit të taksave për njesitë e qeverisjes vendore sipas tabelës së paraqitur nga audituesi në faqen 16, të akt konstatimit nr.8, vërehet se këto vende të ushtrimit të aktivitetit nuk janë të pasqyruara në QKB nga operatorët ekonomikë.

KVO thekson se merr informacion për vendet e ushtrimit të aktivitetit të OE-ve ofertues vetëm nëpërmjet ekstraktit të QKB-se, në faqen zyrtare qkb.gov.al.

Për sa me sipër Audituesi i KLSH mund të ketë akses në sisteme kombëtare ose mund të marrë informacion nëpërmjet auditimeve që kryen në njesitë e qeverisjes vendore, të cilin KVO nuk mund ta disponojë, pasi verifikon vetëm nga ekstrakti i QKB-se dhe nuk si të marrë informacion për vende që ushtron aktivitetin të padeklaruara në QKB. Bejme me dije se është detyrë e institucioneve tatimore për gjurmimin dhe konstatimet e vendeve të ushtrimit të aktivitetit që nuk deklarohen në QKB nga operatorët ekonomikë.

Po ashtu theksojmë se edhe strukturat vendore të mbledhjes së takses faturojnë subjektet vetëm pasi të kenë deklaruar në QKB ushtrimin e aktivitetit.

Sa me lart audituesi i KLSH nuk mund të kërkojë Komisionit të Vlerësimit të ofertave të marrë kompetenca të hetimit tatimor në gjurmimin e mosdeklarimeve të vendodhjes së ushtrimit të aktivitetit nga operatorët ekonomikë, pasi kjo është detyrë dhe kompetencë e institucioneve tatimore.

Opiniononi i Grupit të auditimit

Pas shqyrtimit të observacionit, grupi i auditimit sqaron se ka dalë në konkluzionin e përcjellë nëpërmjet aktkonstatimit dhe Projektraportit, pas verifikimit në SPE të dokumentacionit të paraqitur nga BOE i shpallur fitues dhe konkretisht, ekstraktet historike nga QKB-ja dhe dokumentacioni I paraqitur si punë e ngjashme nga BOE "A " ShPK dhe "A " ShPK. Nga verifikimi I bërë më ekstraktet historike, rezulton se ofertuesi nuk ka bërë shtesën e adresave në vendet ku ka kryer punimet e paraqitura (NIPT sekondar), në kundërshtim me Ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar, neni 43, pika 1, referencë të cilën e keni cituar edhe gjatë vlerësimit të ofertave të tjera në këtë procedurë prokurimi. Sa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

4.Tenderi me objekt: "Blerje nafte për nevoja të Bashkisë Lezhë" me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Blerjen Nafte per nevoja te Bashkise Lezhe" | | |
|---|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 02, Datë 24.01.2022 | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Hartim/Konfirmim Specifikime teknike dhe perlllogaritje fond limit Urdher Nr. 64. dt. 18.01.2022 1. E.P 2. N.P 3. M.H Njesia e Prokurimit Urdhër Nr. 02 dt. 24.01.2022 1. A.L 2. E.M 3. E.Z | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 71 dt. 24.01.2022 1. E.P 2. F.D 3. G.J.L |
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur/ Mallra | | |
| 5. Fondi Limit (pa TVSH) 37,054,956.51 lek | 6. Oferta fituese (pa TVSH) 35,792,954.30 lek nga OE L Sh.P.K | 7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 1,262,002 lek |
| 8. Data e hapjes së tenderit 10.02.2022 | 9. Burimi Financimit: (Te ardhurat) Vene ne dispozicion me ane te vendimit nr. 177, Datë 23/12/2021 të Këshillit Bashkiak Lezhë "Per Miratimin e Buxhetit per vitin 2021 dhe te Programit Buxhetor Afatmesem 2022-2024" | 10. Operatoret Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 2 OE b) S'kualifikuar 1 OE, c) Kualifikuar 1 OE |
| 11. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka. | 12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka | 13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP S'ka |
| b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave | | |
| 14. Lidhja e kontratës Nr. 697/27, datë 28.02.2022 | 15. Vlera e kontratës (me TVSH) 42,951,545.16 lek | 16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. |
| 17- Situacioni Përfundimtar | 18. Afati i kontratës në ditë 365 dite | 19. Zgjatja e kontratës me – ditë: SKA |

Hartimi i fondit limit.

-Me urdhrin nr.64, datë 18.01.2022 të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, është ngritur grupi i punës me përbërje si vijon: E.P , N.P dhe M.H . Grupi i punës ka si detyrë hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit. Sa më sipër, fondi limit është përlllogaritur në vlerën 37,054,956 lekë pa TVSH, për të cilin është mbajtur procesverbali nr.1, datë 18.01.2022, si dhe miratuar nga Titullari i institucionit. Në procesverbalin e mësipërm pasqyrohet mënyra e ndjekur për përlllogaritjen e fondit limit, bazuar në çmimin e karburantit

në bursën PLATTS, si dhe duke aplikuar taksat dhe tarifatat ndaj çmimit të blerjes së karburantit në import.

Referuar sa më sipër, çmimi për litër është përlogaritur në vlerën 167,07 lekë pa TVSH.

Hartimi i kriterëve të ndryshura me shtojcën nr.1, datë 31.01.2022, dokumentuar me procesverbalin nr.679/14, datë 25.01.2022 nga NJP.

Pika 2.3.2 - Subjekti duhet të jetë i pajisur me leje të tregtimit të karburantit (Naftë D1 dhe benzinë) lëshuar nga institucionet përkatëse. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesin lejen përkatëse – Specifikimi i llojit të produktit që duhet të jetë në leje e tregtimit nuk ka bazueshmëri ligjore. Konkretisht titulli i lejes është për tregtimin e karburanteve dhe gazit të lëngshëm, nuk specifikohet lloji i naftës, por përfshihen nënproduktet e kategorive I, II, III dhe IV/A, Kategoria O

A.Nafta bruto

B.Gazi natyror

Kategoria I

A.Gazi i lëngshëm

Kategoria II

A.Benzinë automjetesh

B.Benzinë mjetësh të fluturimit ajror

C.Nënprodukte të tjera, të lëngshme si: benzol, toluol, ksilol, solven, white spirit.

Kategoria III

A.Gazoil (Diezel)

B.Vajguri ndriçues

C.Lëndë djegëse për mjetët e fluturimit ajror reaktive (kerozene)

Ç. Lëndë djegëse për përdorim termik civil dhe/ose industrial.

Kategoria IV

A.Vajrat

B.Solarë

Kategoria V

A.Bitum (asfalt)

B.Mazut

Gjithashtu kërkesa që leja e tregtimit të jetë edhe për tregtimin e benzinës, nuk përputhet me natyrën e kontratës, pasi në këtë rast prokurohet blerja e gazoilit (naftë) dhe jo benzinë. Në pikën 3 të nenit 40 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi A.LL , E.Z dhe E.M .

Konkluzion.

-Sa më sipër, konstatohet se kriteret e veçanta të kualifikimit nuk janë në përputhje me përcaktimet e bëra në pikat 3 dhe 4 të nenit 40 dhe pikën 2 të nenit 78 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Lezhë me nr. 71, datë 24.01.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.P (Kryetar), F.D dhe G.J.L (Anëtar).

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.697/17, datë 11.02.2022 për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave nr.697/21 prot., datë 24.02.2022, drejtuar titullarit të AK për miratim.

Nëpërmjet kërkesës nr.697/18 prot., datë 11.02.2022, KVO i është drejtuar OE L Sh.P.K., për dorëzimin e dokumentacionit. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.697/19, datë 14.02.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 2 OE/BOE, përkatësisht:

1-OE “L ” SH.P.K, me Nuis J....Q dhe me ofertë ekonomike 35,792,954.3 Lekë pa TVSH dhe me normë fitimi në vlerë absolute prej 19.99 Lekë pa TVSH;

2-OE “E ” SH.A, me Nuis K....N dhe me ofertë ekonomike 33,637,126.38 Lekë pa TVSH dhe me normë fitimi në vlerë absolute prej 11.40 Lekë pa TVSH.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, është s’kualifikuar “E ”, Durrës, Albania.

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹⁸, nga OE shpallur fitues, rezulton se OE “L Sh.P.K”, plotëson kriteret e vendosur në DST.

5.Tenderi me objekt: “Shërbimi për organizimin e eventeve, festave dhe dekorit në Bashkinë Lezhë” me këto të dhëna:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: “Shërbimi për organizimin e eventeve, festave dhe dekorit në Bashkinë Lezhë”. | | |
|--|---|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 06, Datë 05.04.2022. | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Hartim/Konfirmim Specifikime teknike dhe perlllogaritje fond limit Urdher Nr. 178. dt. 18.01.2022 1. N.SH 2. R.XH 3. M.H Njesia e Prokurimit Urdhër Nr. 06 dt. 05.04.2022 1. E.P 2. E.Z 3. R.XH | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 205 dt. 05.04.2022 1. E.P 2. A.LL 3. L.GJ |
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur/ Sherbime | | |
| 5. Fondi Limit (pa TVSH) 31,137,828 lekë për 3 vite/10,379,276 lekë për 1 vit, për organizimin e 40 eventeve në vit. | 6. Oferta fituese (pa TVSH) 30,290,100 lekë nga OE R | 7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 847,728 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit 28.04.2022 ora 10:00 | 9. Burimi Financimit: (Te ardhurat) Vene ne dispozicion me ane te vendimit nr. 177, Datë 23/12/2021 të Këshillit Bashkiak Lezhë “Per Miratimin e Buxhetit per vitin 2021 dhe te Programit Buxhetor Afatmesem 2022-2024”. | 10. Operatorët Ekonomike a) Pjesëmarrës në tender 3 OE b) S’kualifikuar 2 OE, c) Kualifikuar 1 OE |
| 11. Ankimime AK-s’ka; APP-s’ka KPP-s’ka. | 12. Përgjigje Ankesës nga AK S’ka | 13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP S’ka |
| b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave | | |
| 14. Lidhja e kontratës Kontrata nr.1 -Nr. 3492/31, datë 25.05.2022 | 15. Vlera e kontratës (me TVSH) Kontrata nr.1 – 10,470,480 | 16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. |
| 17- Situacioni Përfundimtar | 18. Afati i kontratës në ditë Kontrata nr.1 – deri me 31.12.2022 | 19. Zgjatja e kontratës me – ditë: S’ka |

Hartimi i fondit limit.

¹⁸ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

-Me urdhrin nr.178, datë 25.03.2022 të Kryetarit të Bashkisë Lezhë, është ngritur grupi i punës me përbërje si vijon: N.SH , R.XH dhe M.H . Grupi i punës ka si detyrë hartimin e specifikimeve teknike, termave të referencës dhe përlllogaritjen e fondit limit.

Sa më sipër, fondi limit është përlllogaritur në vlerën 31,137,828 lekë pa TVSH, për të cilin është mbajtur procesverbali nr.2, datë 30.03.2022, si dhe miratuar nga Titullari i institucionit. Në procesverbalin e mësipërm pasqyrohet mënyra e ndjekur për përlllogaritjen e fondit limit, bazuar në çmimin mesatar në 3 oferta të marra drejtuar me shkresën nr.3492/9 prot., datë 25.03.2022, ndaj OE A. F. P/F; P Sh.P.K dhe E.U P/F.

Me shkresën nr.3492/10 prot., datë 29.03.2022 është administruar oferta nga OE A. F.P/F, me vlerë 30,668,427 lekë pa TVSH;

Me shkresën nr.3492/11 prot., datë 29.03.2022 është administruar oferta nga OE P.B.Sh.P.K, me vlerë 31,170,705 lekë pa TVSH;

Me shkresën nr.3492/12 prot., datë 29.03.2022 është administruar oferta nga OE E.U P/F, me vlerë 31,574,352 lekë pa TVSH.

Hartimi i kriterëve, dokumentuar me procesverbalin nr.3492/17, datë 25.04.2022 nga NJP.

Pika 2.3.2 - OE ofertues duhet të ketë të punësuar të paktën 5 (pesë) punonjës për periudhën Janar 2022 – Shkurt 2022 - Nga auditimi i procesverbalit për argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, rezulton se nuk shoqërohet me analizë teknike kriteri për numrin e punonjësve.

Për sa më sipër mbajnë përgjegjësi E.P , E.Z dhe R.XH .

-Sa më sipër, konstatohet se kriteret e veçanta të kualifikimit nuk janë në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 4 të nenit 41 dhe pikën 2 të nenit 78 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vlerësimi i ofertave.

Me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Lezhë me nr. 205, datë 05.04.2022 është ngritur KVO i cili përbëhet nga E.P (Kryetar), A.LL dhe L.GJ (Anëtar).

Nga KVO është mbajtur procesverbali nr.01, datë 04.05.2022 për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave nr.3492/23 prot., datë 19.05.2022, drejtuar titullarit të AK për miratim.

Nëpërmjet kërkesës nr.3492/20 prot., datë 06.05.2022, KVO i është drejtuar OE R Sh.P.K., për dorëzimin e dokumentacionit. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr.3492/21, datë 10.05.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij.

Në këtë tender kanë marrë pjesë 3 OE/BOE, përkatësisht:

1.BOE “P ” SH.P.K me Nuis K....A & “E.U ” P/F me Nuis L....U, me oferte ekonomike 30,816,570 Lekë pa TVSH.

2.OE “P ” SH.P.K me Nuis L....H, me oferte ekonomike 30,637,828 Lekë pa TVSH.

3.OE “R ” SH.P.K, me Nuis L....C, me oferte ekonomike 30,290,100 Lekë pa TVSH.

-Nga BOE dhe OE të mësipërm, janë s’kualifikuar 2 OE/BOE, si më poshtë:

| OE/BOE | Arsyet e s’kualifikimit |
|-----------------|--|
| BOE “P ” “E.U ” | Nga verifikimi i dokumentacionit ne SPE rezulton se BOE: Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.1 te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: 2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës Theksojme se per te permbushur piken 2.3.1, ne lidhje me dëshmitë për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet |

| | |
|---------|---|
| | <p>te paraqesin dokumentacion per realizimin e sherbimeve te ngjashme me vlere te pakten prej 6,163,314 leke pa tvsh.</p> <p>Nga verifikimi ne SPE, rezulton se vlere e sherbimeve te ngjashme te paraqitur nga ky BOE eshte prej 5,842,754 leke pa tvsh dhe si rrjedhoje keto sherbime nuk arrijne vleren e 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet.</p> |
| OE "P " | <p>Se pari, nuk ploteson kriterin 2.3.1 te kushteve te veçanta te kualifikimit ku parashikohet se: 2.3.1 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.</p> <p>Theksojme se per te permbushur piken 2.3.1, ne lidhje me dëshmitë për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, OE duhet te paraqesin dokumentacion per realizimin e sherbimeve te ngjashme me vlere te pakten prej 6,163,314 leke pa tvsh.</p> <p>Nga verifikimi ne SPE, rezulton se OE ka paraqitur dokumentacion per furnizimet (mallra), te meparshme te ngjashme te realizuar nga ana e tij.</p> <p>KVO thekson se ne piken 2.3.1, te kushteve te veçanta te kualifikimit parashikohet se: "Operatori Ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit, në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës", dhe si rrjedhoje per te permbushur kete kriter OE duhet te paraqesin dëshmi per shërbimet e ngjashme pasi kontrata qe AK kerkon te prokuroje eshte kontrate shërbimi dhe jo malli.</p> <p>Si perfundim duke qene se OE nuk ka paraqitur dëshmi per shërbimet e meparshme te ngjashme ky kriter konsiderohet i papermbushur.</p> |

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar në sistem dhe fizikisht¹⁹, nga OE shpallur fitues, rezulton se OE "R " Sh.P.K, plotëson kriteret e vendosur në DST.

6.Tenderi me objekt: "Rikonstruksion i çerdhes në Qytetin Lezhë"

Në zbatim të pikës 4 të Programit të Auditimit nr. 870/1, datë 10.10.2023, "Auditim mbi planifikimin dhe zhvillimin e procedurave të prokurimit publik, si dhe zbatimin e kontratave të punimeve" dhe Autorizimit të Kryetarit të KLSH-së nr. 870/9, datë 29.12.2023 për administrimin e dokumentacionit lidhur me auditimin e dy procedurave të prokurimit bazuar në kërkesat e Ligjit 162/2020, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar dhe VKM Nr. 285, datë 19.5.2021, "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", nga audituesit e KLSH-së u auditua procedura si më poshtë:

| Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: "Rikonstruksion i çerdhes në Qytetin Lezhë". | | |
|---|--|---|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 21, Datë 01.06.2022. | 3. Hartuesit e Dokumenteve Tenderit Hartim/Konfirmim Specifikime teknike dhe përllogaritje fond limit Urdhër Nr. 332. dt. 01.06.2022 1. A.L 2. L.GJ 3. L.F Njësia e Prokurimit Urdhër Nr. 21 dt. 01.06.2022 1. A.LL 2. A.L 3. L.GJ | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave Urdhër Nr. 333 dt. 01.06.2022 1. E.P 2. E.P 3. B.B |
| 2. Lloji i Procedurës së Prokurimit E hapur/ Shërbime | | |
| 5. Fondi Limit (pa TVSH) 24,999,965 lekë | 6. Oferta fituese (pa TVSH) 24,880,305 lekë nga BOE "R ", "U " dhe "A ". | 7. Diferenca me fondin limit (pa TVSH) 119,660 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit 21.06.2022 ora 10:00 | 9. Burimi Financimit: (Te ardhurat) Vene ne dispozicion me ane te vendimit nr. 20, Datë 28.02.2022 të Këshillit Bashkiak Lezhë "Për Miratimin e | 10. Operatorët Ekonomike 1. OE "E.Ç " P/F, me NIPT M...I, pa ofertë ekonomike, skualifikuar. |

¹⁹ Për përmbushjen e deklaratave të dhëna nga OE në shtojcën 8.

| | | |
|---|---|---|
| | <i>Buxhetit për vitin 2022 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024</i> ". | 2. BOE "R" Sh.A, me NIPT K....Q & "U" Sh.P.K, me NIPT J....O & "A" SH.P.K, me NIPT K....D dhe me ofertë ekonomike 24,880,305.75 lekë pa TVSH.kualifikuar. 3. OE "T&XH" Sh.P.K, me NIPT L....I dhe me ofertë ekonomike 21,496,547.5 lekë pa TVSH, skualifikuar. |
| 11. Ankimime AK-s'ka; APP-s'ka KPP-s'ka. | 12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka | 13. Përgjigje Ankesës nga APP apo KKP S'ka |
| b. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave | | |
| 14. Lidhja e kontratës Kontrata nr.9941/16 prot., datë 26.07.2022 | 15. Vlera e kontratës (me TVSH) 29,856,366 lekë | 16. Likuiduar plotësisht sipas kontratës. |
| 17- Situacioni Përfundimtar | 18. Afati i kontratës në ditë Kontrata nr.1 – deri me 31.12.2022 | 19. Zgjatja e kontratës me – ditë: S'ka |

Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dokumenteve të sjella nga operatori fitues rezultoi:

Me urdhrin e prokurimit nr. 21, datë 01.06.2022 nxjerrë nga titullari i autoritetit kontraktor z. P.N është përcaktuar fondi limit 24,999,965.21 lekë pa t.v.sh. forma e procedurës e tenderit "E hapur" me mjete elektronike ku është përcaktuar Njësia e Prokurimit dhe me urdhrin nr. 333, datë 01.06.2022, Komisioni i vlerësimit të Ofertave, në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" kreu VII, neni 74 " pika 2. "Për çdo procedurë prokurimi, në varësi të specifikës së objektit të prokurimit, titullari i autoritetit/entit kontraktor krijon njësinë e prokurimit.." dhe neni 75 pika 1 "...1. Komisioni i vlerësimit të ofertave emërohet me urdher të veçantë të titullarit të autoritetit/entit kontraktor dhe përbëhet nga jo më pak se 3 (tre) persona me arsim të lartë, ku të paktën njëri është ekspert i fushës, nëse nevojitet për objektin e prokurimit.,....".

Projekti teknik i zbatimit, preventivi dhe i gjithë dokumentacioni teknik i projektit, është hartuar nga shoqëria "M" Sh.P.K dhe i është bërë dhuratë Bashkisë Lezhë, nëpërmjet kontratës së dhurimit nr.3437/1 prot., datë 18.03.2022, të lidhur ndërmjet palëve.

Nga njësia e ngritur me urdhrin nr. 332, datë 01.06.2022 me procesverbalin nr. 01, datë 01.06.2022 janë konfirmuar specifikimet teknike dhe relacionet teknike të hartuar nga projektuesi dhe se preventivi i hartuar nga projektuesi në vlerën 24,999,965.61 lekë pa TVSH, për secilin zë është kryer në përputhje me VKM nr. 629, datë 17.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre".

Nga Njësia e Prokurimit A.LL , A.L , L.GJ me nr. 9941/6, në datë 03.06.2022 është mbajtur procesverbali për hartimin e dokumenteve përfundimtare të tenderit referuar urdhrin të prokurimit nr. 21, datë 01.06.2022 ku janë përcaktuar procedura e prokurimit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, kapacitetet ekonomike financiare, kapacitetet teknike, gjithashtu janë hartuar dhe Dokumentet Standarde të tenderit të firmosura nga njësia e prokurimit dhe data e hapjes së ofertave datë **21.06.2022** në përputhje me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 78 pika 1. "Dokumentet e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe me legjislacionin në fuqi. Në hartimin e dokumenteve të tenderit, njësia e prokurimit duhet të përdorë dokumentet standarde të tenderit, sipas llojit të procedurës e tipit të kontratës" dhe 2. "Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, kriteret për shpalljen e ofertës fituese (nëse është rasti) dhe çdo informacion tjetër specifik i nevojshëm, bëhen nga specialisti

i fushës, anëtar i njësisë së prokurimit. Në varësi të objektit të prokurimit, nëse nuk është vlerësuar e nevojshme caktimi i një specialisti fushe, hartimi i kërkesave si më sipër bëhet nga njësia e prokurimit. Në çdo rast, hartimi i tyre duhet të argumentohet teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre. Ky procesverbal i vihet në dispozicion personit/ave përgjegjës për prokurimin, i cili/të cilët e bën/bëjnë pjesë të dosjes së tenderit. Seti përfundimtar i dokumenteve të tenderit nënshkruhet në çdo faqe nga anëtarët e njësisë së prokurimit”. Dokumentet e tenderit janë modifikuar me njoftim ndryshimi nr. 9941/8, datë 10.06.2022.

Nga Njësia e Prokurimit janë hedhur në DST në formatin elektronik procesverbali i miratimit dhe argumentimit të specifikimeve teknike dhe të kriterëve të veçanta të pranimit me argumentet përkatëse sipas kërkesave të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 7, “Rregulla të përgjithshme për formën dhe mënyrën e shpalljes së njoftimeve” pika 3: “Hedhja e njoftimit të kontratës, dokumenteve të tenderit dhe procesverbalit të argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, në sistemin elektronik, bëhet nga vetë autoriteti/enti kontraktor”.....

- Nga auditimi i dosjes së prokurimeve në formatin elektronik dhe dosjes fizike u konstatua:

a. Në hartimin e fondit limit të kontratës.

Nga grupi i auditimit u testuan disa prej zërave të preventivit me qëllim vlerësimin e përputhshmërisë së çmimeve për njësi në preventiv me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit miratuar me VKM nr.629, datë 15.07.2015, “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”, i ndryshuar. Nga verifikimi u konstatua se çmimet për njësi përputhen me çmimet e përcaktuara në manualin teknik të punimeve të ndërtimit.

b. Në argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit në DST.

Pika 2.3.3: AK ka kërkuar që OE duhet të ketë një punësim mesatar prej të paktën 12 punonjës të siguruar, për tre muajt Shkurt – Prill 2022.

Për kërkesën e mësipërme, në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit, mungon analiza teknike për argumentimin e numrit të punonjësve të kërkuar.

Për ilustrim si më poshtë vijon:

| Nr. Referenc sipas preventivit | Nr. An sipas manualit | Përshkrimi i punimeve | Njësi | Sasia | Ore pune | Total | |
|--------------------------------|-----------------------|-----------------------------------|-------|-------|----------|-------|--|
| | | 1. Punime kanalizimi | | | | | |
| | | Gërmim dheu | m3 | 626 | | | |
| | | 2. Punime elektrike | | | | | |
| | | F.V. Shtylla metalike për ndriçim | copë | 69 | | | |
| | | 3. Punime trotuari | | | | | |
| | | Gërmim dheu | m3 | 7 | | | |
| | | Mbushje me çakëll | m3 | 7 | | | |
| | | Orë pune total | | | | | |

Mbi bazën e orëve të punës për secilin zë punimesh në preventiv, nuk është përlogaritur sasia totale e orëve të punës duke pasur në konsideratë përlogaritjen për 2 punonjës (Specialist + punëtor), 8 orë punë në ditë, numrin e ditëve të punës sipas grafikut të punimeve. Kjo analizë mbi argumentimin e numrit të punonjësve të kërkuar mungon në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

Pika 2.3.6/a: Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës, si më poshtë: 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë: “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për të paktën 3 muajt Korrik – Shtator 2022.

Kërkesa e mësipërme nuk është në përputhje me pikën 3 në nenin 7 të ligjit nr. 10237, datë 18.02.2010 “Për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë”, i ndryshuar, ku punëdhënësi mund edhe ta kontrakttojë me palë të treta veprimtarinë e sigurisë dhe mbrojtjes në punë. Për më tepër, referuar përcaktimeve të bëra në pikat 4.1 dhe 4.4, Aneksi V në VKM nr.312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”, i ndryshuar, punëdhënësi organizon në brendësi të ndërmarrjes zyrën për mbrojtjen e parandalimin, ose ngarkon persona ose zyra/shërbime jashtë ndërmarrjes. Pra nuk është lënë mundësia e kontraktimit.

Pika 2.3.10: kërkohet që OE ofertues në rast se nuk është prodhues duhet të paraqesë kontratat e furnizimit për materialet si më poshtë:

Pika 2.3.10/1: Për bojërat; Pika 2.3.10/2: Për pllakat dhe parketin; Pika 2.3.10/3: Për materialet e termoizolimit dhe suvasë (Polisterol, Rrjete, Grafiato, Llaç, Fino); Pika 2.3.10/4: Për materialet hidroizoluese (Katrama, Hidroizolues); Pika 2.3.10/5: Për materialet elektrike (Kapitulli X, XI, XII i preventivit); Pika 2.3.10/6: Për materialet hidraulike (Kapitulli XXIII-XXIV i preventivit); Pika 2.3.10/7: Për sistemin HVAC, (Kapitulli XXIX i preventivit).

Për plotësimin e kërkesave sipas pikave të mësipërme nga AK është kërkuar që operatori duhet të paraqesë:

“Kontratë paraprake furnizimi me prodhuesin ose distributorin e autorizuar. Në rast paraqitje kontrate furnizimi me distributorin zyrtar, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizimin/aktin e marrëveshjes ose çdo dokument tjetër që provon lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar”.

Kërkesa për dokumentacionin e mësipërm në rastin kur OE disponon kontratë furnizimi me distributorin e autorizuar, i adresohet palëve të treta dhe jo OE që merr pjesë në garë, pasi në asnjë rast një distributor i autorizuar nuk ka detyrim që një të furnizuarit t’i vendosi në dispozicion dokumentacionin e tij ligjor që lidhet me prodhuesin e materialeve, përveç certifikate analize të cilësisë së materialit, faturë tatimore. Këtu sjellim në vëmendje të NJP edhe shkresën e APP nr.4916/2 prot., datë 14.07.2022 me lëndë “Sjellje vëmendje” drejtuar autoriteteve kontraktore, ku në pikën 3 të kësaj shkresë është kërkuar që AK nuk duhet të kërkojnë: *“Certifikata të prodhuesit, të cilët mund të mos jenë konkurrentë në procedurën e prokurimit, apo për dokumente që i’u përkasin operatorëve ekonomikë që nuk janë palë në procedurën e prokurimit”.*

Në pikën 2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar nuk janë parashikuar kërkesat sipas nenit 43 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” neni 43 “Kërkesat për kapacitetet ekonomiko-financiar” pika 4. *“Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilanci të tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilancet të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”.* Vendosja e kësaj kërkesë i shërbejnë autoritetit/entit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës dhe se është në përputhje dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës.

Sa më sipër, konstatohet se kriteret e veçanta të kualifikimit nuk janë në përputhje me përcaktimet e bëra në pikën 4, shkronjat “a” dhe “b” të pikës 5 të nenit 39, shkronjën “b”, pika 2 në nenin 43, paragrafi 2 në pikën 2 në nenin 78 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar

- Nga auditimi i procedurës së prokurimeve në formatin elektronik dhe dosjes fizike u konstatua:

Nga KVO e ngritur me urdhër të Kryetarit të Bashkisë Lezhë me nr. 333, datë 01.06.2022 i përbërë nga E.P (Kryetar), E.P dhe B.B (Anëtarë) është mbajtur procesverbali nr.01, datë

22.06.2022 për hapjen dhe vlerësimin e ofertave, si dhe raporti përmbledhës i procedurës së vlerësimit të ofertave nr.9941/12 prot., datë 08.07.2022, miratuar nga titullari i AK. Gjithashtu nga KVO është mbajtur procesverbali nr. 02, datë 27.06.2022 për verifikimin e dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, për formën dhe përmbajtjen ligjore të tij, si dhe procesverbali nr.03, datë 22.07.2022, për vlerësimin e dokumentacionit të nënkontraktorit.

Në njoftimin e kontratës nuk është përcaktuar lejimi i nënkontraktimit, në kundërshtim me pikën 2 të nenit 19 në VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Në këtë procedurë kanë marrë pjesë 3 OE/BOE, përkatësisht:

1. OE “E.Ç ” P/F, me NIPT M...I, pa ofertë ekonomike.
2. BOE “R ” Sh.A, me NIPT K...Q & “U ” Sh.P.K, me NIPT J...O & “A ” SH.P.K, me NIPT K...D dhe me ofertë ekonomike 24,880,305.75 lekë pa TVSH.
3. OE “T&XH” Sh.P.K, me NIPT L...I dhe me ofertë ekonomike 21,496,547.5 lekë pa TVSH.

a- Nga KVO janë s’kualifikuar 2 OE/BOE, si më poshtë:

1. OE “E.Ç ” nuk ka paraqitur ofertë ekonomike.
2. OE “T&XH” Sh.P.K me ofertë ekonomike 21,496,547.5 lekë pa TVSH.

KVO nga verifikimi i dokumentacionit të OE “T&XH” Sh.P.K në SPE ka konstatuar se OE:

- Së pari, nuk plotëson kriterin 1, në lidhje me Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit dhe pikën 2.1.1, të kushteve të veçanta të kualifikimit. Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se Operatori Ekonomike nuk ka plotësuar të dhënat për personin/at në cilësinë e anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose që ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik, ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. KVO i është referuar vendimit të KPP nr. 537/2019, datë 14.08.2019, në të cilin ka vendosur skualifikimin e operatorit ekonomik ankimes në këtë vendim pikërisht sepse nuk ka plotësuar e deklaruar të gjithë emrat sipas formatit të shtojcës 8 të DST.

- Për këtë shkak shtojca nr. 8, e dorëzuar nga OE nuk konsiderohet e rregullt pasi nuk përmban të gjithë elementët e nevojshëm dhe të detyrueshëm për tu plotësuar, duke mos përmbushur këtë kriter.

- Nga verifikimi ne SPE, vërehet se OE ka paraqitur një preventiv ofertë i cili nuk përmban asnjë nga elementet apo deklaratimet e parashikuara në Shtojcën nr. 2, të DST-së.

- OE nuk plotëson kriterin 2.3.5 të kushteve të veçanta të kualifikimit ku parashikohet se: “2.3.5 Krahas stafit teknik Operatorët Ekonomike duhet të kenë të punësuar staf mbështetës si më poshtë:

| | | |
|--------------------|---------|--|
| -Teknik Ndërtimi | 1 (një) | Diplome shkollës mesme |
| -Teknik Mekanik | 1 (një) | Diplome shkollës mesme |
| -Teknik Hidraulik | 1 (një) | Diplome shkollës mesme |
| -Teknik Elektronik | 1 (një) | Diplome shkollës mesme |
| -Teknik Elektrik | 1 (një) | Diplome shkollës mesme |
| -Karpentier | 1 (një) | Certifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale |
| -Suvatues | 1 (një) | Certifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale |
| -Pllakashtrues | 1 (një) | Certifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale |
| -Bojaxhi | 1 (një) | Certifikatë trajnimi/Dëshmi Profesionale |

Nga verifikimi ne SPE, rezulton se ky OE nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, disponimin e asnjë nga punonjësit të stafit mbështetës të sipërcituar duke mos përmbushur këtë kriter.

- OE nuk plotëson kriterin 2.3.6, ku parashikohet se: Operatorët Ekonomike duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të paktën:

2.3.6/a -1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë”, në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327, datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier". Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, certifikatën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Shkurt 2022 - Prill 2022.

2.3.6/b -1 (një) punonjës të pajisur me certifikatë “Për punime në lartësi”. Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune dhe certifikatën përkatëse ose dëshmi nga institucione të akredituara si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Shkurt 2022 - Prill 2022.

KVO ka theksuar se, për vlerësimin e këtij kriteri, i referohet vetëm formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pasi bazuar në pikën 1, të nenit 26, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021, nuk legjitimohet për të kryer verifikimin dokumentacioni nëse është paraqitur ndonjë dokument shtesë i saktë apo i pasaktë duke qenë se ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes nga operatorët ekonomik të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit sipas shtojcës përkatëse të DST-së.

- Nga verifikimi në SPE, KVO ka konstatuar se ky OE nuk ka deklaruar në formularin përmbledhës të vetë deklarimit, disponimin e punonjësve të certifikuar në stafin teknik ose mbështetës të sipërcituar sipas kriterit 2.3.6 të DST-së, duke mos përmbushur këtë kriter.

Sa me sipër Komisioni i Vlerësimit të Ofertave mbështetur në nenin 76, pika 3/a dhe në nenin 77, pika 1, 4 dhe 5, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ka vendosur të refuzojë ofertën e Operatorit Ekonomik “T&XH” SH.P.K, për mos përmbushje të kriterëve të veçanta kualifikuese.

b. Nga KVO është shpallur fitues BOE “R ” Sh.A, & “U ” Sh.P.K, & “A ” SH.P.K, me ofertë ekonomike 24,880,305.75 lekë pa TVSH.

Nga auditimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin elektronik dhe në dosjen fizike, nga BOE shpallur fitues, konstatohet:

1. Për OE “R ” Sha,

Për pikën 2.2.2 kërkuar në DST është konstatuar se:

-Nuk plotësohet **pika 2.2.2** në DST, pasi nga OE “R ” Sha, pjesë e BOE, *nuk janë dorëzuar vërtetimet për likuidimin e taksave vendore në bashkitë që ka ushtruar aktivitet: Kavajë dhe Pukë*, si dhe mandat-pagesën e detyrimit tatimor brenda datës 25.05.2022, në zbatim të akt-marrëveshjes nr.2845/2 prot., datë 20.04.2022, të lidhur me DPT.

2. Për OE “A ” SHPK.

- Nuk plotësohet **pika 2.3.3** në DST, pasi OE “A ” SHPK pjesë e BOE shpallur fitues, nuk ka sjellë vërtetimin E-SIG 02/a, ku të specifikohet numri i punonjësve për muajin Prill 2022. Vërtetimi i sjellë prej tij, përfshin të dhënat deri në muajin Mars të vitit 2022.

- Nuk plotësohet **pika 2.3.7** në DST, pasi nga BOE shpallur fitues, janë deklaruar të dhëna për mjetin me targa LE6540A, me kapacitet 7.5-18 ton siguruar nëpërmjet kontratës së qirasë Nr.Rep.4170 Nr.Kol.1735 të deklaruar nga OE “U ”, pjesë e BOE shpallur fitues, *i ka mbaruar vlefshmëria e kontrollit teknik, nuk ka certifikatë për transportin e mallrave.*

Sa konstatuar më sipër BOE “R ” & “U ” Sh.P.K & “A ”, nuk plotëson kriteret e vendosur në DST dhe në këto kushte në zbatim të nenit 98 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, KVO duhet të kishte skualifikuar dhe anuluar procedurën e prokurimit.

Pretendimi i subjektit:

Për sa është trajtuar në Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 870/10, datë 22.02.2024 nga subjekti i audituar Bashkia Lezhë janë paraqitur observacionet me shkresë nr. 870/11, datë 25.03.2024, ku janë shprehur objeksionet si më poshtë:

- Lidhur me konstatimet e audituesit (faqe 25, akt konstatimi nr. 8) për kriterin 2.3.3 ku parashikohet se “Operatorët Ekonomike duhet të kenë një punësim mesatar të paktën 12 (dymbëdhjetë) personave të siguruar për periudhën Shkurt 2022 - Prill 2022”, argumentojmë se bazuar në zërat e preventivit të punimeve numri prej 12 punonjësish është një kërkesë minimale për të krijuar besueshmëri se operatori ekonomik disponon stafin minimal për të realizuar kontratën, pasi për kryerjen e punimeve duke u bazuar në projektin, specifikimet teknike, relacionet teknike për kryerjen e punimeve nevojitet një numër me i lartë se kërkesa prej 12 punonjësish.

- Lidhur me konstatimet e audituesit (faqe 25, akt konstatimi nr. 8) për kriterin 2.3.10 argumentojmë se kërkesa për Autorizim/ Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar, është një kërkesë e cila mund të realizohet lehtësisht nga operatorët ekonomikë të cilët kanë për objekt të veprimtarisë së tyre kryerjen e punimeve me këtë kategori produktesh, pasi kanë për detyrë të dëshmojnë në çdo rast origjinalitetin e mallrave që vendosin në objekt.

- Në lidhje me mandatin pagesën e detyrimit tatimor në zbatim të akt-marrëveshjes nr. 2845/2 prot date 20.04.2022 të lidhur me DPT sqarojmë se në akt marrëveshjen e nënshkruar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve theksohet se OE “R ” SH.A ka kryer pagesat e detyrimeve për nënshkrimin e akt marrëveshjes dhe për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave është e tepërt të kërkohet mandati pagesë kur nga Institucioni i ngarkuar për mbledhjen e detyrimeve pranon se OE “R ” SH.A ka shlyer detyrimet në zbatim të akt-marrëveshjes nr. 2845/2 prot date 20.04.2022. Sa me sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

- Në lidhje me konstatimin se OE “A ” SH.P.K nuk plotëson pikën 2.3.1 Nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se OE “A ” SH.P.K ka paraqitur kontrate për punë të ngjashme në vlerën prej 79,367 euro. Sa me sipër konstatohet një gabim i audituesit mbi llojin e valutës nga lek në euro dhe për rrjedhojë konstatimi për këtë kriter nuk qëndron.

- Në lidhje me konstatimin se OE “A ” SH.P.K nuk plotëson pikën 2.3.3 pasi nuk ka sjelle vërtetimin E-SIG 02/a, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sqaron se ky dokument është administruar fizikisht pranë AK-se dhe është vënë në dispozicion audituesit gjatë auditimit. (të verifikohet dosja fizike pranë KLSH-se). Sa me sipër konstatimi i audituesit nuk qëndron.

Oëndrimi i grupit të auditimit të KLSH-së:

Në lidhje me komentet e bëra nga subjekti i audituar Bashkia Lezhë për Projekt Raportin e auditimit dërguar me shkresën nr. 870/11, datë 25.03.2024 grupi i auditimit gjykon se:

- Për kriterin 2.3.3, nuk është përlllogaritur sasia totale e orëve të punës duke pasur në konsideratë përlllogaritjen për 2 punonjës (Specialist + punëtor), 8 orë punë në ditë, numrin e ditëve të punës sipas grafikut të punimeve. Kjo analizë mbi argumentimin e numrit të punonjësve të kërkuar mungon në procesverbalin e argumentimit të kriterëve të veçanta të kualifikimit.

- Kërkesa (pika 2.3.10) për dokumentacionin në rastin kur OE disponon kontratë furnizimi me distributorin e autorizuar, i adresohet palëve të treta dhe jo OE që merr pjesë në garë, pasi në asnjë rast një distributor i autorizuar nuk ka detyrim që një të furnizuarit t'i vendosi në dispozicion dokumentacionin e tij ligjor që lidhet me prodhuesin e materialeve, përveç certifikate analize të cilësisë së materialit, faturë tatimore.

- Nga OE “R ” Sha, pjesë e BOE, nuk janë dorëzuar vërtetimet për likuidimin e taksave vendore në bashkitë që ka ushtruar aktivitetet: Kavajë dhe Pukë, si dhe mandatin pagesën e detyrimit tatimor brenda datës 25.05.2022, në zbatim të akt-marrëveshjes nr.2845/2 prot., datë 20.04.2022, të lidhur me DPT.

- Në lidhje me komentet se OE “A ” SH.P.K plotëson pikën 2.3.1 u morr parasysht mbasi kontrata dhe pagesat janë në Euro.

Gjykojmë se nga Bashkia Lezhë nuk janë sjellë argumente të qenësishme të cilat mund të ndikojnë në konstatimet tona të cilat janë bazuar në dokumente e fakte. Për sa më lart komentet merren pjesërisht në konsideratë dhe trajtohen në materialin e auditimit.

7. "Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë"

A. Të dhëna mbi objektin:

| Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë" REF-26273-04-25-2022 | | |
|---|---|--|
| Urdhër Prokurimi Nr. 9 datë 22.04.2022 | 3.Njësia e Prokurimit A.LL – Kryetar | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave E.P Kryetar |
| 2.Lloji i Procedurës së Prokurimit "I hapur" | E.Z A.L | E.P GJ.L |
| 5. Fondi Limit (pa tvsh) 250,814,497 lekë | 6. Oferta fituese (pa tvsh) 244,691,098 lekë, U shpk. | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 6.123.00 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit 11.05.2022 | 9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Lezhë | 10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 6 OE b)Skualifikuar 4 OE c)Kualifikuar 2 OE |
| 11. Ankimime AK- Nr. 9682/3, datë 30.02.2022 | 12. Përgjigje Ankesës nga AK Datë 31.05.2022 | 13. Përgjigje nga APP apo AKKP S'ka Nr.682/2022 |
| 13. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave | | |
| 14. Lidhja e kontratës nr.1 dhe nr.2 Datë 21.10.2022 | 15. Vlera e kontratës (me tvsh) 293,629,317.6 Lekë | 16. Likuiduar deri në |
| 17. Situacioni përfundimtar | 18. Afati i kontratës në ditë 6 (gjashtë) muaj | 19. Zgjatja e kontratës |

B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

1. Me kërkesën Nr. 6167/4, datë 22.04.2022, urdhërohet fillimi i procedurës me objekt: "Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë", nënshkruar nga titullari i AK, P.N .

2. Me urdhrin Nr. 242, datë 21.04.2022, ngrihet grupi i punës mbi për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlllogaritjen e fondit limit për prokurimin, me përbërje: E.Z – Kryetar, A.L dhe A.M – anëtar.

3. Me urdhrin nr.244, datë 22.04.2022, ngrihet grupi i punës KVO, për vlerësimin e ofertave, me përbërje E.P Kryetar, E.P. dhe GJ.L .

5. Me shkresën Nr. 6167/6, datë 22.04.2022 është nënshkruar procesverbali tip kontrata e punës me palët kontraktore, nënshkruar nga njësia e prokurimit.

Burimi i financimit.

Fondi është vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Lezhë, miratuar me Vendim nr. 177, datë 23.12.2021 të Këshillit Bashkiak Lezhë "Për miratimin e Buxhetit për vitin 2021 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024", dhe me vendimin nr. 31, datë 04.04.2022 të këshillit të Bashkisë Lezhë "Për një ndryshim ne V.K. Bashkiak nr. 177, date 23.12.2021"Për Miratimin e Buxhetit për vitin 2022 dhe të Programit Buxhetor Afatmesëm 2022-2024", i shtrirë në 3 vite buxhetore .

Mbi përlllogaritjen e fondit limit.

Nga auditimi mbi llogaritjen e FL në vlerën 250,814,497 lekë pa TVSH, rezulton se është kryer në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre.

Projekti i zbatimit; Leje ndërtimi/Infrastrukturore, etj.

Projekti i zbatimit për objektin "Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë" është hartuar nga Studio Projektimi shoqëria "H " SHPK me Nr. Licence N-7023, me Administrator Z. H.H në vitin 2022.

Për projektin e zbatimit me objekt: "Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë" nga Titullari i Bashkisë Lezhë është miratuar "Deklaratë për

kryerje punimesh” me Nr. 564 (nr. 19539/1prot., datë 09.12.2022) veprim ky sipas, ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimi në SPE mbi procedurën e prokurimit ka rezultuar si më poshtë;

Mbi kriteret e vendosura, kapaciteti teknik, AK / njësia e prokurimit ka kërkuar:

Pika 2.3.3 Operatorët Ekonomikë (këtu e në vijim “OE”), duhet të kenë një punësim mesatar të paktën **60** (gjashtëdhjetë) persona të siguruar për periudhën Janar 2022 – Mars 2022.

Në lidhje me vendosjen e kriterit të kërkuar, njësia e prokurimit nuk ka mirëargumentuar disponimin e një numri të lartë punonjësish të kërkuar, duke marrë në konsideratë përcaktimet e pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, që kriteret duhet të jenë në përpjesim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese dhe vlerën e kontratës.

Pika 2.3.4 Operatorët ekonomikë, duhet të kenë pjesë të stafit teknik të shoqërisë;

a) Inxhinier Ndërtimi 1 (një)

b) Inxhinier Mjedisi 1(një)

c) Inxhinier Gjeodet 1(një)

Për stafin e mësipërm Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë pune e vlefshme, dipoloma universitare, si dhe të figurojë në listëpagesat e kompanisë minimalisht për periudhën Janar – Mars 2022.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, grupi i auditimit konstaton se njësia e prokurimit nuk ka mirëargumentuar kërkesat për vendosjen e kriterit inxhinier Mjedisi, sepse kërkesat për vendosjen e një kriteri të tillë, duhet të përfshijnë nevojën për disponimin një inxhinieri që punimet e kryera, duhet të përfshihen në preventiv dhe zërat e kërkuar, sipas llojit të punimeve të parashikuara në VKM nr. 42, datë 16.01.2008, që përfshijnë; *punime të inxhinierisë mjedisore; ndërtime mirëmbajtje ose ristrukturime të veprave dhe punimeve të veçanta ose të shpërndara në territor, dhe vlerësimin të kompaktësimin të zhvillimit të qëndrueshëm të ekosistemit, përfshirë të gjitha veprat dhe punimet e nevojshme për aktivitetet botanik dhe zoologjik.*

Sa më sipër, NjP nuk i është përmbajtur përcaktimeve të pikës 1, nenit 77, të LPP dhe pikës 4, të nenit 39, të Vendimit nr. 285. Datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, që çdo kriter duhet të jetë i lidhur ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës.

Pika 2.3.5 krahas stafit teknik, Operatorët ekonomik, duhet të kenë staf mbështetës si më poshtë;

| | | |
|-------------------|-------------|--|
| - Ing. Ndertimi | 1 (nje) | Diplome Universitare |
| - Teknik ndertimi | 3 (tre) | Diplome shkolles mesme |
| - Teknik mekanik | 1 (nje) | Diplome shkolles mesme |
| - Karpertier | 1 (nje) | Deshmi Profesionale |
| - Shofer | 10 (dhjetë) | Leje Drejtimi |
| - Manovrator | 10 (dhjetë) | Certifikate e Aftesise Profesionale(CAP) |

Për stafin e mësipërm Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin: kontratë pune e vlefshme, dipoloma universitare, si dhe të figurojë në listëpagesat e kompanisë minimalisht për periudhën Janar – Mars 2022.

Në lidhje me vendosjen e kriterit të kërkuar, njësia e prokurimit nuk ka mirëargumentuar disponimin e një numri të lartë punonjësish (Staf mbështetës) të kërkuar, e për rrjedhojë vendosja e tyre kërkon një argumentim më të thelluar teknik dhe ligjor të nevojës për kryerjen e punimeve, duke marrë në konsideratë përcaktimet e pikës 4, të nenit 39, të VKM nr. 285,

datë 19.05.2021, që kriteret duhet të jenë në përpjesim të drejtë dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurrohet. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi Njësinë e prokurimit me përbërje Z. A.LL , Z. E.Z dhe Z. A.L .

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave nga KVO.

Me hapjen e ofertave më datë 11.05.2022, ora 10:00, KVO pasi hyri individualisht në SPE dhe pas përfundimit të fazës së dorëzimit dhe pranimit të ofertave, nga njësia e prokurimit, konstatoi se pjesëmarrës në procedurën e prokurimit janë:

- 1- Operatori Ekonomik “A ” SH.P.K me Nuis K....F, me ofertë ekonomike 247,955,560 (dyqind e dyzet e shtate milion e nenteqind e pesedhjetë e pese mijë e peseqind e gjashtedhjetë) Lek pa TVSH
- 2- Operatori Ekonomik “H ” SH.P.K me Nuis J....B, me oferte ekonomike 248,113,486 (dyqind e dyzet e tete milion e njeqind e trembedhjetë mijë e katerqind e tetedhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH.
- 3- Operatori Ekonomik “M ” SH.P.K me Nuis K....G, pa oferte ekonomike.
- 4- Operatori Ekonomik “S ” SH.P.K me Nuis K....J, me oferte ekonomike 222,222,222 (dyqind e njezte e dy milion e dyqind e njezete e dy mijë e dyqind e njezete e dy) Leka pa TVSH.
- 5- Operatori Ekonomik “U ” SH.P.K me Nuis K....Q, me oferte ekonomike 248,113,486 (dyqind e dyzet e tete milion e njeqind e trembedhjetë mijë e katërqind e tetedhjetë e gjashtë) Lek pa TVSH.
- 6- Operatori Ekonomik “U ” SH.P.K me Nuis J....O, me oferte ekonomike 244,691,098.00 (dyqind e dyzet e kater milion e gjashteqind e nentedhjetë e nje mijë e nentëdhjetë e tetë) Lek pa TVSH.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, kërkoi nga njësia e prokurimit, kthimin në fazën për rivleresim në SPE, me qellim që KVO, të kryejë rivlerësimin e procedurës në sistemin elektronik.

Në vijim KVO, i kërkoi personit përgjegjës të dërgoje për publikim njoftimin e fituesit, pasi në datën 23.05.2022, Operatori ekonomik i klasifikuar i pari, “U ” SH.P.K është paraqitur për të dorëzuar dokumentet provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2, të nenit 26, të VKM-se nr. 285, date 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike me date 11.05.2022, ku rezultoi se dokumentacioni është në përputhje me ofertën e dorëzuar me mjete elektronike, kjo bazuar në procesverbalin nr. 02, date 23.05.2022, “Për vlerësimin e dokumentacionit të Operatorit Ekonomik “U ” SH.P.K”, të mbajtur nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave.

Në vijim, më datë 11.05.2022 është nënshkruar formulari i sigurimit të ofertës, midis Bashkisë Lezhë dhe ofertuesit të siguruar “U ” shpk.

Në datën 30.05.2022, Operatori ekonomik “S ” SH.P.K, ka dorëzuar ankesë pranë AK , dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik (këtu e në vijim “KPP”), në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku ka kundërshtuar vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertes.

Në datën 30.05.2022, Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave me vendimin nr. 9682/ 2 prot, datë 30.05.2022, ka vendosur refuzimin e ankesës së operatorit ekonomik “S ” SH.P.K.

Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin nr. 631/2022 ka vendosur të pranojë ankesën e paraqitur nga Operatori ekonomik “S ” SH.P.K, si dhe ka vendosur që AK Bashkia Lezhë të

anulojë vendimin e KVO-së, mbi skualifikimin e Operatorit ekonomik “S ” SH.P.K, duke bërë rivlerësimin e ofertave.

Më datën 15.09.2022, pas shqyrtimit të dokumentacionit nga KVO-ja, është bërë shpallja e fituesit dhe Publikimi i njoftimit të fituesit në SPE, duke identifikuar si ofertën më të suksesshme operatorin fitues “U ” SH.P.K me Nuis J...O, me oferte ekonomike 244,691,098 (dyqind e dyzet e katër milion e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një mijë e nëntëdhjetë e tetë) lek pa TVSH.

Si konkluzion mund të themi:

1-Dokumentet e tenderit (Kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit) të hartuara nga Njësia e Prokurimit dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, NjP nuk ka të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, veprim ky në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 78, pika 2** “hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit” ku citohet se: “...Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”.

2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dojen e prokurimit dhe në SPE të procedurës me objekt “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë” konstatohet se KVO:

- ka kualifikuar me të drejtë dhe shpallur fitues me të drejtë OE “U ” SHPK, pasi ka plotësuar të gjitha kriteret e vendosura nga AK Bashkia Lezhë dhe,

- ka skualifikuar me të drejtë OE “S ” SHPK pasi, pasi nuk ka përmbushur të gjitha kriteret kualifikuese, dhe nuk ka vërtetuar se zotëron reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi. KVO ka vepruar në përputhje me nenin 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

8. "Rehabilitimi i shëtitorës dhe lulishtes mbi lumin Drin"

A. Të dhëna mbi objektin:

| Zhvillimi i procedurës së prokurimit me objekt: "Rehabilitimi i shëtitorës dhe lulishtes mbi lumin Drin" REF-49586-11-11-2022 | | |
|--|---|--|
| 1. Urdhër Prokurimi Nr. 43 datë 11.11.2022 | 3.Njësia e Prokurimit E.Z – Kryetar | 4. Komisioni i Vlerësimit Ofertave E.P Kryetar |
| 2.Lloji i Procedurës së Prokurimit “I hapur” | L.GJ E.M | E.P B.B |
| 5. Fondi Limit (pa tvsh) 94,750,000 lekë | 6. Oferta fituese (pa tvsh) 92,628,301 lekë BOE M shpk, E shpk & V shpk | 7. Diferenca me fondin limit (pa tvsh) 2,121,699 lekë |
| 8. Data e hapjes së tenderit 30.11.2022 | 9. Burimi Financimit Buxheti i Bashkisë Lezhë | 10. Operatorët Ekonomike a)Pjesëmarrës në tender 3 OE b)Skualifikuar 3 OE c)Kualifikuar 1 OE |
| 11. Ankimime AK-S'ka | 12. Përgjigje Ankesës nga AK S'ka | 13. Përgjigje nga APP apo AKKP S'ka |
| 13. Zbatimi i Kontratës Punimeve/Shërbimeve/Mallrave Nr. 18346/13 | | |
| 14. Lidhja e kontratës Datë 04.01.2023 | 15. Vlera e kontratës (me tvsh) 111,153,962 lekë | 16. Likuiduar deri në |
| 17. Situacioni përfundimtar Në proces | 18. Afati i kontratës në ditë 6 (gjashtë) muaj | 19. Zgjatja e kontratës |

B. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

1. Me kërkesën Nr. 18346, datë 11.11.2022, urdhërohet fillimi i procedurës me objekt: "Rehabilitimi i shëtitorës dhe lulishtes mbi lumin Drin", nënshkruar nga Drejtor E.Z .

2. Me urdhrin Nr. 43, datë 11.11.2022, urdhri i prokurimit, për rehabilitimin e shëtitorës dhe lulishtes mbi lumin Drin, nënshkruar nga Kryetari P.N .

3. Me urdhrin Nr. 18346/1, datë 11.11.2022, ngrihet grupi i punës për hartimin e specifikimeve teknike dhe përlogaritjen e fondit limit për prokurimin, me përbërje E.Z – Kryetar, L.GJ dhe E.M – antar.

4. Me urdhrin Nr. 594, datë 11.11.2022, urdhërohet ngritja e KVO-së me përbërje: E.P – Kryetar, E.P dhe B.B – anëtarë.

5. Me shkresën Nr. 18346/13, datë 04.01.2023 është nënshkruar kontrata e punës me palët kontraktore, nënshkruar nga titullari Kryetari i Bashkisë Lezhë P.N .

Nga shqyrtimi i dokumentacionit dhe verifikimi në SPE mbi procedurën e prokurimit ka rezultuar si më poshtë;

Burimi i financimit.

Vënë në dispozicion nga buxheti i Bashkisë Lezhë (te ardhurat), miratuar me vendimin nr. 105, Datë 23/09/2022 të Këshillit Bashkiak Lezhë “Për disa ndryshime në VKB nr. 177, date 23.12.2021 “Per Miratimin e Buxhetit per vitin 2022 dhe te PBA 2022-2024”.

Mbi përlogaritjen e fondit limit

Nga auditimi mbi llogaritjen e FL në vlerën 94,750,000 lekë pa TVSH, rezulton se është kryer në përputhje me VKM-në nr. 629, datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndertimit dhe të analizave teknike të tyre.

Projekti i zbatimit; Leje ndërtimi/Infrastrukturore, etj.

Projekti i zbatimit për objektin “Rehabilitimi i shëtitorës dhe lulishtes mbi lumin Drin” është hartuar nga Studio Projektimi shoqëria “K ” SHPK me Nr. Licence N-6984/1, me me grup pune me përbërje: Ar. F.P (Lic. A-1166/2), Ark N.GJ (lic. A.0031/4), Ing. Elek. M.G (lic. E.0751/2), Ing. Hidro. E.D (lic. K.1075/3), Ing. Ndërt. B.Ç (lic. K.0383/5).

Për projektin e zbatimit me objekt: “Rehabilitimi i shëtitorës dhe lulishtes mbi lumin Drin” nga Titullari i Bashkisë Lezhë është miratuar “Deklaratë për kryerje punimesh” , veprim ky sipas, ligjit nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar.

Situata 1

Mbi përcaktimin e kriterëve të kualifikimit:

Mbi kriteret e vendosura, kapaciteti teknik, AK / njësia e prokurimit ka kërkuar:

Pika 2.3.6 Operatorët ekonomik duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetës, të certifikuar të paktën;

- **2.3.6/b - 1 (një) punonjës të pajisur me licensë A.1** për vëzhgimin arkeologjik lëshuar nga Instituti Kombëtar i Trashgimisë Kulturore në përputhje me vkm nr. 793, datë 07.10.2020 “Për përcaktimin e kushteve të posacme e të kriterëve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore”.

Për të përmbushur këtë kriter OE duhet të paraqesë kontratë pune, diplome dhe licensën përkatëse si dhe duhet të jetë në listëpagesat e shoqërisë të paktën për periudhën Korrik 2022 - Shtator 2022.

Në argumentimin e grupit të auditimit, kriteri i mësipërm i kërkuar nga njësia e prokurimit, **1 (një) punonjës të jetë i pajisur me licensë A.1 për vëzhgim arkeologjik** dhe të jetë në listëpagesat e shoqërisë, sjell kufizim të pjesëmarrësve të Operatorëve Ekonomik ofertues të mundshëm, të cilët vlerësohet se kanë kapacitetin e nevojshëm dhe të mjaftueshëm për ekzekutimin e kontratës, pasi duhet të jetë në përputhje të plotë me kërkesat e nenit 3, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, për të garantuar një trajtim të barabartë dhe jo diskriminues për operatorët ekonomik dhe për të mos ngushtuar konkurrencën dhe kriteri për disponimin e 1 (një) punonjësi të pajisur me licensë A.1 për vëzhgim arkeologjik në listëpagesat e shoqërisë, mund të kërkohej nëpërmjet kontraktimit osë kontratës së bashkëpunimit nga ana e operatorëve ekonomik.

Për rrjedhojë vendosja e kriterit në listëpagesat e ngushton konkurrencën midis operatorëve ekonomikë.

Përsa sipër, kriteret e vendosura nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e objektit që prokurohet. Përsa sipër, është vepruar në kundërshtim me pikën 4 të nenit 39 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, nenin 78, i ndryshuar, duke ngarkuar me përgjegjësi hartuesit e dokumenteve të tenderit E.Z , Z. L.GJ dhe E.M .

Situata 2

Mbi vlerësimin e ofertave nga KVO.

Në vijim të procedurës, me hapjen e ofertave më datë 30.11.2022, ora 10:00 KVO pasi hyri individualisht në SPE dhe pas përfundimit të fazës së dorëzimit dhe pranimit të ofertave, nga njësia e prokurimit ka identifikuar si ofertën fituese:

BOE “M ” SHPK, & “E ” shpk, & “V ” SHPK , me ofertë ekonomike 92,628,301 lekë pa tvsh. Nga verifikimi i ofertave në QKB, u konstatua se të tre operatorët ekonomik *që janë skualifikuar* nuk kanë për objekt fushën e prokurimit, konkretisht;

- “A ” shpk, me objekt: studio projektimi, supervizioni dhe kolaudimi...etj.
- “D ” shpk, me objekt: shërbime funerale, mirëmbajtje e të tjera komunale, pastrim, gjelbërim e dekorim urban, servis lavazh...ndërtimin e rrugëve pyjore etj.
- “K ” shpk, me objekt: financimi, projektimi, ndërtimi, vënia në punë, administrimi, mirëmbajtja e hidrocentraleve dhe transferimi i tyre...etj.

Për këtë procedurë prokurimi, KVO-ja, me procesverbalin Nr. 18346/10 Prot, datë 05.12.2022 ka identifikuar ofertën ekonomike më të suksesshme dhe ka shpallur formularin e njoftimit të fituesit.

Referuar kësaj ofertë, si nga verifikimi në SPE dhe shqyrtimi i dokumentacionit, operatorët e tjerë pjesëmarrës në këtë tender, nuk kanë dorëzuar asnjë dokumentacion që provon përmbushjen e këtyre kriterëve, e për më tepër, ofertuesit pjesëmarrës nuk kanë për objekt fushën e prokurimit dhe vendosja e kriterëve të sforcuara, i orienton OE drejt një operatori të vetëm fitues.

Mbi vlerësimin e ofertave nga Grupi i Auditimit.

Më datë **04.01.2023**, është nënshkruar kontrata me objekt “Rehabilitimi i shëtitores dhe lulishtes mbi lumin Drin”, me palët kontraktore Bashkia Lezhë dhe Bashkim i Operatorëve Ekonomik fitues.

Mënyra e pagesës do të kryhen me paraqitjen e situacioneve pjesore/tërësore, brenda 30 ditëve kundrejt dorëzimit të dokumentacionit.

Afati për realizimin e punimeve: Sipërmarrësi/Kontraktori merr përsipër të realizojë punimet për rehabilitimin e shëtitores dhe Lulishtes mbi lumin Drin për një periudhë **6 (gjashtë) muajsh** siç është përcaktuar në grafikun e punimeve.

Si konkluzion mund të themi:

-Dokumentet e tenderit (Kriteret e kualifikimit dhe të vlerësimit) të hartuara nga Njësia e Prokurimit dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë Lezhë, NjP nuk ka të argumentuar vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, veprim ky në kundërshtim me VKM-në nr. 285, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **neni 78, pika 2** “*hartimi dhe publikimi i dokumenteve të tenderit*” ku citohet se: “...Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen teknikisht dhe ligjërisht dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre...”.

-Nga shqyrtimi i dokumentacionit në dojen e prokurimit dhe në SPE të procedurës me objekt “Rehabilitimi i Shetitores dhe Lulishtes mbi lumin Drin” konstatohet se KVO:

1. Operatori ekonomike “A ” SH.P.K, me Nuis L...I dhe me oferte ekonomike 93,066,883 (nentedhjete e tre milion e gjashtedhjetë e gjashtë mijë e teteqind e tetëdhjetë e tre) leke pa TVSH, pasi nuk plotëson 3(tri) kritere[-sigurimin e ofertës; - kriterin 2.3.5 dhe 2.3.7 pasi nuk ka vetedeklaruar ne formularin përmbledhës të vetëdeklarimit disponimin e stafit mbështetes, punonjesve të certifikuar dhe mjeteve; - nuk plotëson kriteret 2.3.8, 2.3.9 dhe 2.3.11, të DST-se pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon përmbushjen e këtyre kritereve].
2. Operatori ekonomike “D ” SH.P.K, me Nuis K...Q, pa oferte ekonomike dhe nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion në përmbushje të kritereve të përgjithshme dhe të vecanta të kualifikimit
3. Operatori ekonomik “K ” SH.P.K, me Nuis L...H dhe me oferte ekonomike 92,989,037 (nentedhjete e dy milion e nenteqind e tetëdhjetë e nente mijë e tridhjetë e shtatë) Lek pa TVSH, nga verifikimi i dokumentacionit në SPE rezulton se OE nuk ka paraqitur sigurimin e ofertës sipas shtojcës 3; nuk ka paraqitur formularin përmbledhës të vetëdeklarimit; nuk plotëson kriteret 2.3.1, 2.3.3, 2.3.4, 2.3.5, 2.3.6, 2.3.7, 2.3.8, 2.3.9 dhe 2.3.11, pasi nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që provon përmbushjen e këtyre kritereve. KVO ka vepruar në përputhje me nenin 92, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

Lidhur me aktkonstatimin e mësipërm, me shkresën nr. 15737/25, datë 21.03.2024, e protokolluar në KLSH me nr. 870/11 prot, datë 25.03.2024, është observuar nga përfaqësuesit e Njësisë së Prokurimit dhe KVO-së A.LL dhe E.P , si më poshtë:

Pretendimi i subjektit:

1. Lidhur me konstatimet e grupit të auditimit (faqe 7, e akt konstatimit nr.7) për kriterin 2.3.6 “Operatorët Ekonomike duhet të kenë në stafin teknik ose mbështetes, të certifikuar të pakten:

2.3.6/b – 1 (nje) punonjes të pajisur me license A.1, për Vëzhgim arkeologjik leshuar nga Instituti Kombëtar i Trashigimise Kulturore, në përputhje me VKM-ne Nr. 793, datë 7.10.2020 "Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kritereve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore" bëjme me dije se:

Në lidhje me disponimin e një punonjese të pajisur me license A.1, për Vëzhgim arkeologjik leshuar nga Instituti Kombëtar i Trashigimise Kulturore ky kriter është vendosur bazuar në VKM-ne Nr. 793, datë 7.10.2020 "Për përcaktimin e kushteve të posaçme e të kritereve të licencimit, dokumenteve shoqëruese dhe procedurave për shqyrtimin ose revokimin e licencës për veprimtarinë arkeologjike dhe veprimtarinë arkeologjike nënujore", **pasi projekti përfshin punime edhe në një pjesë të zonës monument kulture të kategorisë A** dhe është e nevojshme disponimi i një punonjese të licensuar për vëzhgim arkeologjik i cili duhet të jetë në kantier gjatë punimeve me qëllim mbrojtjen trashigimise kulturore.

Thëksojmë se pranë këtij kantieri punimesh ndodhet Kisha e Shen Nikollit dhe varri i heroit kombëtar Gjergj Kastrioti, si dhe zona përreth këtij monumenti është klasifikuar si monument kulture i kategorisë A.

Kjo zonë është shumë e rëndësishme për Bashkinë Lezhë dhe çdo germim duhet të bëhet në prani të një punonjese të licensuar për vëzhgim arkeologjik i cili duhet të jetë në kantier gjatë punimeve me qëllim mbrojtjen trashigimise kulturore.

Njësia e prokurimit bëjme me dije se edhe Këshilli Kombëtar i Trashigimise Kulturore Materiale, duke marrë në konsideratë rëndësinë e kësaj zone **monument kulture të kategorisë A**, në miratimin e projektit “Rehabilitim i Shetitores dhe Lulishtes mbi lumin Drin” brenda kufirit Zone Arkeologjike A, ka vendosur që gjatë procesit të zbatimit punimet të mbikqyren nga specialistet e DRTK Shkoder në bashkëpunim me specialistet e DSHA. (Bashkëngjitur gjëni vendimin)

Ndersa ne lidhje me gjykimin e grupit te auditimit se vendosja e kriterit ne listpagesat e shoqerise i orienton drejt nje operatori ekonomik fitues te paracaktuar, duke ngushtuar konkurrencen, Njesia e prokurimit argumenton se ky gjykim nuk eshte i drejte pasi ky kriter eshte vendosur bazuar ne nenin 39, pika 6/c) dhe ç), të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar parashikohet se: ”6.Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

c) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla sipas legjislacionit përkatës; dhe/ose

ç) fuqinë minimale punëtore të operatorit ekonomik, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose”,

Njesia e Prokurimit mban ne konsiderate se vendimi nr. 728, datë 01.09.2010, “Për shpalljen e zonave arkeologjike A e B të qytetit të Lezhës, dhe miratimin e rregullores së administrimit”, parashikon shpalljen e zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të **Lezhës, sipas hartës dhe koordinatave gjeografike, të përcaktuara (ku përfshihet zona ku do te kryhen punimet)** dhe miratimin e rregullores së administrimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Lezhës.

Po ashtu, Njesia e Prokurimit mban ne konsiderate se ne nenin 3, te rregullores së administrimit të zonave arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Lezhës parashikohet se: *Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Lezhës.*

Në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Lezhës lejohet:

1. Restaurimi dhe konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e sondazheve arkeologjike me synim studimin e plotë të zonës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

2. Rikonstruksioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik ujësjellës-kanalizime, ndriçim, telefoni, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.

3. Vendosja e konstruksioneve të lehta (dru, xham, plastikë, metal) me lartësi maksimale 3 m, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara.

Konstruksionet vendosen dhe përdoren nga institucionet shtetërore të specializuara, duhet të jenë të lëvizshme (të çmontueshme) dhe që në asnjë rast nuk duhet të dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin, në funksion të ruajtjes, ekspozimit, informimit publik dhe nevojave të tjera që lidhen me veprimtarinë arkeologjike në veçanti dhe trashëgiminë kulturore në përgjithësi.

Projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe për çdo rast duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj.

Sa me siper njesia e prokurimit thekson se me vendosjen e ketij kriteri nuk eshte kufizuar pjesmarrja pasi ky kriter eshte ne perputhje me natyren dhe volumin e objektit, pasi punimet do te realizohen brenda kufirit Zone Arkeologjike A.

Opinion i Grupit të auditimit

Grupi i auditimit ka dalë në konkluzionin e cituar në aktkonstatimi dhe në Projektraport, nisur nga zërat e preventivit, të cilat nuk kanë natyrë arkeologjike. Përsa citoni në lidhje me punimet që do të bëhen në zonën Monument Kulture, siç citohet edhe në Vendimin nr. 547, datë 12.12.2022 të Këshillit të Trashëgimisë Kulturore Materiale për miratimin e këtij projekti (bashkëlidhur observacionit), janë mbikëqyrësit e DRTK Shkodër që do të kryejnë vëzhgimin arkeologjik të cituar në KVK. Gjithashtu, vëzhguesi arkeologjik i kërkuar, i pajisur me licencën A.1, mund të ishte kërkuar edhe me kontratë të përkohshme, vetëm për

këtë objekt, pa qenë e nevojshme të ketë qenë pjesë e shoqërisë në periudhën Korrik 2022 – Shtator 2022.

- Edhe përsa i përket numrit të punonjësve dhe stafit mbështetës, NjP duhet t'i kishte argumentuar teknikisht në bazë të zërave të preventivit, orëve të punës sipas manualeve të çmimeve dhe grafikut të punimeve.

Përsa sipër, ky pretendim nuk merret në konsideratë.

Procedurat e prokurimit me vlerë të vogël.

-Verifikimi i shpenzimeve të programuara në nivelin e fondeve të buxhetore.

Për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022, Bashkia Lezhë, referuar të dhënave të regjistrit të prokurimeve janë kryer gjithsej **12** procedura prokurimi me vlerë të vogël, me vlerë të Fondit limit **6,266,102 Lekë** dhe me vlerë kontrate **5,215,897 lekë** pa TVSH, procedura të cilat janë mbuluar me financim nga fondet e buxhetit të Bashkisë Lezhë të paraqitura si më poshtë:

| Bashkia Lezhë | | | | | |
|---------------|--|------------------|-------------------|----------------------|-------------------|
| Nr. | Objekti i Prokurimit | Fondi limit | Vlera e kontratës | OE i shpallur fitues | Data e publikimit |
| 1 | Blerje Soba për ngrohje në institucionet arsimore | 961,211 | 661,000 | M.D | 01.12.2022 |
| 2 | Rehabilitimi i murit mbajtës në Fshatin Spiten, Nj. Zejmen | 996,890 | 980,000 | GJ | 06.06.2022 |
| 3 | Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve në rr. e Spitalit Rajonal | 413,972 | 376,338 | N | 14.07.2022 |
| 4 | Blerje Fletëpalosje, Broshura për turizëm | 360,000 | 349,000 | M | 25.01.2022 |
| 5 | Blerje Gaz për gatim | 583,050 | 583,000 | L | 19.01.2022 |
| 6 | Blerje Kondicionerësh për nevoja të Bashkisë Lezhë | 302,000 | 259,000 | N.LL | 15.03.2022 |
| 7 | Blerje materiale sinjali stikë vertikale | 578,698 | 560,000 | S | 25.01.2022 |
| 8 | Blerje pako ushqimore për familjet në nevojë | 232,595 | 230,000 | L | 20.12.2022 |
| 9 | Shërbimi i DDD dhe certifikim | 861,540 | 430,771 | I.K | 25.01.2022 |
| 10 | Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve me objekt: Përmirësimi të infrastrukturës rrugore për këmbësorët dhe biçikletat | 464,930 | 362,414 | K | 17.03.2022 |
| 11 | Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve me objekt: Ndërtimi i trotuarit të ri | 166,753 | 148,303 | R | 04.10.2022 |
| 12 | Shërbimi i mbikëqyrjes së punimeve me objekt: Rikonstruksioni i çerdhes së qytetit Lezhë | 344,464 | 276,071 | R | 15.03.2022 |
| Totali | | 6,266,102 | 5,215,897 | | |

Burimi i të dhënave: Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitin 2022

Për arritjen e objektivave dhe përmbushjen e misionit të auditimit, grupi i auditimit të KLSH-së, pasi u njoh me bazën ligjore mbi të cilën operohej në zbatimin e procedurave të prokurimit, duke u bazuar në metodën e leximit të dokumenteve të paraqitura për auditim, ekzaminimit dhe rishikimit analitik të letrave të punës dhe pasqyrave/informacioneve të paraqitura dhe ato në elektronikë marrë nga sistemi SPE të APP, përzgjedhi për auditim, **3** procedura prokurimi me blerje me vlerë të vogël, për periudhën objekt auditimi 01.01.2021-31.12.2022, me vlerë kontrate **1,651,771 lekë pa TVSH;**

Lekë

| Nr. | Objekti i Prokurimit | Fondi limit | Vlera e kontratës | OE i shpallur fitues | Data e publikimit |
|---------------|---|------------------|-------------------|----------------------|-------------------|
| 1 | Blerje Soba për ngrohje në institucionet arsimore | 961,211 | 661,000 | "M.D" SHPK | 01.12.2022 |
| 2 | Blerje materiale sinjali stikë vertikale | 578,698 | 560,000 | "S" SHPK | 25.01.2022 |
| 3 | Shërbimi i DDD dhe certifikim | 861,540 | 430,771 | (PF) I.K | 25.01.2022 |
| Totali | | 2,401,449 | 1,651,771 | | |

Burimi i të dhënave: Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitin 2022.

Në vijim, po trajtojmë problematikat e konstatuara në 3 (tre) procedura prokurimi me vlerë të vogël, si vijon:

1. Nga auditimi i zbatimit të procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “**Shërbimi i Dezinfektimit, Dezinsektizimit dhe Deratizimit (D.D.D) dhe certifikim në kopshte, çerdhe dhe shkollat publike në Bashkinë Lezhë Blerje**”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

| | | |
|--|---|---|
| Urdhër prokurimi nr. 16104 /4 prot., datë 28.09.2022 | Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël | -Fitues: OE “I.K ” -Vlera fituese 430,771.00 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: 1.Fatura tatimore nr. 7/2022, datë 24.10.2022 me vlerë 215,385,50 lekë pa TVSH 2.Fatura tatimore nr. 1/2023, datë 24.04.2023 me vlerë 215,385,50 lekë pa TVSH |
| Fondi limit 861,540 lekë (pa TVSH) | | |
| Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël | z. A.LL z. E.P z. R.Ç | |
| Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Lezhë | Fitues: OE “I.K ” | -Diferenca nga fondi limit 430,769.00 lekë |
| Data e hapjes së tenderit: 28.09.2022 | Data e zhvillimit të procedurës së tenderit: 29.09.2022 | Titullar i AK – P.N |

Burimi i të dhënave: Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitin 2022.

U konstatua si vijon:

Titulli i Gjetjes nr. 1: Në zbatim të programit të auditimit u audituan procedurat e prokurimit publik ku u konstatuan problematika lidhur me inventarizimin e brendshëm të dosjes së prokurimit me blerje të vogël.

Situata 1:

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se:

- Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;
- Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues;
- Hartimi i kërkesave për kualifikim, që lidhen me kapacitetin teknik, specifikimet teknike, nuk është i argumentuar teknikisht dhe ligjërisht, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre;
- Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Veprimet dhe mosveprimet janë në mospërputhje me përcaktimet e bëra në: Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 19; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 26/2, 27/1, 73/4, 74/3, 78/2, 80;

Situata 2:

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

- Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim jo në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe nenet 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mospërputhje me përcaktimet e bëra në: Ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat”, neni 36; Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 3 dhe 29.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”; Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Impakti:

-Hartimi i Dokumenteve Standarde të tenderit, kriteret e përgjithshme të kualifikimit, nga DST duke mos respektuar kërkesat e Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimet dhe Rekomandimet e APP, mund të kufizojnë pjesëmarrjen e ofertuesve në procedurat e prokurimeve dhe konkurrencën e lirë.

-Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit.

Shkaku: Kryerja e procedurave të prokurimit me blerje të vogël, pa u respektuar rregullat e procedurave të prokurimit publik, hartimit të DST, të kriterëve të përgjithshme të kualifikimit, duke mos respektuar kërkesat e Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Neglizhencë për kryerjen e inventarizimit të dosjes së prokurimit sipas ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”

Rëndësia: E mesme

2. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje soba për ngrohje në institucionet arsimore”, me të dhënat e përgjithshme sipas tabelës,

| | | |
|---|--|---|
| Urdhër prokurimi nr. 19190/3, datë 02.12.2022 | Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël | -Fitues: OE “M D” -Vlera fituese 661,000.00 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 61/2022 , datë 16.12.2022 me vlerë 793,119,95 lekë me TVSH |
| Fondi limit 961,211 lekë (pa TVSH) | | |
| Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël | z. A.LL z. E.P z. R.Ç | |
| Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Lezhë | Fitues: OE “M D” | -Diferenca nga fondi limit 300,211.00 lekë |
| Data e hapjes së tenderit: 01.12.2022 | Data e zhvillimit të procedurës së tenderit: 05.12.2022 | Titullar i AK – P.N |

Burimi i të dhënave: Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitin 2022.

U konstatua si vijon:

Titulli i Gjetjes nr. 2: Në zbatim të programit të auditimit u audituan procedurat e prokurimit publik ku u konstatuan problematika lidhur me specifikimet teknike në ftesën për ofertë dhe, mos inventarizimin e brendshëm të dosjes së prokurimit me blerje të vogël.

Situata 1:

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Veprimet dhe mosveprimet janë në mospërputhje me përcaktimet e bëra në: Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 19; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, “Mbi miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 26/2, 27/1, 73/4, 74/3, 75/4, 78/2, 80;

Situata 2:

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim jo në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe nenet 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe

Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

Veprimet dhe mosveprimet janë në mospërputhje me përcaktimet e bëra në:

-Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, neni 36;

-Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë, neni 3 dhe 29.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”; Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Impakti:

-Hartimi i specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, duke mos respektuar kërkesat e Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Udhëzimet dhe Rekomandimet e APP, mund të kufizojnë pjesëmarrjen e ofertuesve në procedurat e prokurimeve dhe konkurrencën e lirë.

-Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara duke mbartur riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit.

Shkaku: Kryerja e procedurave të prokurimit me blerje të vogël, pa hartimin e specifikimeve teknike në ftesën për ofertë specifikisht: deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues dhe, deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues, duke mos respektuar kërkesat e Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Neglizhencë për kryerjen e inventarizimit të dosjes së prokurimit sipas ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”.

Rëndësia: E mesme

3. Nga auditimi i procedurës së prokurimit me vlerë të vogël me objekt: “Blerje materiale Sinjalistike Vertikale për vitin 2022”, me të dhëna të përgjithshme sipas tabelës,

| | | |
|---|--|--|
| Urdhër prokurimi nr. 8781/2, datë 23.05.2022 | Komisioni i Prokurimit me Vlerë të Vogël z. A.LL z. E.P z. R.Ç | -Fitues: OE “S ” -Vlera fituese 560,000 lekë pa TVSH -Vlera kontratës ose faturës: Fatura tatimore nr. 71/2022, datë 03.06.2022, me vlerë 672,000 lekë me TVSH |
| Fondi limit vlerën 578,697.5 lekë (pa TVSH) | | |
| Procedura e prokurimit – blerje me vlerë të vogël | | |
| Burimi i Financimit: Të ardhurat e Bashkisë Lezhë | Fitues: OE “S ” | -Diferenca nga fondi limit 18,697.50 lekë |
| Data e hapjes së tenderit: 23.05.2022 | Data e zhvillimit të procedurës së tenderit: 24.05.2022 | Titullar i AK – P.N |

Burimi i të dhënave: Regjistri i realizimit të prokurimeve për vitin 2022

U konstatua si vijon:

Titulli i Gjetjes nr. 2: Në zbatim të programit të auditimit u audituan procedurat e prokurimit publik ku u konstatuan problematika lidhur me specifikimet teknike në ftesën për ofertë dhe, mos inventarizimin e brendshëm të dosjes së prokurimit me blerje të vogël.

Situata 1:

Sa i përket specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, konstatohet se;

-Nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues;

-Nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues;

-Nuk administrohen deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël;

Veprimet dhe mosveprimet janë në mospërputhje me përcaktimet e bëra në: Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 19; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në nenin 26/2, 27/1, 73/4, 74/3, 78/2, 80;

Situata 2:

Nga auditimi i dokumentacionit të dorëzuar nga OE shpallur fitues, u konstatua se:

-Dosja e procedurës së prokurimit nuk është arkivuar, inventarizuar dhe numerizuar me numër fletësh, veprim jo në përputhje me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të Ligjit Nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat” dhe nenet 3 dhe 29 të “Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë” miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, në zbatim të Ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003, “Për arkivat”.

Kriteri: Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”; Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

Impakti:

-Hartimi i specifikimeve teknike në ftesën për ofertë, duke mos respektuar kërkesat e Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe, VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, Udhëzimet dhe Rekomandimet e APP, mund të kufizojnë pjesëmarrjen e ofertuesve në procedurat e prokurimeve dhe konkurrencën e lirë.

-Mungesa e krijimit të inventarit të brendshëm të dosjes dhe gjendja faktike e dosjeve të pa inventarizuara mbartin riskun e humbjes ose tjetërsimit të gjurmës së auditimit.

Shkaku: Kryerja e procedurave të prokurimit me blerje të vogël, pa hartimin e specifikimeve teknike në ftesën për ofertë specifikisht: deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues dhe, deklaratë mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues, duke mos respektuar kërkesat e Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

-Neglizhencë për kryerjen e inventarizimit të dosjes së prokurimit sipas ligjit nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”

Rëndësia: E mesme

Sa më sipër mbajnë përgjegjësi anëtarët e komisionit të prokurimit në përbërje: z. A.LL , z. E.P , z. R.Ç , në cilësinë e anëtarëve të KBVV.

Konkluzion:

*Në 3 (tre) raste, nga auditimi mbi përputhshmërinë e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit të blerjeve të vogla me vlerë kontrate **1,651,771 lekë pa TVSH**; në Bashkinë Lezhë, u konstatua se:*

- në 1(një) procedurë prokurimi evidentohet se kriteret për shpalljen e ofertës fituese dhe specifikimet teknike, nuk janë të argumentuara teknikisht dhe ligjërish, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre;

-Në të gjitha procedurat e audituara nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues si dhe nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore;

-Dosjet e procedurave të prokurimit të audituara nuk janë inventarizuar dhe arkivuar me numër fletësh, duke sjellë pasiguri në plotësinë dhe administrimin e dokumentacionit të prokurimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe nenet 3, 29 të “Normave Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Sa më sipër është jo në përputhshmëri të plotë me:

-Ligji nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” neni 19;

-VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.
 -Ligji nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”, neni 36;
 -Norma Tekniko Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë.

2.4.1 Mbi zbatimin e kontratave të punimeve në investimet publike.

II. ZBATIMI I PUNIMEVE

Në zbatim të pikës 4.4 të Programit të Auditimit nr. 870/1, datë 10.10.2023, i ndryshuar, në Bashkinë Lezhë, nga ana e audituesve të KLSH-së, u analizua regjistri i investimeve të përfunduara në periudhën e auditimit. Nga kjo analizë, janë përzgjedhur për auditim në bazë të vlerës së kontratës objektet:

| Nr | Objekti | Vlera e kontrates | Kontraktori |
|----|--|-------------------|----------------------------|
| 1 | “Rindërtimi i konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka” | 151,500,000 | BOE “G ” SHPK & “E ” ShPK |
| 2 | “Rehabilitimi i murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë” | 22,363,882 | BOE “Z ShPK & “A CO” ShPK” |
| 3 | Riforcimi dhe Rikonstruksioni i Bibliotekës “Gjergj Fishta” dhe Pallati i Kulturës “Dedë Ndue Lazri”. | 236,725,554 | “J ”SHPK |
| 4 | Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë | 151,802,481.06 | “U ” SHPK |
| 5 | Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në territorin e Bashkinë Lezhë Loti II | 92,410,112 | BOE “R ” & “D ” SHPK |
| 6 | Rikonstruksionin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Bashkinë Lezhë | 211,461,570 | BOE “U & N ” SHPK |

1. “Rindërtimi i konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 23131/24 prot., datë 31.03.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lezhë, të përfaqësuar nga Kryetari z. P.N dhe të BOE “G ” SHPK & “E ” ShPK, me përfaqësues ligjor respektivisht z. A.N dhe z. A.ZH me licencë profesionale NZ 7849. Vlera e kontratës është 151,500,000 lekë pa TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periudha kohore 244 ditë nga data e dorëzimit të sheshit të ndërtimit. Me shkresën nr. 411/3, datë 17.01.2022 është bërë amendamenti për shtyrje afati të punimeve me 60 ditë (deri në 18.04.2022), për arsye të vonësive në procedurën e përjashtimit nga TVSh dhe të pandemisë Covid-19.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr. 1725/35 prot., datë 12.04.2021, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE “M ” ShPK & “P ” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3119/5 dhe me vlerë të kontratës 1,510,000 lekë.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 11049/2 prot., datë 01.08.2022, është hartuar një kontratë dhurimi për kryerjen e këtij shërbimi nga shoqëria “I ” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3921. Në dosje administrohet Akti i kolaudimit me datë 12.08.2022.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim me datë 23.08.2022, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesit e investitorit, z. N.SH (Drejtor i Arsimit), M.D dhe B.B me profesion inxhinier dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. P.N .

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, është dhënë leje rindërtimi me Vendimin nr. 10949/2, datë 17.06.2021.

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria “A. MK” ShPK , në Dhjetor 2020.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 18.06.2021 dhe kanë përfunduar me datë 18.04.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve, përfshirë amendamentin e kontratës për shtyrjen e afatit të përfundimit të punimeve.

- Nga auditimi i dosjes teknike, pas kërkesës së kontraktorit për përmirësime në projektin e objektit me datë 10.01.2022, rezulton se është hartua një relacion për ndryshimin e volumeve ndërmjet Mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve, që është pasuar me tabelën e volumeve faktike. Ky procesverbal është i shoqëruar nga tabela e ndryshimeve “Punimet që hiqen dhe shtohen”, ku janë shtuar/pakësuar 9,933,167 lekë. Në preventivin e rishikuar janë parashikuar 4 zëra të rinj. Procesverbali i negociimit të çmimeve të zërave të rinj, nuk është i nënshkruar nga Investitori.

- Nga auditimi i dokumentacionit të administruar në dosje, rezultoi se zëri “rrethim i përkohshëm me kollona b/a + rrjet teli” me vlerë të situacionuar 582,939 lekë, nuk është realizuar sipas emërtimit, por me llamarinë të valëzuar dhe binarë druri.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

| Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rindërtimi i konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë | | | | |
|---|--|--|---|------------------------------|
| 14.Lidhja e kontratës Nr. 23131/24 prot., datë 31.03.2021 | 15.Vlera e kontratës (pa tvsh) 151,500,000.3 lekë BOE fitues “G” SHPK & “E” ShPK | | 16.Likuiduar deri dt | |
| 17- Situacioni Përfundimtar Vlera me tvsh 151,499,856 lekë | 18.Afati i kontratës në dite Parashikuar 244 ditë, Zbatuar 304 ditë. Fillimi punimeve: 18.06.2021 Përfundimi punimeve : 18.04.2022 | | 19. Zgjatja e kontratës Amendamenti nr. 411/3, datë 17.01.2022, për shtyrje afati të punimeve me 60 ditë (deri në dt. 18.04.2022) | |
| 20. Mbikëqyrësi i punimeve BOE “M” ShPK & “P” ShPK | Licenca Nr: MK. 3119/5 | Shkresa me nr. 1725/35 prot., datë 12.04.2021 | Likuiduar lekë | Pa likuiduar |
| 21. Kolaudatori i punimeve “I” ShPK | Licenca Nr: MK 3921 | Shkresa me nr. 11049/2 prot., datë 01.08.2022 | Likuiduar (.....lekë) | Pa likuiduar (..... lekë) |
| 22.Akt Kolaudimi Datë 12.08.2022 | 23.Akt i marrjes në dorëzim dt 23.08.2022 | | 24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat) | |

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **1,662,032 lekë pa tvsh.**

Tabela nr. 1

| | Nr | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|------------|--|----------------|-----------------|-------------------------|----------------|-------------|----------------|-------------------------|
| | | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | 3 | Punime mur tulla | | | | | | | |
| 1 | 2 | Mure tulle me 8 vrima , t=10 cm, h~3m, ll.p.M-15 | m ³ | 11,000 | 313.69 | 313.69 | 262 | 51.69 | 568,590 |
| | 4 | Punime betoni dhe b/a | | | | | | | |
| 2 | 1 | Shtresë betoni C 12/15 | m ³ | 8500 | 69.97 | 69.67 | 54.07 | 15.6 | 132,600 |
| 3 | 6 | Kolona b/a C 25/30 h~4 m | m ³ | 17000 | 71.56 | 71.57 | 64.12 | 7.44 | 126,480 |
| | 6 | Punime hidroizolimi dhe çatie | | | | | | | |
| 4 | 1 | H/izolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresa kk | m ² | 11000 | 1175.68 | 1175.68 | 1127.38 | 48.3 | 531,000 |
| | 8 | Punime tavani e suvatimi | | | | | | | |
| 5 | 3 | Plintuse pllake grez, h=10 cm, çmimi | ml | 240 lekë/ml | 1598 | 1598 | 221 lekë/ml | 19 lekë/ml | 30,362 |
| | 12B | Sistemi i fuqisë, ndriçimit | | | | | | | |
| 6 | 40 | FV ndiçues tavanor LED 18 – 20 Ë | copë | 13000 | 177 | 177 | 156 | 21 | 273,000 |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | Total | <u>1,662,032</u> |

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Zëri 3.2. Mure tulle me 8 vrima , t=10 cm, h~3m, ll.p.M-15. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 293.3 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 313.69 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 313.69 m³, i detajuar sipas mureve, me gjatësi dhe lartësi të ndryshueshme. Nga verifikimi i librit të masave, projektit të azhurnuar dhe verifikimit në terren, rezulton se nuk janë zbritur 51.69 m³ brezat b/a të realizuar në lartësinë 1.2 m nga dyshemeja për çdo mur tulle. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 262 m³, ose 51.69 m³, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri 4.1. Shtresë betoni C 12/15. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 72.37 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 69.67 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 69.67 m³, i detajuar si shtresë nën themel sipas themeleve, me gjatësi të ndryshueshme dhe gjerësi 2.5 m e me trashësi të 0.1 m. Nga verifikimi i librit të masave, projektit të azhurnuar dhe verifikimit në terren, rezulton se gjerësi e themelit është 1.4 m dhe gjerësia e shtresës duhej llogaritur 1.8 m. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 54.07 m³, ose 15.6 m³, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri 4.6. Kolona b/a C 25/30 h~4 m. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 172.45 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 71.56 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 71.56 m³, i detajuar për të gjitha tipet e kolonave. Nga verifikimi i librit të masave dhe projektit të azhurnuar, rezulton se është marrë 2 herë kolona K1 në të gjitha katet. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 64.12 m³, ose 7.44 m³, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

4. Zëri 6.1. H/izolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresa kk. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 1579 m². Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 1175.68 m². Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 1175.68 m², i detajuar për themelet dhe tarracën. Nga verifikimi i librit të masave, projektit të azhurnuar dhe verifikimit në terren, rezulton se tarraca është situacionuar me volumin 575.1 m² (43.9 m x 13.1 m) nga 526.8 m² (43.04 m x 12.24 m) që është sipas projektit të azhurnuar. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 1127.38 m², ose 48.3 m², më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

5. Zëri 8.3. Plintuse pllake grez, h=10 cm, çmimi. Nga verifikimi i librit të masave, situacionit përfundimtar dhe verifikimi në terren, rezulton se është situacionuar 1359 ml plintuse pllaka grez me h=10 cm, me çmim 220 lekë/ml, e cila nga verifikimi në terren rezulton të jetë h= 8 cm. Nga verifikimi i analizës së çmimit të këtij zëri pune, sipas manualit (2.324/a), rezulton se çmimi i nënzërit material në këtë zë pune, është 65 % e të gjithë zërit të punës. Nga rillogaritja, çmimi i këtij zëri pune është 221 lekë/ml (65% x 220 lekë/ml x 8cm/10cm + 35 % x 220 lekë/ml), ose 19 lekë/ml më pak se çmimi i situacionuar. Për pasojë, diferenca e çmimit prej 36 lekë/ml (për sasinë e plintuseve prej 1359 ml), është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

6. Zëri 12/B.40. FV ndiçues tavanor LED 18 – 20 Ë. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 177 copë. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 177 copë. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 177 copë, i detajuar sipas ambienteve. Nga verifikimi i librit të masave, projektit të azhurnuar dhe verifikimit në terren, rezulton se janë vendosur gjithsej 156 copë (përfshirë 4 copë të hequra), ose 21 copë, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Titulli i Gjetjes: Diferencë në çmim në objektin “Rindërtimi i konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë, nga zbatuesi i punimeve BOE “G ” SHPK & “E ” ShPK, për zërat e punimeve 3.2, 4.1, 4.6, 6.1, 8.3 dhe 12/B.40.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume në zërat e punës “Mure tulle me 8 vrima , t=10 cm, h~3m, ll.p.M-15”, “Kolona b/a C 25/30 h~4 m”, “H/izolim me emulsion bitumi dhe 2 shtresa kk”, “FV ndiçues tavanor LED 18 – 20 Ë”, “Plintuse pllake grez, h=10 cm, çmimi”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 23131/24 prot., datë 31.03.2021.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas shkresës me nr. 1725/35 prot., datë 12.04.2021.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas shkresës me nr. 11049/2 prot., datë 01.08.2022.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Lezhë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E lartë

Në mënyrë të përmbledhur për këtë investim rezultoi se **i janë likuiduar tepër në vlerën 1,662,032 lekë pa tvsh** sipërmarrësit të punimeve për punime të pakryera, vlerë kjo e cila përbën dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. P.M , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. M.P , me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

2. “Rehabilitimi i murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë”, Bashkia Lezhë

Kontratat

Objekti i mësipërm është kryer sipas kontratës me nr. 14300/12 prot., datë 29.09.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lezhë, të përfaqësuar nga Kryetari z. P.N dhe të BOE “Z ShPK & “A CO” ShPK, me përfaqësues ligjor respektivisht z. Z.Z dhe z.A.GJ me licencë profesionale NZ 2407/13. Vlera e kontratës është 22,363,882.38 lekë me TVSh. Afati i zbatimit të kontratës është përcaktuar periU kohore tre muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Me shkresën nr. 411/3, datë 17.01.2022 është bërë amendamenti për shtyrje afati të punimeve me 60 ditë (deri në 18.04.2022), për arsye të vonesave në procedurën e përjashtimit nga TVSh dhe të pandemisë Covid-19.

Për mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit, sipas kontratës me nr. 16380/7 prot, datë 12.10.2022, është caktuar për kryerjen e këtij shërbimi OE “N ” ShPK, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 3101/12 dhe me vlerë të kontratës 451,605.6 lekë.

Për kolaudimin e punimeve të ndërtimit, sipas shkresës me nr. 2687/1, datë 06.03.2023, është hartuar një kontratë dhurimi për kryerjen e këtij shërbimi nga ing. N.M PF, me nr. licence për mbikëqyrje kolaudim punimesh MK. 0992/3 dhe me vlerë konrate 113,940 lekë. Në dosje administrohet Akti i kolaudimit me datë 16.03.2023.

Në dosjen teknike administrohet certifikata për marrjen provizore në dorëzim me datë 23.03.2023, e nënshkruar nga përfaqësuesit e sipërmarrësit, mbikëqyrësit dhe kolaudatorit, si dhe nga përfaqësuesit e investitorit, z. A.M , E.S dhe A.S dhe të miratuara nga Kryetari i Bashkisë z. P.N .

Projektpreventivi

- Për këtë objekt, është miratuar Deklarata për kryerje punimesh me Vendimin nr. 508, datë 01.11.2022.

- Projekti i zbatimit dhe preventivi është hartuar nga shoqëria “N ” ShPK , në Prill 2022.

Zbatimi i punimeve

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion rezulton se punimet kanë nisur me datë 01.11.2022 dhe kanë përfunduar me datë 27.12.2022, ose brenda afatit kontraktual të përfundimit të punimeve.

- Nga auditimi i dosjes teknike, pas kërkesës së kontraktorit për përmirësime në projektin e objektit me datë 17.11.2022, rezulton se është hartuar një relacion për ndryshimin e volumeve ndërmjet Mbikëqyrësit dhe sipërmarrësit të punimeve, që është pasuar me tabelën e volumeve faktike. Ky procesverbal është i shoqëruar nga tabela e ndryshimeve “Punimet që hiqen dhe shtohen”, ku janë shtuar 1,498,260 lekë dhe pakësuar 614,008 lekë, duke u përdorur fondi rezervë prej 887,455.65 lekë.

- Në zbatim të programit, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Projekt i zbatimit, projekti i azhurnuar
2. Preventivi bazë dhe i ndryshuar,
3. Situacionet pjesore dhe Situacioni përfundimtar,
4. Libreza e masave,
5. Ditarit të punimeve, etj.

| Zbatimi i Kontratës së Punimeve "Rehabilitimi i murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë", Bashkia Lezhë | | | | |
|--|---|---|---|------------------------------|
| 14. Lidhja e kontratës Nr. 14300/12 prot, datë 29.09.2022 | 15. Vlera e kontratës (me tvsh) 22,363,882.38 lekë BOE fitues "Z ShPK & "A CO" ShPK | | 16. Likuiduar deri dt | |
| 17- Situacioni Përfundimtar Vlera me tvsh 22,360,038 lekë Vlera pa tvsh 18,633,365 lekë | 18. Afati i kontratës në dite Parashikuar 92 ditë, Zbatuar 90 ditë. Fillimi punimeve: 01.11.2022 Përfundimi punimeve : 27.12.2022 | | 19. Zgjatja e kontratës Nuk ka | |
| 20. Mbikëqyrësi i punimeve OE "N" ShPK | Licenca Nr: MK. 3101/12 | Shkresa me nr. 16380/7 prot, datë 12.10.2022 | Likuiduar lekë | Pa likuiduar |
| 21. Kolaudatori i punimeve Ing. N.M PF | Licenca Nr: MK 0992/3 | Shkresa me nr. 2687/1, datë 06.03.2023 | Likuiduar (.....lekë) | Pa likuiduar (..... lekë) |
| 22. Akt Kolaudimi Datë 16.03.2023 | 23. Akt i marrjes në dorëzim dt 23.03.2023 | | 24. Fletë Hyrja Nr.... datëlekë (për mallrat) | |

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan diferenca në volume apo punime jo të kryera në përputhje me projektin e hartuar nga projektuesi e të miratuar nga Autoriteti Kontraktor, me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore në vlerën **201,434 lekë pa tvsh.**

Tabela nr. 1

| | Nr | Zëri i punimeve | Njësia | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|---|------------|---|----------------|-----------------|-------------------------|----------------|-------|----------------|-----------------------|
| | | | | | | | | Vol. | Vlera |
| | I | Punime dheu | | | | | | | |
| 1 | 1 | Gërmim dheu me eskavator | m ³ | 280 | 431 | 461 | 135 | 296 | 82,880 |
| | II | Punime mbrojtje me pilota | | | | | | | |
| 2 | 5 | FV hekur betoni i zakonshëm Ø>12 mm (trau lidhës) | ton | 149,000 | 8.181 | 8.181 | 8.035 | 0.146 | 21,754 |
| | III | Punime KUZ | | | | | | | |
| 3 | 7 | Shtresë beoni C 12/15 për riparim pusetash | m ³ | 8000 | 14.4 | 14.4 | 2.3 | 12.1 | 96,800 |
| | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | Total | <u>201,434</u> |

Diferencat e volumeve janë të argumentuara si më poshtë:

1. Zëri I.1. Gërmim dheu me eskavator goma 0.25 m³. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 320 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 431 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 461 m³, i detajuar sipas mureve, në të dy akset. Nga verifikimi i librit të masave, projektit bazë dhe projektit të azhurnuar, rezulton se ky volum, është llogaritur për gjatësi 39 m x 4.6 m gjerësi x 1.2 m lartësi, në aksin 1-1, nga 23 m që është në fakt (gjatësia e murit 20.19 m) x 2.5 m gjerësi x 1.2 m lartësi dhe 32 m x 4.8 m gjerësi x 1.2 m lartësi, në aksin 2-2, nga 22 m që është në fakt (gjatësia e murit 19.3 m) x 2.5 m gjerësi x 1.2 m lartësi. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 135 m³, ose 296 m³, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfutur padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

2. Zëri II.5. FV hekur betoni i zakonshëm Ø>12 mm (Trau lidhës). Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 6.52 ton. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 8.181 ton. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 8.181 ton, i detajuar për shufrat gjatësore të trarëve me Ø=25 mm dhe stafave me Ø=12 mm. Nga verifikimi i librit të masave, projektit bazë dhe projektit të azhurnuar, rezulton se gjatësia e

stafave të vogla është marrë gabim (130 cm ng 110 cm dhe 143 cm nga 123 cm, duke shtuar me 80 cm gjatësinë e çdo stafe. Nga rillogaritja për 40.5 ml tra lidhës me 5 stafa/ml volumi i këtij zëri pune është 8.039 ton, ose 0.142 ton më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

3. Zëri III.7. Shtresë beoni C 12/15 për riparim pusetash. Në preventivin bazë sasia e këtij zëri pune është 0.4 m³. Në preventivin e rishikuar dhe situacionin përfundimtar, ky zë pune figuron në sasinë 14.4 m³. Në librin e masave volumi i këtij zëri pune është 14.4 m³, i detajuar për 4 pusetat (1 m x 1 m x 0.1 m) dhe riparim rruge 35 ml me gjerësi 4 m dhe trashësi 0.1 m. Nga verifikimi i librit të masave, projektit bazë dhe projektit të azhurnuar, rezulton se volumi i riparimit të rrugës duhej llogaritur për gjerësinë e gërmimit 0.55 m. Nga rillogaritja, volumi i këtij zëri pune është 2.3 m³, ose 12.1 m³, më pak se volumi i situacionuar. Për pasojë, vlera e këtij volumi është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Titulli i Gjetjes: Diferencë në çmim në objektin “Rehabilitimi i murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë”, Bashkia Lezhë, nga zbatuesi i punimeve BOE “Z ShPK & “A CO” ShPK, për zërat e punimeve I.1, II.5 dhe III.7.

Situata: Nga auditimi i realizimit të punimeve në objekt, u konstatua se:

-Ka patur diferenca në volume në zërat e punës “Gërmim dheu me eskavator goma 0.25 m³”, “FV hekur betoni i zakonshëm Ø>12 mm (Trau lidhës)” dhe “Shtresë beoni C 12/15 për riparim pusetash”, për pasojë vlera e këtyre diferencave janë përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri: Situacionimi i volumeve jo në përputhje me projektpreventivin dhe faktin, veprime të cilat nuk janë në përputhshmëri me:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 14300/12 prot., datë 29.09.2022.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas shkresës me nr. 16380/7 prot, datë 12.10.2022.

- Kontratën e shërbimit të kolaudimit të punimeve, sipas shkresës me nr. 2687/1, datë 06.03.2023.

Ndikimi: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar dëm ekonomik në fondet e Bashkisë Lezhë.

Shkaku: Neglizhencë nga ana e mbikëqyrësit dhe kolaudatorit të punimeve në verifikimin e zbatimit të projektpreventivit.

Rëndësia: E ulët

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi:

1. Z. V.B , me detyrë mbikëqyrës i kontratës së sipërmarrjes;
2. Znj. N.M , me detyrë kolaudator i punimeve të përfunduara;

3. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt:

“Riforcimi dhe Rikonstruksioni i Bibliotekës “Gjergj Fishta” dhe Pallati i Kulturës “Dedë Ndue Lazri””, me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

| | | |
|---|--|---|
| 13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Riforcimi dhe Rikonstruksioni i Bibliotekës “Gjergj Fishta” dhe Pallati i Kulturës “Dedë Ndue Lazri”” Bashkia Lezhë. (REF-09565-10-26-2021) | | |
| 14.Lidhja e kontratës Nr. 18530/2 Prot., datë 21.01.2022 OE “J” SHPK | 15.Vlera e kontratës Vl e prev ofertues 236,725,554 lekë pa TVSh. Biblioteka “Gjergj Fishta”: | 16.Likuiduar: Biblioteka “Gjergj Fishta”: Sit. 1 në vlerën 23,916,267 lekë pa TVSH Sit. 2 në vlerën 9,943,517 lekë pa TVSH Sit. 3 në vlerën 68,238,450 lekë pa TVSH |

| | | |
|--|---|---|
| | VI e prev ofertues 111,890,699 lekë pa TVSH. Pallati i kulturës “Dedë Ndue Lazri”: VI e prev ofertues 124,834,855 lekë pa TVSH. | Sit. 4 në vlerën 7,127,849 lekë pa TVSH Sit. Nr. 5 Përf. në vlerën 2,664,598 lekë pa TVSH Pallati i kulturës “Dedë Ndue Lazri”: Sit. 1 në vlerën 25,741,057 lekë pa TVSH Sit. 2 në vlerën 3,294,432 lekë pa TVSH Sit. 3 në vlerën 86,024,091 lekë pa TVSH Sit. 4 në vlerën 7,671,410 lekë pa TVSH Sit. Përf. në vlerën 2,106,807 lekë pa TVSH |
| 17- Situacioni Përfundimtar Biblioteka “Gjergj Fishta”: Sit. Nr. 5 Përf. në vlerën 2,664,598 lekë pa TVSH Pallati i kulturës “Dedë Ndue Lazri”: Sit. Përf. në vlerën 2,106,807 lekë pa TVSH | 18. Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 20.04.2022 Përfundimi punimeve: 28.03.2023 | 19. Zgjatja e kontratës Sipas aktit datë 03.05.2022, shtyhet afati me 4 (katër) muaj. |
| 20. Mbikëqyrësi i punimeve. BOE “P & H” & S SHPK | Licenca Nr: MK.3788 Licenca Nr. MK. 2018/20 Licenca Nr. MK.2992/16 | Kontratë nr. 669/15 prot., datë 01.03.2022 |
| 21. Kolaudatori i punimeve OE “A.-S.” SHPK | Licenca Nr: MK.1544/2 | Kontratë nr. 16480/1 prot., datë 31.10.2023 |
| 22. Akt Kolaudimi. Datë: 06.11.2023 | 23. Akt i marrjes në dorëzim: Me nr. 16480/2 prot., datë 10.11.2023. Nga Kryetari i Bashkisë Lezhë është ngritur grupin epunë për marrjen në dorëzim të objektit me përbërje: A.L , R.XH dhe B.B. | |

ku rezultoi me gjetjet dhe rekomandimet, si vijon:

► **Titulli i Gjetjes:** Punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike në objektin “Riforcimi dhe Rikonstruksioni i Bibliotekës “Gjergj Fishta” dhe Pallati i Kulturës “Dedë Ndue Lazri”.

Përshkrimi i situatës:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të kryera jo në përputhshmëri me Specifikimet Teknike, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën **464,289 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

I. Objekti “Pallati i Kulturës “Dedë Ndue Lazri”.

-Zëri (2.209/b) Ulluk shkarkimi vertikal bakri Ø 80-120 mm, është realizuar në gjatësinë 127.63 ml, nuk konsiderohet punë e pakryer sipas kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike dhe për pasojë vlera **375,360 lekë pa TVSH** [127.63 ml x **2,941** lekë (3634 lekë sipas situacionit – 693 lekë sipas faktit)] është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve

-Zëri (2.206/b). Kasetë shkarkimi bakri për ullukun t=1 mm, pse është realizuar në volumin e situacionuar, konstatohet se është realizuar me kosto më të ulët dhe, nuk konsiderohet punë e pakryer sipas kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike dhe, për pasojë vlera **12,463 lekë pa TVSH** [11 copë x **1,133** lekë (2,176 lekë sipas situacionit – 1,043 lekë sipas faktit)] është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

II. Objekti “Biblioteka “Gjergj Fishta”.

Punime tarrace.

-Zëri 8(2.209/b) Ulluk shkarkimi vertikal bakri Ø 80-120 mm, është realizuar në gjatësinë 26 ml, nuk konsiderohet punë e pakryer sipas kushteve të kontratës dhe specifikimeve teknike dhe për pasojë vlera **76,466 lekë pa TVSH** [26 ml x **2,941** lekë (3634 lekë sipas situacionit – 693 lekë sipas faktit)] është përfituar padrejtësisht nga sipërmarrësi i punimeve.

Kriteri:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.

- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.

- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 18530 prot., datë 21.01.2022.

- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 669/15 prot., datë 01.03.2022.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Lezhë .

Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: I lartë.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi: Z. D.K , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

4. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë”, me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

| 13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë” Bashkia Lezhë. (REF-26273-04-25-2022) | | |
|---|--|---|
| 14.Lidhja e kontratës Nr. 17043/3 Prot., datë 21.10.2022 OE “U ” SHPK | 15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 151,802,481.06 lekë pa TVSh. | 16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 15,180,248.16 lekë me TVSH Sit. 2 në vlerën 94,445,430.10 lekë me TVSH Sit. 3 në vlerën 42,176,759.78 lekë pa TVSH Sit. Përf. në vlerën 43,310,219 lekë pa TVSH |
| 17- Situacioni Përfundimtar Sit. Përf. në vlerën 42,176,759.78 lekë me TVSH | 18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 09.12.2022 Përfundimi punimeve: 07.04.2022 | 19. Zgjatja e kontratës 4 (katër) muaj. |
| 20. Mbikëqyrësi i punimeve. OE “M ” SHPK | Licenca Nr: MK.3119/8 | Kontratë Nr. 16879/18 Prot., datë 24.11.2022 |
| 21. Kolaudatori i punimeve OE “P. G.” SHPK | Licenca Nr: MK.3788/2 | Kontratë nr. 16802/1 prot., datë 07.11.2023 |
| 22.Akt Kolaudimi. Datë: 13.11.2023 | 23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 21.11.2022. Grupi i punës për marrjen në dorëzim sipas Urdhrit me nr. 433, datë 14.11.2023, me përbërje: E.Z , A.M dhe I.T . | |

ku rezultoi me gjetjen dhe rekomandimin, si vijon:

► **Titulli i Gjetjes:** Punime ndërtimi të kryera jo në volumet e situacionuara si dhe, punime të kryera pa cilësi në objektin “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë”.

Përshkrimi i situatës:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën **434,804 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

Situata 1:

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve në objektin: “Sistemim asfaltim rruga Dragushë-Mabe” u konstatua se rruga “Dragushë-Mabe Daje” u konstatuan dëmtime të rrugës ku shtresa e binderit është dëmtuar në sipërfaqen 50 m² në vlerën **82,500 lekë pa TVSH** (50 m²*1650 lekë) + stabilizant 50 m² në vlerën **22,000 lekë pa TVSH** (50 m²*440 lekë). Pra në total: dëmtim i rrugës në vlerën **104,500 lekë**.

Situata 2:

Nga auditimi mbi zbatimin e punimeve në rrugëve sipas preventivit, u konstatua se janë librezuar dhe situacionuar volume tepër në zbatimin e zërit “Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri” dhe. “Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri”, konkretisht, sipas tabelës:

| Nr Anal | Zëri i punimeve | Njësi a | Çmimi i ofertës | Situacioni përfundimtar | Libri i masave | Fakti | Diferenca në + | |
|------------|---|----------------|-----------------|-------------------------|----------------|----------|----------------|----------------|
| | | | | | | | Vol. | Vlera |
| I. | Sistemim dhe asfaltim i rrugës Dragushë-Mabe | | | | | | | |
| 4(3.2 211) | Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri | m ² | 480 | 7008.6 4 | 7008.6 4 | 6,908.6 | 100 | 48,000 |
| I. | Sistemim dhe asfaltim i rrugës në te Lagjes Gjader | | | | | | | - |
| 4(3.2 211) | Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri | m ² | 480 | 2111.5 7 | 2111.5 7 | 2,036.57 | 75 | 36,000 |
| | Sistemim dhe asfaltim i rrugës së shkollës Kolsh – Gryk Zezë | | | | | | | - |
| 4(3.2 11) | Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri | m ² | 480 | 5132.6 6 | 5132.6 6 | 5,042.66 | 90 | 43,200 |
| | Sistemim dhe asfaltim i rrugës së rrugës së Lumnajës | | | | | | | - |
| 4(3.2 11) | Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri | m ² | 480 | 2727.8 | 2727.8 | 2,647 | 80.8 | 38,784 |
| | Sistemim dhe asfaltim i rrugës “Gentjan Marku”, Piraj-Blinisht | | | | | | | - |
| 4(3.2 11) | Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri | m ² | 480 | 7301 | 7301 | 7,206 | 95 | 45,600 |
| | Sistemim dhe asfaltim i rrugës së Gazullorve | | | | | | | - |
| 4(3.2 11) | Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri | m ² | 480 | 2118 | 2118 | 2,048 | 70 | 33,600 |
| | Sistemim dhe asfaltim i rrugës së Varrezave, Daç. | | | | | | | - |
| 4(3.2 11) | Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=20 cm, përhapur e ngjeshur me makineri | m ² | 480 | 2394 | 2394 | 2,300 | 94 | 45,120 |
| | Sistemim dhe asfaltim i rrugëve të lagjes, Shënkoll. | | | | | | | - |
| 4(3.2 10) | Shtresë çakëlli mbeturinë kave t=15 cm, përhapur e ngjeshur me makineri | m ² | 400 | 8586.3 2 | 8586.3 2 | 8,486.32 | 100 | 40,000 |
| | Totali në lekë pa TVSH | | | | | | | 330,304 |

Kriteri:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 17043/3 prot., datë 21.10.2022.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 16879/18 prot., datë 24.11.2022.

Ndikimi/Efekt:

Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Lezhë .

Shkaku:

Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia:

I lartë.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi: Z. P.M , në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

5. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: ““Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në territorin e Bashkinë Lezhë Loti II”, me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

| | | |
|---|--|--|
| 13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në territorin e Bashkinë Lezhë Loti II” Bashkia Lezhë. (REF-93502-04-19-2021) | | |
| 14.Lidhja e kontratës Nr. 7534 Prot., datë 14.06.2021 BOE “R ” & “D ” SHPK | 15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 92,410,112 lekë pa TVSh. | 16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 16,011,150 lekë pa TVSH Sit. 2 në vlerën 20,017,350 lekë pa TVSH Sit. 3 në vlerën 16,931,931 lekë pa TVSH Sit. 4 në vlerën 14,040,968 lekë pa TVSH Sit. 5 në vlerën 6,181,356 lekë pa TVSH Sit. 6 në vlerën 18,764,424 lekë pa TVSH Sit. Përf. në vlerën 5,778,095 lekë pa TVSH |
| 17- Situacioni Përfundimtar - 91,543,917 lekë pa TVSH | 18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 13.08.2021 Përfundimi punimeve: 14.04.2022 | 19. Zgjatja e kontratës 4 (katër) muaj. |
| 20. Mbikëqyrësi i punimeve. OE “M ” SHPK | Licenca Nr: MK.3119/5 | Kontratë Nr. 9559/22 Prot., datë 03.08.2021 |
| 21. Kolaudatori i punimeve OE “F ” SHPK | Licenca Nr: MK.3429/1 | Kontratë nr. 12212/1 prot., datë 30.06.2022 |
| 22.Akt Kolaudimi. Datë: --.2022 (Akti i kolaudimit nuk ka datë dhe muaj) | 23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 04.07.2022. | |

ku rezultoi me gjetjen dhe rekomandimin, si vijon:

- **Titulli i Gjetjes:** Punime ndërtimi të kryera jo në volumet e situacionuara në objektin “Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në territorin e Bashkinë Lezhë Loti II”.

Përshkrimi i situatës:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën **529,200 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

I. Banesa 57, rruga Gjergj Fishta, lagjia Gurra.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, duke u përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **79,460 lekë pa TVSH**.

II. Banesa 55, rruga Gjergj Fishta, lagjia Gurra.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, duke u përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **30,015 lekë pa TVSH**.

III. Banesa 50, rruga Gjergj Fishta, lagjia Besëlidhja.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në

likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **63,760 lekë pa TVSH.**

IV. Banesa 47-51, rruga Gjergj Fishta, lagjia Gurra.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **109,380 lekë pa TVSH.**

V. Banesa 46, rruga Gjergj Fishta, lagjia Beslidhja.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **56,130 lekë pa TVSH.**

VI. Banesa 39, rruga Gjergj Fishta, lagjia Gurra.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **33,440 lekë pa TVSH.**

VII. Banesa 35, rruga Gjergj Fishta, lagjia Gurra.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **31,570 lekë pa TVSH.**

VIII. Banesa 31, rruga Gjergj Fishta, lagjia Gurra.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **37,860 lekë pa TVSH.**

IX. Banesa 4, rruga Gjergj Fishta, lagjia Gurra.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **44,755 lekë pa TVSH.**

X. Banesa 2, rruga Gjergj Fishta, lagjia Gurra.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **42,630 lekë pa TVSH.**

Kriteri:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 7534/21 prot., datë 14.06.2021 .
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 9559/22 prot., datë 03.08.2021.

Ndikimi/Efekt: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Lezhë .

Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: I lartë.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi: **Z. P.M**, në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

6. Nga auditimi i zbatimit të punimeve për kontratën me objekt: **“Rikonstruksionin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Bashkinë Lezhë”**, me të dhëna të përgjithshme pasqyruar në tabelën e mëposhtme,

| | | |
|---|--|--|
| 13. Zbatimi i Kontratës së Punimeve “Rikonstruksionin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Bashkinë Lezhë” Bashkia Lezhë. (REF-83518-12-30-2020) | | |
| 14.Lidhja e kontratës Nr. 23034 Prot., datë 18.02.2021 BOE “U & N ” SHPK | 15.Vlera e kontratës VI e prev ofertues 211,461,570 lekë pa TVSh. | 16.Likuiduar: Sit. 1 në vlerën 38,441,070 lekë pa TVSH Sit. 2 në vlerën 46,094,070 lekë pa TVSH Sit. 3 në vlerën 37,714,468 lekë pa TVSH Sit. 4 në vlerën 43,310,219 lekë pa TVSH Sit. Përf. në vlerën 45,901,743 lekë pa TVSH |
| 17- Situacioni Përfundimtar Sit. Përf. në vlerën 45,901,743 lekë pa TVSH | 18.Afati i kontratës në dite Fillimi punimeve: 09.04.2021 Përfundimi punimeve: 18.05.2022 | 19. Zgjatja e kontratës 4 (katër) muaj. |
| 20. Mbikëqyrësi i punimeve. OE “H ” SHPK | Licenca Nr: MK.2018/18 | Kontratë Nr. 1901 Prot., datë 16.03.2021 |
| 21. Kolaudatori i punimeve OE “T ” SHPK | Licenca Nr: MK.3891/1 | Kontratë nr. -- prot., datë ----- |
| 22.Akt Kolaudimi. Datë: 21.12.2022 | 23.Akt i marrjes në dorëzim: Me datë 23.12.2022. | |

ku rezultoi me gjetjen dhe rekomandimin, si vijon:

► **Titulli i Gjetjes:** Punime ndërtimi të kryera jo në volumet e situacionuara në objektin “Rikonstruksionin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Bashkinë Lezhë”.

Përshkrimi i situatës:

Nga auditimi i situacionit përfundimtar, projektit dhe preventivit bazë, preventivit të rishikuar, si dhe nga verifikimi në terren i punimeve të ndërtimit, lidhur me volumet e punës të situacionuara si dhe atyre të kryera në fakt, rezultuan punime të pa kryera në volumet e situacionuara, me pasojë efekt negativ ndaj buxhetit të shtetit, në vlerën **484,326 lekë pa TVSH**, argumentuar si vijon:

I. Objekti nr. 19 Lagjia Gurra, rruga Kol Toma.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, duke u përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **96,220 lekë pa TVSH**.

Objekti Nr. 11, në lagjen Gurra rruga Tom Kola.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, duke u përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **60,390 lekë pa TVSH**.

Objekti Nr. 6, në lagjen Gurra rruga Mbreti Gent.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **5,190 lekë pa TVSH**.

Objekti Nr. 4, në lagjen Gurra rruga Mbreti Gent.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në

likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **6,306 lekë pa TVSH.**

Objekti Nr. 2, në lagjen Gurra rruga Mbreti Gent.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **6,245 lekë pa TVSH.**

Objekti Nr. 8, në lagjen Gurra rruga Princat e Kuvendit.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **64,365 lekë pa TVSH.**

Objekti Nr. 14, në lagjen Gurra rruga Princat e Kuvendit.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **60,675 lekë pa TVSH.**

Objekti Nr. 5, në lagjen Gurra rruga Princat e Kuvendit.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **59,420 lekë pa TVSH.**

Objekti Nr. 2, në lagjen Gurra rruga Kosova.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **88,685 lekë pa TVSH.**

Objekti Nr. 42, në lagjen Gurra “Luigj Gurakuqi”.

Nga auditimi në objekt u konstatua se: Zëri “Suva me llaç special dhe rrjetë përforcuese me fibra xhami” nuk është realizuar me **rrjetë përforcuese me fibra xhami**, përfituar në likuidimin e situacionit përfundimtar, në mënyrë ta parregullt nga sipërmarrësi i punimeve në vlerën **36,830 lekë pa TVSH.**

Kriteri:

- Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12.
- Udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit” e konkretisht Kreu II, Pika 3.
- Kontratën e sipërmarrjes së punimeve sipas aktit me nr. 23034/22 prot., datë 18.02.2022.
- Kontratën e shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve sipas aktit me nr. 1901/22 prot., datë 16.03.2021.

Ndikimi/Efekti: Si pasojë e mangësive të mësipërme, është shkaktuar efekt negativ në fondet e Bashkisë Lezhë .

Shkaku: Mos realizim zëra pune ndërtimi në volumet e situacionuara.

Rëndësia: I lartë.

Sa më sipër për veprimet dhe mosveprimet, ngarkohet me përgjegjësi: Z. F.B., në cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve.

Konkluzion i përgjithshëm mbi zbatimin e kontratave për punë publike:

Nga auditimi i 6 (gjashtë) kontratave për punë publike për periudhën e auditimit në vlerën totale 866,263,599 lekë pa TVSH, u konstatua se:

Në 6 (raste) raste, rezultuan zëra pune të pakryera në volumet e situacionuara si dhe, punime të realizuara jo në përputhje me specifikimet teknike në vlerën 3,776,085 lekë pa TVSH, në mospërputhje me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7, si dhe Kontratave përkatëse të zbatimit, respektivisht për:

- Vlera 1,662,032 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me kontratën me nr. 23131/24 prot., datë 31.03.2021 me objekt “Rindërtimi i konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka” Bashkia Lezhë , me sipërmarrës BOE “G ” SHPK & “E ” ShPK me ofertë 151,500,000 lekë me TVSH.

- Vlera 201,434 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me kontratën me nr. 14300/12 prot., datë 29.09.2022 me objekt “Rehabilitimi i murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë” Bashkia Lezhë , me sipërmarrës BOE “Z ShPK & “A CO” ShPK me ofertë 151,500,000 lekë me TVSH.

- Vlera 464,289 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me Specifikimet Teknik dhe kosto më të vogël se çmimi ofertues, në kontratën me nr. 18530/2 prot., datë 21.01.2022 me objekt “Riforcimi dhe Rikonstruksioni i Bibliotekës “Gjergj Fishta” dhe Pallati i Kulturës “Dedë Ndue Lazri” Bashkia Lezhë , me sipërmarrës shoqërinë “J ” SHPK me ofertë 236,725,554 lekë me TVSH.

- Vlera 434,804 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara si dhe, punime të kryera pa cilësi të mirë, në kontratën me nr. 17043/3 prot., datë 21.10.2022 me objekt “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë”, me sipërmarrës shoqërinë “U ” SHPK me ofertë 151,802,481.06 lekë me TVSH.

- Vlera 529,200 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, në kontratën me nr. 7534/21 prot., datë 14.06.2021 me objekt “Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në territorin e Bashkinë Lezhë Loti II”, me sipërmarrës shoqërinë JV “R ” & “D ” SHPK me ofertë 92,410,112 lekë me TVSH

- Vlera 484,326 lekë pa TVSH, përfaqëson dëm ekonomik për punime të kryera jo në përputhje me volumet e situacionuara, në kontratën me nr. 23034/22 prot., datë 18.02.2022 me objekt “Rikonstruksionin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Bashkinë Lezhë”, me sipërmarrës shoqërinë JV “U & N ” SHPK me ofertë 236,725,554 lekë me TVSH.

2.5 Mbi organizimin, funksionimin e planifikimit dhe zhvillimit të territorit

Bashkia Lezhë ka miratuar Planin e Përgjithshëm Vendor me Vendimin e KKT-së Nr.6, datë 16.10.2017.

Auditimi konsiston në këto fusha:

1. Dhënia e Lejes së Zhvillimit, krahasimi i dokumentacionit me kriteret e vendosura.
2. Dhënia e Lejes së Ndërtimit, dokumentacioni, krahasimi dhe zbatimi i treguesve parametrik.
3. Saktësia e llogaritjes së Taksës së Ndikimit në Infrastrukture.
4. Dhënia e Certifikatës së Përdorimit
5. Kontributi i sektorit privat në krijimin e fondit publik

LEJET E NDËRTIMIT, ZHVILLIMIT DHE PËRDORIMIT PËR PERIUdhËN
01.01.2022 - 31.12.2022

Duke u bazuar në sistemin e-Leje të lejeve të ndërtimit për Bashkinë Lezhë, për vitin 2022, në tabelën e mëposhtme janë pasqyruar të dhënat në lidhje me aplikimet sipas kategorive të lejeve:

| Aplikimet e lejeve të ndërtimit për periudhën 01.01.2022 – 31.12.2022 nga sistemi e-Leje | | | |
|---|--|---------------------------|---------------------------|
| Nr. | Përshkrimi i lejes | Numri i aplikimeve | Numri i miratimeve |
| 1 | Certifikatë përdorimi | 18 | 11 |
| 2 | Deklaratë paraprake për kryerje punimesh | 227 | 90 |
| 3 | Leje infrastrukture | 11 | 7 |
| 4 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ² | 46 | 20 |
| 5 | Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni | 19 | 10 |
| 6 | Leje për ndryshim funksioni | 17 | 13 |
| 7 | Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit | 9 | 2 |
| 8 | Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues | 10 | 8 |
| 9 | Leje përshtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit | 14 | 4 |
| 10 | Leje rind., rikonstr dhe riparimi të nd. së dëmtuar pa shtim/ndryshim funksioni | 95 | 31 |
| 11 | Leje zhvillimi | 57 | 30 |
| 12 | Njoftim për fillim punimesh | 58 | 51 |
| 13 | Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues | 4 | 0 |
| 14 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m ² | 15 | 1 |
| 15 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri, me sipërfaqe më të madhe se 250 m ² | 6 | 5 |
| 16 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m ² | 2 | 1 |
| 17 | Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni | 2 | 2 |

Duke ju referuar sistemit e-Leje për lejet e ndërtimit dhe në bazë informacioneve që janë vendosur në dispozicion nga Bashkia Lezhë, gjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022 janë miratuar **30 leje zhvillimi**, **5 leje ndërtimi** me sipërfaqe më të madhe se 250 m², **20 leje ndërtimi** me sipërfaqe deri në 250 m², **1 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m², **1 leje ndërtimi** për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe deri në 250 m², **31 leje rindertimi**, rikonstruksioni dhe riparimi të ndërtesës së dëmtuar pa shtim apo ndryshim funksioni, **11 certifikata përdorimi**, **90 deklarata paraprake** për kryerje punimesh dhe **7 leje infrastrukture**.

Bashkëngjitur pasqyrohet tabela e vendosur në dispozicion nga Bashkia Lezhë, për lejet e ndërtimit me sipërfaqe më të madhe se 250 m², të miratuara gjatë vitit 2022.

| Nr. | Emërtimi i lejes | Zhvillues | Nr. Prot. | Sipërfaqe | Data e Lejes | Preventivi |
|------------|--|------------------|------------------|------------------|---------------------|-------------------|
| 1 | Magazine per grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqesore 1 kat dhe mur rrethues, Gajush , Shenkoll, Lezhe | SH shpk | 2009 | 859.20 | 13.05.2022 | 9°7'19'455 |
| 2 | Banese nje familjare, Gryke, Kolsh, Lezhe | P.D | 2573 | 286.00 | 07.04.2022 | 9°0'19'019 |
| 3 | Banese 2 kat, Ishull-Shengjin, Shengjin, Lezhe | A.GJ | 2847 | 344.40 | 10.05.2022 | 10°7'96'161 |
| 4 | Salle eventesh 1 kat, Ishull-Lezhe, Shengjin, Lezhe | P.GJ | 17445 | 1060.00 | 19.12.2022 | 23°281'423.00 |

| | | | | | | |
|---|--|-----|-------|--------|------------|----------------|
| 5 | Strukture 4 kate, Ishull-Shengjin, Shengjin, Lezhe | S.C | 18830 | 547.92 | 13.02.2023 | 19°8'13"585.78 |
|---|--|-----|-------|--------|------------|----------------|

Në bazë të analizës së riskut dhe shqyrtimit rast pas rasti në tipologji të ndryshme të ndërtimit, më poshtë janë trajtuar rastet në të cilat janë konstatuar problematika.

| Nr. | Emërtimi i Lejes | Zhvillues | Nr. Prot. | Data e Lejes | Preventivi |
|-----|--|--------------------|-------------------|-----------------|----------------|
| 1 | “Magazinë për grumbullimin dhe ruajtjen e produkteve bujqësore 1 kat dhe mur rrethues” | P.SH dhe E.SH | Nr.2009/6 Prot. | Datë 18/05/2022 | 9,719,455 lekë |
| 2 | "Sallë eventesh 1 kat", me adresë në Ishull-Lezhë, Nj. Adm. Shëngjin, Bashkia Lezhë | P.GJ dhe znj. D.GJ | Nr. 17445/5 Prot; | datë 19.12.2022 | 22,603,379 |

Në lidhje me auditimin e procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimi, si dhe pas vlerësimit të argumentimeve të funksionarëve të Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Urban (këtu e në vazhdim DPZHTU) mbi konstatimet e grupit të auditimit, vetëm në njëjërë prej procedurave të audituara vërehen parregullsitë, më konkretisht për:

“Leje ndërtimi për sallë eventesh 1 kat, me adresë në Ishull-Lezhë, Nj. Adm. Shëngjin, Bashkia Lezhë, me zhvillues z. P.GJ dhe znj. D.GJ, me subjekt ndërtues “S.T Konstruksion” ShPK, miratuar me Vendim Nr. 17445/5 Prot; datë 19.12.2022 të Kryetarit të Bashkisë Lezhë”

Titulli i gjetjes 1: Mangësi në projektin ndërtimor, dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi.

Situata: Nga auditimi i procedurës së miratimit të lejes së ndërtimit dhe zhvillimit u konstatua se projekti ndërtimor nuk është i plotë, ka mangësi në dokumentacionin shoqërues dhe atë të kërkuar në ligj dhe rregullore. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me:

- Plani i rievimit për objektin nuk është i plotësuar me të gjitha detajet e nevojshme, pasi, në zbatim të Nenit 10, të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika ç), duhet të paraqesë konturin e pasurisë të përmatur, të dhëna mbi rrugët, gjerësinë e tyre, si dhe distancat nga objektet kufitare. Rilevimi topografik nuk paraqet asnjë informacion në lidhje me konstatimet e mësipërme;

- Mungon dokumenti i preventivit total të punimeve. Në sistemin elektronik të lejeve gjendet preventivi i punimeve elektrike dhe i punimeve për mbrojtjen ndaj zjarrit. Nga dokumentacioni i kësaj procedura marrim informacionin se vlera e preventivit për zhvillimin e këtij objekti është 22.603.379,00 lekë, ndërsa nga dokumenti i përlogaritje së Taksës së Ndikimit në Infrastrukturë, marrim informacionin se kjo vlerë është 23.281.423,00 lekë. Mungesa e këtij dokumenti është në kundërshtim me Neni 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika dh). Shqyrtimi dhe miratimi i aplikimeve me informacion jo të saktë është në kundërshtim me Nenin 20 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, pika 2, nënpika b);

- Mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjektit që ka hartuar raportin e auditimit të efikasitetit të energjisë, siç janë certifikata e regjistrimi në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) ose ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 “Dokumentacioni për pajisjen me leje ndërtimi”, të VKM-së nr. 408, datë 13.5.2015, “Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit”, i ndryshuar, pika 1, nënpika ë);

- Projekti arkitektonik në formatin DËG nuk është i plotë, pasi mungojnë fasadat teknike të objektit, veprime këto në kundërshtim me Nenin 15 të VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “Për

miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar me Vendim nr. 457, datë 29.06.2022, pika 1, nënpika ç).

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit*”, i ndryshuar, neni 10, pika ç); neni 15, pika 1, nënpika ç), dh), ë); neni 20, pika 2, nënpika b).

Ndikimi/Efekti: Mangësitë në projektin ndërtimor, në dokumentacionin shoqërues të tij, si dhe dokumentacionin e kërkuar në ligj për pajisjen me leje ndërtimi dhe zhvillimi, ndikojnë në cilësinë dhe garatimin e ndërtimeve sipas standarteve, kushteve higjeno-sanitare dhe të sigurisë, nga subjekte të cilat duhet të plotësojnë kriteret e ushtrimit të profesionit, sipas legjisllacionit në fuqi.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Lezhë.

Rëndësia: E lartë

Rekomandimi: Nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Urban (DPZHTU), Bashkia Lezhë të merren të gjitha masat për të kërkuar, në çdo rast që aplikohet për pajisje me leje ndërtimi ose çertifikatë përdorimi, të gjithë dokumentacion e nevojshëm dhe të detyrueshëm, të projektit ndërtimor dhe dokumentacionit shoqërues të tij, sipas kuadrit rregullator dhe ligjor në fuqi, si dhe të mos miratojë asnjë leje ndërtimi me mangësi të tilla. DPZHTU duhet të kërkojë në çdo rast dokumentacionin që vërteton statusin aktiv dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) të subjekteve që kanë hartuar projektin ndërtimor. DPZHTU dhe Bashkia Lezhë të kërkojnë projektin ndërtimor të plotë në formatin DËG. Gjithashtu, të kërkojnë nga aplikanti plotësimin e planit të rlevimit dhe planvendosjes me të gjitha elementët e nevojshëm, me qëllim marrjen e informacionit të plotë mbi parcelën në zhvillim.

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **z. A.L** , në funksionin e drejtorit të DPZHTU;
- **znj. A.M** , në funksionin e kontrolluesit pranë DPZHTU, si dhe drejtuesit (me urdhër nr. 19665, datë 13.12.2022);
- **znj. M.D** , në funksionin e nëpunësit pranë DPZHTU;

Titulli i gjetjes 2: DPZHTU dhe Bashkia Lezhë nuk kanë kërkuar mendimin e të gjitha autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit.

Situata: Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatua Bashkia Lezhë dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Urban (DPZHTU) nuk kanë kërkuar mendimin e të gjithë autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit. Referuar VKM-së nr. 408, datë 13.05.2015 “*Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit*”, i ndryshuar, Neni 21, pika 6, DPZHTU ka detyrimin të kërkojë dhe respektojë mendimin e autoriteteve që duhet të shprehen përpara miratimit të lejeve të ndërtimit. Më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me:

- Nuk është rikërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit, mbi identifikimin e linjave dhe projekteve të këtij operatori.
- Nuk është respektuar mendimi i Policisë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin (PMNZSH), pasi, referuar kthim-përgjigjes së datës 01.12.2022, nr.17445-2022/1 prot; me lëndë: “*Kthim përgjigje*”, shprehen se: “*...ju bëjmë me dije se kërkesa e aplikantit S. T. me zhvillues "P. Gj. ", duhet ti drejtohet drejtorisë/vektorit të MZSH-së, bashkia Lezhë për shkak të kategorisë së objektit...*”. Edhe pse në këto kushte, Bashkia Lezhë ka vazhduar me miratimin e lejes së ndërtimit.

Kriteri: Vendimi i Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Neni 21 “Shqyrtimi i kërkesave për leje ndërtimi nga autoriteti vendor”, pika 6.

Ndikimi/Efekti: Mos-marrja dhe mos-respektimi i mendimit të autoriteteve të cilat duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, rrit mundësitë e zhvillimit të objekteve në kundërshtim me kondicionet urbane, si dhe nuk jep siguri të lartë në lidhje me respektimin e kushteve të sigurisë dhe higjeno-sanitare.

Shkaku: Mosrespektim i kuadrit ligjor dhe rregullator në fuqi nga ana e funksionarëve të Bashkisë Lezhë.

Rëndësia: E lartë

Për gjetjet e konstatuara në procedurat e miratimit të lejeve të ndërtimit të trajtuar më sipër, ngarkohen me përgjegjësi:

- **z. A.L** , në funksionin e drejtorit të DPZHTU;
- **znj. A.M** , në funksionin e kontrolluesit pranë DPZHTU, si dhe drejtuesit (me urdhër nr. 19665, datë 13.12.2022);
- **znj. M.D** , në funksionin e nëpunësit pranë DPZHTU;

Konkluzion i përgjithshëm mbi miratimin e lejeve të ndërtimit:

Nga auditimi i procedurave të miratimit të lejeve të ndërtimit u konstatuan problematika vetëm në një rast, të cilat kanë të bëjnë me miratimin e lejes së ndërtimit në kushtet kur dokumentacioni i ngarkuar në sistemin elektronik të lejeve nuk është i plotë, më konkretisht, është konstatuar se: plani i rilevimit për objektin nuk është i plotësuar me të gjitha detajet e nevojshme; mungon dokumenti i prevetivit total të punimeve; mungon dokumentacioni që vërteton statusin aktiv të subjektit që ka hartuar raportin e auditimit të efikasitetit të energjisë, siç janë certifikata e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB) ose ekstrakti i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit; projekti arkitektonik në formatin DËG nuk është i plotë. Së dyti, është konstatuar se Bashkia Lezhë dhe Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit Urban (DPZHTU) nuk kanë kërkuar mendimin e të gjithë autoriteteve publike që duhet të shprehen në lidhje me miratimin e lejeve të ndërtimit, më konkretisht, këto anomali kanë të bëjnë me: nuk është rikërkuar mendimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit, mbi identifikimin e linjave dhe projekteve të këtij operatori; nuk është respektuar mendimi i Policisë e Mbrojtjes nga Zjarri dhe për Shpëtimin (PMNZSH).

2.6 Mbi organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Mbrojtës së Territorit

Struktura e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit (IVMT) të Bashkisë Lezhë.

Sipas dokumenteve të vëna në dispozicion nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, në lidhje me organizimin e IVMT- së, është ngritur dhe funksionon në bazë të nenit 4, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”. Në strukturën e miratuar me Urdhrin Nr. 68 datë 21.01.2022, “Për miratimin e strukturës, organikës, emërtimet e pozicioneve, klasat për çdo pozicion pune për administratën e bashkisë, të njëjësive administrative, të institucioneve vartëse dhe të punonjësve të njëjësive të shërbimeve për vitin 2022”, IVMT ka në përbërje **6 (gjashtë)** pozicione pune, nga të cilët **1 (një)** Kryeinspektor **3 (tre)** inspektor dhe **1 (një)** jurist dhe **1 (një)** pozicion vakant, të paraqitura në formë tabelle si vijon:

| Nr. | Emër Mbiemër | Funksioni sipas strukturës | Lloji i arsimit/dega | Data emërimit në detyrë | Aktualisht në punë apo larguar, data |
|-----|--------------|----------------------------|----------------------|-------------------------|--------------------------------------|
| 1 | V.T | Kryeinspektor | Drejtësi | 22.07.2022 | Në punë |
| 2 | A.N | Inspektor | Drejtësi | 01.06.2016 | Në punë |
| 3 | E.M | Inspektor | Drejtësi | 03.06.2019 | Larguar dt.17.10.2023 |
| 4 | F.Z | Jurist | Drejtësi | 01.05.2016 | Larguar dt. 18.08.2023 |

| | | | | | |
|---|-----|-----------|-------------------------|------------|------------------------|
| 5 | M.M | Inspektor | Inxhinieri Hidroteknike | 22.07.2020 | Larguar dt. 30.03.2022 |
| 6 | - | - | - | - | Vakant |

Burimi: Sektori i Burimeve Njerëzore Lezhë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Për periudhën 22.07.2022 deri 31.12.2022, IVMT është drejtuar nga Kryeinspektor V.T , i cili rezulton me arsim universitar në degën drejtësi.

Nga auditimi u konstatua se arsimimi i punonjësve të IVMT-së është në përputhje me kriteret e përcaktuara në ligjin Nr. 9780 datë 16.07.2007 “Për Inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin Nr.183/2014 “Për inspektimin e ndërtimit” neni 11 “Arsimimi i kryeinspektorëve dhe inspektorëve të inspektoratit të mbrojtjes së territorit”.

Vlen të theksohet se mungesa e stafit të kualifikuar, sidomos atij inxhinierik përbën mungesë cilësore për mbarëvajtjen e punës së inspektoratit, pasi nuk kanë kualifikimet e nevojshme për të kryer akte kontrolli apo për të përcaktuar dhe përshkruar teknikisht situatat e konstatuara gjatë inspektimit.

2. Mbi ekzekutimin e vendimeve të IVMT-së, për subjektet të cilat kanë kryer kundërvajtje administrative.

Veprimtaria e IVMT Lezhë ushtrohet sipas ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” i ndryshuar, me qëllim mbrojtjen e territorit nga ndërhyrjet e paligjshme si dhe kontrollin ndërtimeve të pajisura me leje.

Bashkia Lezhë, për periudhën objekt auditimi, rezulton të ketë **621** aplikime në sistem për leje zhvillimi, leje ndërtimi, deklarata për kryerje punimesh, leje për ndryshim funksioni, leje për shtesa në objekte ekzistuese, rikonstruksione dhe certifikata përdorimi ndër të cilat u konstatuan të miratuara **286** leje, pasqyruar si më poshtë:

| Nr. | Lloji i lejes | Leje të miratuara /2022 |
|-----|--|-------------------------|
| 1 | Certifikatë përdorimi | 11 |
| 2 | Deklaratë paraprake për kryerje punimesh | 90 |
| 3 | Leje infrastrukture | 7 |
| 4 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe deri në 250 m ² | 20 |
| 5 | Leje ndërtimi për rikonstruksion pa ndryshim funksioni | 10 |
| 6 | Leje për ndryshim funksioni | 13 |
| 7 | Leje për ndryshimin e projektit gjatë ndërtimit | 2 |
| 8 | Leje për ndryshimin e subjektit zhvillues | 8 |
| 9 | Leje për shtyrjen e afatit të lejes së ndërtimit | 4 |
| 10 | Leje rindërtimi, rikonstruksioni, riparim ndërtese | 31 |
| 11 | Leje zhvillimi | 30 |
| 12 | Njoftim për fillim punimesh | 51 |
| 13 | Njoftim për ndryshimin e subjektit zbatues | 0 |
| 14 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues deri në 250 m ² | 1 |
| 15 | Leje ndërtimi për ndërtim të ri me sipërfaqe më të madhe se 250 m ² | 5 |
| 16 | Leje ndërtimi për shtesë në ndërtim ekzistues me sipërfaqe më të madhe se 250 m ² | 1 |
| 17 | Leje ndërtimi për rikonstruksion me ndryshim funksioni | 2 |

Burimi: IVMT Lezhë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se IVMT nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në mospërputhje me nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

a) vendos për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

-nenin 51 “Inspektimi” të ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar i cili përcakton se: “*Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimit dhe drejtë të kundërvajtjesve, që shkelin dispozitat e këtij ligji*”.

-pikën 2 të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” e cila përcakton se: “**Kryeinspektori/inspektori i njësisë vendore, gjatë kontrollit të ushtruar për zbatimin e punimeve në objektet me leje ndërtimi, i vlerëson shkëlqet të punimeve në ndërtim rastet e mospërputhjes së objektit në ndërtim me kërkesat e lejes së zhvillimit/të ndërtimit e të projektit teknik të zbatimit apo me deklarinimin paraprak të miratuar e të konfirmuar nga organi i autorizuar**”.

Nga ana e punonjësve të IVMT –së sqarohet se në mungesë të stafit të kualifikuar, ky kontroll do ishte i pamundur pasi punonjësit nuk kanë kualifikimin sipas ligjit për të kryer akte kontrolli në objektet që kanë leje ndërtimi.

-Nga kontrolli i dokumentacionit, u konstatua se IVMT nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, veprim ky në mospërputhje me nenin 5, germa (f) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, inspektorati i mbrojtjes së territorit i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

f) përgatit dhe i jep të dhëna statistikore Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit çdo tre muaj për masat e marra, sipas shkronjave “b”, “c”, “ç”, “d”, “dh”, të këtij neni.

-IVMT nuk ka përgatitur plane vjetore të punës në mospërputhje me nenin 55 “Inspektoriat Vendor i Mbrojtjes së Territorit” pika 2 (a) të rregullores së brendshme të bashkisë Lezhë, që përcakton se:

Detyrat kryesore të Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit janë:

a) Harton plane vjetore të inspektimit, bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, si dhe kryerjen e inspektimeve në përpunime me planet e miratuara.

Nga auditimi u konstatua se IVMT, nuk ka miratuar planet mujore të punës, në mospërputhje me pikën 1 germa b/ii të VKM-së me nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, që përcakton se:

b) Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit pranë njësisë vendore:

ii) kryen kontrole në territorin administrativ të njësisë vendore, në bazë të planit mujor të punës, të miratuar nga kryeinspektori, si dhe në bazë të njoftimeve të marra nga institucionet qendrore, vendore dhe subjektet fizike e juridike;

Në formë tabele paraqiten vendimet e marra nga IVMT Lezhë për vitin 2022 pasqyruar si më poshtë:

| Nr. | Lloji i aktit | 2022 |
|-----|---|------|
| 1 | PV/Akte kontrolli | |
| 2 | PV/Akte konstatimi | 24 |
| 3 | Vendime gjobe | 14 |
| 4 | Vendime pezullimi | 9 |
| 5 | Vendime prishje | 5 |
| 6 | PV ekzekutimi të prishjeve | 3 |
| 7 | Kallëzime penale | 6 |
| 8 | Kërkesa drejtuar gjykatës për kthimin e gjobave në titull ekzekutiv | 12 |
| 9 | Informacion periodik 3 mujor që dërgohet pranë IKMT | - |
| 10 | Plane vjetore të punës të miratuara nga k/inspektori | - |
| 11 | Plane mujore të punës të miratuara nga k/inspektori | - |

Burimi: IVMT Lezhë, përpunuar nga grupi i auditimit të KLSH-së

-Për periudhën objekt auditimi, u konstatua se janë mbajtur **24** akte konstatimi për punime pa leje. Lidhur me aktet e mbajtura, u konstatua se për **14** raste është nxjerrë vendimi i gjobave. Për rastet e mësipërme, janë mbajtur **5** vendime për prishje dhe **9** vendime pezullimi.

Mosveprimet për marrjen e masave mbi konstatimet e bëra nga inspektorët e IVMT Lezhë, janë në mospërputhje me nenin 5, pika (b), (ç) dhe (d) “Detyrat e inspektoratit të mbrojtjes së territorit të njësisë vendore” të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, i cili përcakton se:

Gjatë ushtrimit të përgjegjësive të parashikuara në nenin 4, të këtij ligji, IMT i njësisë vendore merr masat e mëposhtme:

b. Vendos gjoba, sipas llojit të shkeljeve të dispozitave ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

ç. Vendos pezullimin e punimeve/ndërtimeve në rastin kur një afat kohor paraprak është i nevojshëm për marrjen e vendimit për përmbushjen e detyrimeve ligjore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit;

d. Vendos prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm;

si dhe ligjit nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit” i ndryshuar, neni 52 “Kundërvajtjet administrative” gërma (e) e cila përcakton se: “-e. Kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500,000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera”. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion, u shqyrtuan me zgjedhje mbi bazë risku, procedurat e ndjekura nga IMTV, ku rezultoi si vijon:

Titulli i Gjetjes: IVMT Bashkia Lezhë ka ushtruar funksionet e veta jo në përputhshmëri të plotë detyrimet që përcakton ligji për mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e paligjshme dhe ai për planifikimin e territorit.

Situata 1.

Referuar dosjes së subjektit (PF) A.P , nga inspektimi i bërë në terren nga Inspektorët e IVMT-së (E.M dhe A.N), më datë 16.11.2022, në subjektin (PF) A.P me adresë: Shëngjin, pranë postës së Policisë, market K , pranë Shëtitorës së Shëngjinit, në tarracën e objektit 6 (gjashtë) kate, në zonën e quajtur Shëtitorja Willson në Shëngjin, u konstatua ndërtimi shtesë kati në lartësi me strukturë metalike dhe i mbuluar me panel sanduiç, me dimensione 10 metër linear x 14 metër linear pa leje. Subjekti nuk u paraqit në vendin e punimeve.

Inspektorët e IVMT-së, me procesverbalin nr. 325, datë 16.11.2022, kanë mbajtur akt konstatimin e kundërvajtës për ndërtim pa leje nga DPZHT Bashkia Lezhë.

-Me vendimin nr. 213, datë 21.11.2022 nga kryeinspektori është marrë vendim për prishjen e objektit të kundërligjshëm.

-Me vendimin nr. 125, datë 21.12.2022 nga kryeinspektori është marrë vendimi për dënimin me gjobë në shumën **prej 4.900,000 (katër milion e nëntëqind mijë) lekë.**

-Nëpërmjet kërkesës nr. 6010 prot., datë 31.05.2023 me lëndë “Për lëshim urdhri ekzekutimi” IVMT i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për Vendimin nr. 125, datë 21.12.2022 “Për dënim me gjobë” dhe Vendimin nr. 213, datë 21.11.2022, “Për prishjen e objektit të kundërligjshëm” si dhe për kamatëvonesat.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se në dosje mungonte vendimi i Gjykatës për dënimin me gjobë. Nga IMTV Bashkia Lezhë **nuk është vijuar procedura për prishjen e objektit të kundërligjshëm** në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

Situata 2.

Referuar dosjes së subjektit (PF) H.B , nga inspektimi i bërë në terren nga Inspektorët e IVMT-së (E.M dhe A.N), më datë 14.04.2022, në subjektin (PF) H.B me adresë: Shëngjin, shëtitorja Wilson, Pallati Uldedaj, kati 7, pranë hotel Brilant u konstatua vendosja e një tende me konstruktion metalik. Subjekti nuk u paraqit në vendin e punimeve.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 308, datë 14.04.2022, kanë mbajtur akt konstatimin e kundërvajtjes për vendosje tende pa leje nga DPZHT Bashkia Lezhë.

-Me Vendimin nr. 115, datë 15.04.2022 “Për dënim me gjobë” kryeinspektori ka vendosur dënimin e kundërvajtësit H.B me gjobë, **në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.**

-Me shkresën nr. 6751 prot., datë 27.04.2022 me objekt Kallëzim i veprës penale të “Ndërtim i Paligjshëm” IVMT i është drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë kundër subjektit H.B .

-Nëpërmjet kërkesës nr. 13447 prot., datë 28.07.2022 me lëndë “Për lëshim urdhri ekzekutimi” IVMT i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 115, datë 15.04.2022 “Për dënim me gjobë”.

-Me Vendimin nr. 252 (833) datë 21.09.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka refuzuar kërkesën e IVMT-së për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 115, datë 15.04.2022 “Për dënim me gjobë”.

Gjykata e ka gjetur të pabazuar në prova dhe në ligj kërkesën e IMT –së pasi nuk është provuar që akti nr. 115, datë 15.04.2022 “Për dënim me gjobë” ti jetë njoftuar kundërvajtësit, duke sjellë pamundësinë e hyrjes në fuqi të këtij akti. Në këto kushte, referuar nenit 104/1 të Kodit të Procedurës Administrative, ky akt administrativ nuk ka hyrë në fuqi.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se procedura e njoftimit nëpërmjet të tretit, e ndjekur nga IVMT Lezhë, nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 160 të Kodit të Procedurës Administrative.

Sipas Vendimit nr. 252 (833) datë 21.09.2022, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër, nga ana e organit publik nuk janë kryer përpjekjet e nevojshme për njoftimin e subjektit kundërvajtës.

IVMT Bashkia Lezhë nuk ka ankimuar vendimin e gjykatës, me qëllim justifikimin e kryerjes së veprimeve inspektuese në terren, si dhe arkëtimin e të ardhurave për buxhetin e Bashkisë Lezhë si rrjedhojë e gjobës së vendosur, e cila është në vlerën 500,000 lekë. Të vepruarit në këtë mënyrë, nënkupton se IVMT Lezhë ka pranuar se nuk e ka zbatuar procedurën administrative gjatë veprimeve inspektuese.

Situata 3.

Referuar dosjes së subjektit (PF) Z.N , nga inspektimi i bërë në terren nga Inspektorët e IVMT-së (E.M dhe A.N), më datë 28.04.2022, në subjektin (PF) Z.N me adresë: Ishull Shëngjin, rruga e Hidrovorit, restorant Peshkatari, u konstatua vendosja e një tende me konstruksion metalik në tejkalim të lejes së ndërtimit nr. 434, datë 22.11.2021 “Për vendosje tende” duke e tjetërsuar atë. Subjekti nuk u paraqit në vendin e punimeve.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 310, datë 28.04.2022, kanë mbajtur akt konstatimin e kundërvajtjes për vendosjen e një tende me konstruksion metalik në tejkalim të lejes nr. 434, datë 22.11.2021 “Për vendosje tende” duke e tjetërsuar atë.

-Me Vendimin nr. 117, datë 11.05.2022 “Për dënim me gjobë” kryeinspektori ka vendosur dënimin e kundërvajtësit Z.N me gjobë, në masën 500.000 (pesëqind mijë) lekë.

-Me Vendimin nr. 47, datë 11.05.2022 “Për pezullimin e punimeve” kryeinspektori ka vendosur pezullimin e punimeve për kundërvajtësin Z.N për shkelje të lejes nr. 434, datë 22.11.2021 “Për vendosje tende”.

-Nëpërmjet kërkesës nr. 13305 prot., datë 25.07.2022 me lëndë “Për lëshim urdhri ekzekutimi” IVMT i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 117, datë 11.05.2022 “Për dënim me gjobë” si dhe për kamatëvonesat.

-Me Vendimin nr. 251 (850) datë 27.09.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka refuzuar kërkesën e IVMT për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nr. 117, datë 11.05.2022 “Për dënim me gjobë” si dhe për kamatëvonesat.

Gjykata e ka gjetur të pabazuar në prova dhe në ligj kërkesën e IVMT-së pasi nuk është provuar që akti nr. 117, datë 11.05.2022 “Për dënim me gjobë” ti jetë njoftuar kundërvajtësit, duke sjellë pamundësinë e hyrjes në fuqi të këtij akti. Në këto kushte, referuar nenit 104/1 të Kodit të Procedurës Administrative, ky akt administrativ nuk ka hyrë në fuqi.

Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se procedura e njoftimit nëpërmjet të tretit, e ndjekur nga IVMT Lezhë, nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 160 të Kodit të Procedurës Administrative.

IVMT Bashkia Lezhë nuk ka ankimuar vendimin e gjykatës, me qëllim justifikimin e kryerjes së veprimeve inspektuese në terren, si dhe arkëtimin e të ardhurave për buxhetin e Bashkisë Lezhë si rrjedhojë e gjobës së vendosur, e cila është në vlerën 500,000 lekë. Të vepruarit në këtë mënyrë, nënkupton se IVMT Lezhë ka pranuar se nuk e ka zbatuar procedurën administrative gjatë veprimeve inspektuese.

Situata 4.

Referuar dosjes së subjektit “G “ SHPK, nga inspektimi i bërë në terren nga Inspektorët e IVMT-së (E.M dhe A.N), me datë 26.04.2022, në subjektin ndërtues “G ” SHPK me adresë: Kune Shëngjin, në objektin me konstruksion hekur dhe beton, në objektin ekzistues 7 kat.

Inspektorët e IVMT, me procesverbalin nr. 309, datë 26.04.2022, kanë mbajtur akt konstatimin e kundërvajtjes për ndërtim pa leje nga DPZHT, në zonën e quajtur Kune, në njësinë administrative Shëngjin, u konstatua se në objektin ekzistues 7 kat, në katin përdhe po ndërtohej një objekt me përmasa 20 m dhe 5 m, me beton në pronësi të subjektit “G ” ShPK.

-Me vendimin nr. 116, datë 10.05.2022 “Për dënim me gjobë” kryeinspektori ka vendosur për dënimin me gjobë në shumën **prej 500,000 (pesëqind mijë) lekë.**

-Me vendimin nr. 46, datë 10.05.2022 “Për pezullimin e punimeve” kryeinspektori ka vendosur pezullimin e punimeve për kundërvajtësin “G ” ShPK për ndërtim pa leje.

-Nëpërmjet kërkesës nr. 14985 prot., datë 07.09.2022 me objekt “Për lëshim urdhri ekzekutimi”

IVMT i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 116, datë 10.05.2022 “Për dënim me gjobë” si dhe për kamatëvonesat.

Me Vendimin nr. 259 (852) datë 27.09.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka refuzuar kërkesën e IVMT-së për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit nr. 116, datë 10.05.2022 “Për dënim me gjobë” si dhe për kamatëvonesat.

Gjykata e ka gjetur të pabazuar në prova dhe në ligj kërkesën e IVMT-së pasi nuk është provuar që akti nr. 116, datë 10.05.2022 “Për dënim me gjobë” ti jetë njoftuar kundërvajtësit, duke sjellë pamundësinë e hyrjes në fuqi të këtij akti. Në këto kushte, referuar nenit 104/1 të Kodit të Procedurës Administrative, ky akt administrativ nuk ka hyrë në fuqi.

-Në dosje mungon Urdhri i Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm nga Kryeinspektori, ku për ekzekutimin e këtij urdhri duhet të ngarkohen inspektorët e IMT-së, në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar.

-Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se nuk është respektuar afati ligjor për nxjerrjen e masës administrative referuar vendimit nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore”; i cili përcakton se: *brenda 10 ditëve nga mbajtja e procesverbalit të konstatimit të kundërvajtjes, Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i njësisë vendore nxjerrin vendimin për marrjen e masave përkatëse dhe dhënien e sanksioneve administrative, të cilat nënshkruhen nga kryeinspektori;*

-Nga IMTV-së **nuk është vijuar procedura për nxjerrjen e Urdhrit të Ekzekutimit për prishjen e objektit të kundërligjshëm** në kundërshtim me nenin 5 pika “d” të ligjit nr. 9780, datë 16.7.2007 "Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme" i ndryshuar;

-Procedura e njoftimit nëpërmjet të tretit, e ndjekur nga IVMT Lezhë, nuk është në përputhje me kërkesat e nenit 160 të Kodit të Procedurës Administrative.

Sipas Vendimit nr. 259 (852) datë 27.09.2022, të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër, nga ana e organit publik nuk janë kryer përpjekjet e nevojshme për njoftimin e subjektit kundërvajtës.

IVMT Bashkia Lezhë nuk ka ankimuar vendimin e gjykatës, me qëllim justifikimin e kryerjes së veprimeve inspektuese në terren, si dhe arkëtimin e të ardhurave për buxhetin e Bashkisë Lezhë si rrjedhojë e gjobës së vendosur, e cila është në vlerën 500,000 lekë. Të vepruarit në këtë mënyrë, nënkupton se IVMT Lezhë ka pranuar se nuk e ka zbatuar procedurën administrative gjatë veprimeve inspektuese.

Situata 5.

Referuar dosjes së subjektit “F “ SHPK, nga inspektimi i bërë në terren nga Inspektorët e IVMT-së (E.M dhe A.N) me datë 16.06.2022, në subjektin “F ” ShPK me adresë: Kune, Shëngjin Lezhë, kantieri i subjektit “F ” ShPK, objekt banimi, shërbim+banim, 7 kate banim, papafingo, parkim nën tokë. Në oborrin e këtij kantieri u konstatua ndërtimi i një pishine, në formë ovale të çrregullt me buto beton dhe hekur afërsisht 600 m² pa leje ndërtimi.

Inspektorët e IVMT-së, me procesverbalin nr. 313, datë 16.06.2022, kanë mbajtur akt konstatimin e kundërvajtjes për ndërtim pa leje nga DPZHT.

-Me vendimin nr. 119, datë 27.06.2022 “Për dënim me gjobë” kryeinspektori ka vendosur për dënimin me gjobë në shumën **prej 1,000,000 (një milion) lekë.**

-Nga dokumentacioni në dosje, nuk ndodhet vendimi për prishjen e objektit të kundërligjshëm.

-Nëpërmjet kërkesës nr. 16724 prot., datë 07.10.2022 me objekt “Për lëshim urdhri ekzekutimi”

IVMT i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Shkodër për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 119, datë 27.06.2022 “Për dënim me gjobë” si dhe për kamatëvonesat.

-Me Vendimin nr. 291 (1137) datë 21.12.2022, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Shkodër ka pranuar kërkesën e IVMT-së për lëshimin e urdhrit të ekzekutimit për vendimin nr. 119, datë 27.06.2022 “Për dënim me gjobë” dhe ka **refuzuar** kërkesën në lidhje me kamatëvonesat.

-Nëpërmjet ankesës nr. 1524/1 prot., datë 08.02.2023, IVMT Bashkia Lezhë i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë për ndryshimin e vendimit nr. 291 (1137) datë 21.12.2022, të Gjykatës Administrative e Shkallës së Parë Shkodër.

-Është bërë kërkesa për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor, dërguar me shkresë nr.1524/4 prot, datë 16.03.2023, drejtuar Zyrës Përmbarimore Lezhë për vënien në ekzekutim të Vendimit Gjyqësor nr.291 (1137), datë 21.12.2022 përsa i përket pikës 3 ku citohen kamatëvonesat që derivojnë nga mosekzekutimi i aktit administrativ, nr. 119, datë 27.06.2022 “Për dënim me gjobë”.

-Nga IVMT Bashkia Lezhë është vijuar me Kallëzimin Penal, dërguar me shkresë nr.12508, datë 06.07.2022 për veprën penale ,“Ndërtimi i Paligjshëm“, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal.

-Nga auditimi i dokumentacionit u konstatua se nga IVMT-ja e Bashkisë Lezhë, megjithëse është vijuar procedura ligjore për arkëtimin e gjobës, duke bërë kërkesën në përmbarim, ende nuk është administruar Vendimi Gjyqësor i Gjykatës së Apelit, nëse është lënë në fuqi Vendimi Gjyqësor i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësive vendore”; Kodi i Procedurës Administrative, nr. 44/2015.

Impakti: Mos zbatim i kuadrit ligjor në fushën e inspektimit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.

Shkaku: Personeli i pakualifikuar dhe neglizhencë në kryerjen e detyrës nga IVMT.

Rëndësia: E lartë

Titulli i Gjetjes: Bashkia Lezhë nuk ka bërë arkëtimin e të gjitha masave administrative të vendosura nga IVMT.

Situata:

Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të IVMT-së për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, në mënyrë të përmbledhur paraqitet në tabelën nr. 1, si vijon:

Tabela nr. 1

| Nr. | Subjekti | Proces-verbal Nr./datë | Kundërvajtja | Vlera e gjobës (lekë) | Arkëtuar dhe shfuqizuar me vend. Gjyk. (lekë) |
|-----|---------------|-----------------------------|---|-----------------------|---|
| 1 | T | Pv.Nr.000113, dt.09.02.2022 | Kryerje punimesh hapje trotuari duke shtrirë tubacione për vendosjen e fibrave optike pa leje dhe plan vendosje nga Dr.Pl.Zh.Territorit | 500,000 | Proces Gjyqësor |
| 2 | GJ.D & M.D | Pv.Nr.000114 dt.03.03.2022 | Mos mbarim i punimeve brenda afatit të lejes së dhënë me vendim nr.209 dt.19.06.2020, nr.6709/3 prot datë 19.06.2020 | 100,000 | Në përmbarim |
| 3 | H.B | Pv.Nr.000115 dt.15.04.2022 | Vendosje tende pregolat me konstruksion metalik me përmasa afërsisht 8 m linear *3m linear pa leje nga Dr.Pl.Zh Territorit | 500,000 | Në përmbarim |
| 4 | G ShPK | Pv.Nr.000116 dt.10.05.2022 | Ndërtim pa leje nga Dr.Pl.Zh. Territorit | 500,000 | Proces gjyqësorë |
| 5 | Z.N | Pv.Nr.000117 dt.11.05.2022 | Shkelje e lejes nr.434 dt.22.11.2021, Për vendosje tende pregolate | 500,000 | Në Përmbarim |
| 6 | N ShPK | Pv.Nr.000118 dt.17.06.2022 | Kryerje punimesh në përfundim të lejes së infrastrukturës , me vendim nr.345, dt.19.06.2018 | 500,000 | Në Përmbarim |
| 7 | F SHPK | Pv.Nr.000119 dt.27.06.2022 | Ndërtim i paligjshëm me buto beton ne oborrin e kantierit objekt 1-kat +shërbime 7 kat banim, papafingo+ parking nen toke .Pishinë në formë ovale e çrregullt afërsisht 600m2 | 1,000,000 | Proces gjyqësor |
| 8 | L ShPK | Pv.nr.000120 dt.27.06.2022 | Vendosje strukture provizore (lojëra argëtuese) pa leje nga Dr.Pl.Zh e Territorit. | 500,000 | Në Përmbarim |
| 9 | L ShPK | Pv.nr.000121 dt.27.06.2022 | Hedhje dhe mbushje prone me materiale të ngurta dhe dherave në afërsi të autostradës | 500,000 | Proces gjyqësor |
| 10 | N.K | Pv.Nr.000122 dt.05.07.2022 | Ndërtim pa leje i pasurisë nr.3001, Z.K.1677(pronë shtet) dhe gërmime me ekskavator pa leje nga Dr.PL.Zh. Territorit | 500,000 | Proces gjyqësor |
| 11 | T | Pv.Nr.000123 dt.02.08.2022 | Në segmentin rrugor nga Prokuroria – në Drejtim të Komisarariatit Lezhë është konstatuar kryerje e punimeve në tejkalim të lejes se dhënë dhe pa plan vendosje të miratuar për këtë segment | 500,000 | Proces Gjyqësor |
| 12 | G ShPK | Pv.Nr.000124 dt.31.10.2022 | Shkelje afati të mbarimit të punimeve në objektin e proces zhvillimi miratuar me vendim nr.424 dt.13.08.2019 “Godina banimi 5-kat +2 kat podrum” ndodhur në pasurinë nr.962/3 : 962/6: 962/4 : 962/7 Z.K 2569 | 100,000 | Likuiduar |
| 13 | A.P | Pv.Nr.000125 dt.21.12.2022 | Shtese kati në lartësi “ Ndërtim pa leje” në Objektin 6(gjashte) katesh me konstruksion metalik . | 4,900,000 | Proces Gjyqësor |
| 14 | V ShPK. | Pv.Nr.000126 dt.30.11.2022 | Shkelje te afatit te përfundimit te punimeve te lejes se ndërtimit me vendimin nr.41 dt.04.04.2011. Vendim i K.K.T-se ish-Komuna Shën koll | 100,000 | Likuiduar |
| | Totali | 14 | - | 10,700,000 | Pa arkëtuar 10,500,000 |

Lidhur me gjobat e vendosura nga IVMT, rezulton se janë arkëtuar vetëm 2 (dy) prej tyre dhe mbeten pa arkëtuar 12 gjoba me vlerë **10,500,000 Lekë**.

Sipas të dhënave të vëna në dispozicion nga IVMT Lezhë rezulton se 7 vendime me gjobë janë në procese gjyqësore dhe 5 vendime me gjobë i janë përcjellë Përmbaruesit Gjyqësor Lezhë për ekzekutim.

Kriteri: Ligji nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Ligji nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësive vendore”.

Impakti: Mos zbatim i kuadrit ligjor në fushën e inspektimit dhe mbrojtjes së territorit nga ndërtimet e kundërligjshme.

Shkaku: Personeli i pakualifikuar dhe neglizhencë në kryerjen e detyrës nga IVMT.

Rëndësia: E lartë

Për sa më sipër, për veprimet dhe mosveprimet ngarkohet me përgjegjësi:

1. **Z. V.T**, në cilësinë e Kryeinspektorit të IVMT- së
2. **Z. F.Z**, në cilësinë e juristit të IVMT-së.

2.7 Të ndryshme të dala gjatë auditimit

Nga auditimi në terren, nuk ka dalë asnjë problem për tu trajtuar në këtë kapitull.

IV. GJETJE DHE REKOMANDIME

Për përmirësimin e gjendjes, rekomandojmë marrjen e masave si më poshtë:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi kontrollin e brendshëm financiar publik rezultoi se:

- Menaxhimi i lartë i Bashkisë Lezhë, nuk ka ngritur dhe nuk ka siguruar një sistem efektiv të mjedisit të kontrollit sipas kërkesave të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Punonjësit e Bashkisë Lezhë nuk janë trajnuar mbi njohjen e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Bashkia Lezhë nuk ka hartuar strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të riskut duke identifikuar dhe evidentuar sektorët me risk të lartë.
- Bashkia Lezhë nuk ka hartuar procedura dhe rregulla të shkruara në lidhje me frekuencën e raportimit për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1.Rekomandimi: Menaxhimi i lartë i Bashkisë Lezhë, të marrë masat për të ngritur dhe siguruar një sistem efektiv të mjedisit të kontrollit sipas kërkesave të ligjit të menaxhimit financiar dhe kontrollit:

- Duke trajnuar punonjësit e bashkisë mbi njohjen e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin.
- Duke hartuar strategjinë e vlerësimit dhe parandalimit të riskut, në përputhje me kërkesat e MFK, duke angazhuar strukturat përgjegjëse në identifikimin e risqeve dhe evidentimin e sektorëve me risk të lartë.
- Duke hartuar procedura dhe rregulla të shkruara në lidhje me frekuencën e raportimit për monitorimin e sistemit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me Njësinë e Auditit të Brendshëm u konstatua se:

Nga Njësia e Auditimit të Brendshëm nuk janë marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart. Për këtë arsye kjo njësi nuk i ka dhënë mbështetjen e duhur Titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave, pasi planet vjetore nuk janë hartuar bazuar në vlerësimin objektiv të riskut, veprime në kundërshtim me nenin nr. 5 dhe nr. 6 të ligjit nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik”.

-Nuk ka urdhër për ngritjen e Komitetit të Auditimit e për rrjedhojë as rregullore për të në kundërshtim me ligjin nr. 114/2015 “Për auditimin e brendshëm në sektorin publik” neni 13 “Komitetit të Auditimit të Brendshëm”.

- Në disa dosje nuk ka gjurmë, nuk dokumentohet dhe nuk administrohet në dosje shkresa përcjellëse e kthimit të Projekt Raportit nga pala e audituar (e konfirmuar dhe e nënshkruar nga titullari i subjektit të audituar dhe personat e përfshirë në auditim.

Gjithashtu në disa dosje të auditimit mungon Memo e planifikimit, pra Projekt Drafti i programit të auditimit në fazën e hartimit të programit të angazhimit.

Në Programin për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, nuk ka të përcaktuar Indikatorët e matjes së performancës, gjë që ka kushtëzuar hartimin e raporteve specifike të vlerësimit të performancës dhe si rrjedhim adresimin e rekomandimeve për përmirësim, duke munguar raportimi tek Titullari për këtë procedurë. Rezulton se nuk është kryer procedura sigurimi i cilësisë.

Në lidhje me vlerësimin e brendshëm të cilësisë që kryhet nga vetë NjAB konstatohet se anekset “Monitorimi i vazhdueshëm i veprimtarisë” dhe “vetëvlerësimin periodik” nuk janë plotësuar sipas përcaktimeve në pikën 7.1.1 në Kapitullin VII të MAB, të cilat nuk mbulojnë në të gjitha fazat e auditimit si dhe i mungon komponenti i tretë “Reagimet e subjektit të audituar”. “Për Auditin e Brendshëm Publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 12-28, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1.Rekomandimi: Njësia e Auditit të Brendshëm të marrë masa që në planet vjetore të auditimit, të programohet auditimi i fushave kryesore të veprimtarisë së institucionit, të cilat vlerësohen si fusha me risk të lart, si ngritja dhe implementimi i sistemit të kontrollit të brendshëm, prokurimet publike, në mënyrë që nëpërmjet rekomandimeve përkatëse ti jepet mbështetje titullarit të njësisë publike në arritjen e objektivave. Të realizohen të gjitha proceset në të gjitha fazat e auditimit në përputhje me MAB.

Në vijimësi

3.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave në përgatitjen e PBA 2022-2024, u konstatua se:

Nuk administrohet dokumenti përfundimtar i PBA për periudhën 2022, por në dosje administrohet vetëm VKB nr. 52., datë 31.03.2021 për miratimin e taveve përgatitore për PBA 2022-2024, i cili nuk ka dalë në përputhje me përcaktimin e bërë pikën 6 të nenit 34 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”.

-Për hartimin e PBA 2022-2024 nuk janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit të Bashkisë Lezhë, në kundërshtim me përcaktimin e bërë në shkronjën “ç” të nenit 5 në Ligjin nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore”;

- Për PBA 2022-2024 nuk ka gjetur zbatim përcaktimi i bërë në pikën 1 të nenit 37 të Ligjit nr. 68/2017 “Për financat e Vetëqeverisjes Vendore.

- Për PBA 2022-2024 nga Kryetari i Bashkisë nuk është nxjerrë udhëzimi vjetor për përgatitjen e buxhetit.

-Nuk dokumentohet në dosje dokumenti për publikimin e dokumentit të parë të Programit Buxhetor Afatmesëm.

-Pjese e dokumentacionit te Projekt-dokumentit te PBA 2022-2024 që duhet dërguar ne MFE si edhe në Këshillin Bashkiak janë vetëm formatet output, te cilat gjenerohen nga Instrumenti i Planifikimit Financiar.

-Në buxhetin vjetor të vitit 2022, nuk janë planifikuar fonde për investime në shtimin/përmirësimin e fondit pyjor, në kundërshtim me përcaktimet e bëra në pikën 5 të nenit 23 në Ligjin nr. 9385, datë 04.05.2005 “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”, i ndryshuar, si dhe në pikën 3 të nenit 13 në Ligjin nr. 57/2020 “Për pyjet”. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lezhë, të marrë masat e nevojshme që gjatë fazave të planifikimit të buxhetit afatmesëm dhe atij vjetor, të ngrejë grupin e menaxhimit strategjik, si dhe të dokumentohen kërkesat buxhetore nga çdo drejtues programi ekonomik i Bashkisë Lezhë.

Në vijimësi

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i realizimit të Buxhetit, grupi i auditimit konstaton se, realizimi i investimeve kapitale të trupëzuara të planifikuara paraqitet në nivele jo të mira në vitin 2022, konkretisht në masën 72.2 %. Kjo situatë vjen si rezultat i mosrealizimit të të ardhurave, që do të thotë se nga Bashkia Lezhë në fillim të vitit buxhetor parashikohen procedura të prokurimit publik, duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarifat vendore, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuara me të ardhurat e realizuara. Llogaria 230 kapitale të pa trupëzuara janë planifikuar në vlerën 17,624,000 lekë dhe janë realizuar në vlerën 17,623,969 lekë. Llogaria 231 Kapitale të Trupëzuara është planifikuar në vlerën 495,790,875 lekë është realizuar në vlerën 256,789,380 lekë. Nga auditimi i pagesave të kryera nëpërmjet Bankës dhe testimi i tyre në lidhje me respektimin e afatit 30 ditor të paraqitjes së urdhër-shpenzimit me dokumentacionin shoqëruar në Degën e Thesarit Lezhë, nga data e faturës së operatorit ekonomik, u konstatua se për periudhën 2022, ky afat nuk është respektuar në 20 raste për vlerën 106,457,953 lekë.

Sa i përket likuidimit të detyrimeve të prapambetura për investime, mallra dhe shërbime, konstatohet se nuk respektohet radha e likuidimit të tyre, pra fatura e parë likujdohet më parë, ilustruar me disa raste të evidentuara në Projekt raport. Këto veprime bien në kundërshtim me përcaktimin e bërë në pikat 8 dhe 184 të Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar. Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në shkronjën “a” në nenin 5, në ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, si dhe neni 47 në ligjin nr. 9936, datë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

4.1.Rekomandimi: Drejtorja e Financës dhe Drejtorja e të Ardhurave, të marrin masa që planifikimi i fondeve për investime/shërbime dhe blerje mallrash të bëhet mbi bazën e realizimit të të ardhurave në vitin paraardhës dhe jo të planifikimit të tyre.

Në vijimësi

5. Gjetje nga auditimi : Nga auditimi konstatohet se për vitin 2022, të ardhurat në total janë planifikuar në vlerën 740,000 mijë lekë dhe janë realizuar në vlerën 438,851 mijë lekë ose 59%.

Vërehet se, në disa lloje taksash/tarifash ka realizim më shumë se planifikimi, për arsye se gjatë vitit janë arkëtuar edhe detyrime për taksat/tarifat të prapambetura, si edhe në raste të caktuara për disa lloje taksash/tarifash nuk planifikohet vlerë për t’u arkëtuar, megjithëse gjatë vitit kanë ndodhur arkëtime.

Nga dokumentacioni i audituar rezulton se procesi i planifikimit të taksave dhe tarifave vendore nuk është i dokumentuar, nga Drejtorja e Taksave dhe e Tarifave Vendore nuk është hartuar regjistri i taksapaguesve privatë dhe familjarë.

Grupi i auditimit duke iu referuar analizimit të të dhënave të paraqitura si dhe shqyrtimit të dokumentacionit konstaton që metodologjia e përdorur nga Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore për planifikimin e taksave dhe tarifave vendore nuk parashikon saktë pritshmëritë lidhur me të ardhurat e veta të Bashkisë. Duke iu referuar tabelës më lart vërehet një realizim i dobët i taksave dhe i tarifave vendore.

Këto veprime janë në kundërshtim me VKB-në nr. 157, datë 17.11.2022 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Lezhë, administrimin e tyre dhe penalitetet për kundërvajtjet administrative për vitin 2022”, dhe Rregulloren e brëndshme nr. 493 prot., datë 18.07.2022 neni 43 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1.Rekoamndimi: Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Bashkia Lezhë të hartojë një plan të mirëstudiuar, mbështetur mbi numrin e taksapaguesve, llojit të Taksave dhe Tarifave Vendore, si dhe vlerës së secilës prej tyre. Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Taksave dhe e Tarifave Vendore, Bashkia Lezhë, të hartohet regjistri i taksave.

Në vijimësi

6. Gjetje nga auditimi: Llogaria nr. 520 “Disponibilitete në thesar”, në fillim të vitit 2022 është në vlerën 798,481,575 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 594,883,955 lekë, vlera prej 594,883,955 lekë, është sipas rakordimeve me thesarin. Nga testimi i llogarisë 520, rezulton se në fund të vitit është në vlerën 592,582,104 lekë, ose 2,301,850 lekë më pak nga vlera e pasqyruar në PF në mbyllje të vitit 2022, e cila pasqyrohet në vlerën 594,883,955 lekë. Këto veprime janë në kundërshtim me me Udhëzimi nr. 8 datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar, rubrika 2.3, pika 15 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2., faqe 70-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Lezhë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet kontabilizimi i saktë i llogarisë nr. 520 “Disponibilitete në thesar”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024

7. Gjetje nga auditimi: Llogaria nr. 468 “Debitorë të ndryshëm”, në fillim të vitit 2022 është në vlerën 923,488,685 lekë dhe në fund të vitit 2022 është në vlerën 512,259,280.90 lekë, pra me një rënie të vlerës së debitorëve të Bashkisë Lezhë në vlerën (411,229,404) lekë. Nga verifikimi i listës analitike të debitorëve në fund të vitit 2022, konstatohet se nuk janë kontabilizuar të drejtat për arkëtim në vlerën 50,472,056 lekë, si më poshtë vijon:

- 44,129,056 lekë për taksat dhe tarifat ndaj kategorisë “Familjarë”;

- 103,000 lekë për gjoba të Policisë Bashkiake;

- 6,240,000 lekë kamat-vonesë e papërlllogaritur për gjobat e IVMT;

-Konstatohet se në pasiv të bilancit nuk pasqyrohet llogaria nr. 470 “Llogari në pritje – të ardhura për t’u marrë” (me kundërparti llogarinë nr.468), e cila kreditohet në momentin e konstatimit të të drejtave për t’u arkëtuar.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar, shkronja “ë”, pika 3, neni 12. (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 70-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

7.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Lezhë, të marrë masat e nevojshme për vlerësimin, si dhe kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 “Debitorë të ndryshëm” me kundërparti llogarinë nr.470 “Të ardhura për t’u marrë”.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024

8. Gjetje nga auditimi: Llogaria 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, sipas pasqyrës së pozicionit financiar të Bashkisë Lezhë, në fund të vitit 2022 paraqitet në vlerën 138,604,257

lekë, e cila përfaqëson vlerën e garancisë së kontratave në masën 5%. Vlera e mësipërme është e rakorduar me Degën e Thesarit Lezhë. Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2022, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garanci punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garanci këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466. Nga auditimi konstatohet se nga ana e Dretorisë së financës nuk është marrë asnjë masë për likuidimin e tyre. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, pika 3.2 “Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) – funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4”. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3., faqe 70-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

8.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë e Planifikimit të Territorit, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogarisë nr. 466 “Kreditorë për mjete nën ruajtje”, si dhe të njoftojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave i’u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024

9. Gjetje nga auditimi: Nga shqyrtimi i ekstraktit historik të Shoqërisë Aksionare “Ujësjiellës Kanalizime Lezhë Sh.A” me NIPT M...C, u konstatua se Bashkia Lezhë zotëron 30.71% të aksioneve të kësaj shoqërie ose 30710 aksione me vlerë nominale 100 lekë secili, në total 3,071,000 lekë. Llogaria nr.26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet”, sipas të dhënave të pasqyruara për vitin ushtrimor 2021, ka vlerën kontabël në shumën 0 lekë.

-Pra sa më sipër, llogaria nr. 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” është nënvlerësuar me 3,071,000 lekë.

Ky veprim është në kundërshtim me Urdhërin e Ministrit nr. 64 datë 22.07.2014 “Për shpallje të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuar” me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 5 “Aktivet Afatgjata Materiale dhe Aktivet Afatgjata Jo materiale” pika 55, 56, 57 si dhe me Standardin Kombëtar të Kontabilitetit nr. 14 “Trajtimi kontabël i investimeve në pjesëmarrje”, VKM nr. 302, datë 11.05.2022 “Për politikat kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura” dhe Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 70-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

9.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Lezhë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhen veprimet kontabël në debi të llogarisë 26 “Pjesëmarrje në kapitalin e vet” dhe kredi të llogarive financiare të klasës 5, për pjesëmarrjen me kapitalin e vet.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024

10. Gjetje nga auditimi: Gjendja e llogarisë nr.4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” në fund të vitit 2022, paraqitet në vlerën kontabël 512,259,280 lekë. Llogaria 4341 “Operacione me shtetin (detyrime)” është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në pasiv, në rubrikën e detyrimeve dhe përfaqëson detyrimin që institucioni i ka shtetit për të ardhurat e konstatuara e të paarkëtuara nga vitet e mëparshme. Nga analiza e llogarisë analitike, rezulton se në llogarinë 4341, ndër të tjera janë kontabilizuar edhe debitorët (llogaria 468) ndaj Bashkisë Lezhë, për taksa dhe tarifa vendore, gjoba etj.

-Sa më sipër konstatohet se në llogarinë 4341 është bërë kontabilizim i gabuar i vlerës së debitorëve për taksa dhe tarifa vendore, gjoba etj. Nga analizimi i përbërjes së debitorëve, ilustruar për disa zëra, Bashkia Lezhë nuk ka detyrimin që t’i arkëtojë ato për llogari të buxhetit të shtetit, pasi nuk janë taksa të ndara apo Bashkia Lezhë të veprojnë si agent tatimor.

Në këtë rast kemi të bëjmë me taksa dhe tarifa vendore, si dhe gjoba, të cilat kalojnë direkt në buxhetin e Bashkisë Lezhë.

-Sa më sipër llogaria nr.4341 është mbivlerësuar me vlerën 512,259,280 lekë.

Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar, klasa 4 “Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 70-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

10.1. Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Lezhë të marrë masat e nevojshme, që të kryhet kontabilizimi i saktë i llogarisë nr.4341, duke pasqyruar në këtë llogari detyrime të Bashkisë Lezhë ndaj buxhetit të shtetit.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024

11.Gjetje nga auditimi: Llogaria 467 në fund të vitit 2022 paraqitet me vlerën 89,831,039 lekë. Nga auditimi i llogarisë analitike, konstatohet se nuk janë kontabilizuar detyrimet për vendimet gjyqësore në vlerën 5,082,537 lekë, të cilat janë likuiduar gjatë vitit 2023 për llogari të vitit 2022.

Ky veprim është në kundërshtim me Funksionimin kontabël të llogarive të klasës 4, në Udhëzimin nr. 8, datë 9.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 70-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

11.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës Bashkia Lezhë, të marrë masat e nevojshme, që të kryhet vlerësimi, si dhe kontabilizimi i plotë dhe i saktë i detyrimeve të Bashkisë ndaj të tretëve, në llogarinë nr. 467 “Kreditorë të ndryshëm”. Në përfundim të merren masa për raportimin e detyrimeve të prapambetura në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.

Me mbylljen e pasqyrave financiare të vitit 2024

12.Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi procesin e inventarizimit, kontabilizimit dhe regjistrimit në kadastër të aseteve në pronësi të Bashkisë Lezhë, të tokave, trojeve, terreneve, pyjeve, kullotave, ndërtesave dhe konstruksioneve, në mënyrë të përmbledhur u konstatua se nuk është kryer inventarizimi i tyre; Objektet e kontabilizuara nuk pasqyrohen me emërtimet e tyre, por vetëm me mbishkrimin “Toka, troje dhe terrene”, pra nuk identifikohet përbërja e kësaj llogarie dhe saktësia e veprimeve kontabël; Rregjistri që mbahet nga Drejtoria e Financës për këtë llogari, nuk është i plotë me informacion, pasi mungon informacioni për datën e hyrjes ose marrjes në dorëzim, përshkrimin e aktivitetit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivitetit, vendndodhjen, personin përgjegjës etj; Nuk është kryer kontabilizimi i trojeve të lira dhe ato të zëna me ndërtesat, që sipas rastit i kanë kaluar në pronësi Bashkisë Lezhë, nëpërmjet akteve ligjore/nënligjore, si dhe për më tepër ato troje të cilat janë pajisur edhe me certifikatë pronësie; Nga 4473 pasuri në pronësi të Bashkisë Lezhë, rreth 441 / 10% prej tyre janë regjistruar në kadastër dhe janë pajisur me certifikatë pronësie. Gjithashtu konstatohet se jo të gjithë VKM të cilat kanë kaluar prona në pronësi të Bashkisë Lezhë, gjejnë pasqyrim në inventarin e mbajtur nga Drejtoria e Administrimit të Aseteve. Këto veprime janë në kundërshtim me nenin 35, nenin 37, nenin 41 dhe nenin 44 në Ligjin nr. 20/2020 datë 05.03.2020 “Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë”; Nenin 9 dhe nenin 12 në Ligjin nr.10296 datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”, i ndryshuar; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Kapitulli III, pika 30 dhe paragrafi 104 në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.3, faqe 70-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

12.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, Bashkia Lezhë të marrë të gjitha masat për të kryer procesin e plotë të inventarizimit dhe përditësimit të pronave/pyjeve/kullotave, si vijon:

- Drejtoria e Burimeve Njerëzore të marrë masa për ngritjen e Strukturës së Menaxhimit të Pronave, për verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka bashkia të transferuara me VKM, duke përcaktuar detyra konkrete dhe me përgjegjësi në Rregulloren e Brendshme të bashkisë për miradministrimin e pronave për verifikim fizik të tyre dhe ndjekjen e procedurave për regjistrim.

- Drejtoria Juridike, në bashkëpunim me Drejtorinë e Financës të bashkërendojnë punën me ASHK-në Drejtoria Lezhë, me qëllim arritjen e një bashkëpunimi për të marrë asistencën e tyre të plotë për verifikimin e gjendjes faktike të pronave.

- Të dokumentohen me kujdes të gjitha hapat e këtij procesi të gjatë dhe të rëndësishëm për secilën Njësi Administrative dhe në nivel bashkie.

Brenda 6-mujorit të parë të vitit 2024

13. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi konstatohet se Taksa e tokës bujqësore për vitin 2022 është realizuar në shumën 6,011 mijë lekë nga 10,410 mijë lekë të planifikuara ose në masën 58 % . Planifikimi i taksës së tokës është bërë nga NJA në bazë të realizimit në vitin paraardhës dhe jo mbi bazë të dhënash për bazën e taksueshme, pasi regjistrat e tokës për familjet fermere (taksapagues), nuk janë azhurnuar në mënyrë të plotë dhe të saktë me të gjitha të dhënat e domosdoshme (sipërfaqen, marrëdhëniet juridike me tokën, llojin e tokës bujqësore, kategorinë, zonën e shtrirjes, kryefamiljarin, numrin e ID, nivelin e taksës së tokës të përllogaritur, kështu e parashikuara të pagesës të shtrirë gjatë vitit ushtrimor, njoftimet e kryera, pagesat e kryera, detyrimet e mbetura, nëse janë të kultivuar dhe me çfarë etj.)

Për vitet 2022 menaxhimin e taksës së tokës, ndjekjen e procedurave për faturimin dhe arkëtimin e taksës së tokës të familjeve fermere në 9 Njësitë Administrative i kanë kryer specialistët e NJA dhe jo DTTV. Faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur fermerët janë paraqitur pranë NJA-ve. Nuk është bërë kryqëzimi i regjistrat të familjarëve të mbajtur nga specialistët e NJA-ve me pagesat. Pra nuk ka evidentim të debitorëve dhe si rrjedhojë nuk janë bërë njoftim detyrime për fermerët e pasqyruar në regjistrat e NJA-ve, gjithmonë nëse ka evidentim të tyre, pasi ka pasaktësi dhe mospërditësim të të dhënave mbi bazën e të cilave janë përllogaritur detyrimet.

Këto veprime janë në kundërshtim me Ligjin nr.9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 23 dhe 24 dhe në papajtueshmëri me VKB nr. 157, datë 17.11.2021 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundërvajtësve”, i ndryshuar, Pika A.2.b.4 “Taksa mbi tokën bujqësore”, me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20106 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, neni 24, me ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar neni 9 pika 1.3, neni 35, me ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore” i ndryshuar, neni 3 pika 9 dhe 10 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 70-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

13.1.Rekomandimi: Drejtoria Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Drejtorinë e Bujqësisë, Ujitjes dhe Kadastrës dhe Njësitë Administrative të ngrerë një grup punë me specialistë të fushës, për hartimin e regjistrat të familjeve që disponojnë tokë bujqësore, duke verifikuar në terren si dhe marrjen zyrtare e të dhënave nga institucionet përkatëse (ish-ZVRPP apo ASHK Qarku Lezhë). Pas identifikimit dhe evidentimit me të gjithë treguesit të parcelave të tokës që disponon çdo fermer, të rishikohet planifikimi i të ardhurave për këtë taksë, të ndiqet arkëtimi i saj nëpërmjet njoftim-vlerësimeve për detyrimet për gjithë kohën e papaguar për familjet fermerë dhe për mos pagesat të ndiqen procedurat e tjera administrative e ligjore në strukturat e tjera kompetente, sipas rastit.

Brenda datës 30.12.2024

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi taksimin e subjekteve juridike që kanë kontrata shërbimi me Bashkinë Lezhë në zbatim të VKB-në nr. 157, datë 17.11.2021 “Për sistemin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Lezhë” dhe me Rregulloren e Brendshme nr.393 prot., datë 18.07.2022, neni 43 dhe nënpika 43.2, rezulton se:

Në Bashkinë Lezhë kanë kryer punime 13 subjekte, nga të cilat 7 subjekte kanë paguar detyrimin dhe 6 subjekte nuk i kanë paguar. Kështu për vitin 2023 detyrimi i lindur është në vlerën 1,808,483 lekë duke faturuar vlerën 1,386,995 lekë. Janë paguar vlera 731,949 lekë dhe rezultojnë me detyrim 6 subjekte për vlerën 622,914 lekë, si e ardhur e munguar në buxhetin e bashkisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 70-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

14.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me Sektorin e Procedurave të Prokurimit, të mos lidhë kontratë me subjektet juridike/fizik fitues të procedurave por që nuk janë me vendbanim (qendër biznesi) në këtë NJA, pa bërë më parë regjistrimin në QKB për NIPT sekondar, për periudhën e zbatimit të kontratës dhe kryerjen e pagesave për taksën e tarifave vendore.

14.2.Rekomandimi: Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore, të marrë masa duke ndjekur të gjitha rrugët administrative e ligjore për arkëtimin e vlerën 622,914 lekë ndaj 6 subjekteve debitore.

15. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi lidhur me Tarifën për shfrytëzimin e hapsirave publike konstatohet se në 16 raste janë dhënë leje për shfrytëzimin e hapsirës publike për qëllime biznesi si vendosje mallrash jashtë vendit të tregëtimit, vendosje tavolinash, sipërfaqet e zëna me platforma, sipërfaqe të rrethuara me vazo me lule, bimë dekorative, me kangjella, drurë dekorativë, kufizime me plastmasë dhe sende të tjera, etj., të ngjashme me to.

Nga auditimi i dokumentacionit, nga 16 raste rezulton se në 5 prej tyre është lidhur kontratë për hapsirën publike në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit. Në total për subjektet e sipërpërmendur, sipas Bashkisë Lezhë janë lidhur kontratat për shfrytëzimin e hapsirës publike për qëllime biznesi, me një sipërfaqe prej 849 m². Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga Drejtoria Juridike Lezhë, konkretisht kontratat e secilit subjekt, si dhe nga pamjet e fotografuara, kemi të bëjmë më një situatë ku hapësira publike është dhënë në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit për njësi shërbimi. Për hapësirat e dhëna me qera nga strukturat e Bashkisë Lezhë konstatohet se nuk është vepruar në bazë të kuadrit rregullator të fushës, sipas përcaktimeve në VKM nr. 171, datë 27.3.2019 “Për miratimin e rregullores ‘Për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, të ndryshuar, pikës 7, germa e nenit 14 dhe Urdhrit të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nr. 38 datë 27.01.2022 “Për përcaktimin e mënyrës së aplikimit për vendosjen e strukturës së shërbimit në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit” pika c, d, dh. Pika ç dhe pika 3 (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 70-83, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

15.1.Rekomandimi: Nga Titullari i Bashkisë të analizohet situata e krijuar dhe të nxirren përgjegjësitë ndaj personave përgjegjës. Për kontratat në vijim të ngrihet grup pune për verifikimet në terren para lidhjes së kontratës, me qëllim evitimin e lidhjes së kontratave për hapësirë publike në brezin e shërbimeve të stacionit të plazhit për njësi shërbimi.

Brenda datës 31.12.2024

16. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit, rezultoi se IVMT nuk ka miratuar asnjë akt kontrolli për objektet e pajisura me leje ndërtimi, veprim ky në kundërshtim me nenin 5 germa (a) të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar. Kryeinspektori nuk ka përgatitur informacionin periodik 3 – mujor për IKMT për masat e marra, planin vjetor dhe planet mujore të punës. IVMT Bashkia Lezhë, nuk ka marrë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e

konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke mos aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave, të pezullimit dhe të prishjes së ndërtimeve.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-në nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 141-153, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

Rekomandimi 16.1: Inspektorati Vendor i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Lezhë të marrë masa për:

- Të realizuar kontrollin e objekteve të cilat janë me leje ndërtimi, nëse e zbatojnë me përpikmëri projektin e ndërtimit të miratuar nga Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Lezhë.

- Të kërkuar në çdo rast që konstatohet shmangie nga projekti i miratuar, përveç ndëshkimit me masë administrative, heqjen e licencës profesionale për personat përgjegjës, sipas parashikimeve ligjore, me qëllim forcimin e masave për kontrollin e territorit dhe mbrojtjen e tij nga ndërhyrjet abuzive.

- Të aplikojë të gjitha masat administrative për kundërvajtjet e konstatuara për ndërtimet pa leje ose në shkelje të lejes, duke aplikuar në çdo rast vendimet përkatëse të gjobave, të pezullimit dhe të prishjes së ndërtimeve.

- Në bashkëpunim me Policinë Bashkiake, të marrë masa që të zbatojë vendimet e prishjes së objekteve për rastet e ndërtimeve të paligjshme (pa leje ndërtimi), ndaj të cilave është mbajtur procesverbal prishje objekti. Gjithashtu, të marrë masa për sigurimin e infrastrukturës dhe mjeteve të nevojshme për të bërë të mundur ekzekutimin e vendimeve për prishjen e ndërtimeve pa leje.

Menjëherë dhe në vëmendje

17. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi mbi realizimin e të ardhurave të institucionit, nga vendosja dhe arkëtimi i gjobave të Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Lezhë për periudhën 01.01.2022 deri më 31.12.2022, u konstatua se niveli i arkëtimeve është i ulët, IVMT dhe Bashkia nuk kanë marrë të gjitha masat për arkëtimin e këtyre gjobave. Vlera totale e gjobave të vendosura është 10,700,000 lekë, janë arkëtuar 2 gjoba në vlerën 200,000 lekë dhe janë të pa arkëtuara 12 gjoba në vlerën 10,500,000 lekë, duke sjellë për pasojë krijimin e të ardhurave të munguara për buxhetin e Bashkisë në vlerën prej 10,500,000 lekë.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me Ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar; Ligjin nr. 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar; VKM-në nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati kombëtar i mbrojtjes së territorit dhe ai i njësisë vendore”, Ligjin nr. 10 279, datë 20.5.2010 "Për Kundërvajtjet Administrative" (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 141-153, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

17.1 Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të ndjekin procedurat gjyqësore që kanë ndërmarrë kundër kundërvajtësve që nuk kanë paguar në mënyrë vullnetare gjobat e vendosura nga IMTV, për vlerën totale **10,500,000 lekë**.

IMT të ndjekë me vëmendje të gjitha rastet që nuk e paguajnë gjobën brenda afatit, duke i dërguar menjëherë në gjykatë për të nxjerrë titullin ekzekutiv si dhe të llogarisë kamatë vonesën përkatëse referuar kuadrit ligjor në fuqi.

Menjëherë dhe në vëmendje

18. Gjetje nga auditimi: Në 3 (tre) raste, nga auditimi mbi përputhshmërinë e dispozitave ligjore për realizimin e procedurave të prokurimit të blerjeve të vogla me vlerë kontrate 1,651,771 lekë pa TVSH, në Bashkinë Lezhë, u konstatua se:

- në 1(një) procedurë prokurimi evidentohet se kriteret për shpalljen e ofertës fituese dhe specifikimet teknike, nuk janë të argumentuara teknikisht me natyrën e objektit të prokurimit, dhe të padokumentuara saktë në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.

-Dosjet e procedurave të prokurimit të audituara nuk janë inventarizuar dhe arkivuar me numër fletësh, duke sjellë pasiguri në plotësinë dhe administrimin e dokumentacionit të prokurimeve, veprim ky në kundërshtim me nenin 36 “Arkivat e numerizuara”, të ligjit nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për Arkivat” dhe nenet 3, 29 të “Normave Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”; Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 83-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

18.1 Rekomandimi: Bashkia Lezhë në cilësinë e Autoritetit Kontraktor të marrë masa për:

- Hartimin e argumentuar teknikisht që lidhen me natyrën e objektit që prokurohet, në harmoni me specifikimeve teknike dhe kriterëve për shpalljen e ofertës fituese, si dhe të dokumentohet në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre;

- Inventarizimin dhe arkivimin e dosjeve të procedurave të prokurimit, në përputhje me kuadrin rregullator në fuqi.

Menjëherë dhe në vijmësi

19. Gjetje nga auditimi: Në përfundim të procesit të auditimit në lidhje me 3 (tre) procedurat e prokurimit të marra me zgjedhje, dhe të realizuara me “vlerë e vogël” u konstatua se nuk është kërkuar deklaratë e konfliktit të interesit të OE shpallur fitues si dhe nuk është kërkuar deklaratë mbi gjendjen gjyqësore.

Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme bien në kundërshtim me përcaktimet e bëra në Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”; VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar, për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”; Ligjin nr.9154, datë 6.11.2003 “Për Arkivat”; Norma Teknike Profesionale dhe Metodologjisë të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 83-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

19.1 Rekomandimi: Drejtoria e Prokurimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, në zhvillimin e procedurave me vlerë të vogël të marrë masa që në hartimin e specifikimeve teknike në ftesën për ofertë të kërkojë deklaratën e konfliktit të interesit dhe deklaratën mbi gjendjen gjyqësore të OE shpallur fitues, si dhe të dokumentohet deklaratat e konfliktit të interesit nga komisioni i prokurimit me vlerë të vogël.

Menjëherë dhe në vijmësi

20. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 6 raste u konstatuan mangësi që lidhen me hartimin e kriterëve për kualifikim, të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe objektin e prokurimit, apo të paargumentuara teknikisht, veprime jo në përputhje me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 83-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

20.1. Rekomandim: Drejtoria e Prokurimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme që në procedurat e prokurimit publik, kriteret e veçanta të kualifikimit të hartohen në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës që prokurohet.

Menjëherë dhe në vijmësi

21. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi me përzgjedhje i 8 procedurave të prokurimit publik, të zhvilluara përgjatë periudhës 01.01.2022-31.12.2022, në 4 raste në vlerën totale të fondit limit prej 139,427,639 lekë, u konstatua se kualifikimi i OE të shpallur fitues është bërë në kushtet e mospërmbushjes të disa kriterëve të veçanta të kualifikimit të përcaktuara në DST, kriteret që nuk lidhen me natyrën e plotë të objektit të kontratës, veprime këto në mospërputhje të plotë me Ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe VKM-në nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 83-125, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

21.1. Rekomandimi: Drejtoria e Prokurimeve, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masa për eliminimin e praktikave të tilla, të vlerësohen objektivisht kriteret e DT të miratuara nga AK, duke konsideruar faktin se kualifikimi i OE që nuk plotësojnë kriteret e vendosura në DT, përbën shkelje të procedurave të prokurimit publik dhe risk real për mosrealizimin me sukses të kontratës.

Menjëherë dhe në vijmësi

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Bazuar në ligjin nr. 154, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit” neni 15 shkronja (b) dhe (c) -Të drejtat e KLSH, dhe mbështetur në nenet 98-102, të ligjit nr. 44, datë 30.04.2015 “Kodi i procedurave administrative në Republikën e Shqipërisë”, nenet 21-33, të ligjit nr. 139, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nga **Titullari i njësisë publike**, të nxirren aktet administrative përkatëse dhe të kërkohet në rrugë ligjore (Padi Gjyqësore), duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjyqimit, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit. Nëpunësi zbatues të ndjekë procesin me qëllim shpërblimin e dëmit në vlerën **3,776,085 lekë pa TVSH**, si më poshtë:

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike në kuadër të rindërtimit me objekt: “Riforcimi dhe Rikonstruksioni i Bibliotekës “Gjergj Fishta” dhe Pallati i Kulturës “Dedë Ndue Lazri”, me vlerë 236,725,554 lekë pa TVSH, realizuar nga shoqëria “J ” SHPK , rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në përputhje me specifikimet teknike, në vlerën **464,289** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 18530/2 prot., datë 21.01.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe shoqërisë “J ” SHPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 125-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **464,289 lekë** pa TVSh nga shoqëria zbatuese “J ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 18530/2 prot., datë 21.01.2022, si pasojë e realizimit të punimeve të kryera jo në përputhje me Specifikimet Teknik dhe kosto më të vogël se çmimi ofertues.

Brenda datës 30.06.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike në kuadër të rindërtimit me objekt: “Sistemimi dhe asfaltimi i rrugëve rurale dhe urbane në territorin e Bashkisë Lezhë”, me vlerë 151,802,481.06 lekë pa TVSH, realizuar nga shoqëria “U ” SHPK , rezultuan punime ndërtimi të kryera jo në volumet e situacionuara si dhe, punime të kryera pa cilësi të mirë, në vlerën **434,804** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 17043/3 prot., datë 21.10.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe shoqërisë “J ” SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 125-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

2.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **434,804** lekë pa TVSh nga shoqëria zbatuese “U ” SHPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 17043/3 prot., datë 21.10.2022, si pasojë e realizimit të punimeve të kryera jo në volumet e situacionuara si dhe, punime të kryera pa cilësi.

Brenda datës 30.06.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike në kuadër të rindërtimit me objekt: “Rikonstruksioni i mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në territorin e Bashkinë Lezhë Loti II”, me vlerë 92,410,112 lekë pa TVSH, realizuar nga shoqëria JV “R ” & “D ” SHPK, u konstatuan punime ndërtimi të kryera jo në volumet e situacionuara, në vlerën **529,200** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 7534/21 prot., datë 14.06.2021 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe shoqërisë JV “R ” & “D ” SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 125-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

3.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **529,200** lekë pa TVSh nga shoqëria zbatuese BOE “R ” & “D ” SHPK , në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 7534/21 prot., datë 14.06.2021, si pasojë e realizimit të punimeve të kryera jo në volumet e situacionuara dhe, jo në përputhje me specifikimet teknike.

Brenda datës 30.06.2024

4. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve të ndërtimit të kontratës për punë publike në kuadër të rindërtimit me objekt: “Rikonstruksionin e mjediseve në bashkëpronësi ose të përbashkëta në ndërtesat pallat, të prekura nga tërmeti i datës 26.11.2019, në Bashkinë Lezhë”, me vlerë 236,725,554 lekë pa TVSH, realizuar nga shoqëria JV “U & N ” SHPK, u konstatuan punime ndërtimi të kryera jo në volumet e situacionuara, në vlerën **484,326** lekë pa TVSH. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimi”, i ndryshuar, Kreu III, neni 7 dhe neni 12 si dhe, kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 23034/22 prot., datë 18.02.2022 të lidhur ndërmjet Autoritetit Kontraktor Bashkisë Lezhë dhe shoqërisë JV “U & N ” SHPK *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 125-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit)*.

4.1. Rekomandimi: Titullari i Bashkisë Lezhë në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike të marrin të gjitha masat duke ndjekur të gjitha rrugët ligjore në të gjitha shkallët për arkëtimin e dëmit në vlerën **484,326** lekë pa TVSh nga shoqëria zbatuese JV “U & N ” SHPK, në cilësinë

e sipërmarrësit në kontratën me nr. 23034/22 prot., datë 18.02.2022, si pasojë e realizimit të punimeve jo në volumet e situacionuara dhe, jo në përputhje me specifikimet teknike.

Brenda datës 30.06.2024

5. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rindërtimi i konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë, me vlerë të kontratës (pa tvsh) 151,500,000 lekë pa TVSH, fituar nga BOE “G ” SHPK & “E ” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 1,662,032 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 23131/24 prot., datë 31.03.2021, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lezhë dhe BOE “G ” SHPK & “E ” ShPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 125-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

5.1 Rekomandim: Nga Bashkia Lezhë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **1,662,032 lekë pa tvsh** nga BOE “G ” SHPK & “E ” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 23131/24 prot., datë 31.03.2021, me objekt “Rindërtimi i konviktit të shkollës së mesme profesionale “Kolin Gjoka”, Bashkia Lezhë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të punimeve civile të kontratës me objekt “Rehabilitimi i murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë”, Bashkia Lezhë, me vlerë të kontratës (pa tvsh) 22,363,882.38 lekë me TVSH, fituar nga BOE “Z ShPK & “A CO” ShPK, rezultuan diferenca në volume pune të pakryera në fakt në vlerën 201,434 lekë pa tvsh. Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me kontratën e sipërmarrjes së punimeve nr. 14300/12 prot., datë 29.09.2022, të lidhur mes Autoritetit Kontraktor Bashkia Lezhë dhe BOE “Z ShPK & “A CO” ShPK (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4.1 faqe 125-141 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

6.1 Rekomandim: Nga Bashkia Lezhë të merren masa për arkëtimin e vlerës prej **201,434 lekë pa tvsh** nga BOE “Z ShPK & “A CO” ShPK, në cilësinë e sipërmarrësit në kontratën me nr. 14300/12 prot., datë 29.09.2022, me objekt “Rehabilitimi i murit mbajtës në rrugën e Spitalit Rajonal Lezhë”, Bashkia Lezhë, vlerë që përfaqëson dëm ekonomik ndaj buxhetit të shtetit dhe njësisë vendore, si pasojë e likuidimit të punimeve të pakryera.

Brenda datës 30.06.2024

D. MASA PËR ARKËTIMIN E DETYRIMEVE PËR TATIM TAKSAT VENDORE, PËRFSHIRË DHE DETYRIMET NGA QIRADHËNIA.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit lidhur me borxhit tatimor, sipas të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore, rezulton se ecuria e debitorëve përgjatë periudhës së vitit 2022, për tarifën e pastrimit, ndriçimit, taksën e ndërtesës, truallit, reklamës, tabelës, zënies së hapësirës publike, në mënyrë të përmbledhur pasqyrohet si më poshtë:

-Debia progresive më 31.12.2021 për Biznezin e madh, Biznezin e vogël, institucione dhe pronarë është 242,692,879 lekë.

-Debia e krijuar gjatë vitit 2022 për Biznezin e madh, Biznezin e vogël, institucione dhe pronarë është 3,648,941 lekë.

-Debia më 31.12.2022 për Bisnezin e madh , Bisnezin e vogël, institucione dhe pronarë është 246,341,820 lekë.

-*Borxhi progresiv është dërguar pranë drejtorisë së financës me shkresën nr. 2964 prot., datë 13.03.2023 për vlerën 246,341,820 lekë.*

Nga të dhënat e vendosura në dispozicion rezultojnë se Drejtoria e Taksave dhe e Tarifave Vendore për vitin 2022, ka marrë masa vetëm lidhur me “Njoftim dhe kërkesë për pagesë debie” dhe “Bllokimi i llogarive bankare” dhe si rezultat është mbledhur borxhi për vlerën 16,564,420 lekë. Duke iu referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë së Taksave dhe Tarifave Vendore rezultoi se, për më tej nuk është vazhduar për marrjen e masave të tjera shtrënguese si bllokimi i aktivitetit të biznesit, sekuestron e mallrave të debitorëve deri në kallëzim penal.

Këto veprime, janë në kundërshtim me Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2018, i ndryshuar, Kreu IX “Pagesa dhe rimbursim i tatimit”, Neni 74, “Afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor”, neni 89-“Njoftimi dhe kërkesa për pagim të detyrimeve”, neni 90-“Urdhër bllokimet”, neni 92-“Masa për sigurimin e detyrimit tatimor”, neni 93-“Sekuestro dhe konfiskim i pasurisë” dhe neni 94-“Urdhër sekuestrimi”, nuk gjen zbatim në asnjë moment, duke parë që një pjesë e subjekteve janë debitorë nga njëra periudhë në tjetër (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave, Bashkia Lezhë, të nxjerrë aktet administrative përkatëse dhe të kërkojë në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, me qëllim arkëtimin e vlerës së debitorëve të paarkëtuar për taksat/tarifat vendore në fund të vitit 2022 në vlerën **246,341,820 lekë**, si më poshtë vijon:

a-T’u dërgohen bankave të nivelit të dytë urdhër bllokimet e llogarive bankare.

b-Të dërgohet në Drejtorinë Rajonale të Transportit, kërkesa për vendosjen e barrës siguroese (për mjetet) dhe në ASHK (për pasuritë e paluajtshme),.

c-Në funksion të mbledhjes së detyrimit të papaguar, Drejtoria e të Ardhurave, Licensave dhe Lejeve, Bashkia Selenicë, të angazhojë strukturat e saj për të verifikuar dhe monitoruar në vend aktivitetin tregtar të tatim paguesit, me qëllim konfiskimin në fund të çdo dite të një shume jo më pak se 50 % të qarkullimit të realizuar.

d- Nëse edhe pas njoftimeve zyrtare subjektet, nuk pranojnë të paguajnë detyrimet, në vite nga ana e Sektori i Taksave dhe Tarifave dhe Sektori Juridik, të marrin masa administrative apo sekuestro dhe pas marrjes së këtyre masave të bëhet kallëzim penal.

f- Të hapen regjistrat e debitorëve, ku të evidentohen vlera e detyrimit të paarkëtuar, statusi i tyre dhe hapat e ndërmarra për çdo subjekt në zbatim të Ligjit për arkëtimin e debitorëve.

g- Të bëhet llogaritja e saktë e kamatëvonesave për të gjithë subjektet të cilat nuk likuidojnë në afat detyrimet sipas njoftim detyrimit nga momenti i lindjes deri në datën e pagesës së detyrimit.

Brenda datës 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Bashkia Lezhë, për mbledhjen e detyrimeve për Taksën e ndërtesës dhe tarifë pastrimi-gjelbërim-ndriçimi për abonentët familjarë e realizon nëpërmjet agjentit tatimor që në rastin konkret është UK Sha Lezhë në bazë të VKB nr. 157 prot., datë 17.11.2021 “Për miratimin e nivelit të taksave dhe tarifave vendore, lehtësirat fiskale, strukturat e vjeljes së tyre dhe ato të vendosjes së penalteteve ndaj kundërvajtësve”, i ndryshuar, Pika III. Nga Bashkia Lezhë është lidhur akt-marrëveshje me nr. 6494 prot., datë 16.07.2018 Agjentin tatimor UK sha.

Në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, u konstatua se Bashkia Lezhë nuk ka regjistër të familjeve me të dhënat sa është numri i familjeve gjithsej për sipërfaqet e banimit, që ka secila familje dhe se kujt viteve i përket, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave; nuk plotësohet njoftim detyrimi për familjet që nuk kanë kontratë me UK sha Lezhë për taksën e ndërtesës, tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Debitorë për taksën e ndërtesës dhe tarifën e shërbimit (Pastrim-Gjelbërim-Ndriçim) për vitin 2022 janë 1,650 familje në vlerën 7,675,528 lekë. Nga të dhënat e Drejtorisë së Taksave dhe tarifave Vendore dhe Drejtorisë së Financës dhe Buxhetit për vitin 2022, Bashkia Lezhë nuk

ka planifikuar dhe realizuar të ardhura nga Taksa e ndërtesës dhe Tarifa e shërbimit (pastrim-gjelbërim-ndriçimit) për abonentët familjarë, të cilët nuk kanë kontratë shërbimi për furnizimin me ujë të pijshëm me UK Sh. A Lezhë.

Për vitin 2022 pranë Njësive administrative kemi një numër prej 16,886 familje të cilat taksohen. Konstatohet se nga ana e Sektorit të Taksave dhe Tarifave Vendore nuk është krijuar regjistri i taksave vendore dhe tatimpaguesve.

Debia progresive me 31.12.2021 është 36,453,798 lekë për 2241 familjarë.

Familje debitorë të cilët janë krijuar gjatë vitit 2022 janë në vlerën 7,675,258 lekë.

Debi progresive deri me 31.12.2022 është në vlerën 44,129,056 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë.

Vlera e debive i referohet 7 Njësive Administrative sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Drejtorisë të Ardhurave. Përsa i përket NJA Shënkoll, Ungrej dhe Kolsh faturimet dhe arkëtimet janë kryer vetëm në rastet, kur familjarët janë paraqitur pranë NJA-ve dhe si pasojë e këtij veprimi nuk identifikohen debitorë.

Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me pikën 7 të nenit 4, të Ligjit nr. 9632, datë 30/10/2006 i ndryshuar, dhe nenin 70, të ligjit nr. 9920, datë 19/5/2008, i ndryshuar, me VKB nr. 157, datë 17.11.202021 “Pika A.2.a.5. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-70 të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1. Rekomandimi: Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore në bashkëpunim me Administratorët e Njësive Administrative, Bashkia Lezhë, të marrë masa për ngritjen e grupit të punës, për evidentimin e abonentëve familjarë, ndaj të cilëve nuk janë aplikuar detyrimet për taksat e tarifave vendore. Të hartojë regjistrin përkatës me të dhënat dokumentare e të evidentuara në terren, të kryejë njoftimet për familjet taksapaguese si dhe të ndjekë të gjitha procedurat e nevojshme administrative për arkëtimin e të ardhurave nga taksa e ndërtesës e tarifës së pastrim-gjelbërim-ndriçimit. Gjithashtu Bashkia Lezhë të bashkëpunojë me UK sha për arkëtimin e vlerës debitorë prej **44,129,056 lekë** dhe nëse ka shmangie në lidhje me ndjekjen dhe mos arkëtim të detyrimeve për taksën e ndërtesës dhe tarifën e pastrim-gjelbërim-ndriçimit të aplikohet masë administrative këtij agjenti tatimor.

Brenda datës 31.12.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban, rezulton se janë lidhur 95 kontrata për shfrytëzimin e plazheve nga Bashkia Lezhë për një periudhë nga 1-5 vjet, nga të cilat 49 subjekte janë të vitit 2022, pasqyruar në anekset nr. 4 dhe aneksin nr.5 bashkangjitur Raportit Përfundimtar të Auditimit. Nga këto 49 subjekte, konstatohet se 9 subjekte kanë lidhur kontratë me Bashkinë Lezhë dhe nuk kanë respektuar detyrimin sipas kontratës në vlerën 3,952,850 lekë, vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë. Këto veprime janë në kundërshtim me VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019, “Për miratimin e rregullores për kushtet dhe kriteret e ushtrimit të veprimtarisë së stacionit të plazhit”, Neni 10.

-Nga auditimi i dosjeve të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban u konstatua se në asnjë nga dosjet e audituara për vitin 2022 nuk është depozituar marrëveshja e noterizuar me vrojtuesit e plazhit e vlefshme kjo për gjithë kohën e shfrytëzimit, veprime këto në kundërshtim me VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019 “, i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24/12/2022.

-Të gjitha dosjet nuk kishin të depozituar kopjen e kontratës së lidhur ndërmjet AKB-së, subjektit posedues të plazhit dhe Bashkia Lezhë.

- Mos depozitimi në dosje i vërtetimit mbi pagesën e taksave lokale nga DAV Bashkia Lezhë dhe detyrimeve fiskale nga DPTR Lezhë ose tjera, si dhe vërtetimi që nuk është në ndjekje penale, në kundërshtim me shkronja (d,dh) të pikës 3 e nenit 5 të VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019 i ndryshuar.

-Mungon procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar, në kundërshtim me VKM nr. 171/2019, datë 27/03/2019, i ndryshuar me VKM nr. 1172, datë 24/12/2022.

-Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit dhe Zhvillimit Urban nuk janë kryer rakordimet me Degën e Financës, nuk janë evidentuar subjektet debitorë për çdo fund viti, nuk janë mbajtur aktrakordimet me DAV për pagesat e kryera nga subjektet dhe detyrimet, veprimet në kundërshtim me U.M.F nr.30, datë 27.12.2011”. Kreu III. pikat 34, 35 dhe 36.

Nga auditimi u konstatua se nga ana e inspektorëve të kontrollit në terren nuk dokumentohet asnjë akt-konstatimi i mbajtur, lidhur me matjen e sipërfaqes dhe vendosjen e penalteteve përkatëse, sikurse përcaktohet në VKB-në nr. 157, datë 17.11.2021 pika B.2.6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2.6, faqe 28-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lezhë, në bashkëpunim me Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të Plazhit, të marrë masa duke ndjekur të gjitha procedurat administrative e ligjore në arkëtimin e vlerës **3,952,850 lekë për 9 subjekte** të përcaktuar në pikën 2.2.6 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

3.2. Rekomandimi: Drejtoria e të Ardhurave Vendore Bashkia Lezhë, në bashkëpunim me Strukturën Përgjegjëse të Menaxhimit të Stacioneve të Plazhit, të marrë masa për:

- Nënshkrimin e të gjitha kontratave të miratuara nga AKB për sipërfaqen që subjektet kërkojnë, por gjithmonë sipërfaqja nuk duhet të jetë më e madhe se sipërfaqja e miratuar nga AKB.

- Në çdo dosje duhet të jenë të depozituara vërtetimi mbi pagesën e taksave (vendore dhe të përgjithshme), planvendosjen mbi madhësinë e parcelës dhe pozicionimin e çadrave me largësi të barazlaguara ndërmjet njëra tjetrës dhe bregut, aktkontrollat për verifikimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme dhe respektimin e 20% të plazheve publike, dokumenti mbi detyrimin për plotësimin e masave të sigurisë dhe të kushteve të higjienës, si dhe harta me treguesit kryesorë për sipërfaqen e kontraktuar, marrëveshja e noterizuar me vrojtuesit e plazhit e vlefshme kjo për gjithë kohën e shfrytëzimit, si dhe procesverbali mbi dorëzimin e sipërfaqes së kontraktuar.

- Plotësimin e dosjes me dokumentacionin e plotë ligjor.

Menjëherë

D.1 MASA PËR ELIMIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE NË MENAXHIMIN E TË ARDHURAVE NGA TAKSAT E TARIFAT VENDORE, ME EFEKT MUNGESË TË ARDHURASH.

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i kontratave të qerasë në Bashkinë Lezhë në bazë të VKM nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në VKM nr.391, datë 21.06.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", rezultoi se nga Bashkia Lezhë janë dhënë 3 kontrata, nga të cilat 2 kontrata për vitin 2021 dhe 1 kontratë për vitin 2022. Për kontratën me numër 2733/2 prot., datë 19.04.2022 është aplikuar tarifa referuar VKM. nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në VKM nr.391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave", tabela nr 9. Objekti kontratës është vendosje anemometri për matjen e erës. Njësia e administrimit të pyjeve i është referuar veprimtarisë për kryerjen e operacioneve të kërkim-zbulimit hidrokarbure, gjeologjike e minerare, uji, vendosje objektësh të ndryshme ndihmëse në sipërfaqe. Nga ana e strukturave të Bashkisë Lezhë, konkretisht Drejtoria e Bujqësisë, nuk argumentohet fakti, pse janë referuar tabelës/lidhjes nr. 9 bashkëlidhur VKM. nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006. Sipas objektit të kontratës nga ana e strukturave të Bashkisë Lezhë duhej aplikuar tarifa sipas tabelës 8 të VKM nr.1064, datë 22.12.2010 "Për disa ndryshime në VKM nr.391, datë 21.6.2006 "Për përcaktimin e tarifave në sektorin e pyjeve dhe të kullotave" ku përcaktohet veprimtaria "Për ndërtim teleferik pasagjerësh ose linje të tensionit, aerogjeneratorë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj." Në tabelën

numër 8 niveli i tarifës është i përcaktuar. Tarifa sipas kohëzgjatjes së kontratës lek/ha/vit 2-5 vjet është 150,000 lekë. Subjekti K. O. A. ka paguar vetëm për kontratën nr.273/2 prot., datë 19.04.2022 për vlerën 275,600 lekë, ndërkohë që duhej të paguante 422,000 lekë duke sjellë një vlerë debitore prej 146,400 lekë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë.

Duke iu referuar subjekteve të nxjerra nga regjistri i lejeve minerare, konstatohet se në territorin e Bashkisë Lezhë ushtrojnë aktivitetin e tyre 7 (shtatë) subjekte me veprimtari gurë gëlqeror, argjilë etj. Nga auditimi i dokumentacionit vënë në dispozicion nga Njësia e Administrimit të Pyjeve, konstatohet se për subjektet të cilët janë nxjerrë nga regjistri i lejeve minerare, nuk është lidhur kontratë qiraje për dhënien në përdorim të fondit pyjor/kullosor kombëtar.

-Këto veprime janë në kundërshtime VKM nr.1064, datë 22.12.2010 për disa ndryshime në vendimin nr.391, datë 21.6.2006 (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

1.1.Rekomandimi: Nga ana e sektorit të pyjeve të rishikohet llogaritja e kontratës me nr.273/2 prot., datë 19.04.2022, me qëllim saktësimin e vlerës së qerasë dhe arkëtimin e vlerës prej **146,400 lekë** ndaj subjektit “K”. Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave, të marrë masa për monitorimin e kushteve të kontratave të qiramarrësve, duke e dokumentuar këtë proces, si dhe të veprojë në kohë ndaj të gjithë qiramarrësve që nuk respektojnë përcaktimet në kontratë. Gjithashtu në bashkëpunim me Policinë e Bashkisë dhe Inspektoriatin Vendor të Mbrojtjes së Territorit (IVMT), nuk duhet të lejojë që në territorin e saj të përdoren sipërfaqe pyjore/kullosore pa kontratë me bashkinë.

1.2. Rekomandimi: Drejtoria e Zhvillimit të Bujqësisë dhe Administrimit të Pyjeve/Kullotave Bashkia Lezhë, të marrë masa që për subjektet të cilat janë pajisur me leje shfrytëzimi nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), të hartojë raporte teknike për saktësimin e sipërfaqeve të shfrytëzueshme, të bëjë përditësimin në kadastrën e pyjeve në sipërfaqe dhe vëllim, ku për sipërfaqet e pazbritura nga fondi pyjor, t’i drejtohet subjekteve me leje minerale të bëjë kërkesën për zbritje nga fondi pyjor.

Brenda datës 31.12.2024

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit për taksën e lëshimit të Autorizimeve/Licencave për subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatet e tyre, që operojnë në territorin nën juridiksionin e Bashkisë Lezhë, rezultoi se për periudhën e vitit 2022 ushtrojnë veprimtarin e tyre 13 subjekte. Konstatohet se kemi të bëjmë më 4 (katër) raste të subjekteve të cilët nuk janë të pajisur me licencat përkatëse dhe nuk kanë kryer pagesën.

Për subjektet K me adresë Balldre Lezhë me NIPT J....P, K me adresë Blinisht Lezhë me NIPT J....P, subjektin Prelashi me adresë Zejmen Lezhë me NIPT K....P, subjektin Rombe me adresë Lezhë –Tiranë km2 me NIPT L....Q, nuk rezulton të jenë pajisur me licencat përkatëse si dhe të kenë paguar detyrimin.

Detyrimi nga mos pagesa e autorizimit për subjektet është në vlerën 2,400,000 lekë vlerë e cila përbën të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë.

Nga strukturat e Bashkisë Lezhë nuk është vazhduar ndjekja e procedurave në inspektoriatin Shtetëror Teknik dhe Industrial dhe në Institucionet e tjera përkatëse deri në bllokimin e veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë pa liçencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të hidrokarbureve.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Ligjin nr. 71/2014 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999, “Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre”, i ndryshuar, neni 4, neni 20/pika 2 dhe VKM nr. 344, datë 19.04.2017 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 970, datë 2.12.2015, të këshillit të ministrave, “Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave

për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj” neni 15.1 dhe 15.2. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

2.1.Rekomandimi: Nga ana e strukturave të Bashkisë Lezhë drejtoria e Shërbimeve të merren masa për pajisjen me licencë për subjektet të cilët operojnë në territorin e Bashkisë. Të kërkohet arkëtimi për vlerën prej 2,400,000 lekë të krijuar nga 4 (Katër) subjekte si rezultat i mos aplikimit të tarifës për rinovim licence/autorizimi të subjekteve që ushtrojnë aktivitetet të shitjes me pakicë të hidrokarbureve dhe nënprodukteve të tyre. Përkatësisht subjektet si vijojnë:

- Subjekti Prelashi për vlerën 400,000 lekë.
- Subjekti Romebe për vlerën 600,000 lekë.
- K Blinisht –Lezhë për vlerën 600,000 lekë.
- K Balldre për vlerën 800,000 lekë.

Brenda datës 30.06.2024

3. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i procedurave të ndjekura për arkëtimin e gjobave të vendosura nga Policia Bashkiake, u konstatua se deri më datë 31.12.2022 në mënyrë progresive janë krijuar të ardhura të munguara për buxhetin e Bashkisë Lezhë në vlerën 103,000 lekë, nga të cilat në vitin 2022, nga 623 gjoba gjithsej, nuk janë paguar 4 gjoba në vlerën 63,000 lekë. Për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura për gjobat e Policisë Bashkiake, konstatohet se nuk janë marrë masat përkatëse, gjithashtu nuk janë të kontabilizuara. Nuk rezulton në asnjë rast të jetë bërë kërkesë për titull ekzekutiv ashtu sikurse përcaktohet në pikën 10 të ligjit nr. 10279 datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).

3.1.Rekomandimi: Drejtoria e Financës, në bashkëpunim me Drejtorinë Juridike, të marrë masat e nevojshme duke ndjekur të gjitha rrugët administrative dhe ligjore për arkëtimin e vlerës **103,000 lekë**, si rrjedhojë e gjobave të vendosura.

Brenda datës 30.06.2024

E. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit mbi vendimet gjyqësore, u konstatua se në fund të periudhës ushtrimore 2021 detyrimi i prapambetur është në vlerën 1,022,164 lekë. Përsa i përket vitit 2022 referuar të dhënave të vendosura në dispozicion nga Drejtoria e Financës nuk është parashikuar likuidimi i detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore. Vlera e paguar gjatë vitit 2022 për detyrimin e prapambetur për vendimet gjyqësore rezulton të jetë në vlerën 1,022,164 lekë vlerë, e trashëguar nga vitet e mëparshme. Konstatohet se disa nga vendimet gjyqësore që nuk janë pasqyruar si vlerë e detyrimeve të trashëguara të pa paguara më 31.12.2022, janë si më poshtë:

- Vendimi nr.345 prot ., datë 15.09.2022 në vlerën 1,966,120 lekë për ndërprerje të marrëdhënieve të punës;
- Vendimi me nr. 346. Prot datë 15.09.2022 për vlerën 843,960 lekë për ndërprerje të marrëdhënieve të punës;
- Vendim nr.720/53 dt. 27.11.2018, kësti 6 -V.GJ 2,272,457 lekë.

Këto detyrime nga vendimet gjyqësore, janë paguar në vitin 2023 në vlerën 5,082,537 lekë, për llogari të vitit 2022.

Nga auditimi konstatohet se në total kemi të bëjmë më një detyrim në fund të vitit 2022 në vlerën 14,172,364 lekë, e cila nuk është e raportuar si detyrim i prapambetur nga vendimet gjyqësore, nga të cilat 2,810,080 lekë janë nga vendime gjyqësore për ndërprerje të marrëdhënieve të punës dhe 11,362,284 lekë për çështje të tjera të ndryshme.

Këto veprime janë në kundërshtim me me pikën 8 dhe Pikën 60 e Udhëzimit nr. 9, datë 20.03.2018 “Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimin nr. 1, datë 04.06.2014 “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit”. Udhëzimin e MFE nr. 37, datë 06.10.2020 “Për monitorimin dhe publikimin periodik të stokut të detyrimeve të prapambetura të qeverisjes së përgjithshme”. Udhëzimi nr. 5, datë 21.02.2022 “Për disa ndryshime në Udhëzimin nr. 8, datë 09.03.2018 “Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme”, i ndryshuar (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 28-70, të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

1.1.Rekomandimi: Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Financës, Bashkia Lezhë, të analizojnë të gjitha rastet e vendimeve gjyqësore që do të zbatohë, me qëllim përcaktimin e shkaqeve që kanë sjellë humbjen e çështjes gjyqësore. Rezultatet e analizës të shërbejnë për shmangien në të ardhmen të procedurave të gabuara të ndjekura për çështjen e largimit të punonjësve nga puna dhe çështje të tjera, me qëllim uljen e efekteve negative financiare në buxhet.

Përgjatë zbatimit të buxhetit të vitit 2024 dhe në

vijimësi

2. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i 8 procedurave të prokurimit publik për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 për punë publike, mallra dhe shërbime, në 1 rast u konstatua përlllogaritje e gabuar e fondit limit në vlerën **312,110** lekë më shumë për vendosje të çmimit jo sipas manualin në fuqi të çmimeve të punimeve të ndërtimit, veprime jo në përputhje me VKM nr. 629, datë 15.7.2015 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre” (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4., faqe 83-125 të Raportit Përfundimtar të Auditimit*).

2.1. Rekomandim: Drejtoria e Prokurimeve në bashkëpunim me Sektorin e Investimeve, të analizojnë dhe të nxjerrin përgjegjësitë për rastet e përlllogaritjes së fondit limit në mospërputhje me legjislacionin e punimeve të ndërtimit dhe të marrë masat e nevojshme për mospërsëritjen e tyre në të ardhmen, me qëllim shmangien e keqpërdorimit me ekonomikitet të fondeve të Bashkisë Lezhë për vlerën **312,110** lekë.

Menjëherë dhe në vijimësi

F. MASA DISIPLINORE.

Referuar shkeljeve të konstatuara:

- Në fushën e prokurimeve publike, të ligjit nr. 162/2020, “Për prokurimin publik”, si dhe përgjegjësitë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në dokumentet e auditimit, vërejtjeve dhe komentet e subjektit të audituar trajtuar në Raportin Përfundimtar të Auditimit, të ligjit nr. 10279, datë 20.5.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

- Në mos marrjen së masave për realizimin e të ardhurave nga arkëtimi i tarifave vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, Kreut VII, nenit 35, ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, neni 43 pika 1/1 dhe Udhëzimit nr.24, datë 02.09.2008 i ndryshuar, neni 43/1.

- Në mos marrjen e masave për uljen e borxhit tatimor duke rritur performancën në arkëtimin e detyrimeve për Tatim Taksat Vendore, veprime dhe mosveprime këto në kundërshtim me ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

